

# mediaprint

FAQJA KRYESORE

fillo këtu

RRETH NESH

profili i kompanisë

SHTËPIA BOTUESE

librat tanë

SHTYPSHKRONJA

teknologjia më e fundit




## www.mediaprint.al

KLKONI KËTU

Librat e mësuesit dhe planet mësimore  
për të gjithë titujt që ne disponojmë,  
mund t'i gjeni dhe t'i shkarkoni  
pa pagesë nga faqja e internetit  
**www.mediaprint.al**

Për më shumë informacion  
mund të na shkruani në adresën e emailit:  
**botime@mediaprint.al**

ose të na kontaktoni pranë redaksisë  
në numrin e telefonit:  
**042251614**





Mimoza Verzivoli

Etleva Doka

# LIBËR MËSUESI

## GJUHA SHQIPE

10

Titulli:

**Libër mësuesi Gjuha Shqipe 10**

Autor: **Mimoza Verzivolli**

**Etleva Doka**

Drejtuese botimi: **Anila Bisha**

Redaktore: **Zenaida Agastra**

Dizajn: **Mirela Ndrira**

Kopertina: **Arben Hamzallari**

Shtëpia Botuese Mediaprint

ISBN:

Botimi i parë 2016

Shtypi: Shtypshkronja Mediaprint

## *Hyrje*

Libri i mësuesit, në mbështetje të tekstit të nxënësit për lëndën e gjuhës shqipe 10, është konceptuar si një tekst udhëzues në përdorim të mësuesve që do të zhvillojnë këtë lëndë në klasën e dhjetë.

Libri përmban planifikimin e orëve vjetore (planin vjetor), planin tremujor, si dhe orët e zhvilluara mësimore për çdo temë.

Gjatë planifikimit të orëve vjetore janë mbajtur parasysh udhëzimet e përfshira në programin lëndor, të miratuar nga MAS-i, material i cili përfshihet në këtë tekst, duke qenë se mësuesi ka pavarësinë e tij në trajtimin e lëndës dhe, në këto kushte, programi me kompetencat kyç dhe me kompetencat e lëndës do t'i vijë në ndihmë mësuesit përgjatë mësimdhënies.

Gjatë realizimit të planit janë pasur gjithashtu në vëmendje orët e sugjeruara nga hartuesit e programit të lëndës për secilën fushë (sipas ndarjes kryesore dhe ndarjeve të ndërmjetme). Janë planifikuar orët për njohuritë e reja, përsëritjet, ushtrimet, testet, punët me shkrim, projektet, diskutimet.

Teksti i nxënësit për secilën fushë ka rubrikën: *“Përsiatje dhe endje”*. Sugjerohet që kjo rubrikë të shfrytëzohet nga mësuesi për punë të diferencuar me nxënësit, për planifikim të diskutimeve apo të projekteve.

Temat mësimore janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e programit për zbërthimin e rezultateve të të nxënësve sipas kompetencave kyçe dhe rezultateve të të nxënësve të kompetencave të fushës, sipas temës mësimore; në përputhje me metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies; në përputhje me planifikimin e situatave të të nxënësve, si dhe me teknikat më të suksesshme të të pyeturit dhe të të vlerësuarit të nxënësve.

Në mbyllje, është e nevojshme të sqarohet se ky material mbetet udhëzues e mbështetës për mësuesit, të cilët, nga ana e tyre, kanë hapësira tolerance për ndryshime në përputhje me ecurinë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

### **Programi lëndor**

#### **1. HYRJE NË PROGRAMIN E GJUHËS SHQIPE**

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën **“Gjuhët dhe komunikimi”**. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha **“Gjuhët dhe komunikimi”** i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë. Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit:

- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes;
- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Lënda e gjuhës shqipe, gjithashtu, siguron mundësi që nxënësit të ndiejnë fuqinë e gjuhës si një mënyrë për të shprehur përvojat e tyre, duke u bërë kështu anëtarë kritikë dhe aktivë në shoqëri.

Gjuha shqipe, si çdo lëndë tjetër, mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Këto kompetenca janë të domosdoshme për një individ, i cili duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Këtë “mision” lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Duke u bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës, pesë kompetencat e saj janë:

- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Të lexuarit e teksteve të ndryshme.
- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave lëndore ka nisur që në arsimin bazë. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përballen me sfida të reja. P.sh., nga kontekste familjare dhe informale (me shokët e shoqet e klasës dhe me mësuesit), nxënësit tani do të flasin e do të diskutojnë në kontekste më formale (në një debat në shkollë, në aktivitete me mësues, në veprimtari të ndryshme) dhe do të ushtrohen edhe për të folurit në publik.

Programi i gjuhës shqipe bazohet në parimin e integritit të njohurive dhe në parimin e rimarrjes së tyre, vit pas viti, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato.

## 2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i gjimnazit. Programi lëndor shoqërohet me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe të hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

**Mësuesit** do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit dhe se si duhet ta ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësit me kompetencat kyçe dhe të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit.

**Autorët e teksteve** do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të hartuar tekste shkollore në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe për çdo klasë do t'i ndihmojë ata për të siguruar lidhjen logjike dhe për të shmangur mbingarkesën.

**Prindërit dhe komuniteti**, nëpërmjet programit, mund të informohen për njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës shqipe.

**Specialistët e arsimit** mund ta përdorin programin e gjuhës shqipe për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj.

**Fakultetet e mësuesisë** mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Programi i gjuhës shqipe ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës, gjatë punës për përmbushjen e të cilave do të realizohen temat ndërkurrikulare të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës shqipe me fushat dhe lëndët e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të jetë tërësor e jofragmentar.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës, të klasifikuara sipas disa tematikave. Po kështu, në program janë dhënë sugjerime edhe për shpërndarjen e orëve mësimore.

### **3. QËLLIMET E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE**

Lënda e gjuhës shqipe synon që t'u japë nxënësve mundësi:

- të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për gjuhën dhe komunikimin;
- të pasurojnë fjalorin e tyre, të fitojnë njohuri gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit, të zbatojnë rregullat e gjuhës së folur dhe të shkruar, si dhe të krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme me leximin, nëpërmjet të cilit fitojnë kënaqësi dhe marrin informacion;
- të diskutojnë dhe të ndërveprojnë me të tjerët, të komunikojnë, të shprehin qartë dhe të argumentojnë mendimet dhe idetë e tyre, të zotërojnë "artin" e të folurit dhe të dëgjuarit, të marrin pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme, duke dhënë kontributin e tyre në të gjitha fushat e jetës;
- të përvetësojnë aftësitë e duhura për të analizuar, për të interpretuar, për të vlerësuar dhe për të prodhuar tekste për një larmi funksionesh, të zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit për t'u bërë lexues të pavarur, si dhe për të kuptuar dhe për të gjykuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme;
- të interpretojnë dhe të vlerësojnë informacione të ndryshme për botën në përgjithësi, duke zhvilluar kështu në të njëjtën kohë personalitetin e tyre, si qytetarë të së ardhmes.

### **4. LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇE ME KOMPETENCAT E LËNDËS**

Për të përgatitur qytetarë të së ardhmes, nxënës të suksesshëm në jetën personale e shoqërore, në kornizën kurrikulare janë përcaktuar kompetencat kyçe, të cilat duhen ndërtuar dhe duhen zhvilluar gjatë gjithë procesit mësimor.

Realizimi i kompetencave kyçe kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat e lëndës me kompetencat kyçe për secilën shkallë. Rrjedhimisht, ai duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënësve. Për të gjitha sa më sipër, mësuesi ndjek këta hapa:

Përzgjedh rezultatit/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;

- Përcakton rezultatit e të nxënit të kompetencave kyçe për vit mësimor duke zbërthyer rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallë mësimore (janë përcaktuar në program);
- Përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- Planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit mësimor;
- Kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave e projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe për shkallë për lëndën e gjuhës shqipe.

## **REZULTATET KRYESORE TË TË NXËNIT, SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE QË REALIZOHEN NËPËRMJET LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE GJATË SHKALLËS SË PESTË. (klasa X-XI).**

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”, ku bën pjesë edhe lënda e gjuhës shqipe, si pjesë e kurrikulës bërthamë, ndihmon realizimin e të gjitha kompetencave, por më së shumti në kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit.

Renditja e materialit të mëposhtëm paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës së pestë.

### **4.1 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe (Shkalla V)**

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive).**

**Nxënësi:**

- shprehet, përmes një forme komunikimi, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në atë material;
- diskuton në grup, jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat e të nxënit ose nga jeta e përditshme;
- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej 3 paragrafesh, u përgjigjet pyetjeve të shtruar për llojin e tekstit dhe stilet e të shkruarit;
- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;
- shkruan një tekst për një temë nga jeta e përditshme, me 3 paragrafë, duke respektuar



strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë;

- shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të një eseje;
- prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj. nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe teknologji të tjera.

### **Kompetenca e të menduarit** (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

#### **Nxënësi:**

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh.: temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti etj);
- krahason, të paktën, tri burime të ndryshme të informacionit për trajtimin e së njëjtës temë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore;
- krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore.

### **Kompetenca e të nxënit** (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

#### **Nxënësi:**

- demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;
- shfrytëzon, në mënyrë efektive, përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme;
- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, dhe veçon disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime në formë skice, grafiku, vizatimi etj;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, sipas qëllimeve që i cakton vetes.

## **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)**

### **Nxënësi:**

- harton një projekt duke shkëmbyer informacion me të tjerët, duke u konsultuar me ta dhe duke i informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar e vlerësuar burimet njerëzore, materiale e monetare, në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë) dhe pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme;
- merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle, bashkie dhe më gjerë (p.sh., konkurse mësimore, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura dhe për procesin e organizimit dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse se si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre.

## **Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)**

### **Nxënësi:**

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal;
- merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive dhe në aktivitete të tjera kulturore, duke menaxhuar emocionet e veta;
- ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.

## **Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj së mirës së përbashkët*)**

### **Nxënësi:**

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh., në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel vendor dhe qendror);
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe më gjerë);
- diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj.

## **Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)**

### **Nxënësi:**

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pamjeve të filmuara apo të animuara;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

## **5. LIDHJA E GJUHËS SHQIPE ME TEMAT NDËRKURRIKULARE**

Temat ndërkurrikulare janë tema që integrojnë fushat e të nxënit dhe që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë e të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në kornizën kurrikulare janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të mëposhtme:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Bashkëjetesa paqësore.

Mësimi i gjuhës shqipe, për specifikat dhe hapësirat që ka, lejon krijimin e situatave mësimore nëpërmjet të cilave mundësohet trajtimi i këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme zhvillojnë te nxënësit identitetin kombëtar, si dhe njohjen e vlerësimin e kulturës botërore. Tema, si të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup që mund të zhvillohen gjatë orëve mësimore. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese dhe shkrime e krijime të tjeram me tematikë rreth çështjeve të mësipërme.

Punët në grupe të zhvilluara në lëndën e gjuhës e shqipe ndihmojnë aftësimin e nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

## **7. LIDHJA E GJUHËS SHQIPE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT**

Gjuha shqipe, duke qenë jo vetëm disiplinë, por edhe gjuhë e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënit, ka lidhje të qarta dhe plotësuese me fushat dhe lëndët e tjera mësimore.

Në mënyrë të veçantë, lënda e gjuhës shqipe lidhet me lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”:

- Letërsia i ofron gjuhës një model të përsosur të përdorimit të gjuhës, ndërsa studimi i gjuhëve të huaja siguron transferimin e njohurive gjuhësore nga një lëndë në një tjetër, por edhe vlerësimin e mundësive shprehëse të gjuhës shqipe.

- Lënda e gjuhës shqipe (aftësitë e të lexuarit) mbështet kuptimin e ushtrimeve dhe të **teksteve matematikore**. Kjo lëndë është e nevojshme për formimin e koncepteve dhe proceseve matematikore. Aftësitë e mira gjuhësore e lejojnë nxënësin të përmirësojë elementet pamore, përfshirë edhe organizimin e grafikëve të informacionit, planifikimin, organizimin e ideve dhe përcaktimin e një procedure; të dyja lëndët e ndihmojnë nxënësin të zhvillojë aftësinë për të paraqitur një argument ose për të kryer një analizë nga këndvështrime të ndryshme; të dyja lëndët përdorin një qasje deduktive.
- Kuptimi ose analiza e teksteve të **shkencave të natyrës** kërkon aftësi të mira leximi. Po kështu, p.sh., leximi i një teksti i ndihmon nxënësit të marrin njohuri rreth natyrës, siç njohuritë e marra në shkencat e natyrës nxitin imagjinatën për të realizuar me shkrim një përshkrim të natyrës.
- Në mënyrë të veçantë, lënda e gjuhës shqipe është e lidhur me **historinë** dhe **shkencat shoqërore**, përderisa të gjitha tekstet që studiohen nga nxënësit kanë një kontekst historik dhe socio-kulturor.
- Mësimi i **arteve** të ndryshme mbështetet nga lënda e gjuhës shqipe. Kështu, analiza e teksteve të ndryshme me tematikë nga arti ndihmon nxënësit për lëndët e arteve. Gjithashtu, studimi dhe krijimi i teksteve të ndryshme, si p.sh., i reklamave, kërkon integrim me artet për elementet pamore të reklamave etj.

Duke pasur parasysh gjithçka më sipër, mësuesit, me pasion dhe përkushtim, mund të realizojnë pa fund integritime mes fushave dhe lëndëve në situata të ndryshme të nxëni. Ky integrim i lejon nxënësit të mos marrin njohuri të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta.

## 8. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE PËRSHKRIMI I TYRE

Puna për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës nuk është e copëzuar dhe fragmentare. Çdo orë mësimore kontribuon për to.

Kompetencat ndërliken dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Kështu, kompetenca e të lexuarit të teksteve të ndryshme (njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e kësaj kompetence) ndikon në aftësimin e nxënësve për të shkruar, ndërsa formimi i nxënësve rreth sistemit gjuhësor të shqipes ndikon në zhvillimin e kompetencave të tjera. Më poshtë janë dhënë përshkrimet e kompetencave të lëndës.

### a) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Të folurit është mjeti themelor i komunikimit me të tjerët dhe gur themeli i të mësuarit në të gjitha lëndët mësimore. Duke folur dhe duke biseduar nxënësit jo vetëm japin informacion, por edhe sqarojnë kuptimin dhe domethënien e koncepteve të ndryshme, identifikojnë dhe zgjidhin probleme, zgjerojnë njohuritë, si dhe shprehin mendimet, ndjenjat e opinionet e tyre. Kur ata diskutojnë rreth një informacioni, njohin dhe pranojnë edhe këndvështrimet e bashkëbiseduesve të tjerë, si dhe mjetet gjuhësore apo stilin që ata përdorin. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përmirësojnë aftësitë e tyre për të komunikuar dhe për të prezantuar ide në klasë dhe në situata formale. Nëpërmjet këtyre situatave, nxënësit aftësohen edhe për të folurit në publik. Ata mësojnë të flasin qartë, bindshëm e me vetëbesim dhe të jenë tërheqës për të tjerët:

- duke përdorur gjuhën standarde, sidomos kur këtë e dikton situata dhe dëgjuesit;
- duke diskutuar në grupe të vogla dhe të mëdha, duke marrë role të ndryshme në menaxhimin dhe në moderimin e diskutimeve e të debateve, si dhe duke përfshirë e angazhuar të tjerët për të përmbushur afatet e qëllimit;
- duke respektuar, gjatë prezantimeve me gojë, karakteristikat e një fjalimi, shpjegimi, raportimi, debati etj.;
- duke përzgjedhur fjalët e fjalitë e përshtatshme dhe duke përdorur mjete retorike e të figurshme; duke përdorur dhe duke vlerësuar TIK-un gjatë prezantimeve në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj.

#### b) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Gjatë arsimit të mesëm të lartë, nxënësit reflektojnë ndaj informacioneve të llojeve dhe të fushave të ndryshme; përmbledhin, parafrzojnë dhe vlerësojnë përmbajtjen e informacionit të dëgjuar; analizojnë stilin dhe strukturën e një fjalisë ose të një teksti të dëgjuar; përqendrohen te folësi, diskutojnë dhe zgjerojnë idetë e dëguara; mbajnë shënime të tilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm etj.

#### c) Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Edhe pse disa nxënës që hyjnë në klasën e dhjetë, janë lexues të pavarur, shumë prej tyre mund të kenë nevojë për mbështetje, me qëllim që të zhvillojnë më tej aftësitë në lexim. Pra, ky proces duhet të vijojë edhe në arsimin e mesëm të lartë.

Përveç kësaj, të gjithë nxënësit përballen me sfidat që shtron programi i gjuhës shqipe, i cili kërkon nga nxënësit të përvetësojnë koncepte gjithnjë e më abstrakte, të përdorin struktura gjuhësore më komplekse, si dhe të kenë fjalor më të pasur se në arsimin bazë. Lënda e gjuhës shqipe i ndihmon nxënësit që të lexojnë në mënyrë aktive dhe kritike, si dhe ta përthithin mirë e shpejt informacionin. Një lexues aktiv dhe kritik është ai që jo vetëm i kupton njohuritë që komunikohen në një tekst, por edhe i përdor ato në kontekste të reja. Për ta realizuar këtë, nxënësit zbatojnë një sërë strategjish të të kuptuarit, si dhe njihen me një shumëllojshmëri tekstesh. Njohja me tekste të ndryshme u jep mundësinë nxënësve që të zbulojnë interesat dhe prirjet e tyre dhe, gjithashtu, ta kenë më të lehtë të zgjedhin orientimin e karrierës së tyre.

#### d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Të shkruarit u jep mundësi nxënësve të mësojnë për veten e tyre dhe të lidhen me botën. Një nga qëllimet e programit të gjuhës shqipe është që nxënësit të demonstrojnë siguri dhe saktësi kur shkruajnë, të hulumtojnë para se të shkruajnë një tekst, si dhe të komunikojnë me kompetencë, duke përdorur forma dhe stile të ndryshme të shkruarit. Gjatë tri viteve, nxënësit krijojnë, organizojnë dhe përzgjedhin ide për të shkruar për qëllime, audienca dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Nxënësit zbatojnë gjatë të shkruarit karakteristikat e teksteve dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore.

#### e) Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit demonstrojnë ndërgjegjësim dhe saktësi në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes. Ata i konsolidojnë njohuritë gjuhësore, aftësohen ta përdorin gjuhën saktë dhe brenda rregullave gramatikore. Nxënësit i përdorin njohuritë gjuhësore për të organizuar, për të redaktuar dhe për të përmirësuar shkrimet e tyre, për të folur qartë dhe saktë, për të gjykuar gjuhën e një teksti që dëgjojnë ose lexojnë etj. Në këtë cikël, nxënësit përcaktojnë dallimet mes gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, analizojnë regjistrat e gjuhës, vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe zbatojnë rregullat drejtshkrimore dhe të pikësimit.

## REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË LËNDËS

### Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësi:

- merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;
- dallon karakteristikat e gjuhës së folur, si një formë komunikimi, si dhe krahason përdorimet e kësaj gjuhe në shkollë dhe në komunitet;
- realizon prezantime të ndryshme me gojë, përdor strategjitë e duhura për të përmbushur qëllimin që ka dhe për të tërhequr vëmendjen e interesin e audiencës, respekton kohën gjatë prezantimit;
- përdor TIK-un për të realizuar prezantime të ndryshme, sidomos në situata formale.

Njohuritë:

- Procesi i komunikimit gjatë të folurit. Gjuha verbale dhe joverbale. Karakteristikat e gjuhës së folur. Të shkruarit dhe të folurit, dallimi mes tyre.
- Strategjitë e të folurit. Rëndësia e përdorimit të gjuhës standarde gjatë të folurit. Mjetet që përdoren për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e të tjerëve.
- Karakteristikat e një diskutimi. Rolet në një diskutim.
- Mënyrat dhe mjetet e prezantimit (përfshirë edhe TIK-un).
- Hartimi i dy prezantimeve (individual dhe grup).

Shkathtësitë:

#### a) Komunikimi dhe gjuha gjatë të folurit

Nxënësi:

- përcakton elementet e komunikimit gjatë të folurit;
- përcakton dallimet mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar;
- dallon dhe vlerëson rolin e fjalës dhe të gjuhës joverbale gjatë të folurit (gjestet, mimika, toni i zërit, gjuha e trupit etj.);
- përdor intonacionin e duhur, theksin e saktë (të fjalëve dhe të fjalive), volumin e përshtatshëm të zërit, si dhe pauzat për të bërë përshtypje te të tjerët;
- përzgjedh fjalët, shprehjet, terminologjinë e duhur dhe mjetet stilistike për të shprehur mendimet, idetë, ndjenjat dhe opinionet e tij, si dhe për të ndikuar tek audiencia.

#### b) Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup

Nxënësi:

- komunikon për qëllime, tematika dhe audiencia të ndryshme, duke mbajtur një qëndrim të caktuar gjatë një diskutimi në grup;
- dallon rolet e ndryshme në një diskutim, si: rolin e moderatorit, rolin e drejtuesit, rolin e dëgjuesit etj.;
- paraqet mendimin personal mbi çështjen për të cilën diskutohet në mënyrë të përmbledhur, duke respektuar kohën;
- përmbledh përfundimet e një diskutimi, duke shprehur një mesazh koherent;

- merr parasysh rolin e qëllimit, të audiencës dhe të situatës në një diskutim;
- shfrytëzon pasurinë leksikore e semantike për të shprehur saktë mendimet e tij gjatë diskutimeve në grupe të vogla e të mëdha;
- bën pyetjet e duhura, kur diskutohen tema të ndryshme, si dhe u përgjigjet pyetjeve të të tjerëve duke dhënë sqarime dhe duke bërë ilustrime;
- identifikon faktorët (organizimi, stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajtja, këndvështrimi etj.) që ndikojnë në kompozimin e mesazhit të tij.

#### c) Prezantimi me gojë

Nxënësi:

- përgatit në mënyrë individuale një prezantim rreth një teme familjare ose interesante për moshën e tij;
- prezanton në grup për një çështje/temë të caktuar;
- përdor një shumëllojshmëri strategjish organizative (tabela, diagrame, grafikë, kllaster), si dhe demonstroi strategji efektive të përcjelljes së mesazhit gojor (organizimi, gjuha e gjesteve, fjalor i përshtatshëm);
- përpunon prezantimin gojor për të orientuar drejt audiencën, si dhe përdor TIK-un gjatë prezantimeve;
- përdor një shumëllojshmëri elementesh joverbale, si shprehja e fytyrës, gjestet, kontakti me sy etj., në mënyrë që të përcjellë idetë, duke ndikuar tek audienca, si dhe respekton kohën në prezantimet me gojë.

#### d) Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- respekton rregullat e etikës gjatë të folurit, shmang fyerjet dhe paragjykimet, si dhe format e tjera të gjuhës denigruese;
- përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij, si dhe respekton mendimin e të tjerëve;
- kontrollon nervozizmin, tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë të folurit, si dhe demonstroi seriozitet e sinqeritet gjatë të folurit;
- respekton forcën e fjalës dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- përdor imagjinatë dhe kreativitet për zgjidhjen e problemeve;
- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit gjatë prezantimeve të ndryshme;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve.

### Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësi:

- përdor strategjitë e të dëgjuarit dhe kupton tekste të llojeve të ndryshme;
- bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve;
- zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet



e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti;

- përdor materiale udhëzuese dhe hulumton në leksikon e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;
- analizon gjuhën e figurshme të tekstit;
- identifikon faktin dhe opinionin në tekste të ndryshme;
- identifikon mjetet që përdor folësi për ta bërë tërheqës ose të besueshëm të folurin e tij.

### **Njohuritë**

- Studime tekstesh të ndryshme.

### **Shkathtësitë**

#### **a) Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar**

Nxënësi:

- demonstroi të kuptuarit e tekstit që dëgjon;
- përmbledh informacionin e prezantuar me gojë nga të tjerët;
- vlerëson përmbajtjen dhe mënyrën e prezantimit gojor;
- përgjigjet në mënyrë të përshtatshme në një debat.

#### **b) Të dëgjuarit për të vlerësuar**

Nxënësi:

- përqendron vëmendjen në e mbi folësin ose mesazhin;
- mban shënime të atilla që në mënyrë të përgjegjshme demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm;
- zbulon kuptimin e fjalëve të reja nëpërmjet kontekstit në komunikimet gojore;
- tregon si zgjedhja e fjalëve dhe e gjeve zbulojnë qëllimin e folësit;
- vlerëson besueshmërinë e folësit;
- dallon faktet dhe opinionet në një tekst.

#### **c) Vlerat dhe qëndrimet**

Nxënësi:

- tregon respekt, empati (ndjeshmëri) dhe interes ndaj folësit;
- demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave;
- ndërmerr iniciativa dhe shpreh interes për çështje të ndryshme;
- përdor imagjinatë dhe kreativitet për zgjidhjen e problemeve;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve.

### **Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme**

Nxënësi:

- përdor strategjitë e të lexuarit dhe bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve;
- përdor organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit, parafrazon dhe përmbledh tekstet e punuara;

- kupton tekste të llojeve të ndryshme;
- zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti;
- përdor materiale udhëzuese dhe gjurmon në leksikon e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;
- analizon tema të ndryshme, duke zbuluar gjuhën e figurshme të tekstit; identifikon faktin dhe opinionin në tekste të ndryshme;
- realizon punë kërkimore, përzgjedh informacione për qëllime të ndryshme, vlerëson informacionin e përzgjedhur nga të tjerët, përmbledh materiale të ndryshme, si dhe nxjerr përfundime.

### **Njohuritë**

- Teksti, karakteristikat e tij. Struktura e një teksti. Llojet e teksteve;
- Tekstet e gjuhës së folur, të shkruar dhe mediatike (publiciteti, reklama etj);
- Teksti letrar dhe teksti joletrar.
- Tekstet përshkruese. Teknikat e përshkrimit. Gjuha dhe stili i një teksti përshkrues. Përshkrimi i një personi, i një objekti, i një vendi.
- Tekstet rrëfyese. Teknikat e shkrimit të teksteve rrëfyese. Tekstet rrëfyese letrare dhe joletrare. Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të shkrimit rrëfyes.
- Tekstet udhëzuese. Teknikat dhe karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve udhëzuese.
- Tekstet argumentuese. Teknikat e shkrimit të teksteve argumentuese. Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve argumentuese.
- Tekstet informuese-paraqitëse. Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike.

### **Shkathësitë**

#### **a) Të kuptuarit e tekstit dhe reflektimi ndaj tij**

Nxënësi:

- lexon tekste nga kultura dhe periudha historike të ndryshme;
- përdor një sërë strategjish të ndryshme para, gjatë dhe pas leximit ose dëgjimit, me qëllim që të përftojë kuptimin e teksteve të thjeshta dhe më komplekse, si p.sh: parashikon rreth përmbajtjes së teksteve; aktivizon njohuritë e mëparshme për përmbajtjen ose veçoritë organizative dhe grafike të teksteve; përcakton qëllimin e leximit të teksteve; shtron pyetje për veten për t'u qartësuar ose për të përmbledhur konceptet dhe idetë; rilexon një fragment të vështirë të tekstit; nënvizon dhe mban shënime; krijon një organizues grafik për një tekst ose kapitull për të memorizuar (kujtuar) informacionin; harton një hartë koncepti; lidh informacionin e tekstit me jetën dhe përvojat e tij; lexon informacion shtesë për të plotësuar informacionin e tekstit;
- analizon tekstin, veçoritë dhe strukturën e tij;
- përdor informacionin e tekstit për të zbuluar nëntekstin dhe për të nxjerrë përfundime;
- dallon informacionin kryesor nga informacioni jokryesor;
- parafrazon informacionin e marrë nga tekste të ndryshme;

- bën përmbledhjen e një teksti;
- zbulon elemente të stilit dhe të gjuhës së autorit;
- zbulon qëllimin dhe qëndrimin e autorit në një tekst;
- dallon dhe gjykon për problematika të natyrave të ndryshme që pasqyrohen në tekste të ndryshme;
- analizon se si teksti i një periudhe kohore ose i një kulture të caktuar reflekton kushtet historiko-shoqërore dhe kulturore të kohës;
- analizon gjuhën e figurshme të një teksti;
- dallon faktin nga opinioni në një tekst, duke argumentuar përgjigjen e tyre;
- dallon referencat dhe gjykon për besueshmërinë e një teksti;
- krahason tekste të llojeve të ndryshme.

#### **b) Dallimi i llojeve të teksteve**

- Krahason një tekst letrar me një tekst joletrar.
- Evidenton karakteristikat e teksteve të gjuhës së folur, të shkruar dhe mediatike;
- Përcakton veçoritë e teksteve mediatike; gjykon për vlerën dhe ndikimet e teksteve mediatike në jetën e njeriut;
- Dallon karakteristikat kryesore të tekstit letrar dhe të tekstit joletrar;
- Përcakton funksionet, llojin, qëllimet, teknikat dhe karakteristikat gjuhësore, stilistike dhe strukturore të teksteve joletrare.

#### **c) Pasurimi i fjalorit**

- Përdor materiale udhëzuese (p.sh.: fjalorë, enciklopedi, internet etj.), që janë të përshtatshme për të pasuruar fjalorin në fusha të ndryshme.
- Hulumton fjalët e shkrimeve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;
- Përdor njohuritë e origjinës së fjalëve, si dhe të dhënat e kontekstit historik për të përcaktuar kuptimin e fjalëve të fushave të caktuara të dijes;
- Përdor dukuri të tilla gjuhësore, si: polisemia, homonimia, onomatopetë, shprehjet frazeologjike, sinonimia, antonimia për të rritur forcën shprehëse të mendimit të tij.

### **Vlerat dhe qëndrimet**

Nxënësi:

- është i motivuar për të lexuar për kënaqësi dhe për të marrë informacion; është i vëmendshëm gjatë leximit;
- shfaq empati (ndjeshmëri) gjatë leximit; shfaq vetëbesim dhe vetëvlerësim;
- demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave;
- respekton dhe pranon mendimin e të tjerëve, si dhe respekton etikën gjatë komunikimit personal e në grup;
- vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre;
- shfaq tolerancë dhe respekt për kulturën dhe për gjuhën e tjetrit.

**Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale**

Nxënësi:

- realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij, organizon në mënyrë logjike mendimet dhe idetë, redakton shkrimin duke përdorur edhe mendimet e të tjerëve;
- shkruan qartë, me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike, tekste për qëllime dhe për audiencë të ndryshme;
- zbaton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në shkrimet e tij dhe në procesin e redaktimit;
- përdor materiale të ndryshme burimore që e ndihmojnë gjatë procesit të shkrimit.

### **Njohuritë**

- Procesi i të shkruarit, hapat dhe strategjitë e të shkruarit.
- Përshkrimi i një personi (tekst përshkrues).
- Shkrimi rreth një përvoje personale ose shkrimi i një kronike për një ngjarje (tekst rrëfyes).
- Udhëzime se si arrihet në një destinacion (vendmbërritje) ose hartimi i rregullores së klasës (tekst udhëzues).
- Ese argumentuese (tekst argumentues).
- Shkrimi i një teksti informues/paraqitës.

### **Shkathtësitë**

#### **a) Të shkruarit si proces**

Nxënësi:

- përcakton qëllimin, temën dhe audiencën për të cilën shkruan, duke ndjekur të gjithë hapat e procesit të të shkruarit;
- kërkon dhe përzgjedh informacion në burime të ndryshme (të shtypura ose elektronike) për të mbështetur idetë e tij në punën me shkrim;
- harton një strukturë ose një skedë për tekstin që do të shkruajë;
- redakton shkrimin duke u përqendruar në elementet e përmbajtjes dhe të formës, si: dhënia e informacionit të nevojshëm; përmirësimi i stilit dhe i origjinalitetit; respektimi i strukturës dhe i koherencës së tekstit; përdorimi i gjuhës standarde, respektimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe i shenjave të pikësimit; respektimi i leksikut dhe i terminologjisë, në varësi të llojit e të tematikës së tekstit; plotësimi i tekstit me elemente grafike, kur këto janë të nevojshme;
- përdor njohuri rreth rregullave të pikësimit për të redaktuar shkrimin e tij dhe të të tjerëve.

#### **b) Të shkruarit si produkt**

Nxënësi:

- përdor në shkrimet e veta tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme;
- zhvillon dhe organizon idetë kryesore duke i mbrojtur ato me nënide, shembuj dhe ilustrime;
- shkruan tekste me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore;
- përdor gjuhën e përshtatshme, lloje të ndryshme fjalish, pjesë të ndryshme të ligjëratës, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj për ta bërë tërheqës shkrimin e tij;

- shkruan hyrje dhe mbyllje tërheqëse e koherente;
- përdor rrallë, por në mënyrë efektive, klishetë, zhargonet dhe fjalët dialektore;
- përdor grafikë, tabela ose diagrame për të mbështetur idetë kryesore;
- përdor struktura të tilla, si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj., të cilat e ndihmojnë lexuesin që të kuptojë shkrimin;
- përdor lidhëzat dhe fjalët lidhëse për të lidhur paragrafët;
- përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore në të gjitha punët me shkrim;
- zbaton rregullat e pikësimit në të gjitha shkrimet e tij;
- përdor dhe zhvillon stilin vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës;
- zbaton të drejtën e autorit ndaj informacionit që përdor në punët me shkrim.

### c) Të shkruarit e llojeve të ndryshme të teksteve

Nxënësi:

- shkruan tekste përshkruese (rrëfyese, udhëzuese, argumentuese, informuese/paraqitëse) për qëllime dhe audiencë të ndryshme;

### Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit në mënyrë të pavarur;
- demonstroi imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë të shkruarit;
- respekton gjuhën standarde dhe shmang fjalët e huaja gjatë të shkruarit (kur e kanë fjalën përgjegjëse në gjuhën shqipe);
- vlerëson punët e të tjerëve, si dhe bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim.

## Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

Nxënësi:

- ndërton dhe zhvillon njohuri të reja rreth gramatikës dhe leksikologjisë përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstet që lexon;
- përdor njohuritë gramatikore dhe leksikore gjatë të folurit dhe të shkruarit për të arritur qëllime ose efekte të caktuara;
- dallon disa ndryshime mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve dhe gjuhës standarde;
- zotëron rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit në gjuhën shqipe;
- shkruan saktë, pa gabime dhe argumenton mënyrën e të shkruarit, duke cituar rregullat drejtshkrimore;
- përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.

### Njohuritë

#### I. Morfologji (12 orë të sugjeruara)

Klasat e fjalëve, të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

## 1. Emri

- Emrat që e ndërrojnë gjininë në numrin shumës.
- Emrat që kanë të njëjtën temë, si në njëjës, ashtu edhe në shumës.
- Emrat që përdoren vetëm në numrin njëjës.
- Emrat që përdoren vetëm në numrin shumës.
- Emrat me dy trajta shumësi.

## 2. Folja

- Mënyra dëftore dhe habitore, forma veprare dhe joveprare e foljeve të parregullta.
- Format e pashtjelluara foljore. Pjesorja e foljes.

## 3. Mbiemri

- Mbiemrat cilësorë dhe mbiemrat marrëdhëniorë.
- Mbiemrat e emëruar.
- Shumësi i mbiemrave. Përdorimi në shumës i mbiemrave që përcaktojnë emra mashkullorë me shumësin me *-e*, *-ra* dhe me *-a*.

### II. Sintaksë (10 orë të sugjeruara)

- Gjymtyrët e fjalisë.
- Përshtatja në vetë dhe në numër e kallëzuesit foljor dhe e këpujës me kryefjalën. Përshtatja e gjymtyrës emërore me kryefjalën.
- Fjalja dëftore. Rendi i gjymtyrëve në fjalinë dëftore.
- Fjalja e paplotë. Fjalitë e paplota kontekstuale, situative.
- Gjymtyrët homogjene
- Përshtatja e mbiemrit ose e përemrit që përcakton një varg gjymtyrësh homogjene.

### III. Leksikologji (5 orë të sugjeruara)

- Leksiku i gjuhës shqipe.
- Shtresat e leksikut sipas burimit.
- Shtresat e leksikut sipas përdorimit.

### IV. Drejtshkrim dhe pikësim (5 orë të sugjeruara)

- Drejtshkrimi i emrave të përveçëm dhe i emërtimeve me to.
- Shkrimi i disa trajtave të shumësit të emrave dhe mbiemrave.
- Përdorimi i nyjës së përparme, përshtatja dhe ndryshimet që ajo pëson në strukturat sintaksore.
- Drejtshkrimi i foljeve të parregullta.
- Përdorimi i shenjave të pikësimit (presja, pikëpresja, dy pikat).

## Shkathtësitë

### a) Morfologji

Nxënësi:

- përcakton klasat e fjalëve dhe argumenton përgjigjen e tij;
- klasifikon fjalët në të ndryshueshme dhe në të pandryshueshme;

- dallon emrat e gjinisë mashkullore që e ndryshojnë gjininë, kur kalojnë në numrin shumë;
- përcakton prapashtesën me të cilën e formojnë numrin shumë disa emra mashkullorë, si: prapashtesën *-e* (*shtigje, male, vende, mendime, personazhe, insekte* etj.); prapashtesën *-ra* (*djathëra, vajra, mallra, ujër, shira* etj.);
- përdor drejt emrat që në numrin shumë marrin prapashtesat *ë, -nj, -ër, -inj, -ra* ose ndërrojnë tingujt, si p.sh.: *dibranë, drejtorë, arsimitarë, florinj, priftërinj, prindër, erëra, brigje, kapituj* etj.;
- dallon emrat që përdoren vetëm në njëjës (*benzinë, brymë, latinishtja* etj.) dhe emrat që përdoren vetëm në numrin shumë (*qelqurina, të ardhura, shtojzovalle, Alpe* etj.);
- përdor në trajtën e duhur emrat që kanë të njëjtën temë si në njëjës, ashtu edhe në shumë, si p.sh.: *nxënës, lagje, radio, qeveri* etj.;
- dallon dhe përdor drejt emrat që kanë dy trajta shumësi, si p.sh.: *pikë dhe pika*;
- zgjedhon foljet e parregullta (*jam, them, rri, dua* etj.) në kohët e mënyrës dëftore dhe habitore, në formën veprorë dhe joveprorë;
- dallon variantin e saktë të foljet që në gjuhën e folur kanë disa trajta, si p.sh.: *shkoj/shkoi/shkonj, shkoja/shkonja, por* edhe trajtën kryesore normative *mat/mas, matja/masja, flitni/flisni; bërtisni/bërtitni* etj.
- përcakton format e pashtjelluara që ndërtohen mbi bazën e pjesores;
- klasifikon mbiemrat duke u mbështetur në tiparin që emërtojnë (mbiemra cilësorë dhe mbiemra marrëdhëniorë);
- krahason mbiemrat cilësorë me mbiemrat marrëdhëniorë;
- vendos në trajtën e duhur mbiemrat ose fjalët e tjera përcaktuese pas emrave që e ndërrojnë gjininë në numrin shumë, si p.sh.: *mendime të zymta, personazhe interesante, vende malore, ujëra të rrëmbyeshme, djathëra të kripura* etj.;
- përcakton saktë shumësin e mbiemrave (relativë, shumëngjyrësh etj.).

## **b) Sintaksë**

Nxënësi:

- përcakton gjymtyrët në një fjali dhe argumenton përgjigjen e tij;
- dallon se si përshtaten kallëzuesi foljor dhe këpuja me kryefjalën, në vetë dhe në numër;
- dallon përshtatjen e gjymtyrës emërore me kryefjalën;
- përcakton dhe përdor drejt rendin e gjymtyrëve në fjalinë dëftore;
- dallon kur rendi (kryefjalë- kallëzues ose kallëzues-kryefjalë) është i drejtë ose i anasjelltë dhe përcakton në cilat raste përdoren ato;
- përcakton vendin e gjymtyrëve të dyta (kundrinor, përcaktor etj.);
- tregon se çfarë janë fjalitë e paplota dhe bën krahasimin e këtyre fjalive me fjalitë e plota;
- përcakton fjalitë e paplota të kontekstit dhe fjalitë e paplota të situatës;
- dallon gjymtyrët homogjene në fjali;
- përdor drejt mbiemrat ose përemrat që përcaktojnë një varg gjymtyrësh homogjene;
- përdor drejt foljet ndihmëse në kallëzuesit foljorë homogjenë.

## **c) Leksikologji**

Nxënësi:

- gjykon dhe vlerëson leksikun e pasur të shqipes;
- identifikon shtresat e leksikut sipas burimit dhe përdorimit;
- dallon dhe analizon karakteristikat e secilës shtresë të leksikut të shqipes.

#### **d) Drejtshkrim dhe pikësim**

Nxënësi:

- shkruan dhe përdor drejt: emrat dhe mbiemrat e njerëzve dhe pseudonimet e tyre; emrat e përveçëm që përdoren për të shënuar një kategori të caktuar njerëzish; emrat e përveçëm të botës mitologjike e fetare, si dhe emrat e përveçëm të personazheve të tregimeve popullore; emërtimet e planetëve, të yjësive e të trupave qiellorë; emërtimet e funksionet shtetërore, politike, të gradave etj., që janë bërë pjesë e pandarë e një emri të përveçëm etj.;
- shkruan dhe përdor drejt emrat dhe mbiemrat në numrin shumës, si dhe nyjën e përparme para emrave dhe mbiemrave;
- shkruan dhe përdor drejt foljet e parregullta;
- shkruan dhe përdor drejt shenjat e pikësimit (presja, pikëpresja, dy pikat).

#### **Vlerat dhe qëndrimet**

Nxënësi:

- vlerëson pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- respekton diversitetin gjuhësor mes njerëzve;
- shfaq shpirt krijues në përdorimin e gjuhës;
- shmang fjalët e huaja të panevojshme gjatë komunikimit.



**TREMUJORI I PARË**  
**SHTATOR- DHJETOR (24 ORË)**

Nr	Tematika sipas fushave (72 orë)	Temat mësimore		Situatë e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1	<b>Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe (3 orë)</b>	1.1	Procesi i komunikimit. Gjuha verbale dhe joverbale. Strategjitë e të folurit. Karakteristikat e një diskutimi. Gjuha e trupit.	Dëgjim Diskutim Debat Punë në grup Zbatim (Punë me shkrim)	Me qasje kompetencash: Identifikimi njohurive paraprake për organizim të punës në grup. Kllaster Rrjeti i diskutimit Shkrim i lirë.	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë; Vlerësimi i punës në grup; Vlerësim mes nxënësish.	Teksti i nxënësit për klasën e X; Materiale nga interneti; CD-të, DVD.-të
2		1.2	Të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit për qëllime personale.				
3		1.3	Ushtrime. Praktikë (1)				
4	<b>Njohuri të përgjithshme mbi tekstin (4 orë)</b>	2.1	Teksti dhe karakteristikat e tij. Struktura dhe llojet e tekstit	Studim rasti (një situatë komunikimi) Improvizim Interpretim Punë në grup  Analizë Krahasim Prezantim	Qasje problemore; sfidim i njohurive paraprake, rindërtim i njohurive të reja.  INSERT  Stuhi mendimi  DDM  Pesëvargëshi	Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)  Vlerësimi i aktivitetit gjatë interpretimit;  Vlerësim përmes diskutimit	Tekste nga fusha të tjera;  Slide/ materiale të krijuara nga mësuesit;  Materiale nga enciklopedi;
5		2.2	Burimet sintaksore të shprehësisë. Burimet morfologjike të shprehësisë. Burimet leksikore dhe fonetike të shprehësisë.				
6		2.3	Realizimi i tekstit brenda një situatë komunikative				
7		2.4	Ushtrime për përsëritje (2)				
	<b>Bota përmes</b>	<b>Pjesa 3.1 Njohuri rreth tekstit përshkrues</b>					

8	<b>përshkrimit (14 orë)</b>	3.1 (1)	Njohuri rreth tekstit përshkrues. Teknikat dhe format organizuese të përshkrimit	Vëzhgim Analizë Zbatim Sinteze	Qasje pjesëmarrëse përmes angazhimit individual dhe në grup me synim zbatimin dhe analizimin e njohurive e të aftësive sa i takon zbatimit të rregullave të shkrimit	Vlerësimi i detyrave të shtëpisë;	Tekste nga fusha të tjera;							
9		3.1 (2)	Eseja përshkruese dhe teknikat e saj. Ushtrime praktike për tekstin përshkrues (3)	Punë individuale dhe në grupe.				Slide/materiale të krijuara nga mësuesit;						
<b>Pjesa 3.2 Tekste përshkruese dhe njohuri gjuhësore</b>														
10		3.2 (1)	Kish ardhur vjeshta, Bilal Xhaferri	Bashkëbisedim Diskutim					Kubimi (përdorimi i kubit me lëvizje të shpejta për përshkrim; krahasim.) Imagjinatë e drejtuar	Vlerësimi i punimit të ushtrimeve.	Modele të punëve me shkrim nga nxënësit;			
11		3.2 (2)	Kish ardhur vjeshta, Bilal Xhaferri. Leksiku i gjuhës shqipe	Krahasim Interpretim								Tekste jashtëshkollore		
12		3.2 (3)	Kish ardhur vjeshta, Bilal Xhaferri. Leksiku i gjuhës shqipe. Ushtrime. Praktikë (4)	Prezantim Zbatim i teknikave të shkrimit									Vlerësim përmes prezantimit me gojë	Tekste të shkëputura nga vepra të ndryshme Revistat, atlase.
13		3.2 (4)	Të veshurat shqiptare, Faik Konica											
14		3.2 (5)	Të veshurat shqiptare, Faik Konica. Klasat e fjalëve. Ushtrime praktike për klasat e fjalëve.(5)											
15	3.2 (6)	Të veshurat shqiptare, Faik Konica. Emrat e dygjinishëm. Ushtrime praktike për emrat e dygjinishëm (6)		Vlerësimi i detyrave të										
				Prezantime përmes “turit të galerisë”, përfshirë TIK										

16		3.2 (7)	Babai im, Natali Ginzburg		Qasja dialektike, përmes së cilës nxënësi vendoset përballë situatave reale ose të imagjinuara, në të cilat ai krahason dhe vlerëson informacionet, ngjarjet rrethanat.  Lojë në role  Ditar tripjesësh	shtëpisë;	Enciklopedia
17		3.2 (8)	Babai im, Natali Ginzburg. Emrat që formojnë shumësin me prapashtesa ose me ndërrime tingujsh. Ushtrime praktike për emrat që formojnë shumësin me prapashtesa ose me ndërrime tingujsh. (7)			Vlerësim i punimit të ushtrimeve.  Vlerësim mes nxënësish;	
18		3.2 (9)	Babai im, Natali Ginzburg. Emrat me të njëjtën temë në njëjës dhe në shumës. Ushtrime praktike për emrat me të njëjtën temë në njëjës dhe shumës (8).	Improvizim Lexim Inskenim		Prezantim me shkrim.  Test për një grup temash të caktuara	
19		3.2 (10)	<b>PUNË ME SHKRIM (1) TEKST PËRSHKRUES</b>				
20		3.2 (11)	<b>TEST (1)</b>			Vlerësim projekti	
		<b>Pjesa 3.3 Përsiatje dhe endje</b>					
21		3.3 (1)	<b>PROJEKT (1):</b> Cuneus Prophetarum, Pjetër Bogdani Cuneus Prophetarum, Pjetër Bogdani	Bashkëbisedim Prezantim			
	<b>Bota përmes rrëfimit (13 orë)</b>	<b>Pjesa 4.1 Njohuri rreth tekstit rrëfyes.</b>		Qasje analitike që synon të vendosë nxënësin përballë pyetjeve “pse” dhe “si”,	Vlerësimi i të nxënësve (vlerësimi	Teksti i nxënësit për klasën e X; Materiale nga	
22	4.1 (1)	Teksti rrëfyes letrar dhe joletrar.	Vlerësim mes				

23		4.1 (2)	Strukturat dhe teknikat e rrëfimit letrar.	nxënësish; Vlerësim projekti	duke e lehtësuar përgjatë formulimit të mendimit.	përmbledhës)	interneti; CD-të, DVD
24		4.1 (3)	<b>PUNË ME SHKRIM (2) TEKST RRËFYES</b>	Vëzhgim Dëgjim Analizë Zbatim Punë individuale	Stuhi mendimi Diagrami i Venit Ditari dypjesësh Imagjinatë e drejtuar	caktuara;  Prezantim me shkrim.	Projektori, interneti, Antologjitë

**TREMUJORI I DYTË**  
**JANAR - MARS (24 ORË)**

		<b>Pjesa 4.2 Tekste rrëfyese dhe njohuri gjuhësore</b>				
25		4.2 (1)	Jeta ime, Fan Noli. Biografia dhe autobiografia.	Sekuenca filmike	Lexim me kodim teksti Rrjeti i diskutimit	
26		4.2 (2)	Jeta ime, Fan Noli. Emrat që përdoren vetëm në njëjës ose vetëm në shumës	Bashkëbisedim		
27		4.2 (3)	Jeta ime, Fan Noli Emrat që kanë dy trajta shumësi	Krahasim		
28		4.2 (4)	Këngë nga Çang'gan, Li Po. Poezia si tekst rrëfyës	Zbatim Punë në grupe		
29		4.2 (5)	Një këngë nga Çang'gani, Li Bai/Li Po	Interpretim		
30		4.2 (6)	Një Këngë nga Çanggani, Li Bai/Li Po. Ushtrime për përsëritje (9).	Diskutim Ndërtim pyetjesh (zbatim)		
31		4.2 (7)	Peripecitë e ngjitjes në Everest, Gjergj Bojaxhi.			
32		4.2 (8)	Peripecitë e ngjitjes në Everest, Gjergj Bojaxhi. Drejtshkrimi i emrave të përveçëm.			

33		4.2 (9)	Peripeçitë e ngjitjes në Everest, Gjergj Bojaxhi. Foljet kalimtare dhe jokalimtare.				
		<b>Pjesa 4.3 Përsiatje dhe endje</b>					
34		4.3 (1)	<b>PROJEKT (2)</b> Origjina e gjuhës shqipe, Kostaq Cipo.				
	<b>Bota përmes udhëzimit  (12 orë)</b>	<b>Pjesa 5.1 Njohuri rreth tekstit udhëzues</b>			Qasja dialektike, përmes së cilës nxënësi vendoset përballë situatave reale ose të imagjinuara, në të cilat ai krahason dhe vlerëson informacionet, ngjarjet rrethanat.	Vlerësimi i detyrave të shtëpisë;  Vlerësim i punimit të ushtrimeve.	Tekste nga fusha të tjera;  Slide/materiale të krijuara nga mësuesit;
35		5.1 (1)	Njohuri rreth tekstit udhëzues. Teknikat e shkrimit dhe karakteristikat gjuhësore dhe stilistike të tekstit udhëzues.				
		<b>Pjesa 5.2 Teksti udhëzues dhe njohuri gjuhësore</b>			Lojë në role  Ditar tripjesësh	Vlerësim mes nxënësish;	Materiale nga enciklopedi;
36		5.2 (1)	Si të flasim me adoleshentët rreth seksit, Xhenifër Eshtën.	Diskutim			
37		5.2 (2)	Si të flasim me adoleshentët rreth seksit, Xhenifër Eshtën. Mënyra dëftore dhe habitore, forma veprare dhe joveprare e foljeve të parregullta.	Prezantim Dëgjim Analizë Zbatim			
38	5.2 (3)	Si të flasim me adoleshentët rreth seksit, Xhenifër Eshtën. Format e pashtjelluara					

		foljore.				
39	5.2 (4)	Si të shkruajmë një CV? Qendra e karrierës.	Vëzhgim Punë në grupe Bashkëbisedim		Vlerësim i punimit të ushtrimeve.	
40	5.2 (5)	Si të shkruajmë një CV? Drejtshkrimi i nyjes së përparme.				
41	5.2 (6)	Si të shkruajmë një CV? Mbiemrat cilësorë, marrëdhëniorë dhe të emëruar. Shumësi i mbiemrave.				
42	5.2 (7)	Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, Kushtetuta e Shqipërisë.				
43	5.2 (8)	Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, Kushtetuta e Shqipërisë				
44	5.2 (9)	Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, Kushtetuta e Shqipërisë. Ushtrime (10)				
45	5.2 (10)	<b>TEST 2</b>				
	<b>Pjesa 5.3 Përsiatje dhe endje</b>					
46	5.3 (1)	<b>PUNË ME SHKRIM (3)</b> <b>TEKST UDHËZUES</b> (Udhëzimet e pasaportës së vjetër shqiptare- material		Qasje e orientuar nga objektivi dhe veprimi përmes orientimit dhe mbështetjes së nxënësit në planifikimin dhe organizimin e rregullave të		Tekste nga fusha të tjera;  Slide/materiale të krijuara nga

			plotësues)		ndryshme duke respektuar veten dhe të tjerët.		mësuesit;
	<b>Bota përmes argumentimit (13 orë)</b>	<b>Pjesa 6.1 Njohuri rreth tekstit argumentues</b>					
47		6.1 (1)	Karakteristikat strukturore, gjuhësore, stilistike të tekstit argumentues. Teknikat e shkrimit të tekstit argumentues.	Analizë Debat argumentues Dëgjim Hulumtim	Lexim me kodim teksti Rrjeti i diskutimit Prezantim në grup	Prezantim me shkrim	Modele të punëve me shkrim nga nxënësit;
48		6.1 (2)	Teksti argumentues bindës. Argumentimi dhe format e tij. Si të bindim?	Zbatim			



**TREMUJORI I TRETË**  
**PRILL - QERSHOR (24 ORË)**

		<b>Pjesa 6.2 Tekste argumentuese dhe njohuri gjuhësore</b>				
49	<b>Bota përmes argumentimit (13 orë)</b>	6.2 (1)	A është në rrezik Toka?, Xhon Kristi		Vlerësim i punës me shkrim.	
50		6.2 (2)	A është në rrezik Toka?, Xhon Kristi .Gjymtyrët e fjalisë			
51		6.2 (3)	A është në rrezik Toka?, Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën.			
52		6.2 (4)	<b>PUNË ME SHKRIM (4) TEKST ARGUMENTUES</b>			
53		6.2 (5)	Reklama si tekst argumentues.	Projekt Punë në grup		
54		6.2 (6)	Reklama si tekst argumentues. Fjalja dëftore.	Krahasim		
55		6.2 (7)	Reklama si tekst argumentues. Fjalja e paplotë.	Komente Vlerësim		
56		6.2 (8)	Disidenca shqiptare, Ardian Klosi.			
57		6.2 (9)	Disidenca shqiptare, Ardian Klosi.			
58		6.2 (10)	Disidenca shqiptare, Ardian Klosi.			


			Ushtrime (11)					
		<b>Pjesa 6.3 Përsiatje dhe endje</b>						
59		6.3 (1)	<b>PROJEKT (3)</b> A gënjen aktori?, Aleksandër Moisiu.			Vlerësim projekti		
		<b>Pjesa 7.1 Njohuri rreth tekstit informues</b>						
60		7.1 (1)	Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve info-paraqitëse, si dhe teknikat e shkrimit të tekstit informues-paraqitës.	Dëgjim Lexim Zbatim Diskutim	Qasje pjesëmarrëse përmes angazhimit individual dhe në grup, me synim zbatimin dhe analizimin e njohurive dhe aftësive sa i takon zbatimit të rregullave të shkrimit.	Vlerësim i detyrave të shtëpisë	Tekste nga fusha të tjera;  Slide/ materiale të krijuara nga mësuesit	
61		7.1 (2)	Butrinti, UNESCO. Veçoritë e qytetit antik.		Rrjeti i diskutimit Punë individuale.		Modele të punëve me shkrim nga nxënësit;	
		<b>Pjesa 7.2 Tekste paraqitëse informuese dhe njohuri gjuhësore</b>						
62	<b>Bota përmes informimit (13 orë)</b>	7.2 (1)	Butrinti, UNESCO Gjymtyrët homogjene	Njohje Riprodhim	Punë në grupe. Shkrim i lirë.		Tekste jashtëshkollore	
63		7.2 (2)	Butrinti, UNESCO Ushtrime (12)					
64		7.2 (3)	Lashtësia e përrallave, Dejvid Shulc					
65		7.2 (4)	Lashtësia e përrallave, Dejvid Shulc Gjymtyrët e veçara Ushtrime (13)					
66		7.2 (5)	Lashtësia e përrallave, Dejvid Shulc. <b>(VLERËSIM I PORTOFOLIT)</b>					
67		7.2	<b>PUNË ME SHKRIM (5)</b>				Vlerësim	

		(6)	<b>TEKST INFO-PARAQITËS</b>			individual për punë me shkrim	
68		7.2 (7)	Recension i vonuem, Ardian Ndreca.				
69		7.2 (8)	Recension i vonuem, Ardian Ndreca. Përdorimi i shenjave të pikësimit (presja, pikëpresja, dy pikat).				
70		7.2 (9)	Recension i vonuem, Ardian Ndreca.				
		<b>Pjesa 7.3 Përsiatje dhe endje</b>					
71		7.3 (1)	<b>PROJEKT (DISKUTIM, PREZANTIM) (4)</b> “Gjuha standarde dhe ne” ose “Logoja më e dashur”, “Kënga që na emocionon”, “ <b>Kuq e zi</b> ”, “Skuadra e zemrës” (material mbështetës: Karton <b>kuqezi</b> , <b>Ardian Vehbiu</b> )			Test përfundimtar  Vlerësim i portofolit	
72		7.3 (2)	<b>TEST 3</b>				

## PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE

### TEMA MËSIMORE 1.1 (1) PROCESI I KOMUNIKIMIT. GJUHA VERBALE DHE JOVERBALE. STRATEGJITË E TË FOLURIT. KARAKTERISTIKAT E NJË DISKUTIMI. GJUHA E TRUPIT

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 1</b>			
<p>Krijohet një mjedis i pasur komunikimi me grupe të vogla nxënësish, që bisedojnë me njëri-tjetrin me fjalë, shenja; pastaj grupet futen në një situatë ku secili grup diskuton për një çështje, më pas lideri i çdo grupi prezanton idenë e tij. Nga kjo përvojë propozohen disa rregulla standarde për një komunikim ideal.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon për llojet e komunikimit, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me to, si dhe duke diskutuar mbi informacionin për këtë temë, nxjerrë nga fushat e të nxënit (p.sh. gjuhë, komunikim) ose nga jeta e përditshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për mënyrat dhe prioritetet që ofron komunikimi dhe format e ndryshme të tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të mënyrave dhe teknikave të komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p> <p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me komunikimin, teknikat dhe llojet e tij.</p>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;</li> <li>• përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme</li> <li>• përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të teksteve të ndryshëm;</li> <li>• realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të folurit;</li> <li>• përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Komunikim Zëri, Toni Gjestura Standard Diskutim Prezantim Audiencë Logjikë</p>
<p><b>Burimet:</b></p> <p><b>Vetjake:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;</p> <p><b>Specifike:</b> Rrethanat stimuluese, kontekste audiovizive;</p> <p><b>Te jashtme:</b> materiale të shtypit të shkruar, modele të komunikimi, Figura të gjuhës së shenjave, libri i nxënësit;</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Komunikim:</b> përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij masiv.</p> <p><b>Letërsi:</b> Tekste letrare</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar.</p> <p><b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përvijim i mendimit</li> <li>• Të nxënit ndërveprues</li> <li>• Stuhi mendimi</li> <li>• Hartë konceptesh</li> <li>• Diagramë Veni</li> <li>• Punë në grup</li> <li>• Praktikë e drejtuar</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
	<p>Mësuesja prezantoi veten, një CV të shkurtër për kualifikimin që ka, jep një numër kontakti dhe më pas paraqet në vija të përgjithshme lëndën që do zhvillojë. Pasqyra e lëndës pa hyrë në detaje e dhënë me pozitivitet dhe në mënyrë interesante krijon në klasë një mjedis të ngrohtë, i cili vazhdon me thirrjen emrave të nxënësve ku për secilin mësuesi bën një pyetje apo koment miqësor.</p> <p>Mirë do të ishte të nisesh mësimi edhe me një ftesë drejtuar nxënësve për të parë fotografinë me të cilën hapet Njësia I</p>

Për të siguruar përvijimin e mendimit, mësimi nis me pyetje të tilla:

- Për çfarë na shërben komunikimi?
- Cilët mund të jenë pjesëmarrësit në një komunikim?
- Si komunikoni ju në jetën e përditshme?

Një nxënës ftohet të shkruajë në dërrasë Skemën e komunikimit Tip, (të cilën nëse nxënësit s'e kujtojnë, mësuesi e organizon vetë dhe kërkon të kujtojnë kuptimin e secilit element.)




Ndërkohë që me një shembull mund të arsyetojnë mbi të (p.sh. shkruhet një fjali në tabelë, gjenden elementet e komunikimit dhe përcaktohen tiparet e situatës së komunikimit)

II. Klasa ndahet në grupe të vogla dhe secilit i jepet një detyrë: 1. Diskutoni mbi një temë; 2. Prezantoni një ide përmes njërit prej nxënësve; 3. Provojnë të flasin me gjeste për të komunikuar diçka; 4. Dërgojnë një mesazh me letër a celular. 5. Të komunikojnë mesazhe me kode shenjash.

- Si u përcollën mesazhet?
- Çfarë përdorët më tepër: fjalët, gjestet, zërin, aparatin, letrën?
- Si kaloi mesazhi?

Pasi përcillen mesazhet në të gjithë pjesëtarët e grupit, atëherë nxënësve iu kërkohet të plotësojnë skemën:




➤ Nga përvoja e tyre nxënësit plotësojnë së bashku me mësuesen tabelën.

III. Nxënësve iu kërkohet të krahasojnë dhe dallojnë llojet e komunikimit:

- Pse është kompleks komunikimi?
- Si e ndihmon gjuha joverbale ato verbale?
- Si duhen përdorur ato për të arritur një komunikim të mirë?
- Sillni shembuj nga përvoja juaj mbi këtë integrim të këtyre llojeve të komunikimit.

Nxënësve iu kërkohet t'i krahasojnë këto komunikime me diagram Veni:



**IV.** Klasa ndahet në katër grupe të mëdha: **1.**I jepet një çështje për bisedë; **2.** Zgjidhet nje temë për diskutim;

**3.** Zgjedh një ide për një prezantim të shkurtër; **4.** Ben një pantomë.

Pasi iu lihet 3-4 minuta të diskutojnë bën secili grup paraqitjen e vet.

Vlerësohet paraqitja e secilit grup shpejt dhe pyesim:

- a. Në ç'mënyrë paraqiten mesazhet në këto situata?
- b. A kanë standarde këto paraqitje?
- c. Ç'mund të ndryshonim në këto paraqitje?
- d. A ishte i suksesshëm ky komunikim?

Në këtë fazë, që nxënësit merren me tekstin, mësuesi/ja bën një paraqitje në video të një prezantimi, diskutimi, ligjërimi, a grupi shenjash rreth 1 minutë secila dhe pastaj pyet në klasë :

- Çfarë ka të vecantë në to?
- Si e arrin secili nga komunikuesit standardin?
- Çfarë mendoni se duhet të kenë parasysh ata, për të arritur një komunikim ideal?
- Cilat mund të jenë disa nga këshillat?
  - Diskutojnë 3-4 minuta
  - Nxënësit shohin në libër standardet dhe strategjitë, ndërkohë që mësuesi/ja i paraqet të përmbledhura në tabelë, monitor ose Power point të organizuara.
  - Lexojnë në grupe dyshe –treshe dhe nënvizojnë.

#### **V. Përmbledhje pohim/ mbështetje:**

##### **Të folurit- Strategjitë**

- Përdor gjuhë standarde;
- Merr role të ndryshme menaxhuese në grup;
- Respekton karakteristikat e llojit që përdor (fjalim, shpjegim, raport, debat);
- Përzgjedh fjalë, fjali, mjete të fig.e retorike;
- Vlerëson TIK dhe mjetet etj digjitale.

##### **Diskutimi- Strategjitë**

- Familjarizohuni me temën dhe perceptoni mire kuptimet e saj;
- Përpiquni të zbuloni se cili është thelbi që iu kërkohet (koncept, analizë, temë, pikëpamje);
- Shpjegoni paqartësitë Brenda vetes gjatë diskutimit;
- Krijoni sigurinë të bashkëfolësit tuaj. Ruani integritetin tuaj dhe të bashkëbiseduesit;
- Merrni rolin tuaj ne diskutim, duke e respektuar atë si të rëndësishëm.

##### **Mënyrat dhe mjetet e prezantimit:**

- Drejtojuni audiencës, duke e parë në sy dhe me gjuhën që ajo kupton më mirë;
- Jini konciz/i thukët dhe mënjanoni info e tepërt. Ruani cilësinë dhe injoroni detajet e panevojshme.

- *Theksoni idenë kryesore të prezantimit, ato çka do donit që të tjerët të mbajnë mend nga prezantimi juaj.*
- *Ndiqni një linjë logjike nga fillimi deri në mbyllje.*
- *Praktikoni dhe matni kohën e nevojshme paraprakisht, që të jeni sa më shumë brenda asaj që do prezantoni.*
- *Mendoni se jeni në një skenë duke u qasur me ndjesinë e audiencës.*
- *Përdorni mjetet e TIK me efikasitet, jo si fletë leximi, por si ilustrime të asaj që prezantoni.*
- *Kontrolloni paraprakisht tërë materialin e përgatitur, sidomos pjesën digjitale, pa humbur kontrollin.*
- *Mos harroni falenderimet për bashkëpunëtorët që iu kanë ndihmuar në punën tuaj, realë a virtualë, pa të cilët ju nuk do të kishit qenë të suksesshëm. Kjo tregon seriozitet dhe profesionalitet.*

Nxënësit iu hedhin një vështrim tërësor mbi këto sugjerime dhe këshillohen që të praktikojnë në shtëpi ato.

#### VI. Praktikë e drejtuar

- Zgjidhen tre nxënës të prezantojnë me gjeste disa shenja dhe jepen shpjegimet për kuptimet që marrin
- Diskutohen në klasë ato dhe bëhen komente nga nxënësit. (*vende të ndryshme, interpretime të ndryshme*)
- Imitohen forma të tjera mesazhesh me gjeste të jetës së përditshme.

#### Detyrat dhe puna e pavarur:

- Sipas grupeve; mendoni se cilat nga rregullat janë më të rëndësishme dhe cilat më pak. Shënoni me të gjelbër ato më të rëndësishmet dhe me të zeze ato më pak të rëndësishmet.
- Cilat prej tyre ju dini t'i respektoni në përditshmëri dhe cilat jo?
- Caktoni si detyrë për veten se cilat prej tyre do praktikoni.

#### ➤ Detyrë shtëpie:

U.2 dhe U.4. f. 18

#### Shënim

(U. 4. duke iu përshtatur grupeve që punuan në klasë)



Parapërgatisim klasën për orën tjetër, diskutimin e fotografisë dhe mesazhin që ajo përcjell. **Diskutim i lirë**

#### Vlerësimi i situatës:

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë llojet dhe tiparet e komunikimit dhe t'i zbërthejnë ato konkretisht;
- flasin dhe prezantojnë me qasje drejt standardit;

#### Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit
- për realizimin e hapave të procesit të komunikimit



**TEMA MËSIMORE 1.1 (2) TË DËGJUARIT, TË LEXUARIT DHE TË SHKRUARIT PËR QËLLIME PERSONALE**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 2</b>			
<p>Krijohet një mjedis i pasur komunikimi me grupe të vogla nxënësish, që dëgjojnë mesazhe zanore; lexojnë tekste të shkurtra. Pastaj grupet futen në një situatë ku një grup diskuton për mesazhet që dëgjon, lexuesit për tekstet që lexojnë dhe një lider i një grupi prezanton idenë e tij. Nga kjo përvojë propozohen disa rregulla standarde për një komunikim ideal nëpërmjet dëgjimit dhe leximit. Këto mesazhe i shkruajnë në forma të ndryshme dhe përcjellin prej tyre rregullat dhe standardet.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon për llojet e komunikimit dhe mesazheve që merr, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me to, diskuton mbi informacionin për këtë temë, nxjerrë nga fushat e të nxënit (p.sh. gjuhë, komunikim, komunikim masiv) ose nga jeta e përditshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për mënyrat dhe prioritetet që ofron komunikimi dhe format e ndryshme të tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin e komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b></p> <p>Nxënësi harton situata të përshtatura në botën e gjallë (p.sh: publicistikë, në lidhje me mjedisin social ku ata bëjnë pjesë në përditshmërinë e tyre), duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, në përputhje me rezultatet e pritshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të mënyrave dhe teknikave të komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p> <p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me komunikimin, teknikat e llojet e tij dhe kanalet e komunikimit.</p>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutimet në klasë për kanalet e ndryshme të komunikimit, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;</li> <li>• përdor strategji të të dëgjuarit, për mbajtjen e shënimeve, përmbledhjen e informacionit etj. që demonstrojnë, të mesazheve dhe standardeve që duhen përdorur për një komunikim më cilësor.</li> <li>• përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të këtyre llojeve të komunikimit;</li> <li>• realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të folurit;</li> <li>• përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> Komunikim Proces Dëgjim/dëgjues Standard Strategji Lexim/lexues Tekst Shkrues Qëllim</p>
<p><b>Burimet:</b> <b>Vetjake:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; <b>Specifike:</b> Rrethanat stimuluese, kontekste Audio- vizive; <b>Të jashtme:</b> materiale të shtypit të shkruar, modele të komunikimit, figura të gjuhës së shenjave, libri i nxënësit; <b>Mjete:</b> tabela, <i>fleep-charter</i>, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Komunikim:</b> Nxënësi përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij masiv. <b>Letërsi:</b> Nxënësi përdor tekste letrare dhe joletrare. <b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar. <b>Qytetari:</b> Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutim njohurish paraprake</li> <li>• Këmbim njohurish</li> <li>• Stuhi mendimi</li> <li>• Organizuesi logjik i analogjisë</li> <li>• Punë në grup</li> <li>• Praktikë e drejtuar</li> <li>• Rishikim</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë (<b>U.2,4 fq. 18</b>), ku nxënësit diskutojnë mbi materialet e tyre.</li> <li>➤ Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë, të plotësojnë dhe të vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës.</li> <li>➤ Mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve në komentën e disa prej rregullave që kanë përdorur ata në realizimin e punës së tyre dhe çfarë mund të kishin plotësuar më tepër.</li> </ul> <p>I. Në këtë moment për të hyrë natyrshëm tek procesi i të nxënit mësuesi/ja tërheq vëmendjen me situatë ku dëgjohej një mesazh zanor në një variant audio (ose lexohet një tekst i shkurtër dhe fokusohet vëmendja te dëgjimi).</p> <p>Klasa ndahet në 5 grupe, paraprakisht dhe secilit grup i është dhënë një detyrë përkatëse</p>	

(shpërndarë me fisha a me etiketa):

1. Reflektoni mbi kuptimin e tekstit;
2. Parafrazoni këtë tekst/mesazh që dëgjuat me fjalët tuaja;
3. Nxirrni një veçori të këtij teksti dhe interpretoni atë;
4. Zhvilloni idenë e folësit me qëndrimin tuaj;
5. Mbani disa shënime shkurt që të nxirrni kuptimin e tekstit.
6. Përdorni saktë terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruani

Pasi punojnë 4-5 minuta pasi dëgjojnë tekstin, nxënësit sjellin qëndrimet a reflektimet e tyre.

Diskutohen ato për secilin grup dhe merren disa vlerësime në klasë për reflektimet e tyre.

Për të ndërtuar një lidhje të brendshme mes proceseve të të dëgjuarit, të të lexuarit dhe të të shkruarit, nxënësve u kërkohet të rikujtojnë:

- a) Me cilin lloj komunikimi lidhet procesi i të dëgjuarit ? Po i të folurit?
- b) Ku ndryshon procesi i të shkruarit nga dy të parët?
- c) Si integrohen ato proceset me njëri-tjetrin?
- ç) Si e ndihmojnë ato njëra-tjetrën?
- d) Çfarë kodi, kanali përdor secili lloj komunikimi në procesin e realizimit të tij?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve plotësojnë edhe kllasterin

**Fig.1 mësimi 2**

## **II. Ndërtimi i njohurive nis me procesin e të dëgjuarit sepse aty gërshetohen edhe procesi i të folurit dhe i të lexuarit për t'u dëgjuar.**

- Klasa ndahet në 5 grupet (që ishin ose i riorganizonin ata) dhe iu jepet një tekst i shkruar me qëllim të përcaktuar edhe për lexim e përpunim.
- Klasa bën një përgatitje për lexim, e ndihmuar nga mësuesi, i cili paraqet kontekstin dhe iu jep disa informacione kyçe nxënësve me fjalë kyçe të tekstit që do t'u shpërndajë, (zgjidhet një tekst i thjeshtë: lajm, tekst i shkurtër informues etj.).

a) Vendosni një qëllim, i cili shprehet shkurt;

b) Bëj një parashikim të shpejtë se çfarë pritmërisht keni nga leximi;

c) Çfarë fjalori mendoni se do të ketë ky tekst (në vijë të përgjithshme);

ç) Çfarë dini për këtë temë? Po për këtë lloj teksti?

➤ Mësuesi/ja merr nga nxënësit parashikimin për tekstin dhe përgatitet ta lexojë atë me laps.  
(mundësisht me ngjyra.)

1. Grupi 1 nxjerr kuptimin e tekstit (shpjegon shkurt se çfarë kuptoi dhe çfarë jo nga teksti);
2. Përcakton me shenja dalluese (nxjerr nga njohuritë në lëndë të tjera) dhe përgatit me laps pikat kyçe të informacionit në tekst;
3. Dallon strukturën e tekstit nga mënyra e organizimit të jashtëm, për të kuotuar mënyrën se si zhvillohet idea kryesore e autorit.
4. Bën disa pyetje rreth tekstit duke lidhur informacionet kryesore me përvojën vetjake.
5. Përmbledh tekstin me fjalë të përgjithshme.

6. Korrigjon nga ana gramatikore dhe sigurohet drejtshkrimi dhe pikësimi sipas gjuhës standarde shqipe.

- Nxënësit punojnë rreth 5-6 minuta me tekstin dhe më pas sjellin analizat dhe qëndrimet e tyre. Bëhen ndërhyrje nga mësuesilja për arritjet e grupeve dhe vlerësohen shkurt rezultatet e tyre.

Në këtë mënyrë mësuesi e çon nxënësin tek teksti dhe standardet e leximit përmes punës së tyre dhe i përgatit ata për punë të pavarur në një tekst të shkurtër që do të shkruajnë.

**IV.** Në këtë etapë shkohet tek qëndrimet me shkrim të një teksti.

- Mësuesilja e ndan klasën në dy grupe të mëdha dhe e drejton vëmendjen e nxënësve në tekstin e nxënësit në faqen 20-21 grupi i parë dhe 21-23 grupi i dytë.
- Nga teksti me të cilin ata punuan në etapën paraardhëse mësuesilja njerr një **ide** a **temë** të strukturuar dhe ua sugjeron nxënësve që të shkruajnë (grupi 1 për nevoja personale dhe grupi 2 si detyrë funksionale).
  - Nxënësit shkruajnë disa minuta një tekst të shkurtër, duke pasur parasysh rregullat e shkrimit;
  - Iu lihet kohë e limituar për rishikim.

Gjatë kohës që nxënësit shkruajnë, mësuesi paraqet në tabelë, monitor ose flip-charter në formën e **MEMO-s**, (sugjerimet që do të ndiqen nga nxënësit gjatë kësaj kohe), disa nga rregullat që një shkruar duhet të ketë parasysh.

**Veprimet për çdo hap të procesit të shkruarit**

Parashkrimi:

- mendo për një çështje;
- fill ndërmend njohuri rreth saj;
- parashiko dhe diskuto;
- planifiko idetë e tua.

Skicimi/draftimi/shestimi:

- organizo idetë;
- përshkruaj dhe shpjego;
- përqendrohu dhe projekto;
- shkruaj.

Konsultimi/ndarja me të tjerët:

- diskuto idetë;
- dëgjo sugjerimet.

Rishikimi dhe reflektimi:

- merr parasysh sugjerimet e të tjerëve;
- vlerëso dhe gjyko.

Redaktimi:

- bëj përmirësime;
- rikorrigjo dhe riformo.

Konsultimi me mësuesin/shkrimi përfundimtar:

- diskuto ndryshimet e fundit;
- shkruaj punimin përfundimtar.

Publikimi:

- ndaj me audiencën produktin e shkruar.

**Të shkruarit për një audiencë/lexues të përcaktuar:**

- Shkruesi/nxënësi duhet ta ketë të qartë se kujt po i shkruan:
  - a) një auditori të njohur/ të zgjeruar;
  - b) një auditori të zgjeruar, të panjohur.
- Duke përcaktuar audiencën, duhet të kemi parasysh:
  - a) Ç'dinë lexuesit për çështjen;
  - b) Çfarë informacioni do t'u interesonte;

- c) Çfarë vlerash janë të rëndësishme për ta;
  - ç) Cilët shembuj dhe argumente u përshtaten;
  - d) A do të ndihen më mirë me një trajtim formal ose rastësor të çështjes?
  - dh) Ç'lloj formati do të jetë më tërheqës për ta?
- Lexuesi e mirëpret një shkrim, kur ai e respekton personin që e shkruan:
    - a. Të tregojmë që jemi të mirinformuar rreth çështjes që po trajtojmë;
    - b. Të tregojmë që kemi bërë kërkime a lexime të plota dhe kemi përvojë ;
    - c. T'i tregojmë lexuesit që jemi të besuar;
    - ç) Të japim informacion të sigurt;
    - d. T'i tregojmë lexuesit që jemi të arsyeshëm dhe të paanshëm;
    - dh) Të përdorim ton të besueshëm dhe të shprehim edhe opinionin/mendimin e kundërt.
  - Lexuesi u beson shkruesve që i "sheh" si të besuar, prandaj argumentet duhet t'i mbështetim në burime të respektueshme dhe të vërteta.
    - a) Të lexojmë sa më shumë para se të shkruajmë rreth çështjes që do të trajtojmë;
    - b) Të bëjmë punë parapërgatitore;
    - c) Të shfletojmë burime të ndryshme që japin kuptimin e terminologjisë kyçe të koncepteve që ngjallin debat rreth çështjes;
    - ç) Të kërkojmë me hollësi për çështje të veçanta ku do të përqendrohemi në punën tonë.

#### Këndvështrimi i shkrimit

- Kur fillojmë të shkruajmë, duhet të kemi parasysh se nga cili këndvështrim do t'i shprehim idetë,
  - ✚ *këndvështrimi fizik*, pra duhet të gjejmë vendin dhe pozicionin e përshtatshëm nga do ta vështrijmë objektin.
  - ✚ *këndvështrimi vetjak*: cili është rrëfyesi? Duhet pasur parasysh se ngjarja mund të tregohet në vetën e parë, të tretë ose në vetën e dytë, të përdorur me kuptim vetor të përgjithësuar ose kur i drejtohem dëgjuesit a dëgjuesve.
  - ✚ *këndvështrimi mendor*, pra gjendja shpirtërore në çastin e shkrimit.

#### Formati i shkrimit

- Lloji i punës me shkrim përcakton edhe formatin e shkrimit:
  - a. **Formati** i një lajmërimi, artikulli, autobiografie/biografie, ditari, tregimi, poeme, poezie, monologu, fabule, letre urimi, kërkese, interviste, historie të shkurtër, gazmoreje/përvoje vetjake, udhëzimi etj.
  - b. **Tema** (varet nga kërkesa dhe mundësitë e shkruesit).
    - *Lexohen disa shënime individuale të nxënësve.*
    - *Vlerësohen disa prej tyre.*

*P.s. Nëse nuk del koha për lexim dhe vlerësim, atëherë nxënësit njoftohen se në fillim të orës së ardhshme ata do të lexojnë shkrimet e tyre. Ata duhet vetëm të fokusohen në tabelë dhe të përsëritin detyrat kryesore.*

#### Detyrë shtëpie:

Ushtroni me gojë mbi kërkesat e f. 23 dhe sistemojini ato;

Në tekstet e shkruara në klasë analizoni se cilat nga rregullat e mësuara nga teoria keni arritur të zotëroni. Bëni një klasifikim të tyre.

Vlerësoni shkurt veten se ç'loj shkruesi jeni: i arrirë, measatar, nënmesatar.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përgjigjen saktë;</li> <li>• dallojnë tiparet e strukturës dhe të teknikave të shkrimit të një tekstit dhe i zbërthejnë ato konkretisht;</li> <li>• shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit;</li> <li>• vlerësojnë arritjet dhe shkathtësitë e tyre në situatën e të nxënit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë e përgjigjeve që lidhen me detyrën e shtëpisë dhe ushtrimet në klasë;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

### TEMA MËSIMORE 1.1 (3) USHTRIME. PRAKTIKË

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla V	Klasa 10
<b>Tematika:</b> Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe			
<b>Situata e të nxënit nr. 3</b>			
<p>Krijohet një mjedis i pasur komunikimi me grupe të vogla nxënësish, që dëgjojnë mesazhe zanore; lexojnë tekste të shkurtra, pastaj grupet futen në një situatë ku një grup diskuton për folësin dhe vlerat e tij, mesazhet që dëgjon, lexuesit për tekstet që lexojnë. Ata ushtrohen në ushtrime konkrete për t'i përdorur teknikat e komunikimit për qëllime personale.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi ushtrohet për llojet e komunikimit dhe mesazhet që merr, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me to, diskuton mbi informacionin për këtë temë, nxjerrë nga fushat e të nxënit (p.sh. gjuhë, komunikim, komunikim masiv) ose nga jeta e përditshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për mënyrat dhe prioritetet që ofron komunikimi dhe format e ndryshme të tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre të grupit, individuale apo aktivitetit dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin e komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b></p> <p>Nxënësi hartoi situata të përshtatura në botën e gjallë (p.sh. publicistikë, në lidhje me mjedisin social ku ata bëjnë pjesë në përditshmërinë e tyre), duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar</p>			

të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, në përputhje me rezultatet e pritshme.

➤ **Kompetenca personale**

Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat, përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, dëgjimit, shkrimit; vlerësimit të mënyrave dhe teknikave të komunikimit.

➤ **Kompetenca qytetare**

Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të komunikimit.

➤ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me komunikimin, teknikat e llojet e tij dhe kanalet e komunikimit.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në diskutimet në klasë për kanalet e ndryshme të komunikimit, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;</li> <li>• përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme</li> <li>• Përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të këtyre llojeve të komunikimit;</li> <li>• Realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të folurit;</li> <li>• Përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> Komunikim Proces Folës i mirë Dëgjim/dëgjues Praktikë Strategji/leximi Tekst Shkruar i qëllimshëm Përmbledhje</p>
<p><b>Burimet:</b> <b>Vetjake:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; <b>Specifike:</b> Rrethanat stimuluese, kontekste audiovizive; <b>Te jashtme:</b> materiale të shtypit të shkruar, modele të komunikimit, libri i nxënësit; <b>Mjete:</b> tabela, <i>fleep-charter</i>, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Komunikim:</b> Nxënësi përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij masiv. <b>Letërsi:</b> Nxënësi përdor tekste letrare dhe joletrare. <b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar. <b>Qytetari:</b> Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>

<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutim njohurish paraprake</li> <li>• Rrjeti i diskutimit</li> <li>• Këmbim njohurish</li> <li>• Punë në grup</li> <li>• Praktikë e drejtuar</li> <li>• Shkrim i shpejtë</li> <li>• Rishikim</li> </ul>	<b>Koha: 45'</b>
<b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë të dhëna nga mësuesi, ku nxënësit diskutojnë mbi materialet e tyre e sidomos analizën e bërë mbi rezultatet e arritura në shkrimet e orës së kaluar.</li> <li>➤ Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë, të plotësojnë dhe të vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës.</li> <li>➤ Mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve në komentin e disa prej rregullave që kanë përdorur ata në realizimin e punës së tyre dhe çfarë mund të kishin plotësuar më tepër.       <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cilat nga rregullat kishit parasysh më tepër kur shkruat?</li> <li>2. Çfarë vështirësish hasët në këtë punim?</li> <li>3. Cilat nga rregullat mbani mend më mirë?</li> <li>4. Cilin proces e keni më të lehtë për ta realizuar? Pse?</li> </ol> </li> <li>➤ Meqenëse kjo orë konsiderohet si orë praktike, edhe puna e mësuesit do të konsiderohet si nxitës i aftësive dhe shkathtësive të tyre në praktika të drejtuara.</li> <li>➤ Sugjerohet që mësuesi të ndjekë sipas përvojës së tij mundësi alternative që e çojnë nxënësin te përfitimi i shkathtësive personale dhe kolektive (grupe të vogla).</li> <li>➤ Nxënësve iu është sugjeruar orën e kaluar të sjellin me vete nga një tekst (të llojeve të ndryshme), një pjesë audio ose video dhe punë të shkruara nga ata vetë për qëllime të ndryshme.       <p><b>A. Varianti 1.</b></p> </li> <li>➤ Klasa ndahet në 3 grupe të mëdha dhe më pas në grupe më të vogla, që i dedikohen njëri-tjetrit.       <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njëri grup punon me një tekst të dëgjuar (sugjerohet: Fjalimi i Kadaresë në marrjen e çmimit “Asturias”; një lajm televiziv; një reportazh; një debat ose përdoren tekste të shkëputura nga librat e lëndëve të tjera, si histori, gjeografi etj.)</li> <li>2. Grupit 2 i sugjerohet një tekst për të lexuar.</li> <li>3. Grupi 3 (grupi i ekspertëve) përgatit draftin e vlerësimit të grupeve dhe prezanton ide të nxjerra nga tekstet e grupeve 1 dhe 2.</li> </ol> </li> <li>➤ Grupet punojnë disa minuta dhe me detyra të përcaktuara:       <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Reflektoni</b> mbi kuptimin e tekstit;</li> <li>2. <b>Parafrazoni</b> këtë tekst/mesazh që dëgjuat /lexuat me fjalët tuaja;</li> <li>3. <b>Nxirrni një veçori</b> të këtij teksti audio/i shkruar dhe <b>interpretoni</b> atë;</li> <li>4. <b>Zhvilloni</b> idenë e folësit /shkruesit me qëndrimin tuaj;</li> </ol> </li> </ul>	



5. **Mbani disa shënime** shkurt që të nxirrni kuptimin e tekstit.

6. Përdorni disa **strategji** për secilin proces dhe komentoni ato.

- Pasi punojnë 4-5 minuta pasi dëgjojnë/lexojnë tekstin, nxënësit sjellin qëndrimet a reflektimet e tyre.

Diskutohen ato për secilin grup dhe merren disa vlerësime në klasë për reflektimet e tyre.

- Grupi i ekspertëve (ndahet në dy grupe më të vogla: një që vlerëson grupin 1 dhe tjetri vlerëson grupin II) gjatë kohës që relatojnë grupet e tjera mban shënime dhe përgatit prezantimin për secilin grup.

Lihen disa minuta kohë për këtë dhe nis vlerësimi.

Gjatë prezantimit nxitet nga ana e mësuesit një diskutim mbi nevojat dhe përparësitë e respektimit të standardeve gjatë ushtrimit të kompetencave në secilin proces, të dëgjuarit dhe të lexuarit.

- **Të dëgjuarit:**

a) reflekton ndaj informacioneve;

b) përmbledh/parafrazon informacionin;

c) analizon stilin, strukturën;

ç) zgjeron idetë e folësit;

d) mban shënime.

- **Të folurit:**

a) nxjerr kuptimin e tekstit;

b) përcakton me shenja dhe përgatit pikat kyçe të informacionit në tekst;

c) dallon strukturën e tekstit;

ç) bën disa pyetje rreth tekstit;

d) përmbledh tekstin me fjalët e tij.

- Pas disa përgjigjeve të marra nga diskutimi mësuesi/ja tërheq vëmendjen e klasës që të punojë me shkrim një tekst të shkurtër, me një nga idetë kryesore të nxjerra nga kuptimet e teksteve.

- Klasa ndahet në dy grupe dhe një grup punon me një tekst për qëllime personale dhe tjetri për qëllime profesionale/drejtuar një audience të caktuar.

- Nxënësve iu sugjerohet të ruajnë standardet që duhet të plotësojë një shkruar i mirë.

Klasa shkruan disa minuta (sugjerohet rreth 7-8 minuta) ;

Rilexojnë tekstet e tyre dhe bëhen gati për interpretimin.

Në vlerësimet e shkrimeve mësuesi/ja mund të ketë parasysh edhe një diagramë/tabelë ku vendos dallimet mes një shkrimi për qëllime personale dhe një tjetri për qëllime audience, të cilën e vendos/shkruan, ndërkohë që nxënësit punojnë:

**A. Për nevoja të ndryshme personale :**

Parashkrimi

Skicimi/draftimi/shestimi

Konsultimi/ndarja me të tjerët

Rishikimi dhe reflektimi

**B. Për qëllime auditori:**

Të shkruarit për një audience /lexues të përcaktuar

Këndvështrimi i shkruarit

Redaktimi:

Konsultimi me mësuesin/

shkrimi përfundimtar

Formati i shkrimit

Publikimi

➤ Nxënësi duhet të dallojë që më parë këto dy lloje të shkrimit të varura nga qëllimi që ka.

Kuptohet që në një kohë jo të plotë edhe vlerësimi për to do të jetë i pjesshëm.

Më pas shkohet natyrshëm në disa konkluzione tërësore për dy mënyrat e shkrimit të teksteve.

1. Nga dallohen këto tekste?
2. Çfarë kanë të përbashkët?
3. Si përcaktohet tema në të dyja llojet e shkrimeve?
4. Nga se varet formati i një shkrimi?
5. A është përcaktuese audiencia /marrësi për llojin e shkrimit?

Bëhet një përsëritje e shpejtë nëpërmjet këtyre pyetjeve, duke nxjerrë edhe konkluzione.

Nxënësve iu rekomandohet të përsërisin disa nga konceptet e përpunuara këto dy orë dhe u jepen detyra.

#### **Varianti B.**

Grupet zgjedhin nga një pjesë, punojnë me to dhe “sfidojnë” njëri-tjetrin duke ofruar pyetje rreth tekstit.

#### **Varianti C**

Grupet vendosen përballë njëri-tjetrit. Një grup lexon dhe tjetri dëgjon duke nënvizuar gjërat më të rëndësishme.

#### **Varianti D**

Konkurs ndërmjet grupeve të dëgjuesve, lexuesve, shkruarëve me të njëjtin argument apo me argumente të ndryshme.

Pavarësisht nga mënyra që mësuesi/ja zgjedh për t’i vënë në punë nxënësit sugjerohet që pjesa e pyetjeve për përsëritjen e koncepteve të realizohet me qëllim që nxënësit të përvetësojnë dhe të përfitojnë përmes veprimtarive shkathtësitë e planifikuara e që do t’u nevojiten gjatë gjithë kohës.

#### **Detyrë shtëpie:**

Ushtroni me gojë duke përgatitur një fjalë a një ligjëratë për një auditor.

Shkruani një tekst për një fjalim para klasës “Mbi ndërgjegjësimin e nxënësve për ruajtjen e mjedisit rreth shkollës”.

Vlerësoni shkurt veten se ç’lloj shkruarë jeni: i arrirë, mesatar, nënmesatar.

<b>Vlerësimi i situatës:</b>	<b>Vlerësimi i nxënësve:</b>
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"><li>• përgjigjen saktë;</li><li>• përdorin drejt strategjitë e të dëgjuarit, të lexuarit;</li><li>• dallojnë tiparet e strukturës dhe të teknikave të shkrimit të një teksti dhe i</li></ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"><li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li><li>• për saktësinë e përgjigjeve që lidhen me detyrën e shtëpisë dhe ushtrimet në klasë;</li><li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li></ul>

zbërthejnë ato konkretisht; • shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit; • vlerësojnë arritjet dhe shkathhtësitë e tyre në situatën e të nxënit.	• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit; • për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit; • për vetëvlerësimin e aftësive e të shkathhtësive të arritura.
--	--

## TEMA MËSIMORE 2.1 (1) TEKSTI DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ. STRUKTURA DHE LLOJET E TEKSTIT

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Njohuri të përgjithshme mbi tekstin</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 4</b>			
<p>Krijohet një mjedis i ngjashëm me bibliotekën; Nxënësit lexojnë tekste të shkurtra, pastaj grupet futen në një situatë, diskutojnë për mesazhet që përcjellin tekste. Disa prezantojnë idetë e tyre mbi karakteristikat e tekstit dhe llojet e tyre. Nxënësit lexojnë, shkruajnë, përmbledhin.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon për tekste dhe llojet e tyre dhe mesazhet që merr, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me to, diskuton mbi informacionin për këtë temë, nxjerrë nga fushat e të nxënit (p.sh. gjuhë, komunikim, tekste gjuhësore, letrare, artikuj të ndryshëm) ose nga jeta e përditshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për rëndësinë e teksteve në jetën tonë dhe format, strukturën, dhe llojet e ndryshme të tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi demonstroi shkathhtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin e komunikimit, nëpërmjet leximit të teksteve.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b></p> <p>Nxënësi harton situata të përshtatura në botën e gjallë (p.sh: publicistikë, në lidhje me mjedisin social ku ata bëjnë pjesë në përditshmërinë e tyre), duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, në përputhje me rezultatet e pritshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të mënyrave dhe teknikave të komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p> <p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të komunikimit.</p>			

➤ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me komunikimin, teknikat dhe llojet e tij dhe kanalet e komunikimit.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- merr pjesë në diskutimet në klasë për tekstet, duke marrë në konsideratë qëllimin, karakteristikat dhe situatën e komunikimit në një tekst, si dhe përmbledh përfundimet e një teksti;
- përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme
- përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të këtyre llojeve të komunikimit;
- realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të folurit;
- përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.

**Fjalët kyçe:**

Tekst /Pëlhurë  
Parashtrim  
gjuhësor/jogjuhësor  
Formë  
Strukturë  
Tipare  
Njësi gjuhësore  
Situatë komunikuese  
**FJALOR**  
**ENCIKLOPEDIK**  
etruskët  
Kuintiliani  
Robert Shvarc

**Burimet:**

**Vetjake:** Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;

**Specifike:** Rrethanat stimuluese, kontekste tekstuale të ndryshme;

**Te jashtme:** materiale të shtypit të shkruar, modele të tekstesh të ndryshme, figura të gjuhës së shenjave, libri i nxënësit;

**Mjete:** tabela, *fleep-charter*, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor, ose tabelë interaktive),

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**

**Komunikim:** Nxënësi përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij tekstor.

**Letërsi:** Nxënësi përdor tekste letrare dhe joletrare.

**TIK:** Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar, fjalor.

**Qytetari:** Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**


- Diskutim njohurish paraprake
- Stuhi mendimi
- Organizuesi grafik
- Punë në grup
- Praktikë e drejtuar
- Përmbledhje e strukturuar
- Shkrim i shpejtë/Rishikim

**Koha: 45'**

**Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:**

- Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë, të dhëna nga mësuesi, ku nxënësit diskutojnë mbi materialet e tyre.
- Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë, të plotësojnë dhe të vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës.

- Mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve në komentin e disa prej vlerësimeve që kanë bërë ata për realizimin e punës së tyre dhe çfarë mundësish kishin për të arritur më tepër.



**Vëreni me kujdes fotot e sjella në anë dhe thoni se çfarë përfaqësojnë? Kërkojmë në internet dhe do të zbulojmë respektivisht se bëhet fjalë për tekste:**

- shkrime të vjetra të gjetura në Kretë e që deshifrohen vetëm me anën e gjuhës shqipe;
- dokumenti përfundimtar i Kongresit të Manastirit;
- disa gazeta nga shtypi shqiptar në ditët tona.

Nxis nxënësit të flasin përmes një metode stuhi:


- Çfarë vëreni në tre fotot e mësipërme?
- Çfarë kanë të përbashkët?

Janë tekste të shkruara, iu takojnë fushave të ndryshme.....etj.

( për të organizuar marrjen e njohurive të reja përmes deduksionit, kalimin nga dijenitë e njohura tek ato të panjohura/ të reja e që janë objekt i kësaj situate të nxëni. Mund të procedohet kështu për të njohur shkallën e njohurive të tyre).


**I. Mësuesi/ja nis me shpërndarjen në klasë të teksteve të ndryshme, në grupe prej 5-6 nxënësish. Tekstet sugjerohen të jenë të llojeve dhe organizimeve të ndryshme (një paragraf, një poezi, një pjesë tregimtare, proverb, një lajm nga një organ shtypi, një skedë biografike, një udhëzues përdorimi të një aparati elektroshtëpiak apo medikamenti etj.).**

- Nxënësit e lexojnë në mënyrë të vëmendshme pjesën a tekstin dhe iu përgjigjen disa pyetjeve:
  1. Çfarë janë ato që lexuat?
  2. Pse quhen tekste?
  3. Nga se përbëhen?
  4. E dini se çfarë prejardhje ka fjala tekst?
- Nxënësit sipas përvojës, njohjeve, koncepteve të marra në vitet e mëparshme u përgjigjen pyetjeve. Përgjigjet e tyre ilustrohen me tekstet që kanë përpara dhe argumentojnë qëndrimin e tyre.
- Ato (përgjigjet ) përmbledhen në një **organizues grafik**:



**II. Nxënësit nxiten të karakterizojnë tekstet që kanë lexuar, duke vënë në dukje:**

1. Nga se përbëhet: Fjalë, fjali, paragraf, krye;
  2. Mesazhet që transmetojnë?
  3. A kanë kuptim?
  4. Si janë të organizuara?
- Një nga nxënësit e grupeve lexon me zë pjesë nga teksti i tij dhe në mënyrë të përmbledhur arsyeton:
    - a) Ç' tekst është në përmasa?
    - b) Ka një logjikë kuptimore dhe sintaksore?
    - c) Është i përmbyllur kuptimisht?
    - ç) Çfarë forme kanë tekstet tuaja (e grupit)?
  - Nxënësit sipas llojeve të teksteve që kanë, dallojnë elementet e tij dhe qartësojnë konceptet për kuptimin e tekstit dhe disa tipare të tij.
  - Shkurtimisht përmbledhim disa karakteristika në një kllaster:



Ftohen nxënësit të vërejnë tablonë e punuar në akrilik nga një artiste shqiptare, Violeta Kongo, e titulluar "Gruaja shqiptare".

- Çfarë mbresash ju krijon vështrimi i një tabloje të tillë?
- Në të janë dhënë katër figura femërore në mënyrë të stilizuar dhe secila prej tyre përcjell gjendje shpirtërore të ndryshme. Si gëzim, trishtim etj.

- Rrumbullakësia, pozicioni i lakuar i kokës, ngjyrat e ndezura përcjellin përmes kësaj tabloje emocione të veçanta. Provoni t'i përcillni ato në lloje të ndryshme tekstesh sipas njohurive dhe shkathtësive që fituat.

**III. Pasi shikojnë karakteristikat tërësore të teksteve të tyre nxënësit nxiten të rikujtojnë, duke u drejtuar pyetje:**

- Sa lloje tekstesh njihni?
  - Ç'kuptoni me strukturë të një teksti?
  - Vlerësoni se ç'lloj tekstesh keni përpara për nga mënyra e organizimit?
- *Nxënësve iu lihen disa minuta kohë dhe qëmtojnë organizimin e informacionit. Udhëzohen të shohin konceptin në fq. 29 "Tekstin e nxënësit", mbi terminologjinë dhe kuptimin e saj.*
- *Kështu renditen disa koncepte të organizimit të tekstit në 6 modelet që janë:*
- Struktura shkak-pasojë;
  - Struktura kronologjike;
  - Struktura e krahasimit dhe e kontrastit;
  - Struktura sipas radhës së rëndësisë;
  - Struktura e problemit dhe e zgjidhjes;
  - Struktura e përshkrimit.
- *Nxënësit kanë njohuri paraprake për këto tekste dhe përpiqen të marrin prej tyre disa karakteristika, duke iu përgjigjur disa pyetjeve:*
- Ç'kuptojmë me secilin lloj?
  - A e dalloni këtë veçori në tekstin tuaj;
  - Nënvizoni me laps elemente që gjeni në tekst;

*Pasi punojnë 3-4 minuta me tekstet që kanë në grupe (përzgjedhja e teksteve duhet të jetë e kujdesshme se siç e vërejmë iu kthyem përsëri të njëjtave tekste për të vazhduar punën. Një variant është të ruhet natyra e shembujve në librin e nxënësit "Gjuha shqipe 10") dhe nxënësit të përgjigjen në bazë të njohurive që kanë dhe përvojës së tyre.*

**IV. Grupet në këtë fazë ndërrojnë tekstet me njëri-tjetrin dhe verifikojnë ndryshimet që vënë re nga tekstet e mëparshme. Ndalen te llojet e tyre:**

- Ç'lloj tekstesh janë: të pastra apo të përziera?
  - Pse i quajmë kështu?
  - Të destinuara për t'u lexuar apo folur?
  - Letrare apo joletrare?)
  - Si i dallojmë që janë letrare apo joletrare?
  - Çfarë mjetesh përdorin?
- *Nxënësit mbajnë qëndrimet e tyre, ndërsa mësuesi/j përmbledh në një tabelë të gjitha veçoritë që ka një tekst ose ia shton tabelës së parë ku evidentuam karakteristikat e mëparshme:*

Teksti (Skema) që do të vendoset më vonë



## V. Shkrim i lirë

- *Nxënësve në grupe dyshe iu kërkohet të shkruajnë një tekst të shkurtër që të ketë*
- mesazh
  - kuptim
  - qëllim
  - logjikë
  - saktësi gjuhësore
- Nxënësit këmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe vlerësojnë tiparet e shkrimit të shokut. Nga ky aktivitet nxënësi fiton disa shkathtësi që të arrijë të praktikojë se si mund të shkruajë një tekst në pak kohë dhe me standardin e tekstit.
- Lexohen disa prej tyre dhe vlerësohen nga shokët e klasës, vendimmarrje kjo që i jep aftësinë dhe përgjegjshmërinë e vlerësimit të punës.

### Detyrë shtëpie:

Ushtroni me shkrim duke shkruar një tekst të plotë duke zgjedhur një nga strukturat e mëposhtme:

- Struktura shkak–pasojë
- „ „ kronologjike
- „ „ e krahasimit dhe e kontrastit
- „ „ sipas radhës së rëndësisë
- „ „ e problemit dhe e zgjidhjes
- „ „ e përshkrimit

- Në tekstin e shkruar analizoni: karakteristikat, llojin, veçoritë.

Vlerësoni shkurt veten se ç’lloj shkruesi jeni: i arrirë, mesatar, nënmesatar.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>përgjigjen saktë;</li><li>dallojnë tiparet e strukturës dhe të teknikave të shkrimit të një teksti dhe i zbërthejnë ato konkretisht;</li><li>shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit;</li><li>vlerësojnë arritjet dhe shkathtësitë e tyre në situatën e të nxënës.</li></ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>për pjesëmarrjen në diskutime;</li><li>për saktësinë e përgjigjeve që lidhen me detyrën e shtëpisë dhe ushtrimet në klasë;</li><li>për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li><li>për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li><li>për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li></ul>



**TEMA MËSIMORE 2.1 (1 dhe 2) BURIMET SINTAKSORE TË SHPREHËSISË  
BURIMET MORFOLOGJIKE TË SHPREHËSISË.  
BURIMET LEKSIKORE DHE FONETIKE TË SHPREHËSISË**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Njohuri të përgjithshme mbi tekstin</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 5</b>			
<p>Shpërndahen në klasë tekste; nxënësit lexojnë tekste të shkurtër ku spikasin mjetet gjuhësore të përzgjedhura më parë. Klasa ndahet në grupe pune; grupet futen në një situatë të nxëni ku diskutojnë për mjetet gjuhësore dhe të shprehësisë me të cilat përcillen tekstet. Disa nxënës prezantojnë idetë e tyre mbi karakteristikat gjuhësore të tekstit burimet e shprehësisë dhe llojet e tyre. Nxënësit në këtë situatë dëgjojnë, lexojnë, diskutojnë, shkruajnë, përmbledhin duke respektuar njohuritë gjuhësore të shqipes standarde.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon për burimet e shprehësisë së tekstit dhe llojet e tij, dhe për ngjyrimet shtesë që merr, duke veçuar disa karakteristika gjuhësore që lidhen me to. Ai diskuton mbi informacionin që merr në këtë temë, nxjerr nga fushat e të nxënit (p.sh. tekste gjuhësore, letrare, artikuj të ndryshëm) ose nga jeta e përditshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për rëndësinë e teksteve në jetën tonë dhe burimet, mjetet dhe format e shprehësisë të tyre.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me burimet e shprehësisë së teksteve, nëpërmjet leximit të tyre.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b></p> <p>Nxënësi harton situata të përshtatura në botën e gjallë (p.sh:publicistikë, në lidhje me mjedisin social ku ata bëjnë pjesë në përditshmërinë e tyre), duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, në përputhje me rezultatet e pritshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të mënyrave dhe teknikave të komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p> <p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë komunikimet në</p>			

<p>distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me komunikimin, teknikat dhe llojet e tij dhe kanalet e komunikimit.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutimet në klasë për tekstet, duke marrë në konsideratë qëllimin, karakteristikat dhe situatën e komunikimit në një tekst, si dhe përmbledh përfundimet e një teksti;</li> <li>• përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme</li> <li>• përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të këtyre llojeve të komunikimit;</li> <li>• realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të folurit;</li> <li>• përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> Mjete gjuhësore/ burime shprehësish Ngjyrimet emocionale Shumësi kuptimore dhe figurative Burime leksikore Burime fonetike Burime morfosintaksore Përftesë shprehësie Aforizëm=Proverbë=fjalë e urtë Aftësi shprehëse Lajtmotiv</p>
<p><b>Burimet:</b> <b>Vetjake:</b> Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit; <b>Specifike:</b> Rrethanat stimuluese, kontekste tekstuale të ndryshme; <b>Te jashtme:</b> tekste letrare të llojeve të ndryshme, modele të tekstesh të ndryshme, libri i nxënësit; <b>Mjete:</b> tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor, ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Komunikim:</b> përdor burime gjuhësore të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij tekstor si edhe mjete të figurshme me ngjyresa kuptimore emocionale <b>Letërsi:</b> Tekste letrare dhe joletrare <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar, fjalor <b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• DDM</li> <li>• Rrjeti i diskutimit</li> <li>• Organizuesi grafik</li> <li>• Lexim i drejtuar</li> <li>• Punë në grup</li> <li>• Praktikë e drejtuar</li> <li>• Përmbledhje e strukturuar</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p style="text-align: center;"><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p> <p><b>Shënim:</b> (kujojmë që nxënësit duhet t'i përdorin këto shprehje jo vetëm brenda Njesisë nr 2, por gjatë gjithë punës së tyre në lëndën e gjuhës në Njësitë pasardhëse nr 3, 4, 5, 6 dhe 7 dhe është e udhës që të përvetësohen nga ata. Tabelat mund të afishohen në muret e klasës të paraqitura në mënyrë estetike)</p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë, të dhëna nga mësuesi, ku nxënësit diskutojnë mbi materialet e tyre.</li> <li>➤ Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë, plotësojnë dhe vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke</li> </ul>	

mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës.

➤ Mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve në prezantimin e disa prej komenteve që sjellin ata për realizimin e punës së tyre dhe çfarë mundësish kishin për të arritur më tepër.

■ Ngre, për qëllime reflektimi, disa pyetje që të testojë qasjen e nxënësve nga niveli teorik drejt atij praktik shkrimor:

1. Ç'quajmë tekste?
2. Nga se përbëhen ata ?
3. Kush e hodhi i pari konceptin për tekstin ?
4. Si organizohen tekstet?
5. Sa modele organizimi tekstor kemi?
6. Si i gjejmë tekstet sipas mënyrës së organizimit të informacionit dhe me ç' mjete gjuhësore organizohet?
7. Si mund të organizoni ju një tekst?

I. Pasi sjell përgjigjet e tij, nxënësi nxitet të kujtojë përmes përvojës që ka, shprehje të figurshme në jetën e përditshme ose citojnë pjesë nga tekste të ndryshme letrare që kujtojnë nga leximet ose prezantimet që mund të ketë patur. Kjo bëhet me qëllim që nxënësi të shkojë fillimisht përmes përvojës së tij drejt gjetjes së burimeve gjuhësore dhe mundësive të saj të shprehjes.

Nxënësit citojnë dhe mbajnë shënime përdorime burimesh të ndryshme të shprehjes së gjuhës që prezantohen në klasë. Mësuesi/ja ndihmon të gjejnë disa mjete gjuhësore që i japin:

- Fjalës
- Fjalisë
- Paragrafit kuptime shtesë ose ngjyrim emocionale.

me anë të leximit me zë ose paraqitjes në, disa nga burimet e gjuhës së gjallë, duke i njohur ata me mundësinë që ka gjuha për të sjellë ngjyresa kuptimore të ndryshme.

#### A. Burime sintaksore nga ligjërimi bisedor:

- I riu, si veriu, ( aforizëm);  elipsë
- Djalë për kokën e djalit,(frazologji) ,  përsëritje;
- Gjella me kripë e kripa me karar,(aforizëm) ,  përsëritje;
- I ziu njeri kurrë nuk e di se ç'e pret!  inversion;
- I shtrenjti, i miri dhe i nderuari mik!  enumeracion; enumeracion
- Në shtëpi, në shkollë, në bibliotekë, gjithandej.....;  asindet; enumeracion
- Edhe këtej edhe andej, edhe kudo ....;  polisindet
- Po sa herë të kam thënë?  pyetje retorike

#### B. Burime morfosintaksore:

- Ditë dimri; Natë; Qetësi; etj.. emra në të pashquarën (ligjërim i përditshëm);
- Shkresurina; Vjershurina; teori-ra; poezi-ra, etj., shumësi i emrave;
- Rodhën qiejtë; shumësi i emrave;
- Hutimi; Trishtimi; Lumturia etj., (emra abstraktë si konkretë në përdorim të personifikimeve psikologjike);
- Këmbëshpejtë; Ballçekic; i ngrysur; Turivarur; (mbiemra që përdoren me ngjyrim të caktuar) bisedore;
- Una; Atyne; Neve etj., (përemra me ngjyrim) ; bisedore
- Hollësisht; Qetësisht; Tërësisht, etj., (me ndajfolje); bisedore dhe librare
- Ç'u mërzitëm; S'dihet kur vjen; Thuaje del!; (pjesëza me përdorime ngjyruese që e bëjnë bisedën më të gjallë), bisedore;

\*Këta ose të tjerë shembuj nga ligjërimi bisedor, libror etj. mund të gjejë mësuesi, kjo guidë i ndihmon ta realizojnë këtë etapë më me larmi.

➤ Pasi diskuton me nxënësit mësuesi/ja pyet:


- Si mendoni, sa mundësi ka gjuha për të sjellë ngjyresa kuptimore?
- Çfarë aftësish fiton ajo nga këto përdorime?
- Po folësi/shkruesi çfarë aftësish fiton?
- Vini re sa burime përmendëm më sipër?
- Rendisni ato në një listë në fletore dhe i qëmtoni ato!

II. Nxënësi punon ndërkohë që mësuesi/ja organizon një skemë me disa koncepte të reja:

**TABELA 1**


**Teksti është njësi gjuhësore e përbërë nga:**

a) Fonema	Kombinimi i tyre ndërton tekstin, i	Kombinimi i tyre i qëllimshëm, jo vetëm
b) Morfema	cili mund të jetë i shkruar në:	për të kumtuar, por edhe për të dhënë
c) Fjalët	a) Poezi (vargje)	kuptime të figurshme, për të përcjellë
d) Grupe fjalësh	b) Dramë (dialog, monolog, didaskali)	ndjenja dhe ngjyrimë emocionale
e) Fjali	c) Prozë	ndërton Përftesat e shprehësisë



- Etapa tjetër nis me shpërndarjen në klasë të teksteve të ndryshme, në grupe prej 5-6 nxënësish. Tekstet sugjerohen të jenë të llojeve të ndryshme letrare nga pjesë të vogla deri te pjesë të plota letrare ( një paragraf, një poezi, një pjesë tregimtare, proverbë).
- Nxënësit e lexojnë në mënyrë të vëmendshme pjesën a tekstin dhe iu përgjigjen disa pyetjeve:
- Çfarë burimesh të gjuhës njihni?
  - Çfarë përshtypje lë leximi i tyre tek ju?
  - Krahasoni me fjalitë e marra nga ligjërimi bisedor (citar më lart tek pjesët A dhe B)?
  - Thoni disa mjete gjuhësore dhe stilistikore, si mjete burimore të shprehësisë, që mbani mend.
- Nxënësit thonë sipas dijeve që kanë; më pas orientohen të nënvizojnë në tekstet e zgjedhura që kanë në grupet e punës dhe dallojnë disa prej tyre. Flasin për to duke gjetur dhe nënvizuar në tekste ( aq sa mund të gjejnë). Në këtë kohë mësuesi/ja evidenton llojet e shprehësisë së gjuhës:
- E ndërkohë që nxënësit ndjekin rastet në tekstet, sugjerohet dhe bëhet një kllaster me llojet e tyre:

**SKEMA**



- Përveç skemës rreze mësuesit/es iu rekomandohet që te krijojë me ndihmën edhe të nxënësve një tabelë me të dhënat që do të ishte e përshtatshme të viheshin në një kënd të dukshëm për t'u patur parasysh edhe në orët në vijim.

## TË KTHYERA NË TABELË DO TË KISHIM

### A. Burimet sintaksore të shprehësisë

E ndërkohë që nxënësit ndjekin rastet në tekstet, sugjerohet dhe bëhet një listë me llojet e tyre:

**TABELA 3**

Çfarë funksioni kanë në ligjërim? Çfarë kuptimi a ngjyrimi shtesë i japin atij?	Përftesat sintaksore të shprehësisë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thekson kuptimisht dhe e ngjyros emocionalisht gjymtyrën që del para</li> </ul>	<b>Inversioni</b> , (përmbysja e rendit sintaksor)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• I jep rrëfimit ose përshkrimit ritëm tjetër, duke e nxituar apo ngadalësuar atë. Ndikon në dhënien e situatave pezull</li> </ul>	<b>Elipsa</b> (mungesa e një gjymtyre kryesore) emërore ose foljore)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• E bën sintetike fjalinë, për pasojë më mbresëlënëse. E pathëna vjen e bëhet më e efektshme.</li> </ul>	<b>Lakonizmi</b> (largimi e shprehjeve të tepërta)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• I jep ritëm tjetër frazës duke e ngadalësuar dhe përforcuar praninë e objekteve sendeve apo dukurive që emërtohen</li> </ul>	<b>Polisindeteti</b> (Shton me qëllim lidhëzat të panevojshme)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• E kundërta, e nxiton ritmin e ligjërimit</li> </ul>	<b>Asindeteti</b> (heq me qëllim lidhëzat)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Intonacioni i numërimit krijon ritëm dhe muzikalitet</li> </ul>	<b>Enumeracioni</b> ( është renditja njëra pas tjetrës e gjymtyrëve homogjene)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• E bën rrëfimin më interesant</li> <li>• I jep ligjërimin ngjyrën e konfidencës, sepse flitet për gjëra që marrësi i di dhe</li> </ul>	<b>Pyetja retorike</b> (Pyetje që ndërtohet si e tillë, por që në të vërtetë pohon dhe s'kërkon përgjigje, ose përgjigja është aq e njohur

nuk ka nevojë t'i përgjigjet pyetjes	brenda situatës së komunikimit saqë nuk pret përgjigjen, nuk ka nevojë për të.)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjitha këto përftesa ndërtohen me përsëritje, e cila u jep vargjeve ritëm dhe muzikalitet.</li> <li>• Të njëjtin funksion kryen përsëritja në rastet e përsëritjes së vargut= lajtmotiv</li> <li>• Përsëritjes së strofës= refren</li> <li>• Të një fragmenti=përsëritje epikë etj.</li> </ul>	<b>Përsëritja</b> (për të theksuar, për të përforcuar kuptimisht fjalën, fjalinë etj.)
	<b>Epanalepsi</b> ( vargu nis dhe mbaron me të njëjtën fjalë)
	<b>Epanastrofeja</b> (fjala përmbyllëse e një vargu përsëritet në fillim të vargut pasardhës)
	<b>Anafora</b> (përsëritjen e një a më shumë fjalëve në krye të vargjeve)
	<b>Epifora</b> ( përsëritjen e një a më shumë fjalëve në fund të vargjeve)

Duke u mbështetur në librin e nxënësit mund të ndërtojme në fletore tabela të njejta për përftesat e tjera.

**Qëllimi:** krijimi i një pasqyre që do të afishohet në klasë e që do të përmbushet me shembuj në pesë Njësitë mësimore me të cilat nxënësi do të punojë gjatë vitit, duke filluar me tekstin përshkruar e që do të vijojë me tekstet rrëfyes letrarë dhe jo letrarë, ku burimet gjuhësore të shprehësisë luajnë rol të ndjeshëm.

➤ *Shembujt merren nga Teksti i nxënësit si edhe nga tekstet e dhëna në grupet e punës, dhe nxënësit sipas mundësisë dhe njohjeve komentojnë mënyrat e qasjes së shprehësisë.*

**III.** *Nxiten nxënësit të reflektojnë mbi disa njohuri të gjuhës shqipe dhe mënyrat e organizimi të saj për të ndihmuar shprehësinë. Lexohen burimet e gjetura më lart nga ligjërimi bisedor dhe tekstor për të vazhduar më tej:*

*a. Cilat raste veçuam më lart?*

*b. Çfarë burimesh përdor gjuha shqipe, për të sjellë ngjyime të tjera?*

*c. Po nga leximet tuaja çfarë keni vënë re?*

➤ *Sugjerohet të shohin tekstin në f. 34 N/çështjen “Burimet morfologjike të shprehësisë”; vëzhgojnë veçoritë e gjuhës dhe bëjnë komente.*

*Ndërkohë paraqitet harta e koncepteve në tabelë ose video-projektor.*

**SKEMA**

**Burimet morfologjike të shprehësisë**

- a. **Emër + mbiemër** në vend të bashkimit *emër + emër në gjinore*
- b. **Mbiemri** përdoret për të shprehur qëndrimin dhe vlerësimin tonë për të zbuluar sendin dhe vetitë nga një këndvështrim i ri, lidhur me rrethanat;
- c. **Përdorimi i foljeve** në kohë të ndryshme e pasuron kuptimisht mesazhin; e njëjta gjë për përdorimin e mënyrës habitore me vlerë të dëftores.
- d. **Përdorimi i përemrit të vetës së parë njëjës**, *unë*, e bën më intime poezinë, ndërton subjektivitet
- e. **Përdorimi i vetës së parë të numrit shumë**, *ne*, i jep poezisë ndjesinë e një heroi lirik kolektiv, që përfshin në rrëfimin e përjetimeve edhe lexuesin ideal, *atij që autori i drejtohet*, edhe atë real, *atij të të gjitha kohërave*.
- f. **Përdorimi i përemrit të vetës së dytë njëjës**, *ti*, i jep poezisë ndjesinë e intimitetit, bashkëbisedimit, afërsisë

- Të tëra rastet e përdorimit të këtyre burimeve sqarohen rast pas rasti dhe shoqërohen me shembuj nga teksti për të përvetësuar edhe konceptet e marra duke u shoëruar me shembuj të rinj.
- Grupet punës ndërrojnë me njëri – tjetrin tekstet e dhëna më parë dhe lihet kohë për të parë dhe rastet e tjera duke i diskutuar dhe komentuar çdo shtesë kuptimore ose ngjyrim emocional që u përftua përmes këtyre burimeve gjuhësore.
- Në mbyllje të mësimit bëhet një përmbledhje e strukturuar:
  1. Kombinimet e qëllimshme çfarë i japin tekstit?
  2. Termi “shprehësi” përdoret për?
  3. Synimi i fundmë i çdonjërit cili është?
  4. Cilat janë llojet e burimeve të shprehësisë?
- **Detyrë e drejtuar:** Klasa ndahet në 2 grupe:
  - Grupi 1. Kërkoni në tekste të ndryshme burimet morfologjike të shprehësisë;
  - Grupi 2. Kërkoni në tekste të ndryshme burimet sintaksore të shprehësisë;
  - Në tekstet e shkruara analizoni: karakteristikat, llojin, veçoritë e burimeve në këto pjesë.

Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë, plotësojnë dhe vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim

Kritik ndaj detyrës.

Di:	Dua të di:	Mësova:
-----	------------	---------

- Mësuesi/ja u tërheq vëmendjen nxënësve në përsëritjen e disa prej koncepteve të marra dhe teknikave të organizimit të tyre dhe u kërkoi nxënësve t’u përgjigjen pyetjeve:
  - a. Ç’aftësi fiton teksti nga burime të ndryshme të shprehësisë gjuhësore?
  - b. Ç’quajmë “shprehësi” dhe si përftohet ajo?
  - c. Me çfarë burimesh i arrin gjuha disa ngjyrim të reja? Renditini ato!
  - d. Si formohen? Me ç’mjete gjuhësore dhe ç’tëknika gjuhësore bëhet burim shprehësisë?
- Nxënësit nxiten të punojnë në tabelë për:
  1. plotësimin e një skeme,

2. në një lojë (konkurs) ku edhe arsyetojnë,
3. bëjnë konkuzionet e veprimtarive.

**Grupi 1. Ndërtoni skemën për burimet sintaksore të shprehësisë.**

**Grupi 2. Ndërtoni skemën për burimet morfologjike të shprehësisë.**

**Grupi 3. Karakteristikat e një teksti**

- Teksti :
1. Njësi :
  2. shprehësi:
  3. kombinim kompleks:
  4. kombinim i qëllimshëm:
  5. Synimi:

- Pasi nxënësit plotësojnë këto tabela, , duhet të komentojnë shkurt ato.
- Nxënësit përfshihen sërish në një situatë të tillë ku bashkëpunojnë në procesin e njohjes së lëndës së re.

#### Dua të di:

- Pjesa e dytë e lëndës së re nis me një qasje nga përvoja e nxënësve:

Dy nga burimet e shprehësisë që vumë re na treguan për mundësitë e që ka gjuha shqipe për të pasuruar shprehjen

me ngjyrimë emocionale, po gjuha shqipe ka edhe mundësi të tjera. Le të vërejmë më tej :

- a. Mendoni se burimet morfologjike dhe sintaksore janë burime të jashtme apo të brendshme të gjuhës?
- b. (përgjigjja e saktë : *Burime të jashtme, për arsye se veprojnë me forma të paracaktuara.*)
- c. Po përdorimi i fjalëve (leksikut të shqipes) dhe i marrëdhënieve kuptimore që arrihen përmes
- d. tyre, çfarë përfitesash sjell në llojet e ndryshme të ligjërimit? (përfitesa leksikore)
- e. A mund të shërbejë çdo fjalë si burim shprehësie? (Po, sepse në gjuhën shqipe edhe fjalët më të zakonshme, mund të shndërrohen në përfitesa dhe organizime të ndryshme, marrin ngjyrimë dhe vlera stilistike.)
- f. Cilat mjete përdor gjuha për të pasuruar shprehësinë e saj? Ç'dini nga klasat paraardhëse? P.sh.
- g. Sinonimia, antonimia ...etj...(mësuesi nxit kujtesën e nxënësve për të plotësuar konceptin).

- Plotësohet ideja e nxënësve me shembuj të sjellë në klasë, kryesisht nga jeta e përditshme:
  - Ai është një nga mjekët zemërakë më të mirë. (këtu jo inatçi, po mjek zemre)- Polisemi.
  - *Milionat e telave dhe të rubinetave* (gazetareske) – për milionat e lekëve të shpenzuara për energjinë dhe ujësjellësin.- Polisemi
  - *Kudo vete, shtëpinë me vete.* (Folklor) – Homonime;
  - *Ai do te luajë rolin e tij si drejtues* – Homonim (do - dëshiron);
  - Qetësia shurdhon*- antonime
  - Çorganizim i organizuar( togfjalëshi tipik)* - antonime
  - Ishin, merrnin pjesë,kishin ardhur, asistonin, ndodheshin, ishin ftuar,ishin gjithashtu, etj.* –

#### Sinonime

Ose

- Një gjel; kokosh; këndes;* - **Sinonime**
- Çupë, cucë, çikë, vajzë; ose djalë,voc, çun, etj.* – **dialektore**
- Regjëni, regjënoj, gjellë, fëdigë, fëjej* (mbretëri, mbretëroj, jetë, mundim, gaboj)-**Arkaizma**
- Sonte është tamam aksham* - **Huazim**

Ose



-Fukara-i varfër, sabah-mëngjes, serm-argjend, bahçe-kopësht, avash - ngadalë, hashiqare -haptaz, etj..

**Huazime** – orientalizma që sot përdoren rëndomë në ligjërimin bisedor.

-Barkalec, ngordhalaq, shtrembaluq,- me ngjyresë negative- **Fjalëformim**

- Xhanushe, shpirtkë, zoçke, syçkë, babush - përkëdhelëse – **Fjalëformim**

-Stërhollë, stërlashtë, u stërndamë, stërlëng, etj. – **Parashtesë**

- Stërvodekje, stërshtet, i fundbotshëm, floknajë, i funbotshëm, etj. ( Kadare)- **Neologjizma**

► Pasi lexohen dhe interpretohen këta shembuj, të cilët kanë për qëllim ta afrojnë nxënësin drejt gjuhës së gjallë dhe jo vetëm asaj të kultivuar, raste të të cilave janë edhe tek Libri i nxënësit, mësuesi/ja nis edhe plotëson në tabelë, fleep –charter a video projektor konceptin me burimet leksikore të shprehësisë:

**Burimet leksikore të shprehësisë:**

a) **Sinonimet**

b) **Antonimet**

c) **Polisemia**

d) **Homonimia**

**1.Fjalëformimi:**

a) Fjalët e parme: mbaj, ndaj

b) Fjalët e prejardhura me formim:

parashtesor: përmbaj, shpërnda

prapashtesor: mbajtje, ndarje

parashteso–prapashtesor: zbukuroj

c) Fjalët e përngjitura: shtojzovalle

d) Fjalët e përbëra: shtathedhur

**2. Frazelogjike:**(kur lidhjet e fjalëve bëhen të qëndrueshme dhe përftojnë kuptim të ri, shpesh të figurshëm) *u hodh përpjetë= reagoi, u gëzua, kundërshtoi*  
*I foli me zemë në dorë= me sinqeritet etj.*

**3. Huazimet:** janë fjalë të cilat shqipja i ka marrë nga gjuhët e huaja, të ardhura bashkë me sende ose dukuri të reja ose që janë huazuar pa qenë e nevojshme. Kur gjendemi para tyre duhet bërë kujdes që të pastrohet gjuha kur ndërkaq kemi fjalën shqipe. Në rastet kur ato ngjyrosen kuptimisht huazimet marrin vlerë stilistike.

*O halldup shallvaregjerë...*

*...Ç'ma ke atë surrat...*

**4. Neologjizmat:** fjalë që ndërtohen me brumin e shqipes për të pasuruar aftësitë shprehëse të shqipes. *i fundbotshëm, floknajë, i funbotshëm*

**5. Arkaizmat:** janë fjalë të vjetra, kryesisht të mbledhura nga tekstet e vjetra që kanë dalë nga përdorimi

Fjalën e vjetër *Gjellë=jetë* e gjejmë tek letërsia filobiblrike arbëreshe në titullin “Gjella e Shën Mërisë së virgjër” por kjo fjalë ka vazhduar të jetë aktive tek fjalët e prejardhura p.sh. Gjallesë —→ Gjallëroj, rigjallëroj

- Në këtë etapë nxënësit përfshihen në komunikim me njeri –tjetrin për të diskutuar mbi pasurinë e shqipes dhe mundësitë reale të shprehjes së saj.
- Udhëzohen të shohin Tekstin e nxënësit dhe të marrin dy-tre minuta për të reflektuar mbi rastet dhe shembujt përkatës.
- Mësimi vazhdon me disa momente të tjera, duke tërhequr vëmendjen e nxënësit mbi raste të tjera që ka shqipja e folur dhe e shkruar:

**b. Burime fonetike nga ligjërimi bisedor:**

- Mjaft se me duket *cicërove* shumë.(ngjyresë negative) □ **onomatope**
- Tirana nga tifozyt quhet *Tirona*, (alternim tingulli) □ **merr ngjyrimë emocionale;**
- Na *vdueq!* (Na *vdique!*)(alternim tingulli) " "
- *Flámur dhe flamúr*, dhe me trajtë solemne- *flamùjt* (**lëvizje theksi**)
- *Gusht e gunë –thënie;ose Qeni qepën të hajë;* - **lidhje tingullore** me efekte kuptimore. □

**aliteracion**

- *I vockël, njëckë, pickërr, etj.- tinguj me përshtypje zoogëluese*
- *Na more na! Mos more! Lëre më! Ç'vete!*- **Intonacioni**; Togje të kthyer në pasthirrma
- *Faleminderit!* – ndjesia që duam të shprehim varet **nga intonacioni**

- Pasi sjell disa momente nga gjuha e gjallë mësuesi/ja tërheq vëmendjen e tyre për të lexuar në tekstin e nxënësit disa nga format e burimeve fonetike të gjuhës shqipe.
- Në të njëjtë kohë shfaq në tabelë a mjete të tjera vizuale rastet e këtij birimi të shprehësisë në gjuhën shqipe.

**4. Burimet fonetike të shprehësisë:**

**a. Theksi** - një theks i dytë plotësues (veç atij të ngulitur);

**b. Intonacioni**-përcakton kuptimin e fjalive që shqiptojmë

**c. Organizimet tingullore:**

- a) Aliteracioni**- përsëritja e tingujve të njëjtë brenda një fjalie;
- b) Onomatopetë**- ose imitimet tingullore;
- c) Organizime tingëllore** - jehonat tingëllore;
- d) Paronimia**- kur tingëllimet e fjalëve të përdorura janë të ngjashme;
- e) Ritmi** : **Ritmika në poezi** në një poezi përftohet me anë të theksit të fjalës i cili, kur numër rrokjesh në vargjet pasardhëse, krijon ritmin e poezisë.

- *Shembujt janë edhe në tekstin e nxënësit, po mund t’u kërkohet që nxënësit të sjellin shembuj të ngjashëm me to. Me këto shembuj iu kërkohet nxënësve të ndërtojnë fjali, me anë të të cilave mësuesi/ja kupton dhe vlerëson shkallën e përvetësimit të dijenive të tyre përmes materialeve të sjella në mbështetje të njohurive të reja .*
- *Atëherë pasi ka marrë prej nxënësve një vlerësim të përgjithshëm të këtyre burimeve të shprehësisë në gjuhën shqipe, mësuesi/ja plotëson tabelën 2 të dhënë orën e kaluar me burimet e tjera të shprehësisë së shqipes :*

**TABELA 3**

BURIMET GJUHËSORE SHPREHËSIE			
SINTAKSORE	MORFOLOGJIKE	LEKSIKORE	FONETIKE
Rend gjymtyrësh	Koha e foljes	Sinonime	Përsëritje tingujsh
Fjali mungesore	Mbiemri	Antonime	Imitime
Enumeracion	Përemri në vetën e parë	Homonime	Përsëritje me formë të ndryshuar
Pyetje që nuk presin përgjigje	Përemri në vetën e dytë	Polisemia	
Lakonizmi	Përemri në vetën e tretë	Shprehjet frazeologjike	Theksi
Polisindet	Përdorimi i foleve	Fjalëformimi	Zgjatje zanoresh
Asindet	Kohët e përbëra	Huazimet	Alternime tingujsh

Përsëritje : ○ Fjale, ○ vargu, ○ strofe ○ fragmenti etj.	Mënyra habitore	Arkaizmat	
	Dhanorja etike	Neologjizmat	

➤ Lexohen nga nxënësit dhe diskutohen për 2-3 minuta.

**Etapa e fundit: Mësova:**

*nxënësve u është shpërndarë më parë disa fisha letre, ku gjenden një nga burimet leksikore të shprehësisë dhe një nga burimet fonetike të saj, marrë nga letërsia ose gjuha e gjallë.*

*Punohet për 3-4 minuta dhe diskutohen ato në klasë.*

➤ Pasi merr këto përgjigje dhe bën një përmbledhje të strukturuar, nxënësve iu jepet detyra për të punuar.

**Detyrë shtëpie:** Klasa ndahet në 2 grupe:

- Grupi 1. Kërkoni në tekste të ndryshme burimet fonetike të shprehësisë
- Grupi 2 Kërkoni në tekste të ndryshme burimet leksikore të shprehësisë;

Përsërisni të gjitha burimet e shprehësisë në gjuhën shqipe!

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit përgjigjen saktë</li> <li>• dallojnë tiparet e strukturës dhe teknikave të shkrimit të një tekstit dhe i zbërthejnë ato konkretisht</li> <li>• shkruajnë saktë paragrafët , sipas orientimeve të mësuesit</li> <li>• vlerësojë arritjet dhe shkathhtësitë e tij në situatën e të nxënit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>• për saktësinë e përgjigjeve që lidhen me detyrën e shtëpisë dhe ushtrimet në klasë</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 2.3 – 2.4 REALIZIMI I TEKSTIT BRENDA NJË SITUATE KOMUNIKATIVE; USHTRIME PËR PËRSËRITJE (2)**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika:</b> Njohuri të përgjithshme mbi tekstin			
<b>Situata e të nxënit nr. 6</b>			
<p>Shpërndahen në klasë tekste; nxënësit lexojnë tekste të shkurtra ku dallojnë kontekstin, si edhe elementet e tjera bazike të situatës së komunikimit. Klasa ndahet në grupe pune. Grupet futen në një situatë dhe diskutojnë për burimet kryesore të shprehësisë. Disa prezantojnë njohuritë e tyre mbi llojet e burimeve dhe mundësitë e gjuhës për të shprehur ndjenjat, tekstin dhe burimet e llojet e tyre. Nxënësit dëgjojnë, lexojnë, diskutojnë, shkruajnë, përmbledhin. Vendosen për t’u ushtruar në disa situata komunikative.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon mbi situatën e komunikimit dhe elementet e saj. Ai diskuton mbi informacionin që merr në këtë temë, nxjerr nga fushat e të nxënit (p.sh. tekste gjuhësore, letrare, artikuj të ndryshëm) ose nga jeta e përditshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p>			

Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për rëndësinë e njohjes së situatave të komunikimit në jetën e njerëzve.

➤ **Kompetenca e të nxënit**

Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me burimet e shprehësisë së teksteve, nëpërmjet leximit të tyre.

➤ **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësi hartoi situata të përshtatura në botën e gjallë (p.sh: publicistikë, në lidhje me mjedisin social ku ata bëjnë pjesë në përditshmërinë e tyre), duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar e vlerësuar burimet njerëzore, në përputhje me rezultatet e pritshme.

➤ **Kompetenca personale**

Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të elementeve të komunikimit.

➤ **Kompetenca qytetare**

Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të komunikimit.

➤ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me komunikimin, teknikat e llojet e tij dhe kanalet e komunikimit.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- merr pjesë në diskutimet në klasë për tekstet, duke marrë në konsideratë qëllimin, karakteristikat dhe situatën e komunikimit në një tekst, si dhe përmbledh përfundimet e një teksti;
- përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme
- përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të këtyre llojeve të komunikimit;
- realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të folurit.
- përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.

**Fjalët kyçe:**

Koherencë  
 Kohezion  
 Situatë komunikuese  
 Mesazh  
 Informacion  
 Kod  
 Kontekst  
 Marrës  
 Gjuha si kod komunikimi  
 Referenti


<p><b>Burimet:</b>  <b>Vetjake:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;  <b>Specifike:</b> Rrethanat stimuluese, kontekste tekstuale të ndryshme;  <b>Te jashtme:</b> tekste letrare të llojeve të ndryshme, modele të tekstesh të ndryshme, libri i nxënësit;  <b>Mjete:</b> tabela, <i>fleep-charter</i>, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>  <b>Komunikim:</b> Nxënësi përdor burime gjuhësore të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij tekstor si edhe mjete të figurshme me ngjyresa kuptimore emocionale.  <b>Letërsi:</b> Nxënësi përdor tekste letrare dhe joletrare.  <b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar, fjalor.  <b>Qytetari:</b> Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përvijim i të menduarit</li> <li>• Rrjeti i diskutimit</li> <li>• Lojë me role</li> <li>• Parashikim me terma paraprakë</li> <li>• Organizuesi grafik</li> <li>• Lexim i drejtuar</li> <li>• Punë në grup</li> <li>• Shkrim i shpejtë</li> <li>• Përmbledhje e strukturuar</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë, të sugjeruara nga mësuesi në orën e kaluar dhe nxënësit diskutojnë mbi materialet e tyre.</p> <p>➤ Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë, të plotësojnë dhe të vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës.</p> <p>➤ Mësuesi/ja tërheq vëmendjen e klasës në prezantimin e disa prej komenteve që sjellin ata për vlerësimin mbi aftësitë e fituara gjatë kryerjes së saj. Mangësitë që vihen re dhe metoda për të ndryshuar.</p> <p>■ <i>Mësuesi/ja, për të përvijuar të menduarit e tyre, ndërton disa pyetje që të testojë qasjen e nxënësve ndaj dijeve të fituara në orët e mëparshme deri tek ato që do të fitohen në këtë orë mësimore:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Si mund të orientohemi në një situatë komunikimi?</li> <li>2. Çfarë aftësish duhet të kemi që komunikimi ynë si dhënës apo si marrës të jetë i suksesshëm?</li> <li>3. Ku jeni gjendur më shumë në vështirësi në një situatë komunikimi me gojë a me shkrim?</li> <li>4. Çfarë është për ju një situatë komunikimi?</li> </ol> <p>➤ <i>Diskutohen në klasë të gjitha këto njohje nga përvoja apo nga njohuritë e ngulitura dhe mësimnxënia. Nxënësit futen në një situatë të nxëni që ndërtohet si një lojë me role. Klasa ndahet në grupe dhe vendosen në situata të ngjashme me shembuj nga <u>jeta e përditshme</u>. Secili grup e mendon vetë si do ta çojë një mesazh brenda grupit dhe do të analizojë të gjitha elementet e situatës së komunikimit. Ata ndërrojnë role në skemë: Dhënës-marrës; përshtatin situatën e komunikimit, përcaktojnë referentin,</i></p>	

kanalin që përçojnë, kodin. Si edhe e organizojnë atë në koherencë (vijueshmëri logjike dhe kohezion).

“Loja” zgjat disa minuta, 6-7 minuta, dhe duhet pasur kujdes që analiza të jetë e pasuruar nga nxënësit:

- me komente;
- me skemën e komunikimit;

si dhe nga çdo grup duhet të caktohet një nxënës që do të sjellë para klasës cilësitë e situatës së komunikimit në grupin e tij.




- Pas kësaj, mësuesi/ja evidenton tiparet e një **situatë komunikimi, duke u drejtuar nxënësve pyetje, si:**
  - a) Nga se lind nevoja e organizimit të një teksti?
  - b) Kur merr kuptim një tekst ?
  - c) Çfarë i jep konteksti një teksti?
  - ç) Cili nga elementet është më i rëndësishmi?
- Diskutohen në një rrjet diskutimi disa nga përgjigjet e nxënësve, të cilat komentohen në diagramin e mëposhtme, duke bërë kësaj një përmbledhje të strukturuar:

#### Situata e komunikimit:

Referenti: —>objekti konkret i përshkrimit; (për çfarë, për kë flitet në mesazh)

Konteksti: jep informacionet thelbësore



**III. Etapa tjetër nis me shpërndarjen në klasë të teksteve të ndryshme, në grupe prej 5-6 nxënësish.**

Tekstet sugjerohen të jenë të llojeve të ndryshme letrare nga dialogë të thjeshtë të komunikimit të përditshëm, tekst i koduar me kode të tjera komunikimi **p.sh.** libri i sinjalistikës rrugore **ose** manuale të orientimit të zonave të rrezikshme në rast zjarri apo dhe pjesë të shkurtra letrare (për të dalluar llojet e mesazheve dhe të faktorëve të tjerë që ndryshojnë nga komunikimi i gjallë).

- Nxënësit punojnë të pavarur dhe përcaktojnë karakteristikat e situatës së komunikimit, duke iu përgjigjur pyetjeve:
  - a) Cili ishte mesazhi?

- b) Ç'lloj marrësi ishte?
- c) Dërguesi, kush dhe çfarë qëllimi ka në këtë tekst?
- ç) Cili është kanali i komunikimit?
- d) Ç'kod përdor për të dhënë mesazhin?
- dh) Në cilin kontekst e përdor këtë?
- e) Cili ishte objekti i mesazhit të tij?

Nga kjo lloj analize e bërë nga të gjitha grupet, secili sjell informacionin e tij dhe bëhen konkluzione të shpejta.

IV. Nxënësve iu jepet një detyrë të shkruajnë një paragraf a tekst të shkurtër ku të vlerësojnë elementet e pamungueshme të organizimit të tij: Koherencë dhe kohezion duke ndalur tek hollësitë teknike për secilin prej tyre.

Ndërkohë që nxënësit shkruajnë mësuesi/ja shfaq një tabelë ku strukturon këto teknika:

K	Logjike	Semantiko-gjuhësore
O	<b>frazat, fjalitë dhe</b>	përdorimin e :
H	<b>paragrafët</b> e një	<b>a. termave, kohëve</b> dhe
R	teksti janë të lidhur	<b>mënyrave</b> të duhura
E	logjikisht me	foljore;
N	temën kryesore të	<b>b. përdorimin e regjistrit</b>
C	tekstit dhe midis	<b>gjuhësor të përshtatshëm.</b>
A	tyre.	

K	<i>përshtatjet morfologjike (emër, folje, mbiemër)</i>
O	<i>zëvendësimet për të shmangur përsëritjet</i>
H	<i>përemrat</i>
E	<i>ndajfoljet</i>
Z	<i>sinonimet</i>
I	<i>rimarrja (diçka përherë kërkonte, kërkonte diçka)</i>
O	<i>hiperonimia dhe hiponimia (zoogëlim dhe zmadhim kuptimi)-barby-kukull dhe veturë-Ford</i>
N	<i>parafrazimi</i>
I	<i>konektorët (lidhëza/përemra lidhorë ndajfolje)</i>
	<i>përdorimi i pikësimit në përshtatje me llojin e fjalive që janë përdorur nga shkruesi në tekst.</i>

- Pasi dëgjon dhe vlerëson përgjigjet e nxënësve mësuesi/ja bën një përmbledhje të strukturuar, nxënësve iu jepet detyra për të punuar.

**Detyrë shtëpie:** Klasa ndahet në 2 grupe:

Grupi 1. Shkruani një tekst dhe analizoni koherencën dhe kohezionin.

Grupi 2. Kërkoni në tekste të ndryshme dhe analizoni realizimin e tij në koherencë dhe kohezion.

Në tekstet e shkruara analizoni: karakteristikat, llojin, veçoritë e burimeve në këto pjesë.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• përgjigjen saktë;</li> <li>• dallojnë tiparet e strukturës dhe teknikave të shkrimit të një teksti dhe i zbërthejnë ato</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë e përgjigjeve që lidhen me detyrën e shtëpisë dhe ushtrimet në klasë;</li> </ul>



konkretisht; • shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit; • vlerësojnë arritjet dhe shkathhtësitë e tyre në situatën e të nxënit.	• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja; • për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit; • për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.
---	--

## TEMA MËSIMORE 2.4 (3) USHTRIME. PRAKTIKË

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika:</b> Njohuri të përgjithshme mbi tekstin			
<b>Situata e të nxënit nr. 7</b>			
<p>Krijohet një mjedis i pasur komunikimi me grupe të vogla nxënësish, ku zbulojnë, analizojnë tekstet nga pikëpamje të ndryshme; karakteristikat, llojet dhe struktura e teksteve. Nxënësit vendosen në situatë të nxëni ku analizojnë dhe përdorin në ushtrime konkrete burimet morfologjike, leksikore dhe fonetike të shprehësisë dhe ndërtojnë situata të ndryshme komunikative përmes teksteve të llojeve të ndryshëm.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>          Nxënësi ushtrohet për llojet e teksteve, strukturës dhe burimet e shprehësisë së tekstit, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me to, diskuton mbi informacionin për këtë argumente, nxjerrë nga fushat e të nxënit (p.sh. gjuhë komunikim, komunikim masiv) ose nga jeta e përditshme</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b>          Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve mbi strukturën, llojet dhe burimet e teksteve.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b>          Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyrës së grupit, individuale apo aktivitetit dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin e komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b>          Nxënësi harton situata të përshtatura në botën e gjallë (p.sh:publicistikë, në lidhje me mjedisin social ku ata bëjnë pjesë në përditshmërinë e tyre), duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, në përputhje me rezultatet e pritshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b>          Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat, përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, dëgjimit, shkrimit; vlerësimit të mënyrave dhe teknikave të komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b>          Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të komunikimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b>          Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë komunikimet në</p>			



distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me komunikimin, teknikat dhe llojet e tij dhe kanalet e komunikimit.

<p><b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutimet në klasë për kanalet e ndryshme të komunikimit, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;</li> <li>• përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme</li> <li>• përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të këtyre llojeve të komunikimit;</li> <li>• realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të folurit.</li> <li>• përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> Komunikim Tekst Karakteristika Strukturë Praktikë Burime shprehësie Tekst Shkrues i qëllimshëm Përmbledhje Situatë komunikimi</p>
--	--

<p><b>Burimet:</b> <b>Vetjake:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësve; <b>Specifike:</b> Rrethanat stimuluese, kontekste Audiovizive; <b>Te jashtme:</b> materiale të shtypit të shkruar, modele të komunikimi, libri i nxënësve; <b>Mjete:</b> tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor, ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Komunikim:</b> përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij masiv. <b>Letërsi:</b> Tekste letrare dhe joletrare <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar <b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
--	---

<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutim njohurish paraprake</li> <li>• Rrjeti i diskutimit</li> <li>• Këmbim njohurish</li> <li>• Punë në grup</li> <li>• Praktikë e drejtuar</li> <li>• Shkrim shpejtë</li> <li>• Rishikim</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
--	-------------------------

**Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:**

- Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë të dhëna nga mësuesi, ku nxënësit diskutojnë mbi materialet e tyre e sidomos analizën e bërë mbi rezultatet e arritura në shkrimet e orës së kaluar.
- Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë, plotësojnë dhe vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës.
- Mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve në komentimin e disa prej rregullave që kanë përdorur ata në realizimin e punës së tyre dhe çfarë mund të kishin plotësuar më tepër.

1. Cilat nga mënyrat e përpunimit të tekstit isht më e vështirë për t'u realizuar?
2. Çfarë vështirësish hasët në këto punime ?
3. Çfarë mjetesh përdorët në hartimin e tekstit ?
4. A ka burime alternative të shprehësisë në gjuhën e këtyre teksteve të realizuara?

- Meqenëse kjo orë konsiderohet si orë praktike edhe puna e mësuesit do të konsiderohet si nxitës i aftësive dhe shkathtësive të tyre në praktika të drejtuara. Sugjerohet që mësuesi të ndjekë sipas përvojës së tij mundësi alternative që e çojnë nxënësin te përfitimi i shkathtësive personale dhe kolektive ( grupe të vogla).
- Klasa ndahet në 3 grupe të mëdha dhe më pas në grupe më të vogla, që i dedikohen njëri-tjetrit.

**Grupi I** punon tekste të ndryshme, sugjerohet:

- Fjalimi Nolit përpara shkrimtarëve të rinj
- Teksti i Konicës me këshilla për shkrimtarin
- Tekst libri me artikuj, letra të Dora D'Istrias/Elena Gjika

**Grupit II** i sugjerohet një tekst poetik

- poezi nga Folklori shqiptar .
- poezi të Dritëro Agollit
- Një tekst kënge nga festivali i fundit në Radio Televizionin Kombëtar Shqiptar

**Grupit III** i sugjerohet një tekst letrar në prozë ose fragment dame.

- nga letërsia e kultivuar ; Ismail Kadare
- "Pallati 176" Adelina Balashi
- Tregime nga Teodor Keko

**Shënim** pjesët përzgjidhen nga mësuesi/ja në përshtatje me parapëlqimin e tij/saj dhe gjendjes së klasës.

- Grupet punojnë disa minuta dhe me detyra të përcaktuara:

Secili grup punon tekstit që ka me kërkesa të njëjta.

1. **Analizoni** burimet *morfologjike dhe sintaksore* të shprehësisë së tekstit.
2. **Analizoni** burimet *leksikore dhe fonetike* të shprehësisë së tekstit.
3. **Interpretoni situatën e komunikimit** në këtë tekst.
4. **Komentoni** karakteristikat e tekstit sipas koherencës dhe kohezionit.
5. **Mbani shënime** shkurt që të nxirrni karakteristikat e tekstit.
6. **Përdorni disa strategji** për secilin proces dhe diskutoni për to.

- Pasi punojnë 4-5 minuta me tekstin, nxënësit sjellin reflektimet dhe qëndrimet e tyre.

Diskutohen në fillim për secilin grup dhe më pas merren disa vlerësime në klasë për reflektimet e tyre.

- Grupit i ekspertëve, 3-4 nxënës ndahet në dy grupe më të vogla:

# një që vlerëson grupet gjatë kohës që relatojnë dhe mban shënime

# tjetri përgatitet për prezantimin për secilin grup.

Lihet disa minuta kohë për këtë dhe nis vlerësimi.

Gjatë prezantimit provokohet nga ana e mësuesit një diskutim mbi nevojat dhe përparësitë e njohjes dhe qëllimit të autorit mbi llojin, strukturën dhe burimet e shprehësisë së tekstit.


### Tekstet

- a) Karakteristikat e tekstit;
  - b) Përcakton llojin e tekstit;
  - c) Dallon strukturën e tekstit;
  - d) Evidenton burimet kryesore të shprehësisë së tekstit;
  - e) Analizon situatën e komunikimit në atë tekst.
- Pas disa përgjigjeve të marra nga diskutimi mësuesi/ja tërheq vëmendjen e klasës që të punojë me shkrim një tekst të shkurtër, me nga një qëllim kryesor: Shkrimi i një paragrafi a teksti sipas llojeve të teksteve me të cilat punuan, por tashmë duke ndërruar mes tyre llojin e tekstit.

### Varianti A

- Nxënësve iu sugjerohet të ruajnë standardet që duhet të plotësojë një shkruar i mirë. Klasa shkruan disa minuta (sugjerohet rreth 7-8 minuta); Rilexojnë tekstet e tyre dhe bëhen gati për interpretimin.

Ne vlerësimet e shkrimeve mësuesi/ja mund të ketë parasysh edhe një diagram/tabelë ku vendos karakteristikat e tekstit.



- ➔ Realizohet brenda një situatë komunikimi
- ➔ Njësi shumëdimensionale
- ➔ Përdor mjete gjuhësore të larmishme
- ➔ Ka aftësi të përdorë shumëkuptimësi ndjenjash, duke përdorur burime të shumëfishta gjuhësore.

- Nxënësi duhet të dallojë që më parë këto elemente të tekstit nga qëllimi që ka.
- Më pas shkohet natyrshëm në disa konkluzione tërësore për dy mënyrat e shkrimit të teksteve
1. Nga dallohen këto tekste sipas llojit dhe strukturës?
  2. Çfarë i bashkon ato?
  3. Si përcaktohet struktura e tyre?
  4. Nga se varet aftësia e një teksti për të trasmetuar ndjesitë e shkruarit?
  5. A është përcaktuese situata e komunikimit në një tekst?

Bëhet një përsëritje e shpejtë nëpërmjet këtyre pyetjeve. Duke nxjerrë edhe konkluzione.

Nxënësve iu rekomandohet të përsërisin disa nga konceptet e përpunuara këto tre orë dhe detyra.

#### **Varianti B.**

Grupet zgjedhin të njëjtën pjesë, punojnë me to dhe “ sfidojnë “ njëri –tjetrin, duke ofruar komente të ndryshme rreth teksteve, të cilat më pas hynë në një proces analize dhe vlerësimi sipas përgatitjes së secilit grup.

#### **Varianti C**

Konkurs ndërmjet grupeve të punës dhe shkruesve të mëvonshëm me të njëjtin argument apo me argumente të ndryshme.

- *Pavarësisht nga mënyra që mësuesilja zgjedh për t'i vënë në punë nxënësit sugjerohet që pjesa e pyetjeve për përsëritjen e koncepteve të realizohet me qëllim që nxënësit të përvetësojnë dhe përfitojnë përmes veprimtarive shkathtësitë e planifikuara e që do t'u nevojiten gjatë gjithë kohës.*

**Detyrë shtëpie:** Klasa ndahet në 2 grupe:

Shkruani një tekst me një argument të përzgjedhur në mënyrë individuale, duke patur parasysh të gjitha elementet e skemës së analizës së mësipërme.

Vlerësoni shkurt veten se ç'loj shkruesi jeni: i arrirë, mesatar, nënmesatar.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit përgjigjen saktë</li> <li>• Të përdorin drejt strategjitë e të dëgjuarit, lexuarit</li> <li>• dallojnë tiparet e strukturës dhe teknikave të shkrimit të një tekstit dhe i zbërthejnë ato konkretisht</li> <li>• shkruajnë saktë paragrafët , sipas orientimeve të mësuesit</li> <li>• vlerësojë arritjet dhe shkathtësitë e tij në situatën e të nxënit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>• për saktësinë e përgjigjeve që lidhen me detyrën e shtëpisë dhe ushtrimet në klasë</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> <li>• Vetëvlerësimin e aftësive dhe shkathtësive të arritura</li> </ul>

### **TEMA MËSIMORE 3.1 (1) NJOHURI RRETH TEKSTIT PËRSHKRUES. TEKSNIKAT DHE FORMAT ORGANIZUESE TË PËRSHKRIMIT**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes përshkrimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 8</b>			
<p>Krijohet një mjedis i pasur komunikimi me grupe të vogla nxënësish, të cilat analizojnë nga pikëpamje të ndryshme, analizojnë dhe përdorin në ushtrime konkrete burimet morfologjike, leksikore dhe fonetike të shprehësisë.</p> <p>Ata ndërtojnë situata të ndryshme komunikative përmes teksteve të llojeve të ndryshme.</p>			

## Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe

### ➤ **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

Nxënësi ushtrohet për llojet e teksteve, strukturës dhe burimet e shprehësisë së tekstit, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me to, diskuton mbi informacionin për këtë argumente, nxjerrë nga fushat e të nxënës (p.sh. gjuhë, komunikim, komunikim masiv) ose nga jeta e përditshme.

### ➤ **Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve mbi strukturën, llojet dhe burimet e teksteve.

### ➤ **Kompetenca e të nxënës**

Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e detyrës së grupit, individuale apo të aktivitetit gjatë të nxënës të dijeve të reja në lidhje me llojin e komunikimit.

### ➤ **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësi harton situata të përshtatura me shembuj nga jeta e përditshme (p.sh. publicistikë në lidhje me mjedisin social ku ata bëjnë pjesë në përditshmërinë e tyre), duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar e vlerësuar burimet njerëzore, në përputhje me rezultatet e pritshme.

### ➤ **Kompetenca personale**

Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat, përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, dëgjimit, shkrimit; vlerësimit të mënyrave dhe teknikave të komunikimit.

### ➤ **Kompetenca qytetare**

Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të komunikimit.

### ➤ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me komunikimin, teknikat dhe llojet e tij e kanalet e komunikimit.

### **Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- merr pjesë në diskutimet në klasë për kanalet e ndryshme të komunikimit, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;
- përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme
- përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të këtyre llojeve të komunikimit;
- realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të folurit.

### **Fjalët kyçe:**

Komunikim  
Tekst  
Karakteristika  
Strukturë  
Praktikë  
Burime shprehësie  
Tekst  
Shkrues i qëllimshëm  
Përmbledhje  
Situatë komunikimi

<ul style="list-style-type: none"> <li>përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.</li> </ul>	
<p><b>Burimet:</b>  <b>Vetjake:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;  <b>Specifike:</b> Rrethanat stimuluese, kontekste Audio- vizive;  <b>Te jashtme:</b> materiale të shtypit të shkruar, modele të komunikimi, libri i nxënësit;  <b>Mjete:</b> tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor, ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>  <b>Komunikim:</b> Nxënësi përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe të atij masiv.  <b>Letërsi:</b> Nxënësi përdor tekste letrare dhe joletrare.  <b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar.  <b>Qytetari:</b> Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Diskutim njohurish paraprake</li> <li>Rrjeti i diskutimit</li> <li>Këmbim njohurish</li> <li>Punë në grup</li> <li>Praktikë e drejtuar</li> <li>Shkrim i shpejtë</li> <li>Rishikim</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë të dhëna nga mësuesi, ku nxënësit diskutojnë mbi materialet e tyre e sidomos analizën e bërë mbi rezultatet e arritura në shkrimet e orës së kaluar.</li> <li>➤ Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë, të plotësojnë dhe të vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës.</li> <li>➤ Mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve nëpërmjet komentit rreth disa prej rregullave që kanë përdorur ata në realizimin e punës së tyre dhe duke u vënë në dukje se çfarë mund të kishin plotësuar më tepër, nëpërmjet pyetjeve, si.             <ol style="list-style-type: none"> <li>Cilat nga mënyrat e përpunimit të tekstit ishte më e vështirë për t'u realizuar?</li> <li>Çfarë vështirësish hasët në këto punime ?</li> <li>Çfarë mjetesh përdorët në hartimin e tekstit ?</li> <li>A ka burime alternative të shprehësisë në gjuhën e këtyre teksteve të realizuara?</li> </ol> </li> <li>➤ Meqenëse kjo orë konsiderohet si orë praktike edhe puna e mësuesit do të konsiderohet si nxitës i aftësive dhe shkathtësive të tyre në praktika të drejtuara.</li> </ul>	

- Sugjerohet që mësuesi të ndjekë sipas përvojës së tij mundësi alternative që e çojnë nxënësin te përfitimi i shkathtësive personale dhe kolektive (grupe të vogla).

#### **Varianti A**

- Klasa ndahet në 3 grupe të mëdha dhe më pas në grupe më të vogla, që i dedikohen njëri - tjetrit.

Njëri grup punon tekste të ndryshme (sugjerohet: Fjalimi Nolit përpara shkrimtarëve të rinj) ose përdoren tekste të shkëputura joletrare.

Grupit 2 i sugjerohet poezi nga Folklori Shqiptar.

Grupit 3 i sugjerohet një tekst letrar nga letërsia e kultivuar.

- Grupet punojnë disa minuta dhe me detyra të përcaktuara:

Secili grup punon me të njëjtat kërkesa sipas tekstit që ka në grup.

1. **Analizoni** burimet **morfologjike dhe sintaksore** të shprehësisë së tekstit;
2. **Analizoni** burimet **leksikore dhe fonetike** të shprehësisë së tekstit;
3. **Interpretoni** **situatën e komunikimit** në këtë tekst;
4. **Komentoni** karakteristikat e tekstit sipas koherencës dhe kohezionit
5. **Mbani disa shënime** shkurt që të nxirrni karakteristikat e tekstit.
6. Përdorni disa **strategji** për secilin proces dhe komentoni ato

- Pasi punojnë 4-5 minuta pas leximit të tekstit, nxënësit sjellin qëndrimet a reflektimet e tyre. Diskutohen ato për secilin grup dhe merren disa vlerësime në klasë për reflektimet e tyre.

Grupit i ekspertëve, 3-4 nxënës, (ndahet në dy grupe më të vogla: një që vlerëson grupet gjatë kohës që relatojnë grupet dhe mban shënime dhe tjetri përgatitet për prezantimin për secilin grup.

Lihen disa minuta kohë për këtë dhe nis vlerësimi.

Gjatë prezantimit nxitet nga ana e mësuesit një diskutim mbi nevojat dhe përparësitë e njohjes dhe qëllimit të autorit mbi llojin, strukturën dhe burimet e shprehësisë së tekstit.

#### **Gjatë diskutimit nxënësi:**

- a) përcakton karakteristikat e tekstit;
- b) përcakton llojin e tekstit;
- c) dallon strukturën e tekstit;
- d) evidenton burimet kryesore të shprehësisë së tekstit;
- e) analizon situatën e komunikimit në atë tekst.


- Pas disa përgjigjeve të marra nga diskutimi mësuesi/ja tërheq vëmendjen e klasës që të punojë me shkrim një tekst të shkurtër, me qëllimin kryesor: Shkrimi i një paragrafi a teksti me logjikë kuptimore dhe morfosintaksore.

- Nxënësve iu sugjerohet të ruajnë standardet që duhet të plotësojë një shkruer i mirë.

Klasa shkruan disa minuta (sugjerohet rreth 7-8 minuta);

Rilexojnë tekstet e tyre dhe bëhen gati për interpretimin.

Në vlerësimet e shkrimeve mësuesi/ja mund të ketë parasysh edhe një diagram/tabelë ku vendos karakteristikat e tekstit.



- Realizohet brenda një situatë komunikimi
- Njësi shumëdimensionale
- Përdor mjete gjuhësore të larmishme
- Ka aftësi të përdorë shumëkuptimësi ndjenjash, duke përdorur burime të shumëfishta gjuhësore.

➤ Nxënësi duhet të dallojë që më parë këto elemente të tekstit nga qëllimi që ka.

Më pas, shkohet natyrshëm në disa konkluzione tërësore për dy mënyrat e shkrimit të teksteve, nëpërmjet disa pyetjeve:

1. Nga dallohen këto tekste sipas llojit dhe strukturës?
2. Çfarë i bashkon ato?
3. Si përcaktohet struktura e tyre?
4. Nga se varet aftësia e një teksti për të transmetuar ndjesitë e shkruarit?
5. A është përcaktuese situata e komunikimit në një tekst?

Bëhet një përsëritje e shpejtë nëpërmjet këtyre pyetjeve. Duke nxjerrë edhe konkluzione.

Nxënësve iu rekomandohet të përsëritin disa nga konceptet e përpunuara këto tre orë dhe u caktohen detyra.

#### **Varianti B.**

Grupet zgjedhin të njëjtën pjesë, punojnë me to dhe “sfitojnë” njëri –tjetrin, duke ofruar komente të ndryshme rreth teksteve, të cilat më pas hynë në një proces analize dhe vlerësimi sipas përgatitjes së secilit grup.

#### **Varianti C.**

Konkurs ndërmjet grupeve të punës dhe shkruarëve të mëvonshëm me të njëjtin argument apo me argumente të ndryshme.

➤ *Pavarësisht nga mënyra që mësuesi/ja zgjedh për t’i vënë në punë nxënësit, sugjerohet që pjesa e pyetjeve për përsëritjen e koncepteve të realizohet me qëllim që nxënësit të përvojtojnë dhe përfitojnë përmes veprimtarive shkathtësitë e planifikuara e që do t’u nevojiten gjatë gjithë kohës.*

#### **Detyrë shtëpie:**

Shkruani një tekst me një argument të përzgjedhur në mënyrë individuale, duke pasur parasysh të gjitha elementet e skemës së analizës së mësipërme.

Vlerësoni shkurt veten se ç’lloj shkruarë jeni: i arrirë, mesatar, nënmesatar.

**Vlerësimi i situatës:**

**Vlerësimi i nxënësve:**



<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përgjigjen saktë;</li> <li>• përdorin drejt strategjitë e të dëgjuarit e të të lexuarit;</li> <li>• dallojnë tiparet e strukturës dhe të teknikave të shkrimit të një tekstit dhe i zbërthejnë ato konkretisht;</li> <li>• shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit;</li> <li>• vlerësojnë arritjet dhe shkathtësitë e tyre në situatën e të nxënit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë e përgjigjeve që lidhen me detyrën e shtëpisë dhe ushtrimet në klasë;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit;</li> <li>• për vetëvlerësimin e aftësive dhe shkathtësive të arritura.</li> </ul>
--	--

### TEMA MËSIMORE 3.1 (2) PUNË ME SHKRIM (1) TEKSTI PËRSHKRUES

<p><b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b></p>	<p><b>Lënda: Gjuhë shqipe</b></p>	<p><b>Shkalla V</b></p>	<p><b>Klasa 10</b></p>
<p><b>Tematika: Bota përmes përshkrimit</b></p>			
<p><b>Situata e të nxënit nr. 9</b>          Nxënësit vendosen në një situatë lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë një tekst përshkrues (ese), duke përshkruar pamje, gjendje, apo mjedise të ndryshme.</p>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>              Nxënësi bashkëbisedon për një temë të caktuar, duke diskutuar mbi informacionin për këtë temë, duke përshkruar imazhet dhe gjendjen dhe përfytyrimet e tij mbi temën.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b>  <b>menduarit</b> Nxënësi prezanton, me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për strukturën dhe teknikat e esesë përshkruese</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b>              Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me teknikat e organizimit të përshkrimit.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b>              Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e shkrimit, vlerësimit, kritikës të esesë.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b>              Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen dhe strukturimin e llojeve përshkruese që mbështesin qëllimin e tij.</li> <li>➤ <b>Kompetenca digjitale</b>              Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në</li> </ul>			

distançë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen meshkrimin përshkrues.	
<p><b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• realizon diskutime të ndryshme me gojë, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim mbi strukturën dhe teknikat e përshkrimit</li> <li>• përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme</li> <li>• përdor organizuesit grafikë në funksion të organizimit të esesë përshkruese; realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit të paragrafëve përshkrues;</li> <li>• realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të folurit.</li> <li>• përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore kur shkruan ese përshkruese.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>përshkrim imagjinatë ese</p>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, materiale për t'u vëzhguar, modele të eseve përshkruese në të gjitha format e përfaqësimit, libri i nxënësit, Fjalori i gjuhës shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor, ose tabelë interaktive); foto të ndryshme, imazhe të ndryshme, mjete pune të nxënësit</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Komunikim:</b> përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij masiv.</p> <p><b>Histori dhe shkencat shoqërore,</b> për kontekstin historik dhe sociokulturor të të gjitha teksteve që studiohen nga nxënësit.</p> <p><b>Letërsi:</b> i ofron gjuhës modele të përsosura të përdorimit të gjuhës përshkruese.</p> <p><b>Arte:</b> ofron imazhe të ndryshme mbi të cilat të ngrihen interpretimet</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar</p> <p><b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë ndërtimit të esesë sipas temës.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• prezantim imazhesh</li> <li>• diskutim orientues</li> <li>• shkrim i lirë</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b>	

- Nxënësit janë të informuar që do të kryejnë punë me shkrim (ese përshkruese)
- Pasi u është tërhequr vëmendja me një imazh të tillë, mësuesi kërkon vëmendjen e



Në tabelë është paraqitur me projektor një imazh si ai në të majtë (kujdesemi që imazhi të jetë në tabelë përpara se të fillojë mësimi.


Pyetje: *Sa krijues mund të jeni?*

nxënësve për imazhet që do të shfaqen në tabelë, mbi të cilat nxënësi do të realizojë esenë e tij.



### Unë e dua moshën e tretë...

**Tema:** Realizoni një ese përshkruese ku të portretizoni një person të familjes suaj që i takon moshës së tretë.



### E para është fjala...

**Tema:** Përshkruani gjendjen tuaj shpirtërore në një moment mungese të lirisë së fjalës.




2933...

**Tema:**

*Ju zbrisni nga autobusi në vitin 2933.*

*Përshkruani çfarë shikoni?*

- Fillimisht mësuesi kërkon nga nxënësit të sjellin në mënyrë të rrufeshme disa nga ndjesitë e para që përftojnë në kontakt me imazhin përmes një fjale të vetme ose një togu emër+mbiemër. Mësuesi ndërton në tabelë sipas përshoqërimeve që nxënësit japin për Temën e parë kllasterin:



- Mësuesi diskuton për mënyrën se si do të zhvillohet detyra, duke kërkuar nga nxënësit që 20 minutat e para të punojnë draftin e shkrimit:

- të planifikojnë hyrjen
- të përcaktojnë drejtimet ku do të ndërhyhet për përshkrim
- të organizojnë strukturën e shkrimit (objektet e përshkrimit) dhe paragrafët zhvillues
- të përfytyrojnë mbylljen
- të përzgjedhin fjalorin që duhet të përdorur dhe të kërkojnë sinonime për të evituar përsëritjen e fjalëve (përdorin Fjalorin e gjuhës shqipe)

- Nxënësit janë informuar gjithashtu për kohën në dispozicion dhe mënyrën e vlerësimit të shkrimit, sipas tabelës së mëposhtme:

- Mësuesi monitoron me kujdes situatën. (Mund të zgjidhen disa imazhe, të shfaqen dhe nxënësi të zgjedhë për të shkruar mbi njërin nga ato)

**KUJDES!** Nëse mungon projektori, imazhet mund të ishin fotografi ose piktura të ndryshme, të cilat mësuesi i sjell në klasë. Gjithsesi materiali është orientues, mësuesit sipas pëlqimeve të tyre përdorin foto dhe tema të ndryshme.

Shtjellimi i idesë (2 pikë)	Struktura e esesë (2 pikë)	Stili dhe originaliteti (2 pikë)	Saktësia gjuhësore (2 pikë)																	
a) Reflekton kuptimin e temës b) Zgjedh me kujdes objektin e përshkrimit c) Përshkruan duke mështetur idenë e tij në raport me imazhin e paraqitur d) Ka qartësi mendimi	a) Respekton elementët e strukturës: - Hyrje - Zhvillim - Mbyllje b) Ka organizim logjik, koherencë, unifikim paragrafësh c) Ndërtim paragrafi	A) Përdor një gjuhë që qartë eseistike b) Ka fjalor të pasur Përdor shumllojshmëri tipesh të fjalive për nga kumtimi dhe ndërtimi c) Është origjinal në shprehjen e idesë	a) Strukturon qartë nga pikëpamja gramatikore b) Ndërton fjali të sakta dhe të qarta c) Ka saktësi drejtshkrimore, përdor saktë shenjat e pikësimit																	
a	b	c	d	a	b	c	a	b	c	a	b	c								
+	-	+	-	+	-	+	+	+	-	+	-	+	+	-	+	-	+	-	+	-

**Shënim:** për secilin nxënës mësuesi mund të vendosë në tabelë shënimet vlerësuese që do t'i shërbejnë për të evidentuar nivelin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që ata demonstronjë mbi të cilat mësuesi ndërton punën e tij të mëtejshme. Për kl 10 mendojmë te jenë këto. Shkallë më lart, kërkesa më shumë.

Pasi mësuesi ka plotësuar tabelën dhe ka dalë në përfundimet e tij për nivelin e realizimit të punës me shkrim, në orën në vijim nxënësit do të realizojnë redaktimin e esesë. Ky proces mund t'i lihet nxënësit edhe si detyrë shtëpie. Rivlerësimi i punës me shkrim e pajis mësuesin me bindjen se sa e kanë reflektuar në redaktim nxënësit kërkesat e paketës së indikatorëve. Krahason rezultatet.


Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>nxënësit shkruajnë saktë nga pikëpamja ideore, strukturore, drejtshkrimore e gramatikore</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit, si dhe për përmbushjen e parametrave vlerësues të esesë.</li> </ul>

**Data**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes përshkrimit</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
-------------------------------------	----------------------------	--	-------------------	-----------------


<p><b>TEMA 3.2 (1)</b></p> <p><b>“KISH ARDHUR VJESHTA”</b> <b>BILAL XHAFERRI</b></p>	<p><b>Situata e të nxënësive Nr. 10</b></p> <p>Nxënësist lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin përshkrues, duke analizuar tekstin “Kish ardhur vjeshta”, në aspektin përshkrues të tij. Ata dallojnë teknikat e përshkrimit, si dhe ndërthurjen e këtij të fundit me elemente shpjeguese e argumentuese.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Rezultatet e të nxënësive sipas kompetencave kyçe</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për llojin përshkrues të tekstit, duke veçuar karakteristikat kryesore që lidhen me të, si dhe duke vlerësuar tiparet e tij.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin prezantimeve që lidhen me këtë lloj teksti, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura dhe arti</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënësive</b> Nxënësi demonstroi shkathhtësi funksionale në lexim-shkrim, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënësive të dijeve të reja në lidhje me llojin përshkrues</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, kritikës dhe vlerësimit të tekstit përshkrues.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe tregon interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. duke shfrytëzuar njohjen e llojit përshkrues, që mbështesin qëllimin e tij.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënësive të kompetencave të fushës sipas temës</b></p> <p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me tekstin përshkrues, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda një konteksti të caktuar;</li> <li>• përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin përshkrues;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>përshkrim i natyrës</p> <p>detaje shqisore.</p> <p><b>FJALOR</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ qipare</li> <li>■ monopate</li> <li>■ vigmë</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësive; libri i nxënësive: fragment</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga teksti, si dhe shfrytëzon</p>



<p>(“Kish ardhur vjeshta” - Bilal Xhaferrri); të dhëna nga mjedisi i Dukagjinit; Fjalori i gjuhës shqipe.</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst</p>	<p>materiale të artit për të krahasuar me informacionet e marra nga teksti</p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës, si dhe njohuritë që ofron kjo lëndë për personalitete të letërsisë (Bilal Xhaferrin)</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme që lidhen me temën</p> <p><b>Qytetari:</b> nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p> <p><b>Histori:</b> nxënësi përdor njohuritë për periudha dhe personalitete të ndryshme historike, për të analizuar dhe për të vlerësuar tekste e vepra të ndryshme letrare.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim krahasues mbi vëzhgim</li> <li>• diagrami i Venit</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• skemë rreze</li> <li>• imagjinatë e drejtuar</li> <li>• lexim me ndalesa</li> <li>• praktikë e udhëhequr hap pas hapi</li> <li>• punë në grupe</li> <li>• shkrim i lirë</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Nxënësve u është kërkuar të sjellin materiale (foto, albume etj.) me pamje të natyrës nga krahina të ndryshme të Shqipërisë.</li> <li>➤ Krijohet një mjedis diskutimi krahasues për dy nga fotot e sjella në klasë (natyrë malore dhe bregdetare).</li> </ul> <p>• <b>Diagrami i Venit</b> ndihmon aktivizimin e nxënësve në këtë krahasim</p> <p style="text-align: center;">Natyrë e bregdetit</p> <div style="display: flex; align-items: center;"> <div style="margin-right: 20px;">Natyra malore</div>  </div>	

kanë larmi ngjyrash

- Më pas nxënësve u kërkohet të thonë se ç'dinë për Bilal Xhaferrin, përmes metodës “**stuhi mendimi**”
- Më të dhënat e grumbulluara , si dhe me ndërhyrjet e mësuesit/es plotësohet skema e mëposhtme:



#### Vepra:

- “Njerëz të rinj, tokë e lashtë”
- “Lirishta e kuqe”
- “Era shtyn mjegullat”
- “Krastakraus”

Nxënësit orientohen të vëzhgojnë foton në tekst, fq.57

- Pyetje: *A e keni vizituar ndonjëherë këtë zonë të Shqipërisë?*

Nëse asnjë nxënës nuk ka patur kontakt

- Pyetje: *Ç’përshtypje ju krijohen nga një foto e tillë?*

Nxënësit janë të lirë të sjellin interpretimet e tyre.

Mësuesi i orienton nxënësit drejt interpretimit të ngjyrave.

- Pyetje: *A mund të përshkruani nga pikëpamja*



<p><u>me këto vende, mësuesja paraqet materialin e përgatitur nga interneti për këtë krahinë.</u></p>	<p><i>e mjedisit?</i></p> <p>Nxënësit do të përshkruajnë me kujdes duke u ndalur tek pamja që ofrohet.</p> <p>Nxënësit nxiten në përfytyrimin e tyre me pyetje ndihmëse.</p>
---	--

Në këtë fazë, përmes teknikës së praktikës së udhëhequr hap pas hapi, nxënësit do të lexojnë tekstin: “Kish ardhur vjeshta”.

Gjatë leximit nxënësit duhet të nënvizojnë detajet përshkruese të mjedisit vjeshtor, si dhe do të parapërgatiten të interpretojnë gjuhën shqisore.

**Hapi i parë:** (lexohet paragrafi i parë). Nxënësve u kërkohet të përcaktojnë çfarë ka të veçantë fjalia hyrëse e këtij paragrafi, nga pikëpamja e teknikave të tekstit përshkruar si dhe nga pikëpamja gjuhësore.

Pyetje:

- Cila është pamja që shpalos autori në këtë paragraf?
- Cila kohë e foljes mbizotëron këtu?
- Gjeni pjesët gjegjëse për secilën shqisë të prekur në këtë fragment.
- Cilat janë fjalët përkatëse që nxjerrin më në pah referentin e këtij fragmenti?

**Hapi i dytë:** (lexohet paragrafi i dytë). Nxënësve u kërkohet të analizojnë mënyrën e kalimit nga paragrafi i parë në të dytin.

Pyetje:

- Cilat janë detajet shqisore që preken në këtë paragraf?
- A mund të nënvizoni me të kuqe burimet morfologjike dhe me blu burimet sintaksore të shprehësisë në këtë paragraf?
- Renditni mbiemrat dhe dalloni cilësorët nga epitetet.
- Analizoni llojin e përshkrimit (informues, bindës, shprehës)

**Hapi i tretë:** (lexohet paragrafi i tretë dhe i katërt). Nxënësve u kërkohet të evidentojnë objektet e përshkrimit nga B. Xhaferri.

Pyetje:

- Shpjegoni nëse gjuha e tekstit këtu bëhet më emocionale dhe figurative, duke ilustruar me shembujt përkatës.

( **Model:** do të renditen epitetet, metaforat, enumeracionet – funksioni i tyre stilistik lidhet me krijimin e një imazhi gati legjendar. Tonet e përshkrimit janë ngazëlluese)

- Provoni të lexoni paragrafët duke hequr treguesit kohorë dhe vendorë. Ç’do të ndryshojë në këtë përshkrim?
- Në ç’vetë është realizuar përshkrimi? Çfarë tipare fiton komunikimi në këtë rast?

- Si mendoni ju, ç'janë "portat shkëmbore të Dukagjinit"? Si i imagjinoni ju ato?
  - **Hapi i katërt:** (lexim i paragrafit të fundit të tekstit) Nxënësit duhet të analizojnë nuancat që fiton përshkrimi në këto rreshta të fundit të këtij teksti?

Pyetje:

- Ç'funktion ka ky përshkrim në raport me referentin në këtë tekst?
  - Me ç'detaje përshkruese vjen përshtypja e tij në këtë tekst?
  - A mund të gjejmë burime fonetike shprehësie në këtë tekst?
  - Si mendoni nga ç'lloj këndvështrimi bëhet përshkrimi në tekst?
- Tani u lihet në dorë nxënësve arsyetimi. Klasa ndahet në tre grupe. Secili grup ka detyrat e tij.
- **Grupi I:** renditni detajet sipas llojit të shqisave që ngacmojnë? Plotësoni *ditarin* tripjesësh.

Shqisa	Fragmenti	Detajet përshkruese

- **Grupi II:** Renditni idetë për secilin paragraf përmes një fjalie të menduar të qartë, të plotë dhe të saktë:

Paragrafët	Ideja
Paragrafi I	...
...	

- **Grupi III:** Përshkruani me anë të pesëvargëshit një nga objektet që ju bën më tepër përshtypje në këtë tekst.

Një emër: .....

Dy mbiemrave.....

Tri foljeve .....

Një fjali .....

Një sinonim .....

**Detyrat dhe puna e pavarur:**


- **Shkrim i lirë:** (Nxënësit do punojnë me U.2, fq.58; për të realizuar përshkrimin duke ndryshuar në të tashmen kohët e foljes. Ata do të përcaktojnë më pas ndryshimin që fiton teksti)
- **Detyrë shtëpie:** Nxënësit duhet të realizojnë një përshkrim të një mbrëmjeje në bregdet, me stilin e Bilal Xhaferrit.

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet përshkruese dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin në studim;</li> <li>• zbërthejnë idetë e tekstit dhe funksionin e përshkrimit në mbështetje të idesë;</li> <li>• shkruajnë drejt, në mënyrë të plotë dhe duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të shkruarit.</li> </ul>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Tematika: Bota përmes përshkrimit	Shkalla: V	Klasa: X
<b>TEMA MËSIMORE 3.2 (2)</b> <b>“KISH ARDHUR VJESHTA”</b> <b>BILAL XHAFERRI</b> <b>LESIKU I GJUHËS SHQIPE</b>		<b>Situata e të nxënësve Nr. 11</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me leksikun e shqipes, duke u ushtruar në ushtrime konkrete me to.		
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b>				
➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</b> Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar				

<p>rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, tekste argumentues bindës etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit.</b> Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga fusha e gjuhës (leksiku i gjuhës);</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit.</b> Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë , sipas qëllimeve që i cakton vetes.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale.</b> Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave gjuhësore, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</li> <li>➤ <b>Kompetenca digjitale.</b> Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës</b></p> <p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e leksikut të një gjuhe;</li> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për leksikun e gjuhës shqipe, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të fjalës në tekstin “Kish ardhur vjeshta”</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Leksiku i shqipes Leksiku i përditshëm Leksiku profesional Leksik amtar Leksik aktiv Leksik pasiv</p>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe, <b>Mjete:</b> fleep-charter (projektor), tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti “Kish ardhur vjeshta</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes, si dhe forma të ndryshme të leksikut amtar apo të huazuar <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi që dëshmojnë pasuri leksikore.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• tabela e mendimit</li> <li>• bisedë e kombinuar me shpjegim, DDM</li> <li>• punë në grupe</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	

- Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë.
  - Lexohen dy nga përshkrimet e nxënësve për një mjedis mbrëmjeje vjeshte në bregdet
  - Bëhen diskutimet për punën e nxënësve, duke kontrolluar edhe teknikën e dëgjimit të vëmendshëm
- Në tabelë shkruhet: **Leksiku i një gjuhe** dhe përmes teknikës stuhi mendimi, nxënësve u kërkohet të rikujtojnë:
  - Ç’është leksiku i një gjuhe?
  - Si e gjejmë atë në fjalorin e gjuhës shqipe?
  - Çfarë llojesh të leksikut njohin ata?
- Në bashkëpunim me nxënësit ndërtohet organizuesi grafik



U kërkohet nxënësve të nënvizojnë në tekstin “Kish ardhur vjeshta” fjalë që i takojnë këtyre kategorive të mësipërme.

- Diskutime në klasë
- Më pas përmes teknikës **DDM**, nxënësit plotësojnë njohuritë lidhur me temën.

Di	Dua të di	Mësova
Ç’është leksiku	Si mund të shfaqen njësitë leksikore të huazuara?	-mund të jenë fjalë ndërkombëtare

		Mund të sjellin nuanca kuptimore më të përpikta: ( <u>bejtexhi/vargëzonjës</u> )  -e kërkon një stil i caktuar i gjuhës ( <u>dhaskal/mësues</u> )

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Nxënësit ndahen në **tre grupe** dhe secili nga grupet punon me tekstin me kërkesën

Grupi	Burimi leksikor	Funksioni
Grupi I		
Grupi II		
Grupi III		

➤ **Detyrë shtëpie: Ushtrimet 10& 11; fq.59**

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me trajtimin e leksikut të një gjuhe;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore fjalët e fjalitë;</li> <li>• analizojnë drejt kuptimet dhe funksionet e fjalëve në tekste të ndryshëm.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të shkruarit.</li> </ul>

### TEMA MËSIMORE 3.2 (4) "TË VESHURAT SHQIPTARE", FAIK KONICA


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla V	Klasa 10
<b>Tematika:</b> Bota përmes përshkrimit			
<b>Situata e të nxënit nr. 13</b>			
<p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin përshkrues, duke analizuar tekstin "Të veshurat shqiptare", në aspektin përshkrues të tij. Ata dallojnë teknikat e përshkrimit, si dhe ndërthurjen e këtij të fundit me elementë shpjegues e argumentues.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>            Nxënësi bashkëbisedon për llojin përshkrues të tekstit, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të, si dhe duke vlerësuar tiparet e tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b>            Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin prezantimeve që lidhen me këtë lloj teksti, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura dhe arti</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b>            Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin përshkrues</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b>            Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, kritikës dhe vlerësimit të tekstit përshkrues.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b>            Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojit përshkrues, që mbështesin qëllimin e tij.</p>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me tekstin përshkrues, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda një konteksti të caktuar;</li> <li>• përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>etnografi kulturë shqiptare.</p> <p>FJALOR flokja kërmëz jatagan kapotë</p>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit: fragment (“mbtë veshurat shqiptare”- Konica), të dhëna nga etnografia, albume, Fjalori i gjuhës shqipe.</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, shkurtesa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst F. Konica</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga “të veshurat shqiptare”, si dhe shfrytëzon materiale të artit për të krahasuar me informacionet e marra nga teksti</p> <p><b>Letërsi:</b> përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës, si dhe njohuritë që ofron kjo lëndë për personalitete të letërsisë</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme që lidhen me temën</p> <p><b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p> <p><b>Histori:</b> nxënësi përdor njohuritë për periudha dhe personalitete të ndryshme historike për të analizuar dhe për të vlerësuar tekste e vepra të ndryshme letrare.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim krahasues mbi vëzhgim</li> <li>• diagrami i Venit</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• skemë rreze</li> <li>• imagjinatë e drejtuar</li> <li>• lexim me ndalesa</li> <li>• praktikë e udhëhequr hap pas hapi</li> <li>• punë në grupe</li> <li>• shkrim i lirë</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Nxënësve u është kërkuar të sjellin materiale (foto, albume, etj) me veshje popullore nga krahina të ndryshme të Shqipërisë.</li> <li>➤ Krijohet një mjedis diskutimi krahasues për veshjet e krahinës së Veriut dhe të Jugut. <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Diagrami i Venit</b> ndihmon aktivizimin e nxënësve në këtë krahasim</li> </ul> </li> </ul>	



Veshje të Veriut


Veshje të Jugut



kanë larmi ngjyrash

(Krahasimi bëhet nisur nga përbërësit e veshjes dhe ngjyrat e tyre sipas krahinave)

- Më pas nxënësve u kërkohet të thonë ç' dinë për Faik Konicën, përmes metodës **stuhi mendimi**:
- Më të dhënat e grumbulluara, si dhe me ndërhyrjet e mësuesit plotësohet skema rreze e mëposhtme:



**Vepra:** Shqipëria dhe turqit

Doktor Gjilpëra zbuloi rrënjët e dramës së Mamurrasit

Shqipëria –kopsht shkëmbor i Evropës Juglindore



FOTO E BAJRONIT me veshjen shqiptare

- Pyetje: A keni dijeni se cila është shkenca që merret me veshjet popullore?

- Pyetje: Ç'impresione ju krijohen nga një foto e tillë?

Nxënësit janë të lirë të sjellin interpretimet e tyre. (Në foto paraqitet Bajroni, romantiku i madh anglez, mik i shqiptarëve, adhurues i natyrës dhe tipareve të shqiptarëve, u prit nga Ali Pashë Tepelena dhe udhëtimet e tij i ka përmbledhur në poemën Çajld Harold .)

Mësuesi i orienton nxënësit drejt veshjes së tij.

- Pyetje: A mund të përshkruani kostumin që mban veshur ai?

Nxënësit do të përshkruajnë me kujdes duke u ndalur tek pamja madhështore që transmeton kostumi shqiptar. Nxënësit nxiten në përfytyrimin e tyre me pyetje të tilla si:

- A duket si veshje mbretërore? Pse?

Mësuesi e drejton diskutimin në interesin që ka patur dhe ka veshja shqiptare për shkencën e etnografisë, por edhe për studiues të vendit dhe të huaj, të cilët e kanë parë veshjen si shenjë e origjinalitetit të kombit.

- Si mund të zërtheni simbolikën e ngjyrave të çallmës dhe kombinimin e së bardhës me të kuqen në shegë dhe me të verdhën e floririt?

- Ju jep përshtypjen e një veshjeje kremtërore/festive? Pse?

- A mendoni se pozicioni kryelartë i Bajronit në foto vjen dhe si pasojë e veshjes që ai mban?

Në interpretimin e tyre nxënësit përdorin shpjegimet në U.1, f.64 (për fustanelën, pishqollën, flokjen etj.)

➤ Në këtë fazë, përmes teknikës së praktikës së udhëhequr hap pas hapi, nxënësit do të lexojnë tekstin “Të veshurat shqiptare”.

Gjatë leximit nxënësit duhet të nënvizojnë detajet përshkruese të veshjeve, si dhe burimet ku është mbështetur autori për të nxjerrë vlerat e kostumit shqiptar.

- **Hapi i parë:** (lexohet paragrafi i parë). Nxënësve u kërkohet të përcaktojnë çfarë ka të veçantë fjalja hyrëse e këtij paragrafi, nga pikëpamja e teknikave të tekstit përshkrues si dhe nga pikëpamja gjuhësore. Cilën vet të popullit shqiptar evidenton Konica që në hyrje të tekstit?

(**Model:** Fjalja e parë funksionon brenda teknikave të tekstit përshkrues teksa e orienton përshkrimin nga e përgjithshme tek e veçanta; nis me atë çka është thelbësore e fatit të shqiptarit – lufta-, më tutje tek përpjekjet për mbijetesë kombëtare- gjuha- dhe më tutje tek traditat e moçme. Dhe në mbyllje të fjalisë përqendrohet tek objekti i përshkrimit – kostumi shqiptar. Nga pikëpamja sintaksore fjalja është e përbërë me nënrenditje lejore (mjete lidhëzore- me gjithë). Nga pikëpamja kuptimore lë të kuptosh që populli shqiptar ka qenë i gjendur mes luftërash pushtuese dhe qëllimi parësor ka qenë vetëmbrojtja, por përpos kësaj ka qenë popull që ka pasur dhe ka ditur t’i ruajë vlerat e veta)

Pyetje: Cila është ideja që kërkon të shpalesë autori në mbyllje të paragrafit?

*Nisur vetëm nga fjalja përmbyllëse e paragrafit a mund të nxjerrim një përfundim lidhur me qëllimin e përshkrimit të kostumit shqiptar nga ana e Konicës?*

*Po fakti që teksti është shkruar në vetën e parë shumë, ç’imazhe ju krijon?*

(**Model:** Autori përshkrimin e kostumeve shqiptare duket se e bën jo thjesht për vlerat estetike që këto kostume transmetojnë por në radhë të parë për të përshkruar vlerat kombëtare, vlerat e trashëgimisë së traditës shqiptare, të cilat siguruan mbijetesën e këtij populli të lashtë dhe me prejardhje nga ilirët, popull autokton në trojet e veta. E gjitha kjo bëhej në kushtet kur propaganda shoviniste i mohonte prejardhjen ilire të shqiptarëve. Veta e parë shumë është gjithëpërfshirëse.)

- **Hapi i dytë:**(lexohet paragrafi i dytë).Nxënësve u kërkohet të analizojnë mënyrën e interpretimit etnografik të kostumit kombëtar shqiptar, në funksion të karakterit të shqiptarit. Cilat janë detajet shqisore që preken në këtë paragraf?

(**Model:** shumëllojshmëria e kostumeve shqiptare lidhet në këtë rast me karakterin individualist të shqiptarit. Por fakti që shqiptarët krahas këtyre kostumeve të veçanta kanë edhe një veshje të përbashkët, sërish hedh dritë mbi tiparet që i bashkojnë shqiptarët më shumë se sa i ndajnë ata. Detaje shqisore: veshje kremtërore – festive (shqisa e të parit/ por edhe e të dëgjuarit- mund të flitet për zhurmën e tingujve festivë); prej dere të mirë- përshkrim

ngacmues për imagjinatën e lexuesit (përfshihen të gjitha shqisat me përdorimin e një frazeologjizmi të tillë; imitim i poshtër- detajet e të parit; kur flasim –dy herë e përsëritur në fragmnet- detaj i të dëgjuarit- në këtë rast duket se autori e përdor këtë detaj të fundit për të krijuar idenë se çështja e kostumit shqiptar është me rëndësi të veçantë dhe ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të fushës, të cilët duhen dëgjuar)

Pyetje: *A mund të dallojmë elementë shpjegues në këtë tekst?*

(**Model:** Nxënësit do të dallojnë elementë të shpjegimit, madje edhe të argumentimit në tekst dhe mësuesi duhet të ndalet edhe njëherë tek ideja se është vështirë të gjendet një tekst i pastër përshkrues, argumentues etj, pasi në të gjitha tekstet do të gjejmë elementë të të gjitha llojeve. Psh: ndihet argumenti shpjegues që dëshmon për ndikimin e kulturës shqiptare në Ballkan.)

- **Hapi i tretë:** (lexohet paragrafi i tretë). Nxënësve u kërkohet të evidentojnë objektet e përshkrimit nga Bajroni

(**Model:** pamja e jashtëzakonshme e vendit me ngjyrat e perëndimit- detajet e të parit dhe të të prekurit (dielli), krahasimi me kështjellën Branksome të Skotit; si dhe rrobat e shqiptarëve – madhështore..shqisa e të parit; ngjyrë kremezi (shqisa e të parit); prej kadifeje (shqisa e të prekurit) apo pamje e shijshme (shqisa e të shijuarit)

Pyetje: *Shpjegoni nëse gjuha e tekstit këtu bëhet më emocionale dhe figurative, duke ilustruar me shembujt përkatës.*

( **Model:** do të renditen epitetet, metaforat, enumeracionet – funksioni i tyre stilistik lidhet me krijimin e një imazhi gati legjendar. Tonet e përshkrimit janë ngazëllyese)

- **Hapi i katërt:** (lexim i paragrafëve deri në fund të tekstit) Nxënësit duhet të shpjegojnë përmes cilave detaje përshkruese autori sjell portretin e Bajronit? Ç' funksion ka ky përshkrim në raport me referentin në këtë tekst?

(**Model:** Përshkrimi që i bën autori Bajronit lidhet me karakterin vëzhgues të tij (jo si poet, jo si romantik) dhe kjo lidhet drejtpërdrejt me referentin në tekst (veshjet shqiptare). Qëllimi i autorit është jo vetëm të përshkruajë por edhe të shpjegojë përmes burimeve të besueshme se cili qe karakteri i shqiptarit që reklamohet edhe përmes veshjeve të tij, gjë që ka tërhequr vëmendjen e të huajve të vëmendshëm si Bajroni)

Pyetje: *Cili është përcaktimi i Bajronit për shqiptarët? Me ç' detaje përshkruese vjen përshtypja e tij në këtë tekst?*

( **Model:**Do përmenden detajet e pamjes (së mirë); të të ecurit (shqisa e të parit), të qëndrimit. Duket qartë se Bajroni ka qenë dashamirës i shqiptarëve, i adhuron ata, edhe pse në këtë moment vë në dukje me humor dashamir shkallën e zhvillimit të shqiptarëve të kohës)

Pyetje: *Ç' vlerësim të Bajronit për veshjen shqiptare sjell Konica në fragment? Pse përdoren thonjëzat në këta paragrafë?*

(**Model:** Detajet: *mgnifiques, të vetmet plaçka të shtrenjta* (vlera monetare), janë domethënëse. Vlerësohet qëndrimi që mbanin shqiptarët ndaj veshjes, sa e vlerësonin ata mënyrën e të mbajturit, si kujdeseshin për kostumin popullor duke qenë kështu ruajtës të traditës së veshjes me shije.

Thonjëzat përdoren se sillen në ligjëratë të drejtë fjala e Bajronit, gjë që shton besueshmërinë e burimit)

- Tani u lihet në dorë nxënësve arsyetimi. Klasa ndahet në tre grupe. Secili grup ka detyrat e tij.

- **Grupi I:** Cilat janë mendimet mbi Shqiptarët dhe Shqipërinë që sjellin autorët e përmendur në këtë test dhe përmes cilave detaje të përshkrimit shpalosen ato? Plotësoni **ditarin** tripjesësh

Autorët	Mendimet e tyre	Detajet përshkruese
Nopça		
Shelli		
Bajroni		
Konica		

- **Grupi II:** Renditni idetë për secilin paragraf përmes një fjalie të menduar të qartë, të plotë dhe të saktë:

Paragrafët	Ideja
Paragrafi I	...
...	

- **Grupi III:** Përshkruani me anë të pesëvargëshit një nga kostumet shqiptare që keni në fq.62:

Një emër: \_\_\_\_\_

Dy mbiemrave \_\_\_\_\_

Tri foljeve \_\_\_\_\_

Një fjali \_\_\_\_\_

Një sinonim \_\_\_\_\_

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- **Shkrim i lirë:** (Nxënësit do punojnë me U.1, fq.65; për të përshkruar një objekt që u ka lënë mbresë, sipas modelit në tekst)

**Detyrë shtëpie:** Klasa do të ndahet në tre grupe për të organizuar një orë të **mësimit pa mure:** Grupet kanë të njëjtat kërkesa dhe do të konkurojnë mes tyre për mënyrën e prezantimit të materialeve. Ato duhet të organizojnë:

- *Krijimin e një miniekspozite me veshje popullore (ose albumi)*
- *Plotësimin e një harte memece të trevave shqiptare me kostume karakteristike të atyre zonave*
- *Materiale të veshjeve të sotme nga stilistë vendas të njohur (punime në poëer point; video)*
- *Të gjitha këto mund të shoqërohen edhe me ushqime tradicionale, valle të traditës etj...*

**Vlerësimi i situatës:**


**Vlerësimi i nxënësve:**

<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm</li> <li>• dallojnë tiparet përshkruese dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin në studim</li> <li>• zbërthejnë idetë e tekstit dhe funksionin e përshkrimit në mbështetje të idesë</li> <li>• shkruajnë drejt, në mënyrë të plotë dhe duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>
--	---


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Tematika: Bota përmes përshkrimit	Shkalla: V	Klasa: X
TEMA 3.2 (7)  "BABAI IM"  NATALI GINZBURG		<b>Situata e të nxënit Nr: 16</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin përshkrues, duke analizuar tekstin " Babai im", në aspektin përshkrues të tij. Ata dallojnë teknikat e përshkrimit, si dhe ndërthurjen e këtij të fundit me elementë rrëfyes.		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për llojin përshkrues të tekstit, duke veçuar karakteristika që lidhen me të, si dhe duke vlerësuar tiparet e tij dhe praninë e elementit rrëfyes në të.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin prezantimeve që lidhen me këtë lloj teksti, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura dhe arti</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b> Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në përmbushjen e kërkesave për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin përshkrues me elementë rrëfyes.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, kritikës dhe vlerësimit të tekstit përshkrues.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojit përshkrues, që mbështesin qëllimin e tij.</li> </ul>				
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës</b>  <b>mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me tekstin përshkrues me elementë rrëfyes në të, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda një konteksti të caktuar;</li> <li>• përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin përshkrues;</li> </ul>			<b>Fjalët kyçe:</b>  shpirt i aventurës detaje shqisore ngjyrosje emocionale  <b>FJALOR</b> ■ pajisje  ■ trenta e lode	

<ul style="list-style-type: none"> <li>shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit: fragment (“Babai im”, të dhëna nga mjedisi i Palermos, Fjalori i gjuhës shqipe.</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, markera, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga teksti, si dhe shfrytëzon materiale të artit për të krahasuar me informacionet e marra nga teksti</p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës, si dhe njohuritë që ofron kjo lëndë për personalitete të letërsisë (Natali Ginzburg)</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme që lidhen me temën dhe autoren Natali Ginzburg</p> <p><b>Qytetari:</b> nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, raportet familjare gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>diskutim krahasues mbi vëzhgim</li> <li>diagrami i Venit</li> <li>stuhi mendimi</li> <li>skemë rreze</li> <li>imagjinatë e drejtuar</li> <li>lexim me ndalesa</li> <li>praktikë e udhëhequr hap pas hapi</li> <li>punë në grupe</li> <li>shkrim i lirë</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trjatinin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Diskutim i detyrave të shtëpisë, komente, sqarime.</li> <li>➤ Krijohet një mjedis diskutimi krahasues për dy modele të prindërimit në familje.</li> <li>➤ Përmes diagramit të Venit krahasojmë mënyrën e edukimit përmes formës autoritare dhe demokratike në familjen e sotme</li> </ul>	

- **Diagrami i Venit** ndihmon aktivizimin e nxënësve në këtë krahasim



- Në tabelë paraqitet skeda e autorit.



familja

politika fashiste

filozofia

#### **Vepra:**

- "Të gjitha të djeshmet tona "
- "Kështu ka qenë"
- "Virtytet e vogla"
- "Zërat e mbrëmjes"
- "Zhargon familjar"



➤ Përmes teknikës së praktikës së udhëhequr hap pas hapi, nxënësit do të lexojnë tekstin “Babai im”.

- Gjatë leximit nxënësit duhet të nënvizojnë detajet përshkruese të babait,
- Do të interpretojnë gjuhën shqisore.
- Do të nënvizojnë këndvështrimin e narratorit

- **Hapi i parë:** (lexohet paragrafi i parë). Nxënësve u kërkohet të përcaktojnë çfarë ka të veçantë në këtë përshkrim

Pyetje:

- Cili është aspekti që shpalos autorja në këtë paragraf në raport me babain?
- Cila kohë e foljes mbizotëron këtu?
- Cili është raporti mes narratores dhe babait?
- Gjeni pjesët gjejgëse për secilën shqisë të prekur në këtë fragment.

- **Hapi i dytë:** (lexohet paragrafi i dytë).Nxënësve u kërkohet të analizojnë mënyrën e kalimit nga paragrafi i parë në të dytin.

Pyetje:

- Cilat janë detajet shqisore që preken në këtë paragraf?
- A mund të nënvizoni me të kuqe burimet morfologjike dhe me blu burimet sintaksore të shprehësisë në këtë paragraf?
- Renditni mbiemrat dhe dalloni cilësorët nga epitetet.
- Analizoni llojin e përshkrimit (informues, bindës, shprehës)

- **Hapi i tretë:** (lexohet paragrafi i tretë). Nxënësve u kërkohet të evidentojnë personazhin e ri të përshkruar nga Ginzburg

Pyetje:

- Shpjegoni nëse gjuha e tekstit këtu bëhet më emocionale, figurative, apo shpjeguese, duke ilustruar me shembujt përkatës.
- Në ç’vetë është realizuar përshkrimi? Çfarë tipare fiton komunikimi në këtë rast?
- Pse Xhinoja është i përzgjedhuri i babait, duke ilustruar nga teksti

- **Hapi i katërt:** (lexim i paragrafit të fundit të tekstit) Nxënësit duhet të analizojnë nuancat që fiton përshkrimi në këto rreshta të fundit të këtij teksti?

Pyetje:

- Ç'funktion ka ky përshkrim në raport me referentin në këtë tekst?
- Me ç'detaje përshkruese vjen babai dhe si shfaqen personazhet dytësore të tekstit?
- A mund të gjejmë burime fonetike shprehësie në këtë tekst?
- Si mendoni nga ç'lloj këndvështrimi bëhet përshkrimi në tekst?

➤ Tani u lihet në dorë nxënësve arsyetimi. Klasa ndahet në tre grupe. Secili grup ka detyrat e tij.

- **Grupi I:** renditni detajet sipas llojit të shqisave që ngacmojnë? Plotësoni *ditarin tripjesësh*

Shqisa	Fragmenti	Detajet përshkruese

- **Grupi II:** Renditni idetë për secilin paragraf përmes një fjalie të menduar të qartë, të plotë dhe të saktë:

Paragrafët	Ideja
Paragrafi I	...
...	

- **Grupi III:** Përshkruani me anë të pesëvargëshit *babain*

Një emër: \_\_\_\_\_

Dy mbiemra: _____ Tri folje: _____ Një fjali: _____ Një sinonim: _____ <b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Shkrim i lirë:</b> (Nxënësit do punojnë me U.2, fq.71, për të realizuar përshkrimin Fizik të babait, duke u bazuar në sjelljen e të folurit e tij</li> <li>• <b>Detyrë shtëpie:</b> <i>Përshkruani portretin e njërit prej prindërve tuaj, duke përdorur teknikat e përshkrimit subjektiv.</i></li> </ul>	
<b>Vlerësimi i situatës</b>	<b>Vlerësimi i nxënësve:</b>
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm</li> <li>• dallojnë tiparet përshkruese dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin në studim</li> <li>• zbërthejnë idetë e tekstit dhe funksionin e përshkrimit në mbështetje të idesë</li> <li>• shkruajnë drejt, në mënyrë të plotë dhe duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit.</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Tematika: Bota përmes përshkrimit	Shkalla: V	Klasa: X
<b>TEMA MËSIMORE 3.2 (8)</b> <b>“BABAI IM”, NATALI GINZBURG</b> <b>EMRAT QË FORMOJNË SHUMËSIN</b> <b>ME PRAPASHTESA OSE ME</b> <b>NDËRRIME TINGUJSH</b> <b>USHTRIME.</b>		<b>Situata e të nxënësve Nr. 17</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me emrat që e formojnë shumësin me prapashtesa ose ndërrime tingujsh.		

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

- **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.** Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të emrave në numrin shumës, në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, letër formale dhe joformale, autobiografi etj.
- **Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi që lidhet shumësin e emrave dhe përdorimin e tyre në fjali.
- **Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në mënyrën e përdorimit dhe rregullave të shkrimit të emrave në shumës dhe për të kryer një veprim, aktivitet apo detyrë, sipas qëllimeve të caktuara.
- **Kompetenca dixhitale.** Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin e duhur për shumësin e emrave nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës</b></p> <p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të shumësit të emrave;</li> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit, në rastet e përdorimit të emrave në numrin shumës;</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për shumësin e emrave, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstin “Babai im” dhe në tekste të tjera letrarë ose joletrarë.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Analizë morfologjike Kategoria enumerit Shumësi i emrave Rregulla të drejtshkrimit të emrave në numrin shumës</p>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> fleep-charter (projektor), tabela, markera, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga Ginzburg.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes dhe për të përmbushur rezultatet e të nxënit të kësaj ore</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• bisedë e kombinuar me shpjegim, DDM</li> <li>• punë e pavarur,</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	

- Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Lexohen nga nxënësit dy punime dhe diskutohet mbi mënyrën e realizimit, teknikat e shkrimit, ndërthurjen e elementit rrëfim dhe përshkrim në punimet e nxënësve.


Pyetje: *Risillni momentet kyç të këtij teksti.* (Nxënësi duhet të përmbledhë shumë shkurt tekstin “Babai im”). Mësuesi orienton nxënësin të synojë përshkrimin e fragmentit.

- Tërhiqet vëmendja tek shumësi i emrave

Pyetje: *Formoni shumësin e emrave në paragrafin e parë të tekstit “Babai im”*

Pyetje: *Vini re cilat janë prapashtesat që shërbejnë për formimin e shumësit:*

- Në tabelë mësuesi shkruan *emra në njëjës* dhe kërkon nga nxënësit të sjellin modele të tjera. Në tabelë plotësohet në bashkëpunim me nxënësit skema e mëposhtme:



Mësuesi kujdeset që të shkruajë ngjyra të ndryshme

- Në këtë fazë nxënësit ndahen në dy grupe dhe punojnë me tekstin “Babai im”:
    - Grupi I: Zbuloni emrat në shumës dhe prapashtesat e shumësit në dy paragrafët e parë të tekstit
    - Grupi II: Zbuloni emrat në shumës dhe prapashtesat e shumësit në dy paragrafët në vijim
- Diskutohen përgjigjet e nxënësve në klasë.
  - Në këtë fazë nxënësve u kërkohet të plotësojnë tabelën DDM për njohuritë që lidhen me emrat që e formojnë shumësin me ndërrime tingujsh



<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes përshkrimit</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
<b>TEMA MËSIMORE 3.2 (9)</b> <b>“BABAI IM” – NATALI GINZBURG</b>  <b>EMRAT ME TË NJËJTËN TEMË NË NJËJËS DHE NË SHUMËS</b>  <b>USHTRIME</b>		<b>Situata e të nxënit Nr. 18</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me leksikun e shqipes, duke u ushtruar në ushtrime konkrete emrat me të njëjtën temë në njëjës dhe në shumës.		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</b> Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, tekste argumentues bindës etj.;</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit.</b> Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga fusha e gjuhës (emrat me të njëjtën temë në njëjës dhe në shumës);</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit.</b> Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë , sipas qëllimeve që i cakton vetes.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale.</b> Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave gjuhësore, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</li> <li>➤ <b>Kompetenca dixhitale.</b> Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;</li> </ul>				
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e emrave me të njëjtën temë në njëjës dhe shumës;</li> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për temën, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të fjalës në tekstin “Babai im”</li> </ul>			<b>Fjalët kyçe:</b>  Leksiku i shqipes  Emrat me të njëjtën temë në numrin njëjës dhe shumës	
<b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; libri i nxënësit; enciklopedi; fjalori i gjuhës shqipe. <b>Mjete:</b> fleep-charter (projektor); tabela; shkumësa me ngjyra; mjete pune të		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>  <b>Letërsi:</b> nxënësi përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes, si dhe forma të ndryshme të emrave me temë të njëjtë në		

nxënësit; fragmenti “Babai im”.	njëjës dhe shumës <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi që dëshmojnë njohuri të plota për temën.
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• tabela e mendimit</li> <li>• bisedë e kombinuar me shpjegim, DDM</li> <li>• punë në grupe</li> </ul>	<b>Koha: 45 minuta</b>
<b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexohen dy nga punimet e nxënësve</li> <li>• Bëhen diskutimet për punën e nxënësve, duke kontrolluar edhe teknikën e dëgjimit të vëmendshëm</li> </ul> </li> <li>➤ Në tabelë shkruhet <b>shumësi i emrave</b> dhe përmes teknikës <u>stuhi mendimi</u>, nxënësve u kërkohet të rikujtojnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Si e gjejmë shumësin e emrave në gjuhën shqipe?</li> <li>• Çfarë formash të shumësit njohin ata?</li> </ul> </li> <li>➤ Në bashkëpunim me nxënësit ndërtohet <u>organizuesi grafik</u>:</li> </ul>	
<div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; background-color: #e6f2e6; width: 20%;"> <b>Ndërrimit të tingujve:</b>  Shteg - shtigje  Djalë - djem </div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; background-color: #e6f2e6; width: 20%; text-align: center;"> <b>KUJDES! Shumësi i emrave sipas:</b> </div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; background-color: #ffe0b2; width: 20%;"> <b>Prapashtesave:</b>  punëtor- punëtore  fushë-fusha  bari- barini </div> </div> <div style="text-align: center; margin: 10px 0;"> </div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; background-color: #b3e2fc; width: 30%; margin: 0 auto; text-align: center;"> <b>Me të njëjtën temë të njëjësit dhe shumësit:</b>  <b>(triko- triko)</b> </div>	
U kërkohet nxënësve të nënvizojnë në tekstin “Babai im” fjalë që u takojnë këtyre kategorive të mësipërme.	



- Diskutime në klasë
- Më pas përmes teknikës **DDM**, nxënësit plotësojnë njohuritë lidhur me temën.

Di	Dua të di	Mësova
Ç'është emri	Cilat janë kategoritë e tij?	Gjinia, numri, rasa.....
Shumësi i emrave formohet me parashtesa....	A ka përjashtime nga ky rregull?	Janë emrat që kanë të njëjtën temë në njëjës dhe në shumës

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

Nxënësit ndahen në **tri grupe** dhe secili nga grupet punon me tekstin me kërkesën

Grupi	Shumës me prapashtesa	Shumësi me ndërrim tingujsh	Erma me të njëjtën temë në njëjës dhe në shumës
Grupi I			
Grupi II			
Grupi III			

- **Detyrë shtëpie: Ushtrimet 1/fq.72 & 3/ fq. 73**

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me temën e mësimi;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore fjalët e fjalitë;</li> <li>• analizojnë drejt kuptimet dhe funksionet e fjalëve në tekste të ndryshme .</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 3.3 (1) PROJEKTE:**  
**“PJESË NGA JETA E SHËN MËRISË” PJETËR BOGDANI**  
**“ORIGJINA E GJUHËS SHQIPE” KOSTAQ CIPO**  
**“A GËNJEN AKTORI” ALEKSANDËR MOISIU**  
**“KARTON KUQ E ZI” ARDIAN VEBIU**

**Tematika:** Përsiatje dhe endje

**QËLLIMI I PROJEKTIT:**

Stimulimi i punës kërkimore, analitike, argumentuese e krijuese të nxënësve në mënyrë individuale dhe në grup për të realizuar një produkt analitik.

**SYNIMET E PROJEKTIT:**

- Lexim i orientuar i teksteve
- Analizë e plotë krahasuese e teksteve
- Zbulim i elementëve tekstorë informativë, udhëzues, përshkrues, argumentues e rrëfyes
- Studim nga pikëpamja gjuhësore
- Ekspozim i ideve krijuese në forma të ndryshme

**▣ REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE:**

**▣ Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

*Nxënësi :*

- shprehet, përmes një forme komunikimi, për një studim krahasimor mes tekstesh të llojit joletrar,
- diskuton në grup, jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për temën;
- u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit dhe stilet e të shkruarit;
- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës në një tekst analitik , pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë;
- shkruan një ese krahasuese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara, duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të një eseje;
- prezanton një projekt eksperimentues nga fusha e kritikës krahasuese, të hartuar individualisht dhe në grup, duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe teknologji të tjera;

### ▣ **Kompetenca e të menduarit**

#### **Nxënësi:**

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për projektin, ofron argumente në mbështetje të temën përkatëse krahason,
- shfrytëzon të paktën, tri burime të ndryshme të informacionit për trajtimin e së njëjtës temë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;;
- krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga fusha e kritikës së tekstit

### ▣ **Kompetenca e të nxënit**

#### **Nxënësi:**

- demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e projektit
- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, dhe veçon disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të formë skice, grafiku, vizatimi, etj;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë , sipas qëllimeve që i cakton vetes.

### ▣ **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

#### **Nxënësi:**

- harton një projekt duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;
- merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle, bashkie dhe më gjerë (p.sh., konkurse mësimore, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura dhe për procesin e organizimit dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre

### ▣ **Kompetenca personale**

#### **Nxënësi:**

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal;
- ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.

### ▣ **Kompetenca qytetare**

#### **Nxënësi:**

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh., në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel vendor dhe qendror);

- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë);
- diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj.

#### ▣ **Kompetenca digjitale**

##### **Nxënësi:**

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pamjeve të filmuara apo të animuara;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

#### ▣ **REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS**

##### ▣ **Kompetenca:** *Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar*

##### **Nxënësi:**

- realizon prezantime të ndryshme me gojë, përdor strategjitë e duhura për të përmbushur qëllimin që ka dhe, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës, respekton kohën gjatë prezantimit;
- përdor TIK-un për të realizuar prezantime të ndryshme, sidomos në situata formale.

##### **Njohuritë:**

- Karakteristikat e një diskutimi. Rolet në një diskutim.
- Mënyrat dhe mjetet e prezantimit (përfshirë edhe TIK-un).
- Hartimi i prezantimeve individuale dhe në grup

##### **Shkathtësitë:**

###### **a) Komunikimi dhe gjuha gjatë të folurit**

##### **Nxënësi:**

- përzgjedh fjalët, shprehjet, terminologjinë e duhur dhe mjetet stilistike për të shprehur mendimet, idetë, ndjenjat dhe opinionet e tij, si dhe për të ndikuar tek audiencia.

###### **b) Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup**

##### **Nxënësi:**

- paraqet mendimin personal mbi çështjen për të cilën diskutohet, në mënyrë të përmbledhur, duke respektuar kohën;
- merr parasysh rolin e qëllimit, të audiencës dhe të situatës në një diskutim;
- shfrytëzon pasurinë leksikore e semantike për të shprehur saktë mendimet e tij gjatë diskutimeve në grupe të vogla e të mëdha;
- bën pyetjet e duhura, kur diskutohen tema të ndryshme, si dhe u përgjigjet pyetjeve të të tjerëve duke dhënë sqarime dhe ilustrime;
- identifikon faktorët (organizimi, stili, mjetet letrare, përzgjedhja e fjalëve, toni, përmbajtja, këndvështrimi etj.) që ndikojnë në kompozimin e mesazhit të tij.

###### **c) Prezantimi me gojë**

##### **Nxënësi:**

- përgatit në mënyrë individuale dhe në grup për një çështje/temë të caktuar;

- përdor një shumëllojshmëri strategjish organizative (tabela, diagrame, grafikë, kllaster), si dhe demonstroi strategji efektive të përcjelljes së mesazhit gojor (organizimi, gjuha e gjesteve, fjalor i përshtatshëm);
- përpunon prezantimin gojor për të orientuar drejt audiencën; si dhe përdor TIK-un gjatë prezantimeve;

#### **d) Vlerat dhe qëndrimet**

Nxënësi:

- respekton rregullat e etikës gjatë të folurit, shmang fyerjet dhe paragjykimet, si dhe format e tjera të gjuhës denigruese;
- përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij, si dhe respekton mendimin e të tjerëve përdor imagjinatë dhe kreativitet për zgjidhjen e problemeve;
- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit gjatë prezantimeve të ndryshme;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve.

#### **▣ Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme**

Nxënësi:

- bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve;
- zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti;
- përdor materiale udhëzuese dhe hulumton në leksikon e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;
- analizon gjuhën e figurshme të tekstit;

#### **Njohuritë**

- Studime tekstesh të ndryshme.

#### **Shkathtësitë**

##### **a) Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar**

Nxënësi:

- demonstroi të kuptuarit e teksteve që dëgjon;
- përmbledh informacionin e prezantuar me gojë nga të tjerët;
- vlerëson përmbajtjen dhe mënyrën e prezantimit gojor;

##### **b) Të dëgjuarit për të vlerësuar**

Nxënësi:

- përqendron vëmendjen në mënyrë të përgjegjshme mbi folësin ose mesazhin;
- mban shënime të atilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm;
- vlerëson besueshmërinë e folësit;

##### **c) Vlerat dhe qëndrimet**

Nxënësi:

- tregon respekt, empati (ndjeshmëri) dhe interes ndaj folësit;
- përdor imagjinatë dhe kreativitet për zgjidhjen e problemeve;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve.

#### **▣ Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme**

Nxënësi:

- përdor strategjitë e të lexuarit dhe bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve;

- përdor organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit, parafrazon dhe përmbledh tekstet e punuara;
- analizon tema të ndryshme, duke zbuluar gjuhën e figurshme të tekstit; identifikon faktin dhe opinionin në tekste të ndryshme;
- realizon punë kërkimore, përzgjedh informacione për qëllime të ndryshme, vlerëson informacionin e përzgjedhur nga të tjerët, përmbledh materiale të ndryshme, si dhe nxjerr përfundime.

### **Njohuritë**

- Teksti, karakteristikat e tij. Struktura e një teksti. Llojet e teksteve;
- Tekstet përshkruese (rrëfyese, argumentuese, info-paraqitëse). Teknikat e shkrimit. Gjuha dhe stili i një teksti.

### **Shkathtësitë**

#### **a) Të kuptuarit e tekstit dhe reflektimi ndaj tij**

Nxënësi:

- lexon tekste nga kultura dhe periudha historike të ndryshme;
- analizon tekstin, veçoritë dhe strukturën etij;
- zbulon referentët në tekstet në studim
- shkodifikon mesazhet e teksteve
- realizon analizë krahasuese nga pikëpamja e organizimit të brendshëm të teksteve
- krahason në planin e poetikës së përshkrimit
- zbulon elemente të tekstit informative, shpjegues, përshkrues në tekstet në studim
- mbledh faktet informacionin, ngjarjet lidhur me autorët e veprave në studim
- përcakton mjetet gjuhësore, figuracionin, frazën, retorikën e përdorur në tekstet në studim
- krahason tekstet nga pikëpamja gjuhësore
- ekspozon krijime në pikturë, albume, foto-ekspoze, video-dokumentarë nën frymëzimin e teksteve në studim
- vlerëson mënyrën si paraqiten dhe shtojnë interesin në audiencë këto analiza krahasuese.
- parafrazon informacionin e marrë nga tekste të ndryshme;
- bën përmbledhjen e një teksti;
- zbulon elemente të stilit dhe të gjuhës së autorit;
- zbulon qëllimin dhe qëndrimin e autorit në një tekst;
- analizon se si teksti i një periudhe kohore ose i një kulture të caktuar reflekton kushtet historiko-shoqërore dhe kulturore të kohës;
- analizon gjuhën e figurshme të një teksti joletrar;
- krahason tekste të llojeve të ndryshme;

#### **b) Pasurimi i fjalorit**

Nxënësi:

- përdor materiale udhëzuese (p.sh.: fjalorë, enciklopedi, internet etj.), që janë të përshtatshme për të pasuruar fjalorin në fusha të ndryshme
- hulumton fjalët e shkrimeve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;
- përdor njohuritë e origjinës së fjalëve, sidhe të dhënat e kontekstit historik për të përcaktuar kuptimin e fjalëve të fushave të caktuara të dijes;

#### **c) Vlerat dhe qëndrimet**

Nxënësi:

- është i motivuar për të lexuar për kënaqësi dhe informacion; është i vëmendshëm gjatë leximit;
- shfaq empati (ndjeshmëri) gjatë leximit; shfaq vetëbesim dhe vetëvlerësim
- demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave;
- respekton dhe pranon mendimin e të tjerëve, si dhe respekton etikën gjatë komunikimit personal dhe në grup;
- vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre;
- shfaq tolerancë dhe respekt për kulturën dhe për gjuhën e tjetrit.

▣ **Kompetenca:** *Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale*

Nxënësi:

- shkruan qartë, me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike, tekste për qëllime dhe për audiencë të ndryshme;
- zbaton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në shkrimet e tij dhe në procesin e redaktimit;
- përdor materiale të ndryshme burimore që e ndihmojnë gjatë procesit të shkrimit.

**Njohuritë**

- Procesi i të shkruarit, hapat dhe strategjitë e të shkruarit.

**Shkathtësitë**

**a) Shkrimi si proces**

Nxënësi:

- redakton shkrimin duke u përqendruar në elementet e përmbajtjes dhe të formës si: dhënia e informacionit të nevojshëm; përmirësimi i stilit dhe i origjinalitetit; respektimi i strukturës dhe i koherencës së tekstit; përdorimi i gjuhës standarde, respektimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe i shenjave të pikësimit; respektimi i leksikut dhe i terminologjisë

**Shkrimi si produkt**

Nxënësi:

- zhvillon dhe organizon idetë kryesore duke i mbrojtur ato me nënide, shembuj dhe ilustrime;
- shkruan tekste me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore;
- përdor gjuhën e përshtatshme, lloje të ndryshme fjalish pjesë të ndryshme të ligjëratës, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj për ta bërë tërheqës shkrimin e tij;
- shkruan hyrje dhe mbyllje tërheqëse dhe koherente;
- përdor grafikë, tabela ose diagrame për të mbështetur idetë kryesore;
- përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore e të pikësimit
- përdor dhe zhvillon stilin vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës;
- zbaton të drejtën e autorit ndaj informacionit që përdor në punët me shkrim.

**b) Llojet e teksteve**

Nxënësi:

- shkruan tekste përshkruese argumentuese, informuese/paraqitëse në mbështetje të projektit

**c) Vlerat dhe qëndrimet**

Nxënësi:

- demonstroi imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë të shkruarit;
- respekton gjuhën standarde dhe shmang fjalët e huaja gjatë të shkruarit (kur e kanë fjalën përgjegjëse në gjuhën shqipe);

- vlerëson punët e të tjerëve, si dhe bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim.

▣ **Kompetenca:** *Përvoetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit*

Nxënësi:

- përdor njohuritë gramatikore dhe leksikore gjatë të folurit dhe të shkruarit për të arritur qëllime ose efekte të caktuara;
- dallon disa ndryshime mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve dhe gjuhës standarde;
- përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.

### Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- vlerëson punët e të tjerëve, si dhe bashkëpunon në grup për realizimin me shkrim të një projekti

▣ **KOHA NË DISPOZICION :**

▣ Projekti do të zhvillohet në **4 orë** dhe do të shtrihet përgjatë gjithë vitit

▣ Do të studiohen në mënyrë të veçantë tekstet e rubrikës: *Përsiatje dhe endje:*

- Pjesë nga jeta e Shën Mërisë- **PJETËR BOGDANI**
- Origjina e gjuhës shqipe – **KOSTAQ CIPO**
- A gënjen aktori – **ALEKSANDËR MOISIU**
- Karton kuqezi – **ARDIAN VEBIU**

▣ **FAZA I** – punohet me pjesën nga **P.Bogdani**, sipas çështjeve në tekstin e nxënësit.

- Nxënësit janë ndarë paraprakisht në tre grupe
- Secili grup ka organizuar punën me tekstin, duke:
  - mbledhur materialet për skedën e autorit
  - duke zberthyer karakteristikat përshkruese të tekstit
  - duke punuar me gjuhën përshkruese të tekstit
  - duke analizuar gjuhën e vjetër shqipe dhe transformimin e saj në shekuj
  - duke krahasuar përshkrimet e këtij teksti me tekste të tjera (portretin e Tanushës)
- Grupet prezantojnë punët e tyre përmes:
  - diskutimeve;
  - prezantimeve në punime në Poëer Point
  - shkrimeve kritike në ese (argumentuese, shpjeguese)

▣ **FAZA II**- punohet me tekstin rrëfyes nga **Kostaq Cipo**

- Nxënësit sërish në tre grupe, kanë organizuar punën me tekstin, duke:
  - përgatitur skedën e autorit
  - zbuluar rolin e gjuhës sipas autorit
  - analizuar tiparet që e bëjnë këtë tekst një tekst rrëfyes
  - shpjeguar qëndrimin e autorit ndaj fjalëve me prejardhje latine
  - zbuluar kuptimin e fjalëve përmes hetimit të origjinës së fjalës
  - krahasuar me tekste të ngjashme për nga referentët në studim (“Të veshurat shqiptare”



- Grupet prezantojnë punët e tyre përmes:
  - diskutimeve;
  - prezantimeve në punime në Power Point
  - shkrimeve kritike në ese (argumentuese, shpjeguese)

### FAZA III – punohet me tekstin e Aleksandër Moisiut

- Grupet kanë punuar, sipas orientimeve të mësuesit, dhe sipas ndarjes së punëve brenda grupit:
  - duke ndërtuar skedën e autorit
  - duke analizuar kërkimin e Moisiut, nisur nga fjalët e tij
  - duke shpjeguar tiparet e tekstit argumentues në këtë tekst
  - duke gjykuar për audiencën e këtij teksti, nisur nga gjuha e shkrimit
  - duke shpjeguar terminologjinë e përdorur
  - duke interpretuar shprehje të veçanta të tekstit  
(në organizimin e detyrave nxënësit mbështeten tek pyetjet në fund të tekstit - libri i nxënësit)
- Grupet prezantojnë punët e tyre përmes:
  - diskutimeve;
  - prezantimeve në punime në Poëer Point
  - shkrimeve kritike në ese (argumentuese, shpjeguese)

## FILMA TË INTERPRETUAR NGA ALEKSANDËR MOISIU



## FILMA TË INTERPRETUAR NGA ALEKSANDËR MOISIU

Viti	1910	—	Maskat
-..-	1912	—	Fati i zi
-..-	1914	—	Sytë e Ole Brandit
-..-	1918	—	Dama Pik
-..-	1918	—	Unaza e tre dëshirave
-..-	1918	—	Fati i trashëguar
-..-	1919	—	Biri i tij i vetëm
-..-	1920	—	Martesa e Figaros
-..-	1921	—	Ndërmjet qiellit dhe tokës
-..-	1929	—	Lozha e mbretit
-..-	1931	—	Mbretëreshat e klubit të Natës
-..-	1934	—	Lorenzo de Medici

**Pasqyrë jo e plotë e incizimeve me zërin e Aleksandër Moisiut:** (poshtë shënohet autori dhe titulli i materialit të recituar)

**Shëkspir** — **Hamlet**, Monologu: “Të rros apo

		të mos rrosh"	
-..-	—	<b>Si t'ju pëlqejë:</b> " Kur isha një djalë çamarok"	Kanto muzika nga Huperdinck
-..-	—	<b>Si t'ju pëlqejë:</b> "Eja këtu vdekje"	Kanto muzika nga Huperdinck
Gëte	—	<b>Faust</b> , Monologue I Faustit (pjesa I)	
-..-	—	<b>Faust</b> , Vdekja e Faustit	
-..-	—	<b>Mbreti i xhindeve.</b>	
-..-	—	<b>Hënës.</b>	
-..-	—	<b>Këngë maji.</b>	
-..-	—	<b>Prometeu.</b>	
-..-	—	<b>Perëndia dhe Bajadera</b>	
Shiler	—	<b>Don Karlos</b> , Markiz Poza përpara mbretit	Audiençë e madhe
-..-	—	<b>Cubat</b> , Monologu I Franc Morit	
-..-	—	<b>Krilla e Ibikusit.</b>	
Hofmanstal	—	<b>Jederman</b> , "Paraja"	
Hajne	—	<b>Na ishte një mbret plak</b>	
-..-	—	<b>Fëmija im, ne ishim fëmijë.</b>	
Molier	—	<b>Zhorzh Danden</b>	Kanto, muzika nga Nilson
Andersen	—	<b>Princesha mbi bizele</b>	
Ber-Hofman	—	<b>Këngë djepi për Miriamin</b>	
Hauptman	—	<b>Hanele</b>	Melodramë, muzika Marshalk
Ferheren	—	<b>Era e nëntorit</b>	
Kolombino	—	<b>Në Tripoli</b>	Kanto
Bajron	—	<b>Manfred</b> , "Ndarje me diellin"	Melodramë, muzika Shuman
-..-	—	<b>Bisedë me Basermanin mbi Napolonin.</b>	

Kthimi i tekstit në debat

Improvizimi i një interviste mbi bazën e tekstit argumentues

Improvizimi i një gjyqi imitues se a ka gënjyer aktori Mojsiu?

Lojë me role për prezantimin e tekstit si një monolog etj.

Ndërtimi i teksteve për reklamë në favor të sensibilizimit të trashëgimisë intelektuale të Mojsiut

Ndërtimi i një filmi me metrazh të shkurtër për ecurinë e punës gjatë projektit. Humor dhe refleksion : Ç'mund të bënim ndryshe...

*Një vështrim brenda artistit të madh përmes këtij shkrimi të vetë Aleksandër Moisiut, autodisiplinës dhe metodologjisë së tij të punës.*

A GËNJEN AKTORI?

"Jo maskim - po demaskim"

MAKS REINHARD

A gënjen aktori? A shtiret ai apo është vetë ai lajmëtari së vërtetës së madhe?

Unë do të provoj t'i përgjigjem kësaj pyetjeje vetëm sipas pikëpamjes sime personale, ose më mirë me anën e një monologu, vetëm për mua. Gjatë gjithë viteve të krijimtarisë sime unë nuk mësova kurrë të shtirem ndryshe nga ç'jam.

Në qoftë se për njeriun-karakterin e një roli nuk rreh zemra ime, në qoftë se në të nuk merr frymë kraharori im, në qoftë se në të nuk ka vend gëzimi im, vuajtjet e mia, botëkuptimi im, marrëzia ime, në qoftë se nuk gjej aty thelbin e qenies sime, atëhere unë duhet të kem durim dhe të kërkoj më tej për të gjetur njeriun brenda të cilit do të isha unë dhe e tëra kjo jo vetëm në dukje.

...Unë luftoj me të mirë e me këbëngulje, me të butë dhe me forcë me rolin tim të dashur, derisa krijesa ime të jetë mbushur me gjakun dhe frymën time. Në qoftë se më në fund lëkura dhe ngjyra e flokëve nuk janë pikërisht siç duhet të jenë, atëhere siç dihet, kësaj të mete ke se ç't'i bësh.(janë çështje teknike lehtësisht të superueshme) Dhe fare më ne fund, unë futem te njeriu-karakter që do të interpretoj, si në një xhaketë që më rri mirë për trup.

Por që të bësh që masa ta ndiejë bashkë me ty kur Hamleti u çjerr maskën mbretërve, kur Poza mbron lirinë para një tirani, kur Fedia bën fli jetën e tij dhe Dubedati për bukurinë; për këtë duhet ca më tepër: duhet art, e ky vjen nga dituria.

Gjuha, zëri, gjestet nuk kërkojnë vetëm që t'u japësh shpirt, ato duhet edhe të zotërohen, të fisnikërohen, t'u rrëmbehen çasteve të jetës së përditshme.

Më në fund edhe diçka tjetër: në qoftë se fati e do një aktor në mënyrë të veçantë, atëhere e çon atë te regjizori Maks Reinhard, (*kështu ngjau me mua*). Me një rekomandim të tillë të lartë Maks Reinhardi e merr pastaj atë përdore dhe e fut në atë rrugën ku do të manifestohet patjetër talenti i tij.

Dhe diçka të fundit fare. Aktori nuk e sheh kurrë veprën e tij. Atë ai nuk mund ta shfletojë sikurse një libër dhe nuk mund të qëndrojë përpara saj, sikurse përpara një pikturë apo guri të skalitur.

Lum ai që nuk e harron epigrafin: "Njih vetveten".

### SHKRIME TË ALEKSANDËR MOISIUT

- |                                |  |
|--------------------------------|--|
| 1- "Debutimi im në Burgteatër" | 7- "Si e njoha Fedian"                           |
| 2- "Një ëndërr fëminie"        | 8- "Përshtypje nga Rusia"                        |
| 3- "A gënjen aktori?"          | 9- "Krizja e teatrit gjerman"                    |
| 4- "Një vajzë"                 | 10- "I burgosuri" (dramë mbi Napolon Bonapartin) |
| 5- "Der, Die, Das"             | 11- "Problemet e teatrit gjerman"                |
| 6- "Kostandin Stanislavski"    |  |

#### ▣ FAZA IV – studimi krahasues (faza finale e projektit)

- Nxënësit janë orientuar të lexojnë tekstin e **Adian Vehbiut** dhe të realizojnë një përmbledhje analitike (ose ese ) me shkrim për këtë tekst, duke u udhëzuar nga pyetjet në tekstin e nxënësit në fund të shkrimit të Vehbiut
- Në varësi të numrit të nxënësve në klasë, janë krijuar dy, tre ose katër grupe pune, të cilët do të krahasojnë tekstet, duke zbuluar të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre.
- Janë dhënë orientime nga mësuesi mbi rëndësinë e analizës krahasuese, mënyrën e përzgjedhjes së teksteve për studim, modele të tjera shkrimesh të ngjashme
- Janë marrë parasysh sugjerimet nga nxënësit në përputhje me kërkesat e formimin e tyre

- Një alternativë mund të jetë. Kërkimi në rrugën ku banoni të tabelave, të reklamave ku është anashkaluar gjuha standarde. Psh Bakeri, per prodhime brumi, exchange për këmbimore etj. Parukeri për floktore.etj
- Ndërtimi i një stende gjuha jonë sa e mire...! ku ftohen nxënësit të japin ndihmesën e tyre në ruajtjen të pastër të gjuhës shqipe.
- Përgatitja e dokumentacionit për ngritjen e një shoqate jofitimprurëse “ Miqtë e gjuhës standarde” me anëtarë mësues prindër nxënës etj.
- Daljen me nje peticion kryetarit të Bashkisë apo Komunës për ta përfshirë në këtë lëvizje qytetare ku përfshihen disa nga kompetencat kyçe

➤ **DETYRAT PËR GRUPET E PUNËS (për prezantimin final)**

Nxënësit gjatë prezantimit:

- paraqesin analiza individuale me shkrim, ku zbulojnë referentët në tekstet në studim
- shkodifikojnë mesazhet në këto tekste
- krahasojnë tekstet nga pikëpamja e organizimit të brendshëm
- krahasojnë në planin e veprimit, përshkrimit, argumentimit, shpjegimit
- krahasojnë tekstet nga pikëpamja gjuhësore (figura, fraza, retorika)
- paraqesin material informativ e shpjegues mbi autorët e teksteve
- bëjnë përmbledhje individuale me shkrim të analizave krahasuese të teksteve
- prezantojnë saktë, qartë, përmes një organizimi të mirëmenduar të projektit
- zgjedhin forma mbështetëse nga lloje të tjera të artit (pikturë, foto-ekspoze etj), për të sjellë të plotë projektin
- prezantojnë materialin në Poëer Point.
- Ndërtojnë pyetje për grupet kundërshtarë

Nxënësit vlerësojnë grupet sipas tabelës:

Hapat	Rezultatet e arritjeve					
	keq	dobët	mjaftueshëm	mirë	shumë mirë	shkëlqyeshëm
Zbulimi i referentëve						
Shkodifikimi i mesazheve						
Organizimi i strukturës së brendshme dhe të jashtme						
Gjuha e tekstit						
Teksnikat e shkrimit						
Krahasimi nëpërmjet të lexuarit						
Krahasimi nëpërmjet të shkruarit						

Krahasimi nëpërmjet diskutimit						
Shkalla e prezantimit (tërheqja e vëmendjes së auditorit)						
Përfshirja e shumë llojeve të artit apo shkencës gjatë prezantimit						

➤ **VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit do të vlerësohen për:

- punën individuale (diskutimet, shpjegimet e analizat me gojë, ndërtimin e pyetjeve brenda grupit dhe për grupet kundërshtare, si dhe përmbledhjet individuale me shkrim) (40%)
- punën e grupit (prezantimi final (60%))

➤ **PËRFITUESIT**

- Nxënësit
- Mësuesit
- Të interesuar të tjerë

**KUJDES!** Materialet e projektit përfshihen në dose personale të nxënësit.  
Drejtuesi i projektit  
Mësuesi i lëndës së gjuhës shqipe 10

**TEMA MËSIMORE 4.1 (1) TEKSTI RRËFYES LETRAR DHE JOLETRAR**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes rrëfimit</b>			
<b>Situata e të nxënës nr. 22</b>			
Bota përmes rrëfimit. Teksti rrëfyës.			
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b>			
➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</b> Nxënësi bashkëbisedon për llojet e tekstit rrëfyës, duke veçuar disa karakteristika kryesore që			

lidhen me to, si dhe duke diskutuar mbi informacionin për këtë temë, nxjerrë nga fushat e të nxënësve (p.sh. gjuhë komunikimi) ose nga jeta e përditshme.

➤ **Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për tekstin letrar dhe joletrar, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura dhe arti (arti gojor, miti, përralla, kultura antike etj.).

➤ **Kompetenca e të nxënësve**

Nxënësi demonstroi shkathhtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënësve të dijeve të reja në lidhje me llojin rrëfimit.

➤ **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësi harton një projekt (p.sh.:publicistikë në lidhje me mjedisin) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar e vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme.

➤ **Kompetenca personale**

Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të teksteve, kritikës së teksteve.

➤ **Kompetenca qytetare**

Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., duke shfrytëzuar njohjen e llojeve joletrare të tekstit rrëfyes që mbështetin qëllimin e tij.

➤ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me tekstet rrëfuese të llojit letrar dhe joletrar.

**Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;
- Përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme;
- Përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të tekstit rrëfyes;
- Realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit të paragrafëve rrëfyes;
- Përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.

**Fjalët kyçe:**

Tekst rrëfyes  
letrar/joletrar

**FJALOR**

- protagonist
- antagonist
- ekzistencial
- Ep; epos
- estetikë

<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, materiale të shtypit të shkruar, modele të tekstit tregimtar në të gjitha format e përfaqësimit, libri i nxënësit</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, <i>fleep-charter</i>, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> Nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga një tekst rrëfyes letrar.</p> <p><b>Letërsi:</b> poezi epike prozë, dramë</p> <p><b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar.</p> <p><b>Qytetari:</b> Përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
--	---

<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përvijim i mendimit</li> <li>• Stuhi mendimi</li> <li>• Lexim i drejtuar</li> <li>• Punë në grup</li> <li>• Punë e pavarur</li> <li>• Diagrami i Venit</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
--	-------------------------

### Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:



# A ju tërheq vëmendjen instrumenti muzikor në duart e Demodokut?" Ç'dini për lidhjet e muzikës me rrëfimin në antikitet?

Për të siguruar përvijimin e mendimit, mësuesja vazhdon me pyetje të tilla:


- Ç'ju kujton emërtimi tekst rrëfyes? Si zbatohet rregulli i 5-Ë-ve në organizimin e tij?
- Në ç'marrëdhënie kuptimore mendoni se janë fjalët rrëfyes, tregimtar dhe narrativ? (sinonimie)
- A mund të ndërtojme një skemë rreze me në qendër fjalën tekst rrëfyes?

Nxënësit thonë se ç'lloje tekstesh u kujton ky emërtim. Mësuesi ndihmon për plotësimin e plotë të tabelës.

Mësuesi i fton nxënësit të shohin foton me të cilën hapet njësia 4:

**Bota përmes rrëfimit** duke ndalur tek:

- a) emërtimi i njësisë me këtë tip fjalie emërore.
- b) titulli i fotos: "*Vajtimi i Odisesë gjatë rrëfimit rapsodik të Demodokut*"
- c) përmbajtja;
- d) ngjyrat me të cilat është realizuar ajo.



- A mund të ngjyrosim me të kuqe ato tekste që na shërbejnë për qëllime praktike dhe me blu ato që na japin kënaqësi estetike?

Nxënësve u është kërkuar të sjellin në klasë tekste të ndryshme të llojit letrar (mit, legjendë, fragment romani a tregimi.. etj) dhe joletrar (kronikë, reportazh.. etj.);

Rikujtojmë përmes një veprimtarie, diagrami i Venit, të përbashkëtat dhe të veçantat mes teksteve letrare dhe joletrare.

**“Klasifikimi i teksteve sipas qëllimit dhe funksionit**


Teksti joletrar	Të përbashkëta	Teksti letrar
<ul style="list-style-type: none"> <li>■ kronikë, dokumentari, histori, ditari, biografia, imitimi, filmi, kërcimi etj.)</li> </ul> <p><b>Qëllimi kryesor:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• është të rrëfyerit për ngjarje, vende, dukuri persona.</li> </ul> <p><b>Funksioni praktik:</b></p> <p><b>Ndihmon:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për të informuar;</li> <li>- për të ditur çfarë ka ndodhur, si ka ndodhur, kush është protagonist i cilit i ndodh diçka.</li> <li>- për të mësuar rrethanat kohore dhe hapësinore të ndodhisë.</li> <li>- Kryesisht përmes gjuhës standarde.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■Janë tekste të shkruara.</li> <li>■Shfrytëzohen në mënyrë pasive dhe aktive.</li> <li>■I shërbejnë njeriut për pasurimin e kulturës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■Teksti letrar (mite, legjenda, përralla, tregime, novela, romane poezi, drama etj.)</li> <li>■ Qëllimi kryesor është edukimi artistik i lexuesit.</li> <li>■Funksioni estetik – artistik:</li> </ul> <p>Përdoret:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për kënaqësinë e të lexuarit.</li> <li>- për nxitjen dhe zhvillimin e imagjinatës</li> <li>- për t’u argëtuar etj.</li> <li>- përmes gjuhës së figurshme.</li> </ul>

- Lexohen dy prej teksteve (zgjidhet një lloj letrar dhe një joletrar);

Nxënësi do të rikujtojë njohuritë e mëparshme: *funksionin, qëllimin* e tekstit rrëfimtar: Ai duhet të dallojë *funksionin praktik* (të rrëfejë mbi ndodhi, ngjarje reale) nga ai *estetik* (të rrëfejë për ngjarje e personazhe për të ngjallur kënaqësi estetike përmes gjuhës së figurshme, të përpunojë shijen e së bukurës). Të gjitha këto do të zbulohen në dy tekstet që lexohen nga nxënësit.

- Në klasë u jepen nxënësve llojet e teksteve të paraqitura në skemën e mëposhtme, të plotë, shteruese.
- Skema e **parapërgatitur nga mësuesi** paraqitet në tabelë (me *fleep-charter* ose përmes projektorit):





- Nxënësve u kërkohet të lexojnë tekstet që kanë sjellë vetë ata dhe t'i klasifikojnë ato në njërën nga tipet e sjella në tabelë.
- Në këtë fazë mësuesi do të ketë sërish **të gatshme** skemën e re, e cila do të ilustrohet përmes teksteve (**mundësisht të të gjitha llojeve, pavarësisht se këtu kemi sjellë vetëm dy tipe**), që u janë ndarë nxënësve (nxënësit mund të ndahen në grupe, në varësi të numrit të nxënësve në klasë).

#### Noli "Histori e Skënderbeut"

Zemërimi i Sulltanit kundër shqiptarëve dhe venecianëve ishte aq i madh sa në mes të dimrit, një turmë prej 15.000 turqish, përmes maleve të mbuluara me dëborë, u duk përpara Shkodrës. Kur ardhi lajma në Lesh, kryetrimi i sëmure në shtratin e vdekjes, u përpoq të ngrihej edhe t'i hipte kalit. Po trupi i tij, i tretur prej etheve nuk lëvizte nga vendi, dhe garda pretotiane shkoi këtë herë të lëftonte pa kumandantin në krye. Po tmerri i emrit të tij ishte aq i madh sa turqit, me të parë kalorësit e gardës, kujtuan që ishte ay vetë në krye të tyre, muarnë arratinë, dhe u shuan krejt prej malësorëve nëpër grykat edhe pusirat. Skënderbeu mezi merrte frymë, kur i suallnë lajmën e viktorejes. Kur mësoi nga mjekët që nuk kishte asnjë shpresë për shërim, thirri kapëdanët shqiptarë dhe bajlozët e Venetisë, të cilëve u la shëndet, edhe i këshilloi ta vazhdonin luftën e

#### Kadare "Kronikë në gur"

Përrjashta nata dimërore kishte mbështjellë çdo gjë me ujëra, mjegull dhe erë. Duke futur kokën nën jorgan, unë dëgjoja mbyturazi zhurmën monotone të pikave të shiut mbi çatinë e madhe të shtëpisë sonë. E merrja me mend se si pikat e panumërta rrokulliseshin tani në faqet e pjerrëta të çatisë, duke shpejtuar të binin sa më parë në tokë, që pastaj të avulloheshin dhe të ngjiteshin prapë atje lart, në qiellin e bardhë. Ato nuk e dinin se në strehët e çatisë i priste një grackë e panjohur, qyngji prej llamarine. Tamam në çastin kur bëheshin gati të kërcenin nga çatia në tokë, pikat e shiut gjendeshin befas në qyngjin e ngushtë, bashkë me mijëra e mijëra shoqe të tjera, që pyesnin të frikësuar: "Ku po shkojmë kështu, ku po na çojnë?" Dhe, pa e

përbashkme kundër turqve. Principatën ia la të birit, Gjon Kastrioti, me nënën si regjente, dhe i porositi që, po të ndodheshin në rrezik, të shkonin pranë Ferdinandit të Napolit. Mund ta marrim me mënt hidhërimin që ndjeu, kur hodhi rreth e rrotull syrin e mjegulluar prej vdekjes, dhe nuk pa asnjë kapedan shqiptar të zotin për të pasur veprën që e kishte lënë të pambaruar. Pastaj u përshëndosh me të gjithë, kungoi edhe dha shpirt prej 24 vjetësh të shkuar në luftë për lirinë e Shqipërisë dhe për mprojtjen e Evropës.

mbledhur veten mirë nga ky vrap i çmendur nëpër qyngj, binin papritur në një burg të thellë e të errët nën tokë, në sternën e madhe të shtëpisë sonë.

Kur shirat vazhdonin tri-katër ditë rresht, babai e shkëpuste qyngjin në një vend, që sterna të mos mbushej më tepër se ç' duhej. Sterna ishte shumë e madhe. Ajo shtrihej pothuaj nën gjithë sipërfaqen që zinte shtëpia jonë dhe në qoftë se shpërthente mund të përmbyste në fillim kubenë dhe pastaj të shkatërronte krejt themelet e shtëpisë, sepse qyteti ynë ishte i pjerrët dhe në këtë qytet mund të ndodhte çdo gjë.

Përmban fillim, zhvillim, mbyllje  
 Përmban rrethana kohore dhe hapësinore  
 Ka personazhe  
 Ka konflikte: protagonistin me veten (pendesa, dilema)  
 protagonistin me një personazh tjetër (joprotagonist)  
 protagonistin me shoqërinë  
 protagonistin me natyrën  
 Përmban një moral  
 Zëri i rrëfimitarit (i lumtur, i penduar, misterioz)

Punohen në klasë dy shembujt e librit duke i tërhequr nxënësit:

- ❖ në zbulimin e elementeve rrëfimtare që japin *zërin gazmor* dhe *zërin misterioz* në këto dy grimca (*sekuenca*) rrëfimi.
- ❖ në vazhdimin e secilit prej tyre me nga një fjali shtesë.

#### Detyrat dhe puna e pavarur:

- Sipas modelit të shembujve në tekstin e nxënësit, nxënësit orientohen të ndërtojnë (në grupe) tashmë paragrafë me 3 - 4 fjali që përcjellin *zërin komik*, *mburravec*, *të penduar* dhe *të trishtuar* të rrëfimitarit.
- I lexojmë me zë nga një punim për secilin rast dhe diskutojmë:  
*A kanë arritur shokët apo shoqet të japin ngjyresën e zërit komik, mburravec, të penduar apo të trishtuar?*
- Nxënësit mbrojnë punën e tyre duke nënvizuar ato elemente të rrëfimit që i japin këtë ngjyresë paragrafëve të tyre.

#### Detyrë shtëpie:

Ushtrimin praktik n.2, fq. 84

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit përgjigjen saktë;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit rrëfyes letrar dhe joletrar dhe i zërthejnë ato konkretisht;</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>
--	---

## TEMA MËSIMORE 4.1 (2) STRUKTURAT DHE TEKNIKAT E RRËFIMIT LETRAR

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes rrëfimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 23</b>			
Teksti rrëfyës.			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon për llojet e tekstit rrëfyës, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me strukturën dhe teknikat e tij, si dhe duke diskutuar mbi informacionin për këtë temë, nxjerrë nga fushat e të nxënit (p.sh. gjuhë komunikimi).</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për strukturën dhe teknikat e tekstit letrar dhe joletrar, ofron argumente për mbrojtjen e mendimit të tij nga kultura dhe arti (arti gojor, miti, përralla, kultura antike etj.).</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me teknikat e organizimit të rrëfimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të teksteve, kritikës së teksteve, si dhe organizimit strukturor.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p> <p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen dhe strukturimin e llojeve joletrare të tekstit rrëfyës që mbështetin qëllimin e tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me tekstet rrëfyese të llojit letrar dhe joletrar.</p>			

<p><b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>realizon diskutime të ndryshme me gojë, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim mbi strukturën dhe teknikat e rrëfimit, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;</li> <li>përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme</li> <li>përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të çështjeve që lidhen me organizimin e tekstit rrëfyes; realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit të paragrafëve rrëfyes;</li> <li>përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> Strukturë Teknika rrëfimi Skena e rrëfimit Problemi qendror Zhvillimi dhe ecuria e veprimit Zgjidhja e problemit Mbyllja Perspektiva e rrëfimit Akti i rrëfimit</p> <p>FJALOR Estetikë</p>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, materiale të shtypit të shkruar, modele të tekstit tregimtar në të gjitha format e përfaqësimit, libri i nxënësit <b>Mjete:</b> tabela, <i>fleep-charter</i>, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga një tekst rrëfyes letrar. <b>Letërsi:</b> poezi, prozë, dramë <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar. <b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përvijim i mendimit</li> <li>Stuhi mendimi</li> <li>Lexim i drejtuar</li> <li>Punë në grup</li> <li>Punë e pavarur</li> <li>Diagrami i Venit</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë (<b>U.2, fq. 84</b>), ku nxënësit diskutojnë mbi materialet e tyre.</li> <li>➤ Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë, të plotësojnë dhe të vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës. Ç'mund të kishim bërë ndryshe?</li> <li>➤ Mësuesi i vendos nxënësit në një pozicion vëzhguesi virtual. <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Nga shembujt e ndryshëm që u sollën në klasë a mund të dallojnë ata pozicionin e rrëfimitarit përmes mjeteve gjuhësore: <ol style="list-style-type: none"> <li>Përemrit vector të atij që rrëfen ngjarjen;</li> </ol> </li> </ul> </li> </ul>	

b) Vetës së foljes që përdor rrëfimtari në tekstet e sjella?

A mund të dalim në përfundim për tre prej tyre?

Le të ndërtojmë një lloj përkufizimi me përfundimet që nxorëm.

.....Kur ngjarja rrëfëhet nga.....

► Ç'kuptojmë me fjalën strukturë? Cilët janë elementet e strukturës së tekstit rrëfyes që bëjnë pjesë në të?

- skena e rrëfimit
- prezantimi i personazheve
- konflikti/problemi qendror
- zhvillimi dhe ecuria e veprimit
- zgjidhja e problemit
- mbyllja

- Mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve të rikujtojnë *përrallën e Kësulëkuqes*. Parashtrohet struktura e përrallës, duke u mbështetur nga skema e mëposhtme. (Skema e mëposhtme riprezantohet sërish e **gatshme** dhe interpretimi i saj do të shoqërohet me shembujt nga teksti i nxënësit:)
- Nxënësve u kërkohet të rikujtojnë përralla nga fëmijëria dhe t'i ndërtojnë ato sipas modelit të shembullit në tekst për strukturën e përrallës së Kësulëkuqes.
- Në grupe pune nxënësve u rindahen tekstet e të gjitha tipeve të llojit letrar dhe joletrar (mit, legjendë, kronikë, fragment romani, epos etj.) të zgjedhura paraprakisht nga mësuesi dhe ata duhet të vëzhgojnë:
  - ndërtimin e paragrafit hyrës (mënyrën se si fillon ai); ndërkohë tabela teorike është e shfaqur përpara nxënësve që ata të orientohen në përcaktimet e tyre.
  - katër përbërësit kryesorë: perspektiva, akti i rrëfimit, lloji i ligjërimit dhe koha.
  - teknikën e së vërtetës;
  - teknikën e dramaticitetit;
  - teknikën e detajeve;
  - teknikën polifonike.
- Kjo detyrë do të përmbushet në atë masë sa nxënësit kanë njohuri të mëparshme mbi çështjen.

**Pyetje:** Vini re si fillojnë paragrafët? Ç'lloj fjalish kemi nga pikëpamja e kumtimit?

Në ç'vetë është ndërtuar rrëfimi? A është ai i drejtpërdrejtë?

Në ç'kohë është rrëfimi? A flasim për vërtetësi në rrëfimet në studim?

- Sipas tekstit dhe shembujve të tekstit mësuesi shtjellon teknikën e dramaticitetit, teknikën e detajeve dhe teknikën polifonike.
- Nxënësi i zbulon këto teknika në tekstet që ka në duar.
- Diskutime në grupe dhe parashtrim i përgjigjeve në klasë.



**Struktura:** - skena

- prezantimi i personazheve
- konflikti/problemi
- zhvillimi i ngjarjes
- zgjidhja e problemit
- mbyllja

**Teknikat:**

- teknika e së vërtetës
- teknika e dramaticitetit
- teknika e detajeve
- teknika polifonike

**Teknikat:** a) **lidhen me paragrafin hyrës i cili mund të fillojë me:**

- dialog
- një fjali pohuese
- një fjali mbi problemin
- një fjali për një veprim të papritur
- një përshkrim të një rrethane vendore
- një përshkrim të një rrethane kohore

b) **lidhen me katër përbërësit kryesorë:**

perspektivën e rrëfimit:

- a) veta e parë: (rrëfimtari në qendër të rrëfimit);
- b) veta e dytë (lexuesi përfshihet si personazh në rrëfim);
- c) rrëfimtari i jashtëm.

aktin e rrëfimit:

- a) rrëfim i drejtpërdrejtë (rrëfyesi komunikon direkt me ne);
- b) rrëfim i kornizuar (edhe pse në vetën e parë rrëfehët për dikë tjetër);
- c) rrëfim jo i drejtpërdrejtë (rrëfim në pësore).


ligjërimin:

- a) i drejtë;
- b) raportues;
- c) i zhdrejt;

kohën: (e tashme, e shkuar, e ardhme)

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Përmes diagramit të Venit nxënësit realizojnë krahasimin mes dy llojeve të tekstit rrëfimtari:



- tekste rrëfyes
- rrëfejnë ngjarje, situata....
- u japin përgjigje pyetjeve: kush?, kur?, çfarë?, pse?, ku?
- Struktura:.....

- Diskutime me shembuj nga tekstet e shpërndara në klasë.

**Detyrë shtëpie:**

- U. 1, fq. 91; (si shembull mund të shërbejë modeli i zgjidhur në faqen 85,86 )
- U.2, fq:93.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit përgjigjen saktë;</li> <li>• dallojnë tiparet e strukturës dhe teknikave të shkrimit të tekstit letrar dhe joletrar dhe i zbërthejnë ato konkretisht;</li> <li>• shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë e përgjigjeve që lidhen me detyrën e shtëpisë dhe ushtrimet në klasë;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

## TEMA MËSIMORE 4.2 (1) "JETA IME", FAN S. NOLI. BIOGRAFIA DHE AUTOBIOGRAFIA

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla V	Klasa 10
<b>Tematika: Bota përmes rrëfimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 25</b>			
<p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi autobiografinë, duke përcaktuar llojin e tekstit "Jeta ime", të Fan Nolit, tiparet e tij dhe mënyrën se si janë shprehur tiparet e këtij lloji në këtë tekst. Ai dallon teknikat e shkrimit biografik dhe funksionet e tij.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon për llojin rrëfyes, të biografisë dhe autobiografisë, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me to; diskuton mbi tekstin konkret, duke analizuar dhe vlerësuar tiparet e tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e autobiografisë dhe biografisë, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura dhe arti.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin biografik dhe autobiografik.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të tekstit autobiografik, kritikës së llojeve biografike dhe autobiografike.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p> <p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore,</p>			

historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojit biografik dhe autobiografik, që mbështetin qëllimin e tij.

**Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me tekstin biografik dhe autobiografik, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;
- Bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit biografik dhe autobiografik, si dhe analizon e interpreton kuptimet që merr fjala brenda një konteksti, duke dalluar veprën letrare me elemente biografike nga biografia;
- Parafrazon pjesë nga tekste rrëfyese (lloji biografi/ autobiografi);
- Përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin autobiografik;
- Shkruan saktë dhe pa gabime.

**Fjalët kyçe:**

Tekst

biografik/autobiografik

FJALOR

- plotore
- nyja gordiane
- ekzistencial

**Burimet:**

Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit: fragment (“Jeta ime”- Noli), **Autobiografi** të tjera (Jul Cezari), “Autobiografi” Ethem Haxhiademi.

**Biografi** “Balzaku” – S. Cvajg (mund t’i shërbejë mësuesit për të krahasuar biografinë me autobiografinë).

**Mjete:** tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga F.S Noli.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**

**Arte:** Nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga “Jeta ime”.

**Letërsi:** Përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës.

**TIK:** Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar.

**Qytetari:** Përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.

**Histori:** nxënësi përdor njohuritë për periudha dhe personalitete të ndryshme historike për të analizuar dhe për të vlerësuar tekste e vepra të ndryshme letrare.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

- Diskutim mbi vëzhgim
- Punë në grup
- Diagrami i Venit
- Praktikë e udhëhequr hap pas hapi
- Punë e pavarur

**Koha:** 45’

**Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:**

- Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Mësuesi kërkon nga nxënësit të sjellin shembuj konkretë (7 shembuj) të teknikave për të hapur një tekst rrëfyës letrar. Diskutohen përgjigjet e nxënësve në klasë. Mësuesi ndërkaq ka përgatitur modelet e tij (sipas sipas shembujve në tekstin e nxënësit), të cilat ua demonstroi nxënësve.

**Model:**

- Në Pallatin e sportit do të bëhen ndeshjet e basketbollit. “Lajmëro shokët!”, - tha mësuesi.
- Mësuesi i edukimit fizik hyri edhe në klasën e 10-të C.



- c) Ndeshja do të fillonte dhe sportdashësit që ta inkurajonin duket sikur nuk ishin përgatitur.
- ç) Dhjetë nxënës të klasës iu afruan mësuesit dhe i treguan flamurët dhe tabelat e përgatitura.
- d) Ata kishin veshur bluza me logon e gjimnazit të tyre dhe ishin gati të niseshin.
- dh) Jashtë, shiu pushoi dhe ndërkaq doli dielli.
- e) Ora e qytetit tingëlli, duke u dëgjuar qartë në të gjitha mjediset shkollore, gjë që tregonte se orari i ndeshjes po afronte.)
  - Më pas nxënësit ftohen të vëzhgojnë foton.



- Pyetje: Sa të vërtetë jemi ne kur shkruajmë për veten tonë? Cilat janë rrethanat që na shtyjnë të jemi ose jo të vërtetë?
- Mësuesi e drejton diskutimin drejt faktit që në një autobiografi njeriu është i vërtetë, por ka parasysh që shkrimi do të lexohet edhe nga të tjerë. Pra, njeriu sjell përpara të tjerëve personalitetin e tij, kështu që ai përpiket të lërë te të tjerët mbresa pozitive.

- Pyetje: Si mund ta interpretoni një foto të tillë?

Nxënësit janë të lirë të sjellin interpretimet e tyre. (Vajza po sheh veten në pasqyrë; po mediton për veten; po krahason portretin e saj me foton në prehër; i kthehet së kaluarës etj.)


Mësuesi i orienton nxënësit drejt shpjegimit të termit *autobiografi* /biografi.

- Pyetje: Pse kemi nevojë të shkruajmë ne? A kemi nevojë të shkruajmë për jetën tonë?

Sërish nxënësit sjellin mendimin e tyre mbi nevojën për të shkruar. (Shprehin ndjenjat e tyre, rrëfejnë ngjarje nga jeta e tyre dhe e të tjerëve, ndajnë mendimet e tyre me të tjerët, memorizojnë kujtimet e tyre etj.) Përdorimi i empatisë, futja e vetes në vendin e rrëfimtari. (“të veshësh këpucët” e tjetrit për të përjetuar të njëjtat përvoja).

- Pas këtij diskutimi, nxënësit nxiten të rikthehen në përvoja vetjake për të rrëfyer një moment të caktuar të së shkuarës. Klasa ndahet në dy grupe, por brenda grupit secili mendon individualisht.
  - A) Nxënësit e njërit grup kujtojnë momente që lidhen me të kaluarën, por që protagonistë janë vetë ata;
  - B) Nxënësit e grupit tjetër do të sjellin ngjarje nga e kaluara, por protagonist të jetë dikush tjetër.
    - Pyetje: Në ç’vetë shkruajmë kur flasim për veten tonë? Po për tjetrin?

Në përfundim të përgjigjeve të nxënësve, si konkluzion i përgjigjeve të tyre, mësuesi kërkon nga nxënësit që përmes diagramit të Venit të krahasojnë:



➤ Në këtë fazë, përmes teknikës së praktikës së udhëhequr hap pas hapi, nxënësit do të lexojnë tekstin “Jeta ime”.

- Arsyetimi nis me **titullin**.

Pyetje: *Ç’ide ju krijon titulli i këtij teksti? Çfarë prisni të sjellë autori në këtë shkrim? Nxënësit do të sjellin idetë e tyre që do t’i afrohen së vërtetës së autobiografisë.*

- **Hapi i parë:** Lexohet paragrafi i parë. Nxënësve u kërkohet të përcaktojnë **fjalinë hyrëse** dhe të zbulojnë teknikën (*përshkrim i rrethanave vendore*) e përdorur në hyrjen e tekstit.

Pyetje: *Ç’ mjedis shpaloset në tre paragrafët e parë? (Model: mjedis i ngrohtë e plot ngjyra, pamje ngazëlluese) Cilat janë tonet e rrëfimit? (Model: tone të nostalgjisë) Po koha e foljes? (Model: koha e shkuar)*

Dallohet që autori është nostalgjik kundrejt së kaluarës, kohës së shkuar, ai kalon nga rrëfimi për vendin tek rrëfimi për njerëzit, atmosfera është idilike.

- **Hapi i dytë:** Lexohen dy paragrafët në vijim. U kërkohet nxënësve të përcaktojnë **bërthamat e paragrafëve** (Model: bërthama e paragrafit është fjalia kyç e paragrafit që përmbledh referentin e tij; konkretisht bërthama e paragrafit të parë është: Përshkrimi i mjedisit të natyrës së fshatit të autorit).

Sipas këtij modeli nxënësi duhet të gjejë bërthamat e dy paragrafëve të tjerë: (Model: a) bollëku i Ibrik- Tepesë; b) mungesa e vajzave në fshat).

Pyetje: *Ç’ mund të thoni për ecurinë e rrëfimit deri në këtë moment? Si do ta konsideronim paragrafin e tretë po të nisemi nga organizimi i strukturës së tekstit? (Model: Duhet të orientohen nxënësit që të kuptojnë që vijimi i tekstit do të lidhet me një linjë erotike në embrion, sjellë përmes perceptimit femënor).*

- **Hapi i tretë:** Lexohen dy paragrafët e tjerë.

Pyetje: *Dalloni vetën e rrëfimit. Ç’efekte krijon për ju ky përdorim? (Model: Veta e tretë. Noli rrëfen për Nolin. Krijohet përshtypja e një distance objektive e rrëfyesit në ngjarjen dhe personazhin. Qëndrimi i rrëfyesit tenton të jetë neutral).*

Pyetje: *Si e interpretoni të qeshurën e gjyshes? Ç’ tipar të fëmijës zbuloni në këta paragrafë? Si lidhen këto paragrafë me fjalinë e fundit të paragrafit paraardhës? (Model: Vendosen paralel naiviteti femënor: ( Noli) me përvojën jetësore (gjyshja); reagimi i gjyshes sjell informacion për natyrën delikate, gati femërore të Nolit fëmijë; fjalia e fundit e paragrafit të mësipërm jep cilësi të vajzave të Ibrik-Tepesë, të cilat zbërthehen në shembuj konkretë në paragrafët që po studiojmë-*

konkretisht Noli u zgjodh nga Shasha).

- Tani u lihet në dorë nxënësve arsyetimi. Klasa ndahet në tri grupe. Secili grup ka detyrat e tij.

• **Grupi I:** *Cilat janë ndjesitë që e drejtojnë personazhin drejt pushkës? Cili është raporti i shqiptarit me pushkën? Referojuni ushtrimeve 8 dhe 9, fq. 98. (Model: Noli- fëmijë preket në sedrën mashkullore dhe brenda logjikës tradicionale të raportit të shqiptarit me pushkën (shenjë burrërie, madhështie, force...), vërsulet (veprim që emërton aksion kafshëror -jo **shkon**) dhe rrëmben (njëlloj: nuk përdoret **merr**), veprime instinktive që burojnë nga thellësitë e nënvetëdijes. Mësuesi mund të shpjegojë se ky reagim e ka pikënisjen që në paragrafin e tretë (përshkrimi i vajzave), pra është instinkti i thellë mashkullor që e orienton djalin. Në funksion të këtyre veprimeve që orientohen nga shtysat e thella të nënvetëdijes vjen pa paralajmërim edhe onomatopeja “Bam!” (figura e harmonisë imitative). Zhurma është përmbyllje (shpërthim i jashtëm) e reaksioneve të brendshme shpirtërore të fëmijës. Pikëçuditja duket sikur është urdhër për të mos u trajtuar më si fëmijë, aq më pak si djalë delikat.)*

• **Grupi II:** *Çfarë ndjesish përftoni nga rrëfimi i Nolit për veten? Referojuni ushtrimeve 10 dhe 11 fq.100? Nxënësi duhet të zgjedhë alternativat e ushtrimit 10 dhe të shpjegojë qëndrimin e djalit në dy fazat e sjella në pyetjen 11.*


• **Grupi III:** *Zbuloni shprehjet frazeologjike në tekst dhe shpjegoni ngjyresat kuptimore që fiton shprehja nga ky përdorim? Ç’tipare të dialogut vini re? Referojuni ushtrimeve 5 dhe 6; fq. 99. (Model: merrte me mend; të hiqte mendjen; zunë dyshekun; pret nyjen gordiane; mbeti në dorë. Në të gjitha rastet, teksti shkon drejt komunikimit të thjeshtë popullor, drejt stilit bisedimor, duke i dhënë tekstit tiparin e thjeshtësisë dhe vërtetësisë. Po ashtu, dialogu është karakterizues: barishte (në sytë e fëmijës barnat janë thjesht barishte - shenjë naiviteti, pafajësie etj. Ndërkaq për gjyshen (barëra- ilaçe)- shenjë e përvojës jetësore. Nëse krahasojmë dialogun e gjyshes një herë me Nolin dhe një herë me Shashën vëmë re kujdesin e gjyshes për Nolin. Ka ngjyresë humori në fjalët e saj për nipin (kur kërkon ta vërë në lojë me dashamirësi), por ka një nuancë “talljeje” (thellë=xheloz) të gjyshes ndaj Shashës. Dhe kjo bën diferencën).*

#### **Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Nxënësit përmes diagramit të Venit do të dallojnë të përbashkëtat dhe të veçantat e Nolit fëmijë dhe Shashës. Paraqitet skema në tabelë. Diskutime në klasë.
- Realizojnë një pesëvargësh për titullin e tekstit “Jeta ime” (Model:  
Jeta ime (përshkrim me një fjalë i temës- zakonisht ka emër).  
E pastër, naive (përshkrim me dy fjalë i temës – zakonisht dy mbiemra).  
Ikën shpejt, kthehet në memorje, më ngjall nostalgji (tri veprime që kryhen nga tema- folje).  
Jeta lë gjurmë në memorjen e njeriut. (fjali me pak fjalë që shprehin qëndrim, ndjenjë për temën).
- Kohë që rrjedh. (një grup fjalësh sinonime me temën).

#### **Detyrë shtëpie:**

- U.3; f.100

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfrytëzoni materiale nga interneti apo burime të tjera informacioni mbi jetën e Nolit dhe plotësoni imazhin e plotë të <i>vendlindjes</i> së Nolit, e cila konfigurohet në hartën në tekst, në fq. 97. Përgatitni një paragraf rrëfyes për karakteristikat e vendlindjes së Nolit, duke u mbështetur në këto materiale.</li> </ul>
<p align="center"><b>Vlerësimi i situatës:</b></p>	<p align="center"><b>Vlerësimi i nxënësve:</b></p>
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit biografik dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin “Jeta ime”;</li> <li>• shkruajnë drejt pesëvargëshin, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 4.2 (2) “JETA IME”, FAN S. NOLI. EMRAT QË PËRDOREN VETËM NË NJËJËS OSE VETËM NË SHUMËS**


<p align="center"><b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b></p>	<p align="center"><b>Lënda: Gjuhë shqipe</b></p>	<p align="center"><b>Shkalla V</b></p>	<p align="center"><b>Klasa 10</b></p>
<p><b>Tematika: Bota përmes rrëfimit</b></p>			
<p><b>Situata e të nxënësve nr. 26</b></p> <p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me emrat që përdoren vetëm në njëjës ose në shumës, duke u ushtruar në ushtrime konkrete me to.</p>			
<p align="center"><b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit dhe drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, letër formale dhe joformale, autobiografi etj.;</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga fusha e gjuhës;</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënësve</b> Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, sipas qëllimeve që i cakton vetes.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat</li> </ul>			

e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.

➤ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të emrave të përdorur në tekst;</li> <li>• Zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit;</li> <li>• Ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për emrat që përdoren vetëm në njëjës apo në shumës, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstin “Jeta ime”.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Analizë morfologjike Trajta e shumësit Emra që përdoren vetëm në njëjës/ shumës; Rregulla të drejtshkrimit të emrave.</p>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> <i>fleep-charter</i> ose projektor, tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga F.S Noli.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> Përdor tekstet letrare për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes.</p> <p><b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutim</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• bisedë e kombinuar me shpjegim, DDM</li> <li>• Punë e pavarur</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. (U.2; fq.100) Lexohen nga nxënësit dy punime dhe diskutohet mbi mënyrën e realizimit, teknikat e shkrimit, ndërthurjen e elementit rrëfim dhe përshkrim në punimet e nxënësve.</p> <p>➤ U kërkohet nxënësve të nënvizojnë nga 4 emra në punimet e tyre dhe ndihmohen ata të kujtojnë klasën e emrave.</p> <p>Kërkesë: <i>Nënvizoni me të kuqe emra në numrin njëjës, gjinia femërore dhe me blu emra në numrin shumës, gjinia mashkullore.</i></p> <p>➤ Në tabelë mësuesi shkruan <i>emri</i> dhe përmes teknikës, <i>stuhi mendimi</i>, kërkon nga nxënësit të rikujtojnë njohuritë që lidhen me të. Në tabelë plotësohet në bashkëpunim me nxënësit skema e mëposhtme:</p>	



- Nxënësve u kërkohet të shpjegojnë tabelën e mësipërme përmes shembujve që kanë nxjerrë nga punimet e tyre. Mësuesi ndërhyr për saktësi në shpjegim.
- Në këtë fazë nxënësve u kërkohet të lexojnë tekstin “Jeta ime” të ndarë në 2 grupe:
  - Grupi I: Zbuloni 3 emra në numrin njëjës (analizojini ato) (**Model:** vajzë- emër, gjinia femërore, numri njëjës, trajta e pashquar, konkret, i përgjithshëm, rasa emërore)
  - Grupi II: Zbuloni në tekstin “Jeta ime” 3 emra në numrin shumës (analizojini ato).
- Në projektor është paraqitur tabela e emrave që përdoren vetëm në njëjës dhe vetëm në shumës:

Emra vetëm në njëjës	Emra vetëm në shumës
nxehhtësi	krundet
guxim	makaronat
kos	të hollat
rërë	pantallonat
rini	syzet
veri	skitë
kollë	dhentë
fruth	ethet
spinaq	shytat
shqipja	Alpet
kimia	thashethemet

- Ftohen nxënësit të vëzhgojnë tabelën dhe, përmes teknikës DDM, klasifikojnë njohuritë e tyre të qëndrueshme dhe ato të reja në raport me emrat që përdoren vetëm në një numër (njëjës/shumës).
- Me ndihmën e Fjalorit të Gjuhës Shqipe, shpjegohen kuptimet e emrave të mësipërm për t’u klasifikuar sipas kërkesës.

Di	Dua të di	Mësova
Ka emra që përdoren vetëm në njëjës.	Çfarë shprehin emrat vetëm në njëjës?	Emrat vetëm në njëjës shprehin:
		lëndë të pandashme (kos);
		dukuri atmosferike (nxehhtësi)
		.....

Ka emra që përdoren vetëm në shumës.	Çfarë shprehin emrat që përdoren vetëm në shumës?	Emrat vetëm në shumës shprehin:
		sende që janë përbërë nga dy apo më shumë pjesë (pantallona) ..
		.....

### Detyrat dhe puna e pavarur:

- Kërkesë: Zbuloni në tekstin “Jeta ime” emra që përdoren vetëm në njëjës dhe emra që përdoren vetëm në shumës. Shpjegoni çfarë shprehin ata? (**Model:** barishte, barërat, tifoja, fat)
- Kërkesë: Shpjegoni, duke u mbështetur edhe në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, çfarë tregon përdorimi i fjalës “plakat” vetëm në numrin shumës. A mund të sillni shembuj të përdorimit të kësaj fjale?

(**Model:** Sipas mitologjisë, plakat janë tri ditët e fundit të marsit a fillimit të prillit dhe sipas bestytive lidhet me përfytyrimin popullor për një plakë që shau marsin, kur kujtoi se iku dimri: “Marsi i thotë prillit: - prill, o im vëlla, më jep dy ditë hua, ta thaj plakën me gjithë ç’ka. Dhe marsi e thau” (*Ikën plakat*))

### Detyrë shtëpie:

Gjeni në Fjalorin e Gjuhës Shqipe 5 emra të përdorur vetëm në njëjës dhe 5 emra të përdorur vetëm në shumës, që lidhen me fëmijërinë tuaj. Formoni një tekst të shkurtër autobiografik.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me trajtimin e emrave që përdoren vetëm në njëjës ose vetëm në shumës;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore;</li> <li>• analizojnë drejt funksionet e emrave që përdoren vetëm në njëjës apo në shumës.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

## TEMA MËSIMORE 4.2 (3) “JETA IME”, FAN S. NOLI. EMRAT QË KANË DY TRAJTA SHUMËSI

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla V	Klasa 10
<b>Tematika:</b> Bota përmes rrëfimit			
<b>Situata e të nxënit nr. 27</b>			
Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me emrat që kanë dy trajta shumësi.			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>			
Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të emrave me dy trajta shumësi në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, letër formale dhe			



<p>joformale, autobiografi etj.;</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi që lidhet me temën e emrave me dy trajta shumësi;</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të nxënët</b></p> <p>Nxënësi shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në mënyrën e përdorimit dhe rregullat e shkrimit të emrave me dy trajta shumësi për të kryer një veprim, aktivitet apo detyrë, sipas qëllimeve të caktuara.</p> <p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</p> <p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin e duhur për emrat me dy trajta të shumësit nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të emrave me dy trajta shumësi;</li> <li>• Zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit, në rastet e përdorimit të emrave me dy trajta shumësi;</li> <li>• Ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për emrat me dy trajta shumësi, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstin “Jeta ime” dhe tekste të tjera letrare ose joletrare.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Analizë morfologjike Trajta e shumësit Emra që kanë dy trajta shumësi; Rregulla të drejtshkrimit të emrave me dy trajta shumësi.</p>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> <i>fleep-charter</i> ose projektor, tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga F.S Noli.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> Përdor tekstet letrare për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes dhe për të përmbushur rezultatet e të nxënët të kësaj ore.</p> <p><b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutim</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• bisedë e kombinuar me shpjegim, DDM</li> <li>• Punë e pavarur</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Lexohen nga nxënësit dy punime dhe diskutohet mbi mënyrën e realizimit, teknikat e shkrimit, ndërthurjen e elementit rrëfim dhe përshkrim në punimet e nxënësve.</p>	



Pyetje: Ritregoni momentet në tekst nga **vitet** e fëmijërisë së Nolit. (Nxënësi duhet të përmbledhë shumë shkurt tekstin “Jeta ime”). Mësuesi orienton nxënësin të synojë rrëfimin jo përshkrimin e rrëfimit.

➤ Tërhiqet vëmendja tek togu: **vitet** e fëmijërisë.


Pyetje: Në ç’numër është pjesa kryesore e këtij togu (vitet)? Nxënësi përgjigjet. Kërkohet sërish nga nxënësi trajta e njëjësit (vit).

Pyetje: A mund të kujtoni një trajtë tjetër të shumësit të këtij emri? (vjet)

Pyetje: Përdorini këto trajta në fjali: Vini re në cilat raste përdoren ato. Nxënësit japin idetë e tyre.

(Model: përdoret trajta vjet dhe jo vitë kur shoqërohet me numëror **P.sh**: 3 vjet)

➤ Në tabelë mësuesi shkruan: “**Emri me dy trajta shumësi**” dhe kërkon nga nxënësit të sjellin modele të tjera të emrave me dy trajta shumësi. Në tabelë plotësohet në bashkëpunim me nxënësit skema e mëposhtme:



➤ Mësuesi kujdeset që të shkruajë me të kuqe emrat (me –ra) dhe me blu tipet e tjera.

➤ Në këtë fazë nxënësit ndahen në grupe dhe punojnë me Fjalorin e Gjuhës Shqipe sipas rubrikave:

- Grupi I: Shkruani dy trajtat e shumësit të emrave të mëposhtëm dhe përcaktoni kuptimet e tyre: (Përdoret teknika e ditarit tripjesësh).

Njëjësi	Shumësi	Kuptimet
dru	drutë	Trung ose degë druri e prerë, që përdoret për t’u djegur.
	drurët	Bimë shumëvjeçare me trung të trashë, të fortë e me degë.
flamur	flamurët	
	flamujt	
gjak	gjaqet	
	gjakrat	
lëkurë	lëkurët	
	lëkurat	
fyell	....	
	....	
farë		
rreth		

petë		
gram		
gji		

• Grupi II: Çfarë mund të thoni për emrat e mëposhtëm, në raport me përdorimin e dy trajtave të shumësit më-ër dhe më-ë? A lidhet ky përdorim me normën gjuhësore, me kuptimin e figurshëm të fjalës apo është përdorim dialektal? Ilustroni mendimin tuaj përmes shembujsh në një kontekst të caktuar.

Emri	Pse ky përdorim?		Ilustrimi përmes shembujsh
buf	bufë	shumësi normativ	Bufi veshgjatë është një kategori e llojit të bufëve
	bufër	fig: keqësuese, mospërfillëse	Ata janë bufër, të trashë nga mendja.
hajvan	hajvanë		
	hajvanër		
këlyshër	këlyshë		
	këlyshër		
qenër			
ujqër			

• Grupi III: Cila prej trajtave të shumësit të emrave të mëposhtëm pranohet si normative në botimet e ndryshme të fjalorit të shqipes dhe në gramatikat?

Emrat	Trajta e shumësit në normë	Ilustrim me shembull
labë lebër	të dyja trajtat	
nipa nipër		
prindë prindër		
gjyshë gjyshër		
gardhe gjerdhe		
zgjoj zgjoje		

#### Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkesë: zbuloni në tekstin “Jeta ime” 3 emra që përdoren në dy trajta të shumësit. (Model: paragrafi parë- kohë)

#### Detyrë shtëpie:

Gjeni në Fjalorin e Gjuhës Shqipe 5 emra që përdoren në të dyja trajtat e shumësit dhe ndërtoni me to fjali që lidhen me mbresa nga jeta juaj.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve me gojë;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore;</li> <li>• analizojnë drejt funksionet e emrave me dy trajta shumësi.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime në grup dhe në klasë;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 4.2 (4) – 4.2 (7) “KËNGË NGA ÇANG’GAN”, LI PO. POEZIA, SI TEKST RRËFYES**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla V	Klasa 10
<b>Tematika: Bota përmes rrëfimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 28</b>			
<p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, duke përcaktuar llojin e rrëfyes të tekstit poetik “Këngë nga Çang’gani”, të Li Po, duke zbuluar tiparet e këtij lloji rrëfyes, si dhe duke shpjeguar mënyrën se si janë shprehur ato në këtë tekst.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon për llojin rrëfyes të poezisë, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të; diskuton mbi tekstin konkret, duke analizuar dhe vlerësuar tiparet e tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve lidhur me tekstin poetik, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura dhe arti.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin rrëfyes të poemës.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të një teksti poetik.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p> <p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje shoqërore, letrare, artistike, duke shfrytëzuar njohjen e llojit rrëfyes të tekstit poetik;</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me tekstet poetike të llojit rrëfyes.</p>			

<p><b>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në diskutime që lidhen me tekstin rrëfyes poetik për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës në diskutime për tema shoqërore, si dashuria dhe ngjarje të ndryshme nga jeta personale;</li> <li>• Bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit rrëfyes poetik, si dhe analizon e interpreton kuptimet e figurshme që merr fjala brenda një konteksti të caktuar;</li> <li>• Përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të tekstit rrëfyes poetik;</li> <li>• Shkruan qartë dhe me stil vetjak e në mënyrë logjike tekste rrëfyese të këtij lloji për qëllime dhe audienca të ndryshme;</li> <li>• Shkruan saktë dhe pa gabime nga pikëpamja drejtshkrimore.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Tekst rrëfyes poetik.  Poezi/vjershë  Poema  Poema rrëfimtare  Subjekt</p> <p><b>FJALOR</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ sintetike</li> <li>■ poemë simfonike</li> <li>■ ekspozicion</li> <li>■ pikë lidhje e veprimit</li> <li>■ pikë kulmore</li> <li>■ zgjidhje</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit për poezinë, modele të tekstit tregimtar në vargje Epika legjendare, libri i nxënësit, poezi nga Lasgush Poradeci dhe Ismail Kadare,</p> <p><a href="https://it.ëikipedia.org/ëiki/Li_Bai">https://it.ëikipedia.org/ëiki/Li_Bai</a>.</p> <p><b>Mjete:</b> magnetofon (ose kompjuter dhe boxera), tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor, ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> Nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga një tekst rrëfyes letrar i llojit poetik.</p> <p><b>Letërsi:</b> folklor dhe poezi e kultivuar</p> <p><b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme në funksion të temës.</p> <p><b>Qytetari:</b> Përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore gjatë diskutimit për temën.</p> <p><b>Gjeografi:</b> Përdor të dhëna gjeografike dhe historike për Lindjen e Largët, <i>google earth</i>.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim i orientuar</li> <li>• skemë rreze</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• praktikë e udhëhequr hap pas hapi</li> <li>• grupet e ekspertëve</li> <li>• punë në grupe</li> </ul>	<p><b>Koha: 135'</b></p> <p><i>(Këtu përfshihen 3 tema mësimore që do të shtrihen në 3 orë sipas zgjedhjes së mësuesit)</i></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>(Ora e parë e kësaj teme):</p> <p>➤ Mësimi nis me diskutimin e disa prej detyrave të orës së kaluar. Nxënësit lexojnë fjalitë e përgatitura dhe bëhen komente rreth tyre.</p>	



➤ Në një moment pauze, mësuesi vendos në magnetofon një linjë muzikore (këngë) me motive të Lindjes dhe në këtë situatë paraqet në projektor pamjen nga gryka e lumit Çutang. Fton nxënësit të vëzhgojnë foton dhe të ndjekin linjën muzikore në heshtje për disa minuta.

Pyetje: *Cilat janë disa nga mbresat që ju provuat?*

*Përpiquni t'i sillni në tri- katër vargje të gjata mbresat tuaja. Nxënësit sjellin variantet e tyre.*

Mësuesi ka përgatitur variantin e vet, sipas modeleve më poshtë:

(**Model 1:** Nën tinguj harmonike ëndrradrellëse vëzhgoj / se si hapet para meje një peizazh i bukur dhe i heshtur.

/ i paqtë /madhështor dhe i prekshëm/ natyrë dhe zemër njerëzore mpleksen nën tinguj e kësaj melodie magjike).

ose:

**Model 2:** Mund të sillen në klasë për t'u dëgjuar poema simfonike të famshme


[https://www.youtube.com/results?search\\_query=poemi+simfonici](https://www.youtube.com/results?search_query=poemi+simfonici)

- Kjo situatë ndihmon në hapin tjetër, ku mësuesi shkruan në tabelë: **Poezia**, dhe u kërkon nxënësve të shpalosin njohuritë e tyre mbi poezinë. (Stuhi mendimi)



- Në këtë moment, jepen sqarime plotësuese për gjinitë letrare, sërish duke ftuar nxënësit të sjellin njohuritë e tyre paraprake. Në tabelë shkruhet: **gjinitë letrare**;

Plotësohet kllasteri më poshtë:



➤ Të gjitha çështjet teorike shoqërohen me shembuj nga nxënësit në bashkëpunim. Mësuesi ka gati modelet e veta. (**Model:** “Gjergj Elez Alia”; poezi nga L. Poradeci; “Prometeu”).

- Mësuesi, gjatë bashkëbisedimit mbi skemën e mësipërme, kujdeset të sqarojë që poema dhe vjersha janë të ngritura mbi vargun dhe ky mund të jetë:
- i matur ose jo,
  - i lirë ose i thyer,
  - i organizuar në strofa ose njëshkolonë,
  - me rimë të plotë ose të pjesshme (asonanca dhe konsonanca).

Në dallim nga proza ku ligjërimi është i lirë për të shpjeguar gjithçka, gjer në imtësitë më të thella, endja e një tekste poezie ndjek rregulla të caktuara, duke “luajtur” me rregullat e sintaksës e duke na çuar tek burime shprehësie fonetike, leksikore dhe morfosintaksore.

- Në këtë fazë të mësimin, lexohet teksti poetik “Një këngë nga Çang’gan”; Li Bai(Li Po). Nxënësit u shpjegohet se do të jenë ata që do ta komentojnë poezinë (edhe në orët në vazhdim).

*Atyre u kërkohet të jenë të vëmendshëm gjatë leximit dhe të nënvizojnë me të kuqe emrat e kafshëve që përmenden në poezi dhe me blu llojet e bimëve e të pemëve.*

*Kërkohet nga nxënësit që të bëjnë pyetje rreth tekstit, që do të lidhen me të kuptuarin e tekstit. Nëse ata nuk kanë pyetje ndërhyjnë mësuesi me pyetje. (**Model:** Ç’ mund të thoni për zërin e rrëfimitarit në këtë tekst? Ata duhet të shpjegojnë që kemi të bëjmë me një rrëfimtari të brendshëm)*

*Pyetje: Cilat ishin kafshët e përmendura në tekst? Ç’domethënie kanë ato, sipas jush, për rrëfimtaren? Nxënësit japin përgjigjet e tyre. (**Model:** përmenden kalë bambuje dhe majmunët. Imazhet që krijohen tek lexuesi janë mbresëlënëse. Kali (simbol i rrugës, udhëtimit, forcës, energjisë) prej një druri ekzotik nxit përfytyrimin e një ndjenje të thekshme romantike, veshur me tisin e lumturisë, por që e ka pikënisjen që në fëmijërinë e largët. (Kali vjen vërdallë, pra është shumë pranë rrëfimtares). Ndërkaq imazhi i kalit zbehet drejt majmunit (shëmtrim, plakje nga largësia dhe rëndesa), gjë që dëshmon largimin dhe rëndesën e pritjes.)*

*Pyetje: Ç’rol luajnë kumbullat në tablonë e së kaluarës fëmijore të të rinjve? (**Model:** fruti i përmendur është shumë sensual dhe ngjyra jeshile krijon imazhin e papjekurisë ose mungesës*

së pjekurisë së thellë, siç mund të jetë e verdha.)

Pyetje: *Shpjegoni kuptimin e fjalëve “namusqar” dhe “sokak”, nisur nga konteksti. Nxënësit japin shpjegimet e tyre të mbështetur nga mësuesi.*

- Nxënësit do të diskutojnë në grupe dyshe për pyetjet e shtruar që në fillim (para leximit të poezisë).
- (Kjo orë mund të mbyllet me këto diskutime).


### Detyrë shtëpie (për orën e parë):

U. 4:f.106 (Të shkruarit) *Gjeni në internet informacion mbi jetën e autorit. Silleni informacionin në formën e një teksti rrëfyës.*

## ORA E DYTË E TEMËS 29

- Nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Lexohen dy punime. Nxënësit sjellin informacion për autorin, plotësohet kështu skeda e autorit, si dhe realizohet qëllimi i realizimit të një teksti rrëfyës. Mësuesi nxit diskutimet për detyrat me pyetje mbi jetën e autorit, por edhe për karakteristikat e tekstit rrëfyës që zbulohen në dy punimet e nxënësve.

Është momenti kur mund të paraqitet organizuesi grafik i mëposhtëm për të plotësuar njohuritë mbi poezinë si tekst rrëfyës.



- Klasa ndahet në grupe me nga 5 nxënës (grupet e ekspertëve). Ndahen rolet për çdo nxënës të grupit. Pyetjet paraqiten në tabelë, përmes projektorit, *flip-chart-it* ose shkrimit të lirë.

• **Nxënësit me nr.1:** Shënoni vendet në të cilat ndodh rrëfimi dhe identifikoni rrëfimtaren në kohë të ndryshme përmes rrëfimit të saj



(**Model:** vendi: sokaku i Çang'ganit; rrëfimtaria fëmijë- flokët s'ia kishin mbuluar akoma ballin dhe luante te porta e mblidhte lule.... Në këtë linjë vazhdon arsyetimi në vijim)

• **Nxënësit me nr.2:** Renditni kronologjikisht historinë e dashurisë nisur nga zhvillimi i gjendjes shpirtërore të rrëfimtares dhe arsytet e ndryshimit të kësaj gjendjeje sipas vetë rrëfimtares.

(**Model:** në paragrafin e parë rrëfimtaria është zemërlumtur dhe burim i lumturisë është se i dashuri i saj ishte me të....Në këtë linjë arsyetimi vijon përgjigjja e plotë)

• **Nxënësit me nr.3:** Zbuloni ndjenjën që shkakton te vajza pamja e strofës III-IV. Bëni lidhjen e kësaj strofe me strofën e fundit dhe shpjegoni kuptimin që merr përdorimi i pasthirmës "Oh!".

(**Model:** Pamja e gjurmëve të humbura nën mykun e trashë, gjethet e rëna të vjeshtës, fluturat që kërcëjnë rreth kopshtit (mund të jetë imazhi i lojës së dashurisë, që rrëfimtares në këtë çast i mungon), i thyjnë zemrën. Rrjedhimisht, pasthirrma e strofës së fundit është më shumë dhimbje e një pritjeje të gjatë, sesa kënaqësi që pritja po mbaron. Nuk ka asnjë të dhënë që të përlligjë fundin e pritjes. Në çastin e fundit ajo ëndërron me dhimbjen e shpirtit të lodhur kthimin e të dashurit.)

• **Nxënësit me nr. 4:** Zbuloni nga vargjet ëndrën e rrëfimtares, ilustroni idenë tuaj. Ndërkohë zbërtheni mesazhin e kësaj pjese.

(**Model:** Duket qartë që ëndrra e rrëfimtares është të rikthehej i dashuri për të rijetuar edhe një herë çastet e lumtura që ajo i kërkon duke u shmangur me mend drejt së shkuarës. Kjo duket qartë që në ëndjet e saj në kujtime dhe në pritjen me imazhin e çastit kur ajo do të ritakonte dashurinë e saj. Mesazhi lidhet me dhimbjet që shkakton largimi (qoftë dhe i përkohshëm – megjithëse në këtë rast është largim pa kthim) i një dashurie të madhe dhe nostalgjinë e kthimit në kohën e fëmijërisë.)

- Nxënësit bashkohen në grupet eksperte për të planifikuar se si do ta japin mësimin nga çdo rol. Më pas, nxënësit kthehen në grupet bazë, ku çdo ekspert drejton pjesën e tij të diskutimit.
- Mësuesi ndjek punën e grupeve dhe mënyrën e diskutimit të nxënësve.
- Në mbyllje mësuesi fton nxënësit të reflektojnë mbi këtë poemë, duke paraqitur me projektor ose me *fleep-charter* skemën e mëposhtme.


### Reflektim mbi poezinë

- ❖ Pritja e burrit që ka ikur larg na kujton Penelopën.
- ❖ Dashuria e adoleshentes me përkushtim deri në vdekje.
- ❖ .....Halili dhe Tanusha
- ❖ .....

### Detyrat dhe puna e pavarur:

- Nxënësit ftohen të shohin foton e mëposhtme.





Pyetje: Ç'mund të thoni për mënyrat e kërkimit të dashurisë në kohët e teknologjisë?

Duke e vrojtuar me kujdes foton që mësuesja ua demonstron iu kërkon nxënësve të dallojnë disa mënyra të kërkimit të dashurisë që paraqiten në mozaikun që ndërton këtë fotografi.

Shkruani nga një paragraf ku rrëfëni për disa nga mënyrat se si e kërkohet dashurinë sot.

### Detyrë shtëpie (për orën e dytë):

U.1 (Të shkruarit) Bazuar në të dhënat e pjesës, shkruani një tekst prej 3 paragrafesh, që identifikon rrëfimtaren e poemës, vendndodhjen, humorin që e karakterizon në çdo fazë të jetës dhe tematikën e trajtuar.

### ORA E TRETË E TEMËS 30

- Kjo është një orë ushtrimesh, ku nxënësi do të ushtrohet në çështje të strukturës, teknikave të shkrimit të tekstit, por edhe koncepte gjuhësore të marra në orët e mëparshme të kapitullit.
- Mësimi nis me detyrën e shtëpisë. Lexohen 3 prej punimeve. Gjatë leximit nxënësit e tjerë orientohen të mbajnë shënime për:
  - A) mënyrën se si nxënësi që përgjigjet e identifikon rrëfimtaren, vendndodhjen, humorin etj...
  - B) teknikat e përdorura në realizimin e paragrafit, fjalorin e përdorur gjatë shkrimit (mënyra si niset punimi, koherenca e kohezioni ...).
  - C) mënyrën e prezantimit të detyrës, teknikat e leximit, intonacioni, rrjedhshmëria e saktësia në lexim.
- Nxënësit e tjerë vlerësojnë punën e shokëve me pikë (3 pikë për secilën nga rubrikat e mësipërme. Plotësohet tabela vlerësuese:

Rubrikat e kërkesës	Pikët e plota	Pikët e fituara
A) Mënyra se si nxënësi që përgjigjet e identifikon rrëfimtaren, vendndodhjen, humorin etj...	3	
B) Teknikat e përdorura në realizimin e paragrafit, fjalorin e përdorur gjatë shkrimit (mënyra si niset punimi, koherenca e kohezioni ...).	3	
C) Mënyra e prezantimit të detyrës, teknikat e leximit, intonacioni, rrjedhshmëria e saktësia në lexim.	3	
Gjithsej	9	....

- Ky moment ndihmon që nxënësit të jenë në gjendje të vlerësojnë veten dhe shokët.
  - Në këtë fazë, klasa ndahet në 2 grupe, me detyra specifike:
    - GRUPI I:
      - Në mënyrë të pavarur nxënësit punojnë me **U.9 dhe 10 , fq. 106.**  
Mësuesi pyet dy nxënës për interpretimin që do t'i bënin çështjeve.
- (Modeli (U.9):
- përdorimi i vetës I .....
  - motivet:

- dashuria , —→ Lasgushi,
- pritja —→ Ismail Kadare
- malli.....etj)
- o Si do ta interpretonit premtimin e rrëfimitares?  
*...Se do të të dal përpara, paçka sa larg do jesh,*  
*Deri tutje në Çang-feng Sha, ?!....* (mendoni që Çang-feng Sha është 300 km larg Çangganit,vendit ku jetonte rrëfimitarja)

- GRUPI II: Analizoni strukturën e këtij teksti rrëfimitar.

**(Model:**

Përmban fillim, zhvillim, mbyllje ..... ilustrim

Përmban rrethana kohore dhe hapësinore.....gjejini

Ka personazhe ....dallojini.....

Ka konflikte: protagonistja me veten (.....)

protagonistja me një personazh tjetër

(joprotagonist)

protagonistja me shoqërinë

protagonistja me natyrën

Përmban një moral....mesazhi që përcjell.....

Zëri i rrëfimitares (e lumtur, e trishtuar, përmalluar,)

Nxënësit përgjigjen, duke ilustruar me kujdes çdo mendim të tyrin.

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Kjo orë ka hapësirë të rikthehemi tek njohuritë e mëparshme gjuhësore. Nxënësit, në mënyrë të pavarur, të ndarë në grupe, do të zbulojnë në tekstin: **“Një këngë nga Çanggan”** emra:
  - që përdoren vetëm në njëjës ..... (myk, vjeshta)
  - që përdoren vetëm në shumës ..... (vetullat, flokët)
  - që formojnë shumësin me dy trajta .... (grykat)

**Detyrë shtëpie (për orën e tretë):**

- U.2, fq.106 (Të shkruarit) *Ktheni rrëfimin poetik të mësipërm në prozë duke përdorur teknikat e tekstit rrëfyjes.*

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• diskutojnë brenda etikës së komunikimit për të interpretuar mesazhet konkrete të poemës;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit rrëfyjes poetik dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin “Një këngë nga Çanggan” (Li Bai);</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes rrëfimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 31</b>			
<p>Nxënësit vendosen në situata të leximit, të të folurit, të të dëgjuarit dhe të të shkruarit, duke përcaktuar llojin e tekstit “Peripeçitë e ngjitjes në Everest”, tiparet e tij, si tekst rrëfyesh, si dhe ndërthurjen e rrëfimit me elemente të përshkrimit. Ata dallojnë teknikat e shkrimit në këtë tekst, si dhe funksionet e këtij lloj teksti.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p>			
<p>Nxënësi bashkëbisedon për llojin rrëfyesh mbi ngjarje reale, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të; diskuton mbi tekstin konkret, duke analizuar dhe vlerësuar tiparet e tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p>			
<p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e tekstit rrëfyesh, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura e arti dhe ngjarjet e përditshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p>			
<p>Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin e tekstit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p>			
<p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të tekstit rrëfyesh me elemente të përshkrimit, kritikës së tij.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p>			
<p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojit rrëfyesh, që mbështet qëllimin e tij.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me tekstin rrëfyesh me elemente përshkruese për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• Bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit rrëfyesh të këtij lloji, si dhe analizon e interpreton kuptimet që merr fjala brenda një konteksti;</li> <li>• Analizon tema të ndryshme, duke zbuluar gjuhën e figurshme të tekstit rrëfyesh, si dhe duke identifikuar faktin e opinionin në një tekst rrëfyesh;</li> <li>• Shkruan qartë dhe me stil vetjak e brenda rregullave të drejtshkrimit, duke përdorur materiale të ndryshme burimore që e ndihmojnë gjatë këtij procesi.</li> </ul>		<p>tekst rrëfyesh me elemente të përshkrimit, alpinist, ekspeditë.</p> <p><b>FJALOR</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ aklimatizim,</li> <li>■ sureale</li> <li>■ ekspeditë</li> </ul>	

<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit: fragment (“Peripecitë e ngjitjes në Everest”, Gj. Bojaxhi), interneti, shkenca e gjeografisë, dokumentarë televizivë etj</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, projektor, <i>fleep-charter</i>, shumësia me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga F.S Noli.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Arte:</b> Nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga “Peripecitë e ngjitjes në Everest”, si dhe për të interpretuar imazhet e fotografitë etj. <b>Letërsi:</b> Përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës. <b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme që lidhen me temën. <b>Qytetari:</b> Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore gjatë diskutimit për temën. <b>Gjeografi:</b> Nxënësi përdor njohuritë që ofron kjo shkencë për majën e Everestit.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vëzhgim për të kuptuar</li> <li>• stuhi mendimi /ditar dypjesësh</li> <li>• grupet e ekspertëve</li> <li>• vëzhgim për të kuptuar dhe folu</li> <li>• Punë e pavarur</li> <li>• shkrim i lirë</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Ora hapet me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Një nxënës lexon detyrën, e cila më pas komentohet për nga shkalla e realizimit dhe e përmbushjes së kërkesave me nxënësit e tjerë. Kjo do të shërbejë që të rikujtojmë edhe një herë teknikat e shkrimit të tekstit rrëfyes. (Nxënësit orientohen që ta kenë lexuar më parë tekstin në mënyrë që të fitojmë kohë në punën me detyrat e klasës.)</p> <p>➤ Më pas nxënësit ftohen të vëzhgojnë foton e mëposhtme:</p> <div data-bbox="525 1347 1042 1800" style="text-align: center;"> </div> <p>➤ Në tabelë janë paraqitur pyetjet, që duhen plotësuar nga nxënësit (ditari dypjesësh).</p>	
<p><b>Pyetje</b></p>	<p><b>Përgjigje</b></p>

Cilat janë impresionet e para që ju krijon kjo foto?	
Si mendoni ju, pse autori ka zgjedhur të rrëfejë një përvojë të tillë?	
A ju tërhoqi ideja e ngjitjes së majave? Pse?	
Ju tërhoqi më shumë informacioni i këtij teksti, rrëfimi mbi këtë informacion apo mënyra e përshkrimit?	
Po fakti që në atë majë u shpalos për herë të parë flamuri shqiptar si ju bën të ndiheni?	

Listohen idetë më të rëndësishme, të cilat do shërbejnë për të kaluar në fazën tjetër.

➤ Le t'i qasemi më afër së bashku këtij teksti për të provuar (vërtetuar, saktësuar) përshtypjet e para.

- Analizoni **titullin** e pjesës:
  - ndërtimi

(**Model:** fjali e paplotë emërore)

- imazhet që ju zgjon

(**Model:** sfidë, krenari, frikë ...)

- Analizoni fjalinë hyrëse të tekstit dhe klasifikojeni atë, sipas parametrave të organizimit të hyrjes së një teksti rrëfyes.


(**Model:** një fjali mbi problemin)

- Gjeni momente të kalimit nga ligjërimi i drejtë në të zhdrejtë. Ç'fiton teksti nga kjo zhvendosje?

(**Model:** Gjithçka e ke para syve dhe nuk arin t'u besosh syve: është apo s'është e vërtetë e gjithë kjo?

Kjo përzierje ligjërimesh na ofron përzierjen e zërit dokumentues, faktik dhe zërit nostalgjik, brenda teknikës polifonike të shkrimit të tekstit.)

- Këtu: gjeni një fakt dhe një opinion të autorit lidhur me faktin. Shpjegoni raportin që krijohet mes tyre. (në ndihmë të nxënësit vjen dhe skema e parapërgatitur mbi opinionin dhe faktin.



- Në bashkëpunim me nxënësit rikujtojmë dallimin mes argumentit dhe opinionit

ARGUMENTI	OPINIONI
Objektiv	Preferenca subjektive
Fakte	Pohime
Dëshmi e provueshme	Supozime
Mbështet opinionin	Ndërtohet mbi argumente
Interpretohet	Interpretohet

- Në këtë fazë funksionon **grupi i ekspertëve**. Nxënësit ndahen në grupe me nga 5 nxënës, secili nga ata ka detyrën e vet. U lihet në dorë nxënësve arsyetimi. Ndahen detyrat:

- **Nxënësi me nr.1:** (U.1/2;fq112)

A. Gjeni të paktën një shembull nga teksti ku rrëfyesi përdor përshkrimin për të na njohur me rrethanat. Si e ndihmon përshkrimi ankthin që ju ndjell rrëfimi i alpinistit?

(Model: Paragrafi II- stresi, presioni i përgjithshëm, ngjitja dukej e *pabesueshme, gati surreale*. Ky përshkrim i rrethanave të ngjitjes, përmes epitetesh që lidhen më shumë me përrallën sesa me realitetin, ngacmon imagjinatën e lexuesit, duke e ngarkuar atë me kuriozitet që të mban shpirtin pezull mbi aventurën e alpinistit...)

B. Çfarë do të kishte ndryshuar në këtë rrëfim, nëse do të tregohej në vetën e tretë?



(**Model:** fiton distancë objektive të rrëfyesit me rrëfimin dhe ngjarja bëhet më e besueshme, pasi zhvishet nga subjektivizmi i rrëfyesit.)

- **Nxënësi me nr.2 :** (U.6/ 7; fq 112)

A. Përqendrohuni tek paragrafi “...Me vete kisha...” deri te “... dhe dy të vajzës”. Shpjegoni si plotësohet karakteri i alpinistit me një dimension të ri.

(**Model:** Në këtë paragraf autori sjell një aspekt të ri të natyrës së tij që reflektohet në rrëfimin e tij. Rrëfimi plotësohet me tone të humorit të këndshëm, por aty zbërthehen disa mesazhe që lidhen me sinjalin që jep autori që “njerëzit e vegjël” (këtu: kukullat) mund të ngjitin lartësitë e mëdha. Përfytyrimi zgjerohet në atë që njeriu është i vogël përballë natyrës dhe në mënyrë të natyrshme autori zbulon subkoshiencën e tij që lidhet me ëndrrën e njeriut për majat. Fakti që e lidh me fëmijët (ata ia dhanë kukullat), jo vetëm zbulon dashurinë e tij për fëmijët, por e shtyn këtë tendencë njerëzore ndër breza. Ky është njeriu i zbuluar deri në thellësitë ekzistenciale.)

B. Analizoni paragrafin e mësipërm duke reflektuar mbi tonin, përzgjedhjen e fjalëve, komunikimin me fëmijët .(**Model:** Tonet janë të gëzueshme, zëri i rrëfyesit vjen gazmor dhe me nuanca humori, që duket në përzgjedhjen e fjalëve (“njerëz të vegjël”), por është edhe disi misterioz. (“fshhtësi”)

- **Nxënësi me nr.3:** (U.4/9; fq.112)

A. Nëse do ta shihnim nga pikëpamja e vetëvlerësimit, si e paraqet veten rrëfyesi?

(**Model:** Duke qenë i ndërgjegjshëm se shkrimi nuk është personal dhe i drejtohet një publiku gjykues, ai përpiket të jetë i vërtetë, por gjithsesi në momentin e parë mund të duket sikur ka një lloj idealizimi të vetes për të dhënë një imazh, siç do ta donte lexuesi, zmadhohen efektet e veprimeve të tij dhe vetë veprimet, duke u orientuar drejt heroizmave, por duke pasur kulturën e nevojshme mbi sfidën e ngjitjes në Everest vërejmë madhështinë e sfidës.)

B. Teksti tregon përshkrime interesante të një përvoje të pangjashme me asgjë, që ngjall mbresa tek lexuesi. Ç’mbresa fitoni vetvetiu (apo rifitoni ju, nëse i keni përjetuar nga lexime të aventurave të ngjashme, nga filma dokumentarë ose artistikë.)

(**Model:** Mbresat lidhen me detajet fantastike që përshkruan autori, informacionet mbi një vend të tillë që jo kushdo ka fatin ta prekë. Nxitet dëshira për aventurë, njeriu ndihet i pushtetshëm për të sunduar natyrën...)

- **Nxënësi me nr.4:** (U.3/10; fq.112)

A. Cilat janë disa nga vështirësitë që lartësi të tilla u paraqiten alpinistëve? (**Nxënësi i zbulon ato në tekst**) Alpinisti tregon një fakt tronditës se në Everest gjenden 100–120 trupa të vdekur, gjë që flet se sa e rrezikshme ka qenë dhe është sfida që kanë ndërmarrë. Si e gjykoni këtë fakt? Mendimin tuaj ilustrojeni me pjesë nga rrëfimi.

(**Model:** Të ngjitësh Everestin nuk është gjë e lehtë; kërkon sakrificë gjë që provohet edhe nga faktet e sjella në tekst. Por sjellja e këtij fakti nuk është shkak frenimi për lexuesin, por është tregues i madhështisë së këtij veprimi, si model i sfidës ndaj vdekjes.)

- **Nxënësi me nr.5:** (11/12; fq.113)

A. Gjeni në tekst mendimin e alpinistit për dukurinë e vdekjes gjatë përpjekjeve për të arritur majën e Everestit. Tregoni si e sheh alpinisti këtë dukuri dhe interpretoni këndvështrimet e tij.

(**Model:** Kërkimi shtrihet që nga paragrafët e parë, me sfidat që duhet të kalojë alpinisti, para dhe gjatë kësaj lëvizjeje, deri në momentet kur ai merr kontakt të drejtpërdrejtë me vdekjen. Por a thotë: “nuk mund ta mohoj... ta merrje më seriozisht ngjitjen” dhe kjo do të thotë se ai jo vetëm që nuk frenohet nga vdekja, por e sfidon atë. Kjo ngjitje i jep kuptim në formën më të

plotë jetës dhe për aq kohë sa kjo funksionon vdekja nuk ka vend.

**B. Thonë që “Mali e ashpëron njeriun”. A ju duket se ndodh kështu me dy alpinistët që kemi njohur deri tani përmes teksteve tona: alpinisti baba në tregimin e Natali Ginzburgut dhe alpinisti baba në rrëfimin e mësipërm? Ilustroni përgjigjen tuaj me pjesë nga tekstet. (Nxënësit gjykojnë sipas opinionit të tyre në plan krahasues)**

- Ekspertët kthehen në grupet e tyre dhe shpjegojnë secilën pyetje në mjedisin e tyre. Diskutime brenda grupeve. Mësuesi ndjek diskutimin e nxënësve dhe ndërhyr për qartësi në rrethana të caktuara.
- Në projektor mësuesi paraqet material të shkurtër dokumentar për malet e Himalajës ose foto nga kjo hapësirë për të nxitur frymëzimin krijues të nxënësve, gjë që përgatit situatën e re, në fazën vijuese.

Pasi nxënësit kanë parë edhe materialin filmik (2 -3 minuta) ushtrohen në punë grupesh. Do të orientohen të punojnë në 3 grupe:

**Grupi I:** Nxënësit e këtij grupi zgjedhin në mënyrë individuale të përcaktojnë nëse e konsiderojnë rrëfimin e alpinistit mbi përvojën e ngjitjes, si:

- a. thjesht të mrekullueshme;
- b. të pangjashme me asgjë;
- c. festive, madje ceremoniale;
- ç. profesionale dhe e pritshme.

**Grupi II:** Nxënësit diskutojnë për mënyrën se si e kuptojnë ata përsëritjen e vazhdueshme të fjalës sureale në tekst, si dhe shprehin mendimin e tyre nëse e konsiderojnë edhe ata sureale një situatë të tillë? Në këtë interpretim ata ndihmohen edhe nga të dhënat e U.8; fq112.

**Grupi III:** Nxënësit lexojnë U.13; fq113, dhe, duke u mbështetur në orientimet e dhëna në tekst, ndërtojnë me gojë një mbyllje tjetër të tekstit, ku të evidentohen sakrificat, vështirësitë, por edhe madhështia e këtij aksioni.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** (shkrim i lirë)

Klasa ndahet në 15 grupe (sa paragrafë ka edhe teksti). Secili grup sipas kërkesës (U. 3; fq.113), së pari shkruan me pak fjalë bërthamën e paragrafit dhe, më pas, kthen paragrafin nga veta I në vetën III.

Pasi vërejnë se ç’ndodh me rrëfimin, diskutohet në klasë për këtë teknikë shkrimi.

**Detyrë shtëpie:**

U.1; fq.113. Nxënësit do të përshkruajnë një përvojë personale sipas modelit të këtij ushtrimi.

**Vlerësimi i situatës:**

**Vlerësimi i nxënësve:**



<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit rrëfyës mbi një përvojë personale dhe i zbërthejnë ato konkretisht;</li> <li>• diskutojnë mes tyre mbi çështje të ndryshme, brenda etikës së komunikimit;</li> <li>• shkruajnë saktë, përmes një stili vetjak dhe duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë në përgjigjet individuale dhe diskutimet në grup;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë prezantimit të ndjesive që përjeton, si dhe interpretimit të çështjeve të caktuara të tekstit konkret;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>
--	---

**TEMA MËSIMORE 4.2 (8) “PERIPECITË E NGJITJES NË EVEREST”, GJERGJ BOJAXHI.  
DREJTSHKRIMI I EMRAVE TË PËRVEÇËM**

<p><b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b></p>	<p><b>Lënda: Gjuhë shqipe</b></p>	<p><b>Shkalla V</b></p>	<p><b>Klasa 10</b></p>
<p><b>Tematika: Bota përmes rrëfimit</b></p>			
<p><b>Situata e të nxënit nr. 32</b></p> <p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me drejtshkrimin e emrave të përveçëm, duke u ushtruar në ushtrime konkrete që lidhen me tekstet rrëfyese në studim, por edhe më tej.</p>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, letër formale dhe joformale, autobiografi etj.</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për tema nga fusha e gjuhës që lidhen me përdorimin dhe drejtshkrimin e emrave të përveçëm.</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë të caktuar që lidhet me temën.</p> <p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</p> <p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash, në mbështetje të koncepteve gjuhësore të caktuara.</p>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të emrave të përdorur në tekst;</li> <li>• Zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit, që lidhen më emrat e përveçëm në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit;</li> <li>• Ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për emrat e përveçëm, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstet e llojit rrëfyes (“Jeta ime”; “Një këngë nga Çang’gani” dhe “Peripecitë e ngjitjes në Everest”).</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>analizë morfologjike emra të përgjithshëm/ të përveçëm; emërtime rregulla të drejtshkrimit të emrave të përveçëm.</p>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, Fjalori i Gjuhës Shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> fleep-charter, projektor, tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmentet në tekst nga teksti rrëfyes.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> Përdor tekstet letrare për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes në lidhje me klasën e emrave;</p> <p><b>Shkenca shoqërore:</b> Përdore tekste të tilla, si gjeografi, histori, shkenca sociale etj, për të studiuar përdorimin e emrave të përveçëm në kontekste të ndryshme;</p> <p><b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim</li> <li>• stuhi mendimi/tabela e koncepteve</li> <li>• bisedë e kombinuar me shpjegim, DDM</li> <li>• Mendo/puno në dyshe/shkëmbe me të tjerët,</li> <li>• Punë e pavarur</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. (U.1; fq.115) Lexohen nga nxënësit dy punime dhe diskutohet mbi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• mënyrën e realizimit të fjalisë hyrëse;</li> <li>• teknikat e shkrimit (teknika e së vërtetës, teknika e dramaticitetit, teknika e detajeve, teknika polifonike);</li> <li>• ndërthurjen e elementeve rrëfim dhe përshkrim;</li> <li>• përdorimin e emrave të njerëzve, kafshëve, vendeve ...etj.</li> </ul> </li> <li>➤ U kërkohet nxënësve të tjerë të nënvizojnë emra të kategorisë së mësipërme në punimet e tyre dhe ndihmohen ata të kujtojnë <u>klasën e emrave</u>, kategorinë (i përgjithshëm / i përveçëm).</li> <li>➤ Në tabelë paraqitet ndarja sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe e emrave në: të përgjithshëm / të përveçëm.</li> </ul>	

**EMRI  
SIPAS FJALORIT  
TË GJIJHËS**

**I PËRGJITHSHËM:**

emërton një klasë të tërë qeniesh të gjalla, sendesh a dukurish, sipas tipareve të tyre të përbashkëta (njeri, dele, ujk, libër, liri, lumturi...)

**I PËRVEÇËM:**

emërton një qenie a një send të veçantë, duke e dalluar nga qeniet a sendet e të njëjtit lloj dhe pa shprehur ndonjë lidhje ndërmjet qenies a sendit të veçantë e kuptimit të përgjithshëm që ka a mund të ketë pasur fjala emërtuese ose togfjalëshi emërtues (Agimi, Shqipëria...)

- Është momenti që nxënësit të ndahen në 3 grupe me detyrën e përbashkët: *Nëvizoni me të kuqe emrat e përveçëm dhe me blu emrat e përgjithshëm në tekstet rrëfyese:*
  - GRUPI I: punon me tekstin “Jeta ime”;
  - GRUPI II: punon me tekstin “Një këngë nga “Çang’gan”;
  - GRUPI III: punon me tekstin “Peripecitë e ngjitjes në Everest”.

Plotësoni ditarin tripjesësh (nga një nxënës për secilin grup plotëson tabelën përpara klasës):

emri	i përgjithshëm/ i përveçëm	emërton
Everest		
Jeta		

- Nxënësve u kërkohet të krijojnë (me gojë) fjali të tyret me shembujt që kanë paraqitur në tabelë (të nxjerra nga tekstet në studim; p.sh.: me fjalën ). Mësuesi ndërhyr për të saktësuar idetë. Ai vlerëson nxënësit për mënyrën e të shprehurit dhe saktësinë në të shprehur, si dhe për shkathësinë në përgjigje.
- Në projektor është paraqitur tabela e mëposhtme:

Shkruhen me shkronjën e parë të madhe :		Shembuj
1.	emrat dhe mbiemrat e personave realë (apo personazheve) si dhe pseudonimet e tyre;	Gjergj Kastrioti , Aleksandër Duma i Biri, Gjon Buzuku, Ismail Qemali, Aleksandri i Madh, Migjeni, Çajupi, Vaçe Zela, Dritëro Agolli, Erazmi etj.
2.	emrat e mbiemrat e përveçëm, të cilët, megjithëse <u>përdoren për të shënuar një kategori të caktuar njerëzish</u> , nuk janë	Janë të rrallë në histori <i>Gjergj Kastriotët</i> . Ai është një <i>Promete</i> i ditëve tona.

	kthyer në emra të përgjithshëm;	
3.	emrat e përveçëm të botës mitologjike e fetare, si edhe ata të figurave e të tregimeve popullore, emërtimet e planetëve, të yjësive e të trupave qiellorë;	Eva, Adami, Buda, Krishti, Zeusi Jupiteri, (tek grekët dhe romakët), e Bukura e Dheut, Hirushja, Borëbardha, Ylli Polar etj.
4.	emërtimet e funksioneve shtetërore, politike, të gradave e titujve etj, që janë bërë pjesë e pandarë e një emri të përveçëm.	Princ Vidi, Baba Faja, Hoxha Tahsini, Kont Urani

- Mësuesi kërkon nga nxënësit që të plotësojnë shembujt në tabelën më lart me fjalë nga tekstet rrëfyese (“Jeta ime”, “Peripecitë e ngjitjes në Everest” dhe “Një këngë nga Çanggan”).

**(Model:** Përfshihen në tabelën më sipër, tek shembujt që ilustronë rregullin e parë:

*Sumba, Ibrik-Tepe, Fan Noli, Theofani, Shasha, Zoti...*)

- Në këtë moment mësuesi ndan në klasë formate me tekstet e mëposhtme (mund të zgjidhen edhe tekste të tjera që të përmbushin kërkesën). Klasa ndahet në dy grupe të mëdha. Secili nxënës pajiset me formatin e tij.

*Kërkesa: Shkruani sipas rregullave të drejtshkrimit të shkronjës së madhe (të vogël) për emrat e përveçëm (të përgjithshëm), tekstin e mëposhtëm.*

- Sipas teknikës, Mendo/puno në dyshe/shkëmbe me të tjerët, rregullojnë gabimet në tekst, sipas rregullave të drejtshkrimit, në mënyrë individuale. Më pas e diskutojnë detyrën në dyshe, pastaj ndahet mendimi me grupet e mëdha dhe dilet me një punim të vetëm.

1.

Kur flasim për kostumin Shqiptar është nevoja për ca shpjegime. Populli shqiptar është shumë individualist dhe nuk vesh gjithnjë po një rrobe. E vërteta është se ka aq kostume shqiptare, sa ka edhe qarqe të ndryshme në Shqipëri. Po përmbi këtë ndryshim lokal ka qenë gjithnjë një farë veshjeje e përgjithshme në karakteristikat e saj që mund të quhet kostum kombëtar. Flokja midis të tjerash, ka pasur në formë të saj një farë afrimi në të gjithë vendin dhe fustanella, gjer pak kohë më parë, ishte një pjesë e veshjes kremtërore të çdo njeriu prej dere të mirë, si në Shqipëri të sipërme ashtu edhe në Shqipëri të poshtme. Puna që të tilla moda veshjeje mund të gjenden edhe në vendet fqinje s’regon tjetër gjë veç influencës së fortë që shqiptarët kanë ushtruar në kohën e shkuar mbi kombësitë

2.

Debati aktual i hapur në gazetë në lidhje me atë se ç’po ndodh në shtypin e shkruar, në mënyrë indirekte është një diskutim për funksionimin e demokracisë sonë. Kjo jo vetëm sepse vetë media është një nga "Pushtetet" e demokracisë, por edhe sepse përmes medias shoqëria (opinionin publik, thuhet së fundi) realizon kontrollin e saj mbi pushtetet e tjera. Është pikërisht kjo cilësi që i jep asaj autoritetin dhe karakteristikat e një pushteti të katërt. Me fuqizimin e medias elektronike, me fuqizimin dhe penetrimin në rritje të internetit, por edhe të burimeve të tjera të informacionit, që sa vjen e bëhen edhe më globale, pa asnjë dyshim që edhe media e shkruar në Shqipëri, që nga veriu në jug, duhet të përshtatej me këtë realitet të ri. Brenda këtij pushteti, roli i medias së shkruar gjithsesi mbetet specifik. Pavarësisht

rreth e rrotull. Për shembull, është thënë me përsëritje prej studiuesve të këtij subjekti se i ashtuquajturit kostum "modern" grek në të vërtetë është një imitim i poshtër i kostumit shqiptar. Ky kostum u përhap në mes të grekëve në shek. XIV, kur shqiptarët nën bua Shpatën shkelën dhe pushtuan Greqinë.

se media elektronike ka një ndikim publik më të gjerë, qoftë në Francë, qoftë në Itali apo SHBA, duhet t'i drejtohesh shtypit të shkruar. E, në këtë këndvështrim, një analizë specifike e gjendjes së medias së shkruar është e domosdoshme, pavarësisht se duket disi e vonuar, qoftë në Veri të Shqipërisë, ashtu edhe në Jug.

- Gjatë diskutimit në klasë, mësuesi kërkon nga nxënësit të shpjegojnë rregullën që kanë zbatuar, duke iu referuar tabelës në projektor.

(**Modeli 1:** kostumin shqiptar, qarqe, Shqipëri të Sipërme, Shqipëri të Poshtme, shqiptarët, kombësitë, grek, grekëve, Bua Shpatën, Greqinë.

(**Modeli 2:** gazetë, demokracisë, media, pushtetet, Shqipëri, veriu, jugu (nuk është e njëjta situatë me: "Veri të Shqipërisë, ashtu edhe në jug", ku *veri* dhe *jug* shkruhen me shkronjë të vogël).

- Mësuesi fton nxënësit të shikojnë rastet më poshtë, të cilat paraqiten me *fleep-charter* (projektor).
- Përmes teknikës DDM, klasifikojnë njohuritë e tyre të qëndrueshme dhe ato të reja në raport me përdorimin saktë të shkronjës së madhe në emrat e përveçëm.

1. Perëndim i vagëlluar mbi Liqerin pa kufir. Po përhapet dal – nga - dalë një pluhurë si një hije. Nëpër Mal e nër Lëndinë Shkrumb' i natës që po bije, dyke zbritur që nga qjelli nëpër fshat po bëhet fir..	2.
	ministri i Arsimit
	deputeti i Kuvendit Popullor
	Presidenti i Republikës
	Mbretëresha Teutë

- Plotësohet ditari tripjesësh

Di	Dua të di	Mësova
1. Emrat e përgjithshëm shkruhen më shkronjë të vogël në fillim të fjalës.	Po në rastin e poezisë së L.Poradecit pse shkruhen me shkronjë të madhe (Liqer...)?	Në rastin konkret, autori për efekte stilistikore i trajton këta emra të përgjithshëm si emra të përveçëm.
2. Emërtimet e funksioneve shtetërore, politike, të gradave e titujve etj, që janë bërë pjesë e pandarë e një emri të përveçëm.	Po në rastin në tabelë pse shkruhen me të vogël (ministër...)	Rregulli përfshin rastet kur janë bërë pjesë e pandarë e emrit të përveçëm.

#### Detyrat dhe puna e pavarur:

Punë në çift:

Kërkesa: Jepini njëri-tjetrit një listë me pesë emra, ku janë shkruar gabim emrat e përveçëm.

(Rastet e përdorimit të jenë të ndryshme.) Përcaktoni rregullën që nuk është përdorur saktë për secilin

rast.	
<p><b>Detyrë shtëpie:</b>          Kërkesa: Në tekstin “Peripeçitë e ngjitjes në Everest” <i>evidentoni shprehjet frazeologjike. Përdorni të njëjtat shprehje në një shkrim tuajin që lidhet me mbresa nga një sfidë personale. Kujdesuni të përdorni në shkrimin tuaj të paktën 5 emra të përveçëm, duke përfshirë emra që përmbushin rregullat e tabelës së njohurive të mësipërme. (emra realë, emërtime postesh a funksionesh...)</i></p>	
<b>Vlerësimi i situatës:</b>	<b>Vlerësimi i nxënësve:</b>
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me zbatimin e rregullave të shkrimit të shkronjës së madhe tek emrat e përveçëm;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore;</li> <li>• shpjegojnë drejt rregullat e përgjithshme dhe përjashtimet që lidhen më temën.</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 4.2 (9) “PERIPECITË E NGJITJES NË EVEREST”, GJERGJ BOJAXHI. FOLJET KALIMTARE DHE JOKALIMTARE**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes rrëfimit</b>			
<b>Situata e të nxënësve nr. 33</b>			
Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me klasën e foljeve dhe klasifikimin e tyre në kalimtare dhe jokalmimtare, duke u ushtruar në ushtrime konkrete me to.			
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>          Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, letër formale dhe joformale, autobiografi etj.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b>          Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga fusha e gjuhës.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënësve</b>          Nxënësi shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, sipas qëllimeve që i cakton vetes.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b>          Nxënësi ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë</p>			


<p>mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</p> <p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të foljeve (sipas klasifikimit kalimtare/jokalimtare të përdorura në tekst);</li> <li>• Shkruan saktë dhe pa gabime;</li> <li>• Zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore që lidhen me përdorimin e llojeve të ndryshme të foljeve në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit;</li> <li>• Ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për foljet kalimtare dhe jokalimtare, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstin “Peripecitë e ngjitjes së Everestit”;</li> <li>• Shkruan qartë me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike tekste rrëfyese për qëllime dhe për audiencë të ndryshme.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Analizë morfologjike Pjesë e ndryshueshme e ligjëratës Folje kalimtare /jokalimtare kalimtare (të drejta/të zhdrejta)</p> <p><b>FJALOR</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Aforizëm</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, fjalori i gjuhës shqipe, tekste plotësuese</p> <p><b>Mjete:</b> <i>fleep-charter</i>, projektor, tabela, shumësia me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga Gj. Bojaxhi.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> Përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes</p> <p><b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi, që lidhen me kategoritë e foljes.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• harta e mendjes</li> <li>• bisedë e kombinuar me shpjegim, DDM</li> <li>• Mendo/puno në dyshe/shkëmbe me të tjerët,</li> <li>• tabela e klasifikimit</li> <li>• Punë e pavarur</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit kanë realizuar një shkrim për mbresat nga jeta personale, në të cilin do të përfshiheshin <i>shprehjet frazeologjike</i> të tekstit “Peripecitë e ngjitjes në Everest”, duke përdorur <i>5 emra të përveçëm</i>, (emra realë, emërtime postesh a funksionesh...)</p> <p>➤ Diskutohet mbi përmbushjen e kërkesave të ushtrimit si dhe mënyrën e realizimit të tekstit rrëfyës mbi një mbresë nga e kaluara, në 2 prej punimeve të nxënësve. Gjithashtu, u kërkohet nxënësve të shpjegojnë teknikat : e së vërtetës, të dramaticitetit, të detajeve dhe ato polifonike në punimet e detyrave të shtëpisë.</p> <p>➤ Më pas nxënësit orientohen të nënvizojnë nga 5 folje në punimet e tyre. Lexohen disa</p>	



shembuj dhe nxiten ata të kujtojnë klasën e foljeve.

Kërkesë: Nënvizoni me të kuqe folje që tregojnë veprime që bien mbi një kundrinor dhe me blu folje, veprimi i të cilave nuk ndiqet nga një kundrinor (i drejtë ose i zhdrejtë).

- Në tabelë mësuesi shkruan "**folja**" dhe përmes teknikës "**stuhi mendimi**" kërkon nga nxënësit të rikujtojnë njohuritë që lidhen me të. Në tabelë plotësohet në bashkëpunim me nxënësit skema e mëposhtme:



- Nxënësve u kërkohet të shpjegojnë tabelën e mësipërme përmes shembujve që kanë nxjerrë nga punimet e tyre të detyrës së shtëpisë. Mësuesi ndërhyr për saktësi në shpjegim.
- Në këtë fazë nxënësve u kërkohet të lexojnë tekstin "Peripeçitë e ngjitjes në Everest", të ndarë në 2 grupe:
  - Grupi I: Zbuloni 3 folje në numrin njëjës (analizojini ato) (**Model:** Në fjalinë: Ndjesinë që maja do të jetë e jotja..., do të jetë - folje, numri njëjës, veta III, mënyra dëftore, koha e ardhme, diateza....)
  - Grupi II: Zbuloni 3 folje në numrin shumës (analizojini ato).

Pyetje: Si mendoni ju, në tekstin rrëfyet, cili është raporti mes foljeve dhe mbiemrave apo emrave?



**Model:** Lexoni aforizmën e mëposhtme:

"E vërteta është si luani. Nuk ke pse e mbron. Liroje dhe e mbron vetë veten."

Dalloni dendësinë e përdorimit të foljeve në raport me pjesët e tjera të ligjëratës.

(Nxënësi duhet të provojë se një tekst rrëfyet në dallim nga ai përshkruar funksionon përmes foljeve, pasi ky tekst synon aksionin më shumë sesa përshkrimin e situatave. Mendimi do të ilustruhet me shembuj nga teksti në studim "Peripeçitë e ngjitjes në Everest".)

- Në projektor është paraqitur tabela e mëposhtme: (në mungesë të projektorit, mund t'u jepet secilit nxënës një format me njërin nga tekstet.)



1.

- Cili je ti? Ç'kërkun në këtë vend? A mos ke humbur gjësend e ke dalë ta kërkosh?

- Unë jam bari lopësh, rrogëtar për bukë e kripë, - u tha Muji. – gjithë ditën bredh bjeshkëve pas kullotave. Sot më ndodhi një e keqe e madhe: humba lopët e tim zoti e dola t'i kërkoj. Nata më zuri në këtë vend e u ula të prehem, të fle. S'munda të mbyll sy, se qanin këto dy foshnja. M'u dhimbsën e u përkunda djepet. Mezi i vura në gjumë.... Po ju ç'jeni? Ç'e keni këtë dritë të bardhë që ju ka veshur fytyrën dhe shtatin?

Ato e njohën sakaq Mujin se e kishin parë shumë herë, nga larg, bjeshkëve e mrizeve tek kulloste e mrizonte lopët. I thanë:

- Ne jemi zana, Muj. Dolëm, si çdo natë, lart e poshtë nëpër botë që të ndihmojmë njerëzit e mirë e të drejtë. I lamë foshnjat vetë. Ti, Muj, paske qenë njeri i mirë, i paske përkundur e i paske vënë në gjumë. Rrofsh e qofsh! Na thuaj tani, o Muj, ç'kërkun të japim ne për të mirën që na bëre? A do forcë, Muj? A do luftë të luftosh? A do mall e gjë? A do dije? A do gjuhë? Kërko ç'të duash e ne do të ta japim.

Ja ç'u kërkoi Muji zanave:

2.

Jo shumë larg vendit ku unë jetoj, gjendet një kodër që ndahet në mes nga një përrua. Nga gërryerja e vazhdueshme e ujit është formuar një pjesë toke, në të cilën ka rrënjë të vjetra dhe guralecë që bien shumë në sy. Po ta shohësh nga larg, nuk dallohet gjë tjetër veçse një djerrinë toke e ngritur. Por, kur i afroresh, vëren diçka të mrekullueshme, një strehë të vogël shkëmbore që duket po aq e ndërlikuar dhe e ndërtuar mirë, sa dhe ato që la kultura e lashtë, kur u zhduk në mënyrë misterioze, shekuj më parë. Kjo kodër, e kthyer në mijëra hoje, mund të shfaqej si një qiell i shndritshëm, ku bletët jetonin e ngordhnin. Është një kodër me labirinte. Në të çarat e disa prej gërmimeve dalin gjysmërrathë prej argjili, që u ngjajnë tendave të diellit, të vendosura mbi dyer. Kjo është një tokë e kthyer në argjilë në hojet e bletëve dhe bëhet e dukshme sa herë që ato gërmojnë thellë në strehëzat e tyre.

### Kujdes!

Nuk janë nënvizuar të gjitha foljet; nxënësit duhet të zbulojnë edhe foljet e tjera në tekst.

- Nxënësit do të lexojnë këto fragmente, të ndarë në 2 grupe. Ata do të nënvizojnë sa më shumë folje dhe do t'i klasifikojnë ato në folje që pranojnë kundrinor (të drejtë ose të zhdrejtë) dhe në folje që nuk pranojnë kundrinor (të drejtë ose të zhdrejtë).
  - Do të punohet me teknikën: **Mendo/puno në dyshe/ndaj me të tjerët.**  
Pasi punojnë individualisht, nxënësit ndahen në grupe dyshe dhe diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas, zgjerojnë diskutimin në grupe të mëdha dhe dalin me një konkluzion të përbashkët.

Folje që pranojnë kundrinor	Folje që nuk pranojnë kundrinor
tha (kujt?- kundrinor i zhdrejtë)	dal
përkunda (kë? / kujt))	qanin

- Ftohen nxënësit të përkufizojnë vetë konceptin kalimtar dhe jokalmimtar të foljes. (Model: foljet kalimtare janë ato folje që pranojnë një kundrinor; *Vajza bleu librin*. Foljet jokalmimtare janë ato që nuk pranojnë një kundrinor; *Sonte nuk kam fjetur mirë*.)
- Konkluzionet e tabelës së mëposhtme do të nxirren në diskutimet me nxënësit. Ata vetë do t'i nxjerrin konkluzionet dhe do të sjellin shembujt.

Di	Dua të di	Mësova
Foljet që pranojnë kundrinor të drejtë janë folje kalimtare.	Nëse foljet marrin kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë, si emërtohen?	Këto emërtohen folje kalimtare të zhdrejta.
Foljet që nuk pranojnë kundrinor të drejtë janë jokalmimtare.	Po nëse folja ndiqet nga kundrinor i zhdrejtë me parafjalë? ( <i>Flas me shokun</i> )	Në rastin që folja ndiqet nga kundrinor i zhdrejtë me parafjalë, ajo sërish është jokalmimtare.
Di të bëj dallimin mes foljeve kalimtare dhe jokalmimtare.	Po në rast se folja merr njëkohësisht kundrinor të drejtë dhe të zhdrejtë? (M'u dhimbsën e u përkunda djepet.)	Në këtë rast, ato emërtohen folje kalimtare me kundrinor të dyfishtë.
Di të bëj dallimin mes foljeve kalimtare dhe jokalmimtare.	Po për foljet që përdoren herë si kalimtare, herë si jokalmimtare, si do të përcaktojmë grupin të cilit i përkasin?	Duhet vëzhguar se në cilin kuptim janë përdorur në kontekst.

#### Detyrat dhe puna e pavarur:

- Nxënësit do të punojnë fillimisht me U.1; fq.115, për të dalluar dhe krahasuar foljet kalimtare dhe jokalmimtare në tekstin e ushtrimit. Diskutime për ushtrimin.
- Më pas punojnë me U.3 dhe U.4 (fq.115). Diskutime.

#### Detyrë shtëpie:

Kërkesa: *Shkruani një rrëfim të shkurtër të ngjites në Everest nga vështrimi i kukullave që alpinisti i tekstit "Peripeçitë e ngjites në Everest" kishte marrë me vete. Përdorni lloje të ndryshme foljesh kalimtare ose jokalmimtare dhe klasifikojini ato sipas llojit, në një tabelë krahasuese.*

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen shpejt e saktë pyetjeve që lidhen me trajtimin e formave kalimtare dhe jokalmimtare të foljeve;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja kuptimore, drejtshkrimore e gramatikore;</li> <li>• analizojnë drejt funksionet e foljeve në përdorimet e ndryshme të tyre, që lidhen me format kalimtare e jokalmimtare të saj.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për analizat konkrete të foljes në tekste të ndryshme;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të shkruarit me qëllim të përcaktuar (në këtë rast me përdorimin e saktë të foljeve në kontekste të caktuara).</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 5.1 (1): NJOHURI RRETH TEKSTIT UDHËZUES.**

**TEKNIKAT E SHKRIMIT DHE KARAKTERISTIKAT GJUHËSORE DHE STILISTIKE TË TEKSTIT UDHËZUES**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes udhëzimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 35</b>			
<p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi karakteristikat e tekstit udhëzues. Ata përcaktojnë teknikat e shkrimit, si dhe karakteristikat gjuhësore e stilistike të këtij lloji teksti, duke u ushtruar konkretisht në aktivitete të ndryshme gjatë orës së mësimi.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p>			
<p>Nxënësi bashkëbisedon për llojet e tekstit udhëzues, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p>			
<p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për tekstin udhëzues.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p>			
<p>Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me llojin udhëzues.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p>			
<p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit, kritikës së teksteve udhëzuese, si dhe realizimit të teksteve të tilla.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p>			
<p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të teksteve udhëzues që mbështetin qëllimin e tij.</p>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme për adoleshencën, prindërit, rolin e medias, të drejtat e fëmijëve;</li> <li>• përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme</li> <li>• Përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të tekstit udhëzues, duke parafrazuar dhe përmbledhur paragrafë të teksteve të punuara.</li> <li>• Realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të</li> </ul>			<p><b>Fjalët kyçe:</b> tekst udhëzues material udhëzues rregullore udhëzuese aktmarrëveshje</p> <p><b>FJALOR</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ vizual</li> <li>■ manual</li> <li>■ leksiku i lojës</li> <li>■ sistola</li> <li>■ diastola</li> </ul>

shkruarit të paragrafëve dhe teksteve udhëzues, si dhe përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij.

- Përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit argumentues dhe kur shkruan tekste udhëzuese.

**Burimet:**  
Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, modele të tekstit udhëzues në të gjitha format e përfaqësimit, libri i nxënësit.  
**Mjete:** tabela, *fleep-charter*, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor, ose tabelë interaktive)

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**  
**Komunikim:** Nxënësi përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij masiv.  
**Histori dhe shkencat shoqërore,** për kontekstin historik dhe sociokulturor të të gjitha teksteve që studiohen nga nxënësit.  
**Letërsi:** i ofron gjuhës modele të përsosura të përdorimit të gjuhës udhëzuese.  
**TIK:** Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit udhëzues.  
**Qytetari:** Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

- Përvijim i mendimit /Të nxënit ndërveprues
- INSERT
- DRTA (Të menduarit dhe të lexuarit të drejtuar)
- Punë e pavarur
- Skema rreze
- Lexim i koduar (në çift)

**Koha: 45'**

**Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:**

- Me synim përvijimin e mendimit paraqitet pamja e mëposhtme ose modele të ngjashme (rregullore e shkollës, Kushtetuta e Shqipërisë etj.) në projektor (në mungesë të projektorit, nxënësve u jepet në formate të gatshme A4).



- Nxënësit ftohen të interpretojnë fotot.

Pyetje: Ç'loj komunikimi zbulojmë në fotot në studim?

(**Model:** komunikim përmes fjalës, rasti I, dhe nëpërmjet shenjave, rasti II)

Pyetje: Cili është funksioni dhe qëllimi i këtyre komunikimeve?

(**Model:** funksioni praktik. Qëllimi: të udhëzojë të interesuarit për një vend pune mbi rrugët që duhet të ndjekin për ta fituar atë, si dhe të udhëzojë për rregullat e qarkullimit në rrugë)

Pyetje: Ç'mund të thoni për strukturën e tekstit të parë?

(**Model:** nxënësit do të dallojnë specifikat në organizimin e tij; renditjen e fjalëve sipas një radhe të përcaktuar, ndarjen e paragrafëve sipas një strukture të mirëpërcaktuar, elementet e gjuhës së shkrimit etj.)

Pyetje: Ç'modele të tjera tekstesh të kësaj natyre njihni ju?

(Nxënësit mund të sjellin modele të ngjashme sipas mënyrës së tyre.)

- Në këtë moment nxënësit orientohen të lexojnë tekstin deri tek teknikat e shkrimit. Gjatë leximit ata udhëzohen të vendosin shenjat e mëposhtme, duke u sqaruar për funksionimin e kësaj procedure.
- Më pas, informacioni i shenjëzuar hidhet në tabelë.
- Gjithashtu, mësuesi sqaron që edhe procesi i deritanishëm është një tekst (i folur) udhëzues.

**INSERT** → metodë që ju lejon të kontrolloni shkallën tuaj të të kuptuarit gjatë leximit.

√	+	-	?
	procedurat e eksperimenteve në kimi janë tekste udhëzuese		vizual manual

√ (kontrollo) = ajo që lexon pohon atë që dini ose mendoni se e dini  
 + (plus) = një pjesë e informacionit është i ri për ju  
 - (minus) = nëse kjo pjesë informacioni kundërshton ose është e ndryshme nga ajo që dini  
 ? (pikëpyetje) = nëse ka informacion të paqartë ose duhet të dini më shumë për të.

- Diskutohet me nxënësit INSERT-i.
- Në klasë janë sjellë gurët e lojës në mënyrë që çdo veprim në trajtimin e teknikave të shkrimit të tekstit udhëzues të demonstron konkretisht në klasë.
- Sipas **DRTA**, paraqitet tabela e mëposhtme që orienton nxënësit në të kuptuarit e teknikave të shkrimit të një lloj teksti udhëzues.

(KUJDES! Mësuesi duhet të plotësojë tabelën në bashkëpunim me nxënësit përmes teknikës së **leximit të orientuar**; Tabela nuk duhet të jetë e plotësuar!!!)

Hapat e shkrimit	Manuali i lojës domino
<b>Titulli:</b>	Si mund të luajmë domino?
<b>Paragrafi hyrës:</b> (informacione të përgjithshme mbi lojën, ku luhet në ç'kushte dhe terminologjia e lojës)	Një set donimosh duhet të ketë 28 pllakëza prej druri.....
	Sipërfaqja (në të cilën luhet loja) duhet të jetë e sheshtë....
	Terminologjia e lojës (leksiku i lojës), sjellë sipas rendit alfabetik: dopjo dysh/ domino, fushë, tresh etj.

<p><b>Paragrafët zhvillues.</b></p> <p><b>Udhëzimet konkrete mbi lojën:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruara sipas radhës së veprimeve;</li> <li>- të renditura me numra ose me pika;</li> <li>- të shoqëruara me imazhe ose ilustrime;</li> <li>- të shoqëruara me shpjegime për veprimet e lojës;</li> </ul>	<p><b>Fillimi i lojës</b> (demonstrohet në klasë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- ktheji dominotë përmbys;</li> <li>- secili lojtar zgjedh 7 domino;</li> <li>- dominotë mbahen në mënyrë të tillë që të mos i shohë kundërshtari;</li> <li>- lojtari që ka dopjon më të lartë e hedh atë në tavolinë (dopjo gjashta është më e larta, në mungesë fillohet nga dopjo pesa ...);</li> <li>- lojën e fillon lojtari që ka fituar lojën e parë;</li> </ul>
	<p><b>Vazhdimi i lojës:</b> (demonstrohet në klasë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- lojtari tjetër duhet të hedhë një gur që ka një nga pikët e gurit të hedhur nga lojtari i parë;</li> <li>- nëse nuk ka gur të tillë në dorë, duhet të tërheqë nga rezervat që rrinë në anë të sipërfaqes ku luhet loja.</li> <li>- nëse nuk i del asnjë gur i tillë, ai thotë “pas” dhe radha i shkon lojtarit tjetër;</li> <li>- kjo vazhdon derisa të mbarohen të gjithë gurët;</li> </ul>
	<p>Mbledhja e pikëve: (demonstrohet në klasë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- gurët që mbeten në dorë janë pikë për kundërshtarin;</li> <li>- ai që kap 120 pikët më parë është fitues.</li> </ul>
<p><b>Paragrafi përmbyllës:</b> (- nxit lexuesin të kryejë këtë veprimtari; - shpreh diçka mbi kënaqësinë që vjen nga kjo veprimtari; - prezanton një veprimtari që mund të kryhet pas kësaj loje.)</p>	<p>Loja e dominove ka shekuj që luhet nga popuj të ndryshëm të botës.....</p>	

Pyetje: A luani edhe ju kështu domino? Çfarë mund t'i shtoni tjetër këtyre udhëzimeve për të ndihmuar ata që nuk e dinë lojën?

(Nxënësit përgjigjen sipas mënyrës së tyre dhe diskutohen përgjigjet.)

#### Detyrat dhe puna e pavarur:

- Klasa ndahet në 3 grupe, sipas grupeve në modelin më poshtë dhe diskutojnë brenda grupit në çift.

GRUPI I: *Studioni mënyrën, kohën dhe vetën e foljes në tekstin e lojës domino.*

**(Model:** koha e tashme, mënyra lidhore, dëftore/mënyra urdhërore, veta II njëjës ose shumës, ose edhe veta III shumës)

GRUPI II: *Cilat janë mjetet e tjera gjuhësore që përdoren në tekst? (Mjete që tregojnë rrjedhën kohore të veprimit; mjete që tregojnë shkak-pasojë.)*

**(Model:** së pari, pastaj, pas kësaj, ndërkohë etj; sepse, për rrjedhojë, si rezultat..etj; mjete që



mundësojnë krahasimet, si: nga ana tjetër, madje, sikurse etj.; mjete lidhëzore: edhe, gjithashtu etj.)

GRUPI III: *Stili gjuhësor: fjalitë, klasat më të përdorura të fjalëve, terminologjia...*)


(**Model:** fjali të shkurtra, të qarta; pak ndajfolje dhe mbiemra, vetëm sa për t'i bërë më precize udhëzimet; terma teknikë)

- Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë nga një nxënës.
- Në këtë fazë mësuesi shkruan në tabelë: *Shpjegimi brenda tekstit udhëzues.*

**Pyetje:** *A mund të gjeni në tekstin tuaj elemente të shpjegimit? (nxënësit do të gjejnë fjali shpjeguese të lojës dhe do t'i sjellin mendimet në klasë.*

**Pyetje:** *A mund të zbuloni ç'tipare mund të ketë shpjegimi në një tekst udhëzues. Cili do të jetë funksioni i tij?*

- Skema rreze ndihmon për të vjelë mendimet e nxënësve të cilat plotësohen nga mësuesi.



- Nxënësve u kërkohet të lexojnë tekstin (**Funksionimi i zemrës**) dhe gjatë leximit, në grupe dyshe, të kodojnë tekstin për rubrikat e mësipërme. Më pas, ata i lexojnë në klasë përgjigjet e tyre dhe nxirren përfundime.

**Detyrë shtëpie:**

Nxënësit duhet të shkruajnë një tekst udhëzues sipas skemës dhe kërkesës së **U.3, fq: 131**

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përgjigjen saktë në situatat në të cilat vendosen;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit udhëzues (teknikat e shkrimit, strukturën, gjuha etj.) dhe i zbërthejnë ato konkretisht;</li> <li>• shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit që lidhen me tekstin udhëzues.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për analizat tekstuale;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 5.2 (1): SI TË FLASIM ME ADOLESHENTËT RRETH SEKSIT?  
XHENIFER ESHTËN**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes udhëzimit</b>			
<b>Situata e të nxënës nr. 36</b>			
Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin, duke përcaktuar llojin udhëzues, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit e të organizimit gjuhësor të tij.			
<b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon për llojin udhëzues, duke veçuar karakteristikat kryesore të tij, përmes studimit të tekstit konkret.</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e tekstit udhëzues, si dhe ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi.</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të nxënës</b></p> <p>Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave gjatë të nxënës të dijeve të reja, në lidhje me llojin udhëzues.</p> <p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave mbështet avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit, kritikës së këtij lloji si dhe ushtrimit në shkrime të llojit udhëzues.</p> <p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b></p> <p>Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojit udhëzues, që mbështet qëllimin e tij.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
Nxënësi:		■ Tekst shpjegues udhëzues	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me llojin udhëzues, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• Bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së tekstit konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda këtij konteksti;</li> <li>• Dallon elementin shpjegues udhëzues në tekstin në studim;</li> <li>• Përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin udhëzues;</li> <li>• Shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>		<b>FJALOR</b>	
		■ skeptik	
<b>Burimet:</b>		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>	
Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit: fragment ("Si të flasim me adoleshentët rreth seksit?" Xhenifer Eshtën), materiale nga interneti, apo media të tjera që lidhen me temën.		<b>Arte:</b> Nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga "Si të flasim me adoleshentët rreth seksit?"	
		<b>Letërsi:</b> Nxënësi përdor teknikën letrare të	




<p><b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga Xh.Kristi.</p>	<p>interpretimit të kuptimit të fjalës.</p> <p><b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme tekstesh udhëzuese.</p> <p><b>Qytetari:</b> Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p> <p><b>Histori:</b> Nxënësi përdor njohuritë për periudha të ndryshme historike për të analizuar dhe për të vlerësuar tekste të llojit udhëzues në kohë.</p>
--	--

<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• praktikë e udhëhequr hap pas hapi</li> <li>• diskutim</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• DDM - punë në grupe dyshe</li> <li>• ditari dypjesësh</li> <li>• punë e pavarur (shkrim i lirë)</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
---	-------------------------

**Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:**

➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Mësuesi kërkon nga **2 nxënës** të paraqesin në tabelë punimet e tyre, sipas skemës më poshtë:



- Ndërkaq nxënësit e tjerë vlerësojnë duke iu referuar parametrave të mëposhtëm. Ata mbajnë shënime gjatë procesit të dëgjimit për të diskutuar më pas për punimet.

A mbahen parasysh gjatë realizimit të punimit të shokut orientimet që lidhen me:

- ❖ Organizimin e formatit sipas diagramit që kërkon ushtrimi;
- ❖ Tiparet udhëzuese të tekstit;
- ❖ Elementet shpjeguese të tekstit;
- ❖ Ndjekjen e logjikës së radhës së hapave të procesit;
- ❖ Llojin e foljeve që përdoren;
- ❖ Stilin im personal;
- ❖ Raportet shkak-pasojë;
- ❖ Përdorimin e termave teknikë.

- Në tabelë shkruhet tema: **SI TË FLASIM ME ADOLESHENTËT PËR SEKSIN?**
- Nxënësit ftohen të lexojnë paragrafin në hyrje të tekstit.

Pyetje: *A mund të zbulojmë funksionin e këtij paragrafi?*

*A mund të zbulojmë tiparet e një paragrafi udhëzues?*

(Nxënësit do të sjellin idetë e tyre, të cilat diskutohen në klasë. Kryesisht do të shpjegojnë lidhjen e titullit me këtë paragraf /duket sikur ky paragraf është përgjigja më e parë për pyetjen që shtrohet në titull. Do të vënë re edhe foljet e përdorura).

- **Stuhi mendimi.** Tema që studiojmë sot lidhet më shumë se çdo temë tjetër me ju. Cilat janë sipas jush disa nga mënyrat e komunikimit me adoleshentët për çështje të seksit.

(nxënësit sjellin ide të tyre të cilat renditen në tabelë.

(**Model:** - duhet të jemi /ose jo të drejtpërdrejtë në diskutime të tilla;

- është e domosdoshme të flitet me prindërit për këtë çështje në mënyrë që të mos i lihet gjithçka në dorë mjedisit, shoqërisë;
- të folurit për seksin nuk është më një tabu;
- mjafton informacioni që marrim nga shtypi dhe interneti;
- informacionet nganjëherë janë të pakontrolluara dhe krijojnë devijanca të sjelljeve.)

- Në këtë fazë, përmes teknikës së praktikës së udhëhequr hap pas hapi, nxënësit do të lexojnë në dyshe tekstin.
- Gjatë leximit, kodojnë sipas mënyrës së tyre tekstin për të plotësuar më pas tabelën e mëposhtme, duke zbatuar procedurën **DDM**, për të kuptuar tekstin.

Di	Dua të di	Mësova
Problemet e jetës seksuale tek adoleshentët janë të rëndësishme.	Sa ndikon qëndrimi i prindit (mosdakordësia e tyre për fillim të marrëdhënieve seksuale që herët) te fëmija.	Studimet shkencore provojnë se ata fëmijë me prindër të tillë përfshihen më vonë dhe më pak në marrëdhënie seksuale.

Prindërit duhet të zbulojnë prirjet seksuale të fëmijëve të tyre.	Cilat janë disa nga format përmes të cilave një prind mund të zbulojë orientimet seksuale të fëmijës?	Pyetjet: Çfarë mendojnë shokët kur një vajzë takohet me një djalë? Kur mendon se duhet të nisnin jetën seksuale etj?
.....	.....	.....
.....		

- Në grupe dyshe, nxënësit përpiqen të ndërtojnë dhe të shpjegojnë tani, sipas tabelës së orës së kaluar, strukturën e tekstit “Si të flasim me adoleshentët rreth seksit?”

Hapat e shkrimit	Teksti udhëzues: Si të flasim me adoleshentët	
<b>Titulli:</b> (krijon lidhjen e drejtpërdrejtë me çështjen, në formë pyetjeje për të siguruar vëmendjen e lexuesit, për ta bërë atë pjesë të komunikimit dhe për të ngritur shtratin e udhëzimeve)	Si të flasim me adoleshentët për seksin??	
<b>Paragrafi hyrës:</b> (informacione të përgjithshme mbi temën, grupet e interesuara për çështjen)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fëmijët kanë shumë informacione për problemin, të cilat shpesh janë të gabuara;</li> <li>- Prindërit duhet ta njohin dhe ta pranojnë këtë dukuri;</li> <li>- Për këtë arsye duhet të kenë parasysh rregullat e këtij komunikimi delikat.</li> </ul>	
<b>Paragrafët zhvillues.</b>  <b>Udhëzimet konkrete mbi sjelljen e prindërve kundrejt fëmijëve:</b>	<b>Paragrafi I</b> (udhëzime shpjeguese për detyrën parësore të prindërve)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të sqarojë keqinformimet që kanë adoleshentët për seksin;</li> <li>- Të jenë seriozë gjatë këtij komunikimi, edhe kur situatat shkaktojnë humor.</li> </ul>
	<b>Paragrafi II</b> (udhëzime të mëtejshme sipas radhës së rëndësisë së çështjeve)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Duhet të dijë që fëmijët ndikohen nga shokët;</li> <li>- Prandaj prindërit duhet t’ua bëjnë të qartë fëmijëve pikëpamjen e tyre mbi seksin;</li> <li>- Shembull shkencor: (Fëmijët që njohin qëndrimet mohuese të prindërve, përfshihen më pak në jetën seksuale.)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruara sipas radhës së veprimeve;</li> <li>- të renditura në paragrafë që shoqërohen me shpjegime;</li> </ul>	<b>Paragrafi III</b> (udhëzime mbi raportet mes teorisë (leksioneve për çështjen) dhe	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Duhet të dëgjohen fëmijët teksa flasin hapur për probleme të seksit.</li> <li>- Duhet të respektohen ...</li> <li>- .....</li> <li>- Nuk duhet t’i ndëshkojnë ata</li> </ul>

- të shoqëruara me ilustrime (fotoja në tekst).	praktikës (diskutimeve të gjalla për çështjen)	- ..... - .....
	<b>Paragrafi IV</b> (disa nga pyetjet për të njohur prirjet seksuale të fëmijëve)	- Çfarë mendojnë shokët kur një vajzë takohet me një djalë? - Pse mendon se disa fëmijë të moshës sate janë aktivë seksualisht? - .....
<b>Paragrafi përmbyllës:</b> (- në përfundim i rikthehet pyetjeve që s'u duhen bërë adoleshentëve: - prezanton një veprimtari që mund të kryhet pas kësaj veprimtarie)	- ..... ..	- ..... - Fëmijët e mbyllin aq shpejt komunikimin, sa prindit i vjen mendja rrotull.

### Detyrat dhe puna e pavarur:

Klasa ndahet në 3 grupe:

GRUPI I: Zbuloni karakteristikat gjuhësore të tekstit, duke plotësuar tabelën e mëposhtme:

Mjetet gjuhësore dhe stilistike	Karakteristikat	Shembulli në tekst	Funksioni i tyre
<b>Foljet</b>	në të tashmen dëftore dhe lidhore	është, nuk duhet të qeshë	Problemi është i gjithkohshëm (dëftore); siguron karakterin sugjerues....
<b>Mjete gjuhësore të tjera</b>	Mjete që tregojnë sekuenca kohore	Në radhë të parë, së dyti	.....
	Mjete që tregojnë shkakun dhe pasojën	Por kujdes duhet treguar edhe me pyetjet sepse ka pyetje që i dëshpërojnë fëmijët	I japin natyrë shpjeguese tekstit
	Mjete që mundësojnë krahasimet	.....	.....
	Mjete lidhëzore të tjera	.....	.....
<b>Stili gjuhësor</b>	Fjali të shkurtra, të qarta e të sakta		

	Përdorim ndajfoljesh apo mbiemrash		
	Terminologjia teknike		
	Stil i figurshëm	-..... -.....  -shprehje.. frazologjike	- teksti vjen më pranë gjuhës së thjeshtë, që të memorizohet më shpejt nga lexuesi; - ka një nuancë ironie me këtë gjuhë komunikimi indirekte.)

GRUPI II: Zbuloni rolin që luan media televizive në qëndrimet e të rinjve ndaj seksit në adoleshencë. Shkruani një tekst udhëzues (deri në 10 fjali), që të përcaktojë rolin që duhet të luajë media në shoqëri.

GRUPI III: A na mbrojnë vërtet prindërit kur duan të na formatojnë sipas traditës? (kujtoni historinë e Nolit). Shkruani një tekst udhëzues (deri në 10 fjali), ku të udhëzoni adoleshentët si të sigurojnë një sens mase mes bindjes ndaj të rriturve dhe revoltës ndaj tutelës së tyre.

#### Detyrë shtëpie:

Bëni një prezantim të shkurtër me gojë, me temë: “Adoleshenti dje dhe sot”, ku të trajtoni figurën e të riut në lidhje me dëshirat, shijet, interesat dhe marrëdhëniet më të tjerët.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit udhëzues dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin “Si të flasim me adoleshentët rreth seksit?”</li> <li>• shkruajnë drejt tekste udhëzuese, sipas orientimeve të mësuesit;</li> <li>• zbatojnë rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për mënyrën se si i përcjellin njohuritë e fituara;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit dhe debatit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 5.2 (2): “SI TË FLASIM ME ADOLESHENTËT?” XHENIFER ESHTËN MËNYRA DËFTORE DHE HABITORE, FORMA VEPRORE DHE JOVEPRORE E FOLJEVE TË PARREGULLTA**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes udhëzimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 37</b>			
<p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me mënyrën dëftore dhe habitore të foljes. Ata zhvillojnë njohuritë për format veprare dhe joveprare të foljeve të parregullta;</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>                  Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të foljeve të parregullta, në situata të ndryshme të komunikimit dhe shkrimit.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b>                  Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) që lidhet me temën e foljeve të parregullta, mënyrat dhe format e saj.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b>                  Nxënësi shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, sipas qëllimeve që i cakton vetes.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b>                  Nxënësi ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes e të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</p>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>                  Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të foljeve të parregullta në tekst;</li> <li>• Zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit;</li> <li>• Ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për foljet e parregullta në mënyrën dëftore dhe habitore, si dhe në formën veprare dhe joveprare të tyre.</li> </ul>			<p><b>Fjalët kyçe:</b>                  analizë morfologjike                  mënyrat e foljes                  mënyra dëftore / habitore                  forma veprare/pësore                  folje të rregullta/të parregullta</p>
<p><b>Burimet:</b>                  Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe  <b>Mjete:</b> <i>fleep-charter</i> (projektor), tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst.</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>  <b>Letërsi:</b> Nxënësi përdor tekstet letrare për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes.  <b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>	

<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• lojë mësimore</li> <li>• tabela e mendimit</li> <li>• punë në grupe dyshe</li> <li>• ditari pesëpjesësh/ditar dypjesësh</li> <li>• punë e pavarur,</li> </ul>	<b>Koha: 45'</b>
--	------------------

**Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:**


- Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Një nxënës prezanton me gojë punimin e tij me temë: “*Adoleshenti dhe sot*”. Nxënësit e tjerë plotësojnë tabelën vlerësuese, sipas rubrikave të përcaktuara në tabelë, të cilën e plotësojnë në grupe dyshe.
- Në fund secili grup dysësh jep numrin e pikëve që arrin gjatë prezantimit nxënësi që prezanton. (P.sh.,: pikët e fituara në tabelën më poshtë janë 19. Ato mund të konvertohen në notë (30 pikë japin notën 10). Kjo krijon situatën e një **loje** në klasë.

Trajtimi i plotë i idesë	Struktura e tekstit	Saktësia gjatë të folurit prezantues	Respektimi i kohës dhe i audiencës																																																																				
- sillat në mënyrë të plotë mendimi; - mbrohet përmes shembujsh a përvojash ideja; - nxirren përfundime në mënyrë logjike - teksti është bindës	- dallohen paragrafët sipas bërthamave; - teksti është koherent; - mjetet gjuhësore mbështetin logjikën e tekstit.	- shqiptim i saktë; - intonacion i drejtë; - pauza të shkurtra/të gjata në pozicionin e duhur; - kontrolli i emocioneve; - gjuhë e zgjedhur (fjalor i pasur); - fjali të shumëllojshme.	- respekton minutat në dispozicion; - zgjedh fjalor të përshtatshëm për audiencën; - siguron vëmendjen; - tonet të qeta dhe me mirësjellje;																																																																				
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td>a</td><td>a</td><td>b</td><td>b</td><td>c</td><td>c</td><td>d</td><td>d</td> <td>a</td><td>a</td><td>b</td><td>b</td><td>c</td><td>c</td> <td>a</td><td>a</td><td>b</td><td>b</td><td>c</td><td>c</td><td>d</td><td>d</td><td>e</td><td>e</td><td>f</td><td>f</td> <td>a</td><td>a</td><td>b</td><td>b</td><td>c</td><td>c</td><td>d</td><td>d</td> </tr> <tr> <td>+</td><td>-</td><td>+</td><td>+</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>+</td> <td>+</td><td>+</td><td>-</td><td>+</td><td>+</td><td>-</td> <td>+</td><td>+</td><td>-</td><td>+</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>+</td><td>+</td><td>+</td><td>-</td><td>-</td> <td>-</td><td>+</td><td>+</td><td>+</td><td>-</td><td>-</td><td>+</td><td>+</td> </tr> </table>	a	a	b	b	c	c	d	d	a	a	b	b	c	c	a	a	b	b	c	c	d	d	e	e	f	f	a	a	b	b	c	c	d	d	+	-	+	+	-	-	-	+	+	+	-	+	+	-	+	+	-	+	-	-	-	+	+	+	-	-	-	+	+	+	-	-	+	+			
a	a	b	b	c	c	d	d	a	a	b	b	c	c	a	a	b	b	c	c	d	d	e	e	f	f	a	a	b	b	c	c	d	d																																						
+	-	+	+	-	-	-	+	+	+	-	+	+	-	+	+	-	+	-	-	-	+	+	+	-	-	-	+	+	+	-	-	+	+																																						

Pyetje 1: A mund të kujtoni, ç'është kategoria e mënyrës?

(**Model:** Kategoria e mënyrës shpreh lidhjen mes veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv. Veprimi paraqitet si i vërtetë, i mundshëm, i dëshirueshëm, i domosdoshëm).

- U kërkohet nxënësve t'u rikthehen punimeve të tyre dhe të gjejnë në to folje në kohë të ndryshme të mënyrës dëftore. Në tabelë paraqitet skema:



Pyetje 2: A mund të zgjedhësh një nga foljet e zbuluara në tekstet tuaja në të gjitha kohët e mënyrës dëftore? Plotësohet tabela e foljeve.

➤ Një nxënës e zgjedhon një nga foljet në tabelë. (Model: gaboj )

Pyetje 3: Çfarë shpreh folësi kur përdor foljen në mënyrën dëftore? (Model: Ndjenjën e vërtetësisë)

MËNYRA DËFTORE							
KOHËT E THJESHTA				KOHËT E PËRBËRA			
E tashme	E pakryer	E kryer e thjeshtë	E ardhme	E kryer	Më se e kryer	E kryer e tejshkuar	E ardhme e përparme
gaboj	...			kam gabuar			
gabon	...			ke gabuar			
gabon				ka gabuar			
...							
...							

Pyetje 3: Ç'mund të themi për kategoritë zgjedhimit, numrit dhe të vetës? (Nxënësit sjellin përgjigjet e tyre mbi zgjedhimin e foljeve të rregullta, numrin njëjës dhe shumës, vetën I, II, III)

➤ Në këtë fazë nxënësve u kërkohet të ndahen në **2 grupe**, me të njëjtën kërkesë:

Gjeni të gjitha foljet në mënyrën dëftore (në të gjitha kohët që ato shfaqen) në tekstin: "Si të flasim me adoleshentët për seksin?" .

- Njëri grup punon me tekstin e fq.132 dhe grupi tjetër punon me tekstin e fq. 133. Brenda grupit ata do të punojnë në grupe dyshë.
- Më pas, u kërkohet të plotësojnë ditarin pesëpjesësh (sipas rubrikave të përcaktuara).
- Mësuesi kujdeset në plotësimin e tabelës, duke plotësuar edhe me vetën e parë njëjës.

Folja në dëftore	Koha e foljes	Ktheje në kohën e kryer e thjeshtë	Pjesorja e foljes	Ktheje në pësore/veprore (sipas rastit)
Është (jam)	e tashme	qe (qeshë)	qenë	ka (kam)



kanë (kam)	e tashme	patën	patur	Janë
shkaktojnë	e tashme	shkaktuan	shkaktuar	shkaktohen
ndikohen	e tashme	u ndikuan	ndikuar	ndikojnë
....				
.....				

- Pasi plotësohet tabela me të gjitha foljet (1 nxënës për secilin grup), shtrohet kërkesa:

Kërkesë: Nënvizoni me të kuqe foljet që kanë një temë të përbashkët, kur zgjedhohen në kohët e dëftores dhe me blu ato folje që gjatë zgjedhimit nuk mund të grupohen me foljet e tjera.

(**Model:** mund të grupohen bashkë foljet: shkaktoj/shkaktova/shkaktuar, ndikoj/ ndikova/ ndikuar), por nuk mund të përfshihen këtu foljet kam/pata/pasur; apo jam/qeshe/qenë).

- 2 nxënës të tjerë paraqesin në tabelë këto dallime:
- Mësuesi qartëson dallimin mes foljeve të rregullta dhe atyre të parregullta, duke iu referuar shembujve të nxjerrë nga nxënësit.
- Përmes lojës në të nxënë, mësuesi kërkon që të gjitha foljet në tabelë të kthehen në mënyrën habitore.

Pyetje: Çfarë shpreh folësi kur e vendos foljen në mënyrën habitore? (**Model:** ndjenjën e habitës për diçka që është e vërtetë.)

- Tabela e mëposhtme ndihmon nxënësit të kthejnë foljet e mësipërme në mënyrën habitore.

MËNYRA HABITORE			
KOHËT E THJESHTA		KOHËT E PËRBËRA	
E tashme	E pakryer	E kryer	Mëse e kryer
gabukam	gabukështa	paskam gabuar	paskështa gabuar
	...		
...			
...			

### Kujdes!

Gabuakam = gabua(r) + kam      Gabuakështa = gabua(r) + kështa (kisha)

↓      ↓
↓      ↓

pjesorja      e tashmja
pjesorja      e pakryera e

e foljes      e foljes kam
e foljes      foljes kam

**Pyetje:** A mund të shpjegoni formimin e kohëve të përbëra të habitores?

- Në këtë fazë nxënësit do të punojnë me **ditarin katërpjesësh**, me kërkesën:
  1. Përpiquni të ktheni në formën pësore foljet e paragrafit të fundit (zgjidhni tri fjali dhe vini re ndryshimet që ndodhin te kryefjala, kundrinori dhe folja).
  2. Kthejeni foljen në habitore në format e veprores dhe pësores.

(**Model:**

Veprorë /Dëftorë	Joveprorë / Dëftorë	Veprorë /habitore	Joveprorë /Habitore
<u>Ka</u> pyetje që i <u>dëshpërojnë</u> fëmijët.	<u>Gjenden</u> pyetje prej të cilave fëmijët <u>dëshpërohen</u> .	<u>Paska</u> pyetje që i <u>dëshpëruakan</u> fëmijët.	<u>U gjendkan</u> pyetje prej të cilave fëmijët <u>u dëshpëruakan</u> .

### Detyrat dhe puna e pavarur:

Klasa ndahet në dy grupe.

Punohet në librin e nxënësit me **U.1,fq.137** (grupi I) dhe me **U.2, fq 137** (grupi II)

### Detyrë shtëpie:

*Realizoni një tekst të shkurtër udhëzues, sipas kërkesës së U. 11, fq.134.*

*Provoni të ktheni foljet në habitore. A mund të kryejë funksionin e tij një tekst udhëzues, nëse foljet janë në habitore? Pse?*

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me trajtimin e foljeve të parregullta në mënyrën dëftore dhe habitore;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore;</li> <li>• analizojnë përdorimet e foljes në pësore dhe veprorë, si dhe ndryshimet që pësojnë kryefjala, kundrinori dhe folja përgjatë kalimit nga veprorja në pësore dhe anasjelltas.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë në përgjigjet;</li> <li>• për mendimet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 5.2 (2): “SI TË FLASIM ME ADOLESHENTËT RRETH SEKSIT?”****XHENIFER ESHTËN****FORMAT E PASHTJELLUARA FOLJORE**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes udhëzimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 38</b>			
Krijohen situata të tilla ku nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me format e pashtjelluara foljore: pjesore, paskajore, përcjellore, mohore			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit që lidhen me përdorimin e saktë të formave të pashtjelluara foljore, në kontekste dhe rrethana të ndryshme të shkrimit, si: ese, letër formale dhe joformale, shkrim argumentues etj.;</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi që lidhet temën e formave foljore të pashtjelluara;</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>. Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për mënyrën e ndërtimit dhe shkrimit drejt të fjalive për të kryer një veprim, aktivitet apo detyrë, sipas qëllimeve të caktuara.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin e duhur mbi format foljore të pashtjelluara nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të formave të pashtjelluara foljore, si dhe rregullave të përdorimit të tyre në fjali;</li> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit të teksteve të ndryshme,</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për foljet e parregullta, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstin “Si të flasim me adoleshentët rreth seksit?” dhe tekste të tjera letrarë ose joletrarë.</li> </ul>		<p>analizë morfologjike forma të pashtjella të foljes; temë foljore.</p> <p><b>FJALOR:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ pjesore</li> <li>▪ paskajore</li> <li>▪ përcjellore</li> </ul>	

<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, modele tekstesh të llojit letrar dhe joletrar, fjalori i gjuhës shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> fleep-charter (projektor), tabela, shumësia me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga Xh.Eshtën.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes dhe për të përmbushur rezultatet e të nxënës të kësaj ore.</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim mendimi /</li> <li>• diskutim</li> <li>• praktikë e udhëhequr</li> <li>• diskutim/ organizues grafik</li> <li>• ditar tripjesësh</li> <li>• INSERT</li> <li>• punë e pavarur në grupe</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Lexohen nga nxënësit dy punime dhe <u>diskutohet</u> mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mënyrën e realizimit,</li> <li>• teknikat e shkrimit të tekstit (teksti duhet të jetë udhëzues),</li> <li>• transformimet që fiton teksti nëse foljet kthehen nga urdhërore në habitore.</li> </ul> <p>Brenda kontekstit të tekstit që është punuar në klasë diskutimi për problemin e trajtuar e ngremë në një nivel më të përgjithshëm. Përgjigjja e kësaj pyetjeje është dhënë dhe pranuar, madje ka “goditur” në shenjë. Përdorimit i një pyetjeje të tillë për të ndërtuar punën me njohuritë gjuhësore të programuara jo vetëm realizon lidhjen e llojit të tekstit dhe problemit jo aq delikat që trajton me njohuritë gjuhësore, por nxit të folurën e nxënësve për tema Tabu lirshëm thuajse në mënyrë të vetvetishme brenda situatave ku merr përparësi saktësia gjuhësore.</p> <p>➤ Në tabelë shkruhet kërkesa e këtij ushtrimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Në respektimin e traditës <u>duhet stimuluar pozitivja dhe progresivja. Pse?</u></i></li> </ul> <p><b>Pyetje 1:</b> <i>A mund të risillni në kujtesë si është formuar folja e nënvizuar në fjalinë e mësipërme?</i></p> <p><b>(Model:</b> Nxënësit do të orientohen drejt përgjigjes që lidhet me formimin e kësaj foljeje sipas modelit duhet (do) + <u>pjesore</u>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Në tabelë sillet skema:</i></li> </ul>	

Në respektimin e traditës duhet stimuluar pozitivja dhe progresivja. Pse?

Duhet + stimul(o)+ uar



**Tema e foljes**

- Tema fjalëformuese është pjesa që mbetet pasi hiqet prapashtesa trajtëformuese (mbaresat)
- Rrënja është njësia më e vogël e fjalës, pasi hiqen të gjitha prapashtesat, prapashtesat dhe mbaresat.

**Pyetje 2:** A ju kujtohen format e pashtjelluara të foljes?

(**Model:** nxënësit duhet të përgjigjen : pjesore, paskajore, përcjellore dhe forma e pashtjelluar mohore.)

Kërkesë 1: Nënvozoni në tekstin “Si të flasim me adoleshentët për seksin” (me ngjyra të ndryshme) të gjitha foljet e pashtjelluara.

Kërkesë 2: Përpuni të analizoni **në grupe dyshe** mënyrën e formimit të formave të mësipërme dhe plotësoni

- Më pas plotësoni **ditarin tripjesësh:**

Forma e pashtjelluar	Emërtimi	Formimi
duhen <u>trajtuar</u>	Pjesore	trajtua-(m); temë foljore e së kryerës së thjeshtë, shumës + <u>prapashtesën - r</u>
<u>për të bërë</u>	Paskajore	bër - (a); temë foljore e së kryerës së thjeshtë, njëjës + <u>prapashtesën -ë</u>
kanë <u>dëgjuar</u>	Pjesore	dëgjua -(m); temë foljore e së kryerës së thjeshtë, shumës + <u>prapashtesën - r</u>
thonë <u>hapur</u>	Pjesore	hap-(a/ëm); temë foljore e së kryerës së thjeshtë, njëjës/shumës + <u>prapashtesën -ur</u>
<u>pa u shqetësuar</u>	Mohore	shqetësua-(m); temë foljore e së kryerës së thjeshtë, shumës + <u>prapashtesën - r</u>
<u>duke i pyetur</u>	Përcjellore	pyet- (a/ëm); temë foljore e së kryerës së thjeshtë, njëjës/shumës + <u>prapashtesën -ur</u>
<u>për të filluar</u>	Paskajore	fillua-(m); temë foljore e së kryerës së thjeshtë, shumës + <u>prapashtesën - r</u>
<u>pa kryer</u>	Mohore	krye- (j); temë foljore e së tashmes (# nga e kryer e thjeshtë - kreve) + <u>prapashtesën - r</u>
duhet <u>treguar</u>	Pjesore	tregua-(m); temë foljore e së kryerës së thjeshtë, shumës + <u>prapashtesën - r</u>

- Nxënësve u kërkohet të lexojnë me kodim tekstin INSERT dhe të plotësojnë tabelën:

V	+	-	?
---	---	---	---

Informacion i njohur	Informacion i ri	Informacion ndryshe	Informacion që duhet thelluar
....			
....			

➤ Pasi nxënësit kanë plotësuar tabelën, paraqitet në formë të plotë në bashkëpunime nxënësit skema e re:

**Pyetje 1:** Si formohet pjesorja e foljes?

(Nxënësit nisur nga shembujt e nxjerra nga teksti, përkufizojnë. Plotësohet tabela hap pas hapi)

**Pyetje 2:** Si formohet mohorja? /përcjellorja?/ paskajorja?

(Gjithmonë duke iu referuar shembujve nga teksti “Si të flasim me adoleshentët për seksin?”, nxënësit përkufizojnë deri sa plotësohet e gjithë tabela.)

**Pyetje 3:** A mund të sillni në mend, në ç’funksion e ndeshim pjesoren e foljes?

Po paskajoren?

Po mohoren?

Po përcjelloren?

- (Përgjigjet e nxënësve do të merren një nga një paralelisht me plotësimin e tabelës më poshtë. Aty ku nxënësi nuk shpjegon dot, ndërhyt mësuesi.
- Kur flitet për përdorimin duhet që nxënësit të gjejnë shembujt përkatës si në tabelë.)

**Pyetje 4:** Si e formojnë formën joveprorë format e pashjtelluara? Provoni të ktheni një nga shembujt e mësipërm në joveprorë.

**KUJDES!** Tabela e mëposhtme është mirë të mos jetë e parapërgatitur, por të plotësohet gradualisht.

Format e pashtjelluara	Formimi	Kuptimi / Përdorimi
Pjesorja	<p>- i shtohet temës foljore një nga prapashtesat: -rë (r), -ur. -ë dhe - në</p> <p>- në tabelën e mësipërme nxënësit do të shpjegojnë se cilat janë temat foljore të cilave u shtohen prapashtesat e mësipërme</p> <p><b>KUJDES!</b> : në tabelën e mësipërme mungon foljet që e formojnë pjesoren me prapashtesën -në (vë-në, lë-në) Ka folje që pjesoren nuk e marrin as nga shumësi i së kryerës së thjeshtë dhe as nga e tashmja, por është e ndryshme nga ato. (<u>rënë</u> (bie, rashë,</p>	<p>- kryen funksionin e <b>një mbiemri</b>: (Qielli <u>trazuar</u> nga retë...)</p> <p>- ka marrë një kundrinor (<u>nga retë...</u>), njësoj sikur të ishte <b>folje</b>)</p> <p>- me vlerë <b>foljore</b> vjen pas foljeve <i>do dhe duhet</i></p> <p>- vjen më shpesh si pjesë përbërëse e <b>foljeve në kohët e përbëra</b> (kanë <u>dëgjuar</u>)</p> <p>- si gjymtyrë më vete, ajo vjen si <b>përcaktor i veçuar</b> (<u>Shqetësuar</u> nga prindërit, adoleshentët...)</p>

	<i>rënë</i> )	
Mohorja	- vendoset para pjesores së foljes pjesëzën mohore <i>pa</i> - shpreh moskryerjen e një veprimi në të shkuarën ose në të ardhmen	- përdoret në funksion kohor: (shembulli në tekst) - në funksion mënyror : (shembulli në tekst) (KUJDES! Këto raste i shpjegojnë nxënësit) - në funksion kushtor: ( <i>Pa luajtur</i> këmbët, nuk luan dhëmbët)
Përcjellorja	- vendoset para pjesores fjalëza <i>duke</i>	- shoqëron veprimin e foljes kryesore (prindërit duhet t'i zbulojnë....duke i pyetur...) - me funksion mënyror - me funksion kohor - me funksion shkakor - me funksion kushtor
Paskajorja	- vendosen para pjesores fjalëzat <i>për të</i>	përdoret me funksion: - qëllimor - përcaktor - kallëzuesor (pas foljeve jam, kam, bëhem)

➤ **Detyrat dhe puna e pavarur:**

- Grupi I: Nxënësit plotësojnë në tekstin e nxënësit **U.3; fq. 138**  
(**Model:** pa ndërtime, pa zhurmë, pa darkë, pa dritë= nuk kemi të bëjmë me pjesore)

- Grupi II: **U.4; fq.138**

Ushtrimet diskutohen në klasë.

- **Detyrë shtëpie:** Zbuloni në tekstin e mëposhtëm format e pashtjelluara të foljes. Ndërtoni një tabelë organizuese, sipas modelit të punës në klasë.

**PËR TË NJOHUR KROKODILIN**



**DUKE U NJOHUR ME KROKODILIN**



Krokodili është një kafshë me katër këmbë edhe i verdhë në ngjyrë, lindur në lumin Nil, lumë që vadit tokën e Egjiptit.... Është i gjatë mbi 20 këmbë dhe armatosur me dhëmbë e thonj goxha të mëdhenj; lëkura e tij është aq e ashpër, saqë ai lëviz pa i ndjerë goditjet e gurëve. Ditën banon në tokë e natën tendoset duke u prehur në lumë; vezën nuk e lëshon mbi dhe, por shmanget për ta lënë në vende që lumi të mos e prekë. Edhe dijeni, se është pa gjuhë; është e vetmja kafshë e botës që lëviz nofullën e sipërme duke e mbajtur të palëvizshme të poshtmen. Në e vëntë njeriun nën vete, e ha duke u përlotur dhe duke mos u tërhequr prapa në aksionin e tij! Oh! Në këto rrethana është për t'u ruajtur nga ai!



Ndodh që, kur zogu që mban emrin strofilos, kërkon cofëtina për të ngrënë, ai e detyron krokodilin të hapë gojën, për t'i kruajtur gurmazin, edhe ky e hap krejt grykën duke u shkrirë nga qejfi që do të kruhet. Duhet kështu kujdes në kontaktin me të.

Mbasandaj vjen një tjetër peshk hidër: kokatriksi që depërton përbrenda trupit të krokodilit dhe i shkon përmatanë, duke e dërrmuar e copëtuar mikpritësin e vet në atë mënyrë sa e vret krejt. Edhe delfinët që kanë po ashtu një si sharrë përgjatë kurrizit, kur e shohin krokodilin të notojë, i venë më të poshtë, duke e sharruar atë nga barku, për ta bërë fërtele fare.

Dhe mësojeni se kokatriksi, edhe pse lindur në ujërat e Nilit, s'është peshk, por gjarpër uji; i gatshëm për ta vlarë njeriun, në guxoftë ky ta prekë, pa asnjë shans për shërim....

Në atë tokë banojnë njerëz trupvegjël, por që janë trima e të fortë sa nuk ua bën syri tërr për t'u rënë pas krokodilëve. Sepse ka nga këta, që i gjuajnë njerëzit kur i shohin duke ua mbathur para tyre, por ama u shkojnë shtatë para atyre që mbrohen. Ndodh ahëre që, po u kap ndonjë prej tyre, - dhe kur kapet, krokodili mposhtet,- ai, duke harruar çdo krenari, bëhet aq i butë sa të zotët e tyre veç u hipin përsipër e ç' nuk bëjnë me të! Kur është brenda në lumë, ai nuk shquan gati-gati kurrgjë, po në tokë sheh mrekullisht mirë; edhe rri pa ngrënë gjithë dimrin, fare vetëm, duke e duruar kështu etjen e urinë bashkë gjatë katër muajve të mjegullinës. Duke mos i marrë këto të dhëna, ne nuk mund të ishim të informuar kaq sa jemi tani.

- **Detyrë shtëpie e diferencuar:** provoni të flisni me veten për temat e mëposhtme duke përdorur format foljore të pashtjelluara.

*PËR TË NJOHUR VETEN*

*DUKE U NJOHUR ME VETEN*

**Shënim:** Mësuesja mund ta sugjerojë veprën ose tekst sipas dëshirës në përputhje me nivelin e nxënësve.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve me gojë që lidhen me temën</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore</li> <li>• analizojnë drejt format e pashtjelluara foljore në shembujt e dhënë.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime në grup dhe në klasë</li> <li>• për shkathtësinë në përgjigje dhe fjalorin e përdorur</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

<b>Fusha:</b> Gjuhët dhe komunikimi	<b>Lënda:</b> Gjuhë shqipe	<b>Tematika:</b> Bota përmes udhëzimit	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> X
<b>TEMA MËSIMORE 5.2 (4)</b>			<b>Situata e të nxënësve Nr. 39</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë	



<p><b>Si të shkruajmë një CV?</b></p> <p><b>Qendra e karrierës</b></p>	<p>mbi këtë lloj teksti, duke përcaktuar llojin udhëzues, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit dhe organizimit gjuhësor të tij.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për këtë tip teksti udhëzues, duke veçuar karakteristikat kryesore të tij, përmes studimit të tekstit konkret</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e një CV, si dhe ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënës</b> Nxënësi demonstroi shkathhtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave gjatë të nxënës të dijeve të reja, në lidhje me llojin e CV, si tekst udhëzues.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave mbështet avancimin personal në fushën e aplikimit të këtij lloji.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. duke shfrytëzuar njohjen e llojit udhëzues, që mbështet qëllimin e tij.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës</b></p> <p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me llojin e CV, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda këtij konteksti;</li> <li>• dallon elementin shpjegues udhëzues në tekstin në studim;</li> <li>• përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin udhëzues të tipit të CV;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ CV</li> <li>▪ Curriculum Vitae</li> <li>▪ Adaptim</li> <li>▪ Delegim</li> <li>▪ Huluntim</li> <li>▪ Përditësim</li> <li>▪ Menaxhim</li> <li>▪ Formulim</li> <li>▪ Negociatë</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit; libri i nxënësit: fragment (“Si të shkruajmë një CV? Qendra e karrierës”), materiale nga interneti, apo media të tjera që lidhen me temën.</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, markera, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor teknikat letrare të interpretimit të kuptimit të fjalës, në përmbushjen e qëllimit të shkrimit.</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë modele të ndryshme tekstesh tip të CV udhëzuese.</p> <p><b>Qytetari:</b> nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për</p>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

- përvijim i mendimit
- organizues grafik
- praktikë e udhëhequr hap pas hapi
- diskutim
- stuhi mendimi
- DDM - punë në grupe dyshe
- Ditari dypjesësh
- punë e pavarur (shkrim i lirë)

**Koha: 45 minuta****Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:**

- Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Mësuesi kërkon nga **2 nxënës** të paraqesin punimet e tyre
- Ndërkaq nxënësit e tjerë vlerësojnë duke iu referuar parametrave të mëposhtëm. Ata mbajnë shënime gjatë procesit të dëgjimit, për të diskutuar më pas për punimet.

A mbahen parasysh gjatë realizimit të punimit të shokut, orientimet që lidhen me:

- ❖ Organizimin e formatit sipas diagramit që kërkon ushtrimi
- ❖ Tiparet udhëzuese të tekstit
- ❖ Elementët shpjegues të tekstit
- ❖ Ndjekjen e logjikës së radhës së hapave të procesit
- ❖ Llojin e foljeve që përdoren
- ❖ Stilin impersonal
- ❖ Raportet shkak-pasojë
- ❖ Përdorimin e termave teknike

- Në tabelë shkruhet tema: **SI TË SHKRUAJMË NJË CV?**
- Nxënësit diskutojnë mbi titullin
- Më pas ata orientohen të lexojnë tekstin.

Pyetje: *A mund të zbulojmë funksionin e këtij teksti?*

*A mund të zbulojmë tiparet e një teksti udhëzues?*

(Nxënësit do të sjellin idetë e tyre, të cilat diskutohen në klasë. Kryesisht do të shpjegojnë lidhjen e titullit me këtë tekst /duket sikur teksti është përgjigja më e parë për pyetjen që shtrohet në titull. Do të vënë re edhe foljet e përdorura)

Pyetje: *a mund të zbulojmë elementë të shpjegimit në këtë tekst?*

- **Stuhi mendimi.** Tema që studiojmë sot lidhet më shumë se çdo temë tjetër me ju. *Cilat janë sipas jush disa nga nevojat e shoqërisë së sotme për përdorimin e CV?* (nxënësit sjellin ide të tyre të cilat renditen në tabelë.

(**Model:** - duhet të jemi të përfshirë në modelimin e CV se është kërkesë e kohës;

- është e domosdoshme të njihen strukturat e organizimit të CV, për një paraqitje dinjitoze në mjedise të ndryshme komunikimi të këtij lloji;
- ka mjaft informacione nga shtypi dhe interneti për mënyrën e ndërtimit të një CV.
- Në këtë fazë, përmes teknikës së praktikës së udhëhequr hap pas hapi, nxënësit do të lexojnë në grupe me nga dy tekstin në : qëllimin e CV, shkrimin e CV efektive, formatin dhe fjalët kyç në përdorim.
- Gjatë leximit, kodojnë sipas mënyrës së tyre tekstin për të plotësuar më pas tabelën e mëposhtme, duke zbatuar procedurën **DDM**, për të kuptuar tekstin.

Di	Dua të di	Mësova
Sot në të gjitha prezantimet është e domosdoshme CV e individit	Sa ndikon organizimi drejt i CV në fitimin e një vendi pune, apo gjithçka tjetër të ngjashme.	
CV demonstroi vlerat e tua dhe shkathtësitë e tua	A duhet të përzgjedhim informacionin që paraqesim në CV, apo duhet të jemi thellësisht të vërtetë në gjithçka tonën.	
Gjithçka duhet të përfshij në CV	A duhet të respektojmë një radhë renditjeje të informacionit në CV, apo nuk është e domosdoshme kjo.	
.....		

- Në grupe me nga dy, nxënësit përpiqen të ndërtojnë dhe shpjegojnë tani, sipas tabelës së orës së kaluar, strukturën e tekstit “Si shkruajmë një CV?”

Hapat e shkrimit	Teksti udhëzues: Si të ndërtojmë një CV?
<b>Titulli:</b> (krijon lidhjen e drejtpërdrejtë me çështjen, në formë pyetjeje për të siguruar vëmendjen e lexuesit, për ta bërë atë pjesë të komunikimit dhe për të	<b>Si të ndërtojmë një CV?</b>

ngritur shtratin e udhëzimeve)		
<p><b>Paragrafët zhvillues.</b></p> <p><b>Udhëzimet konkrete mbi hartimin e një CV:</b></p> <p>-të shkruara sipas radhës së veprimeve</p> <p>-të renditura në paragrafë që shoqërohen me shpjegime</p> <p>-të shoqëruara me ilustrime (fotoja në tekst)</p>	<p><b>Paragrafi I</b></p> <p>(shpjegimi i termit, nevoja e CV)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Termi vjen nga latinishtja</li> <li>- Dokumenti i parë që nevojitet për punësim</li> <li>- Informacion i përzgjedhur por i saktë</li> </ul>
	<p><b>Paragrafi II</b></p> <p>(udhëzime të mëtejshme për llojet e paraqitjes së CV në funksion të arsyes për se do të përdoret)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kur aplikojmë për studime për jashtë shteti...</li> <li>- Kur aplikohet për punë...</li> </ul>
	<p><b>Paragrafi III</b></p> <p>(udhëzime mbi çka nuk duhet të përfshihet në CV)</p>	
	<p><b>Paragrafi IV</b></p> <p>(parametrat për një CV efektive)</p>	

- **Detyrat dhe puna e pavarur:** Klasa ndahet në 3 grupe dhe secili grup do të punojë me të njëjtën pyetje: *Analizoni CV e paraqitur në fq.142.*

Parametrat e analizës	Modeli në tekst
Qëllimi i CV	

Renditja e informacionit	
Gjatësia e informacionit	
Stili i shkrimit (terminologjia e përdorur)	
Formati i shkrimit	
Organizimi	

➤ **Detyrë shtëpie:** U. 3 fq. 143

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit udhëzues dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin konkret;</li> <li>• shkruajnë drejt CV e tyre, sipas orientimeve të mësuesit;</li> <li>• zbatojnë rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• mënyrën si i përcjellin njohuritë e fituara;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit dhe debatit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit të CV.</li> </ul>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Tematika: Bota përmes udhëzimit	Shkalla: V	Klasa: X
<b>TEMA MËSIMORE 5.2 (6)</b> <b>“SI TË SHKRUAJMË NJË CV?”</b>  <b>DREJTSHKRIMI I NYJËS SË PËRPARME</b>		<b>Situata e të nxënësve Nr. 40</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me nyjat. Ata zhvillojnë njohuritë për përdorimin dhe drejtshkrimin e nyjës së përparme.		
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</b> Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të nyjave, në situata të ndryshme të komunikimit dhe shkrimit</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit.</b> Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) që lidhet me përdorimin e nyjës së përparme.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënësve.</b> Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për</li> </ul>				


<p>të kryer një veprim, aktivitet, detyrë , sipas qëllimeve që i cakton vetes në raport me temën e mësimit.</p> <p>➤ <b>Kompetenca personale.</b> Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës</b></p> <p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e nyjave të përparme në tekst;</li> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit;</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për përdorimin dhe drejtshkrimin e nyjës së përparme në situata të ndryshme.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>analizë morfologjike rasat e emrit nyjë e përparme ndërtime sintaksore mbiemër i nyjshëm emër në gjindore</p>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe <b>Mjete:</b> tabela, markera, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor tekstet letrare, për të studiuar modele të përdorimit të nyjave të përparme; <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, për vlerësim të zbatimit të rregullave të drejtshkrimit të nyjës së përparme.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• lojë mësimore</li> <li>• tabela e mendimit</li> <li>• punë në grupe me nga dy</li> <li>• ditar katërpjesësh</li> <li>• punë e pavarur</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p> <p>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Një nxënës prezanton CV e vet, punuar sipas modelit në tekst. Nxënësit e tjerë plotësojnë tabelën vlerësuese, sipas rubrikave të përcaktuara në tabelë, të cilën e plotësojnë në grupe dyshe</p> <p>➤ Në fund secili grup jep numrin e pikëve që arrin gjatë prezantimit nxënësi që prezanton. (Psh: pikët e fituara në tabelën më poshtë janë 8. Ato mund të konvertohen në notë (14 pikë japin notën 10). Gjithçka demonstron si <b>lojë</b> në klasë.</p>	
<p><b>Trajtimi i plotë i idesë</b></p>	<p><b>Struktura e tekstit</b></p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- plotësohet në mënyrë të plotë CV - ja</li> <li>- mbrohen përmes përvojash aftësitë e shkruarit</li> <li>- nxirren përfundime në mënyrë logjike</li> <li>- teksti është bindës</li> </ul>								<ul style="list-style-type: none"> <li>- dallohen paragrafët sipas bërthamave</li> <li>- teksti është koherent, sipas modelit udhëzues në tekstin e nxënësit</li> <li>- mjetet gjuhësore mbështesin logjikën e tekstit)</li> </ul>					
a	a	b	b	c	c	d	d	a	a	b	b	c	c
+	-	+	+	-	-	-	+	+	+	-	+	+	-

Pyetje 1: A mund të kujtoni ç'është kategoria e nyjës?

(Nxënësit japin përgjigjet e tyre, duke sjellë shembuj të përdorimit të nyjës.)

- U kërkohet nxënësve t'u rikthehen punimeve të tyre dhe të gjejnë në to mbiemra të nyjshëm apo emra në gjinore. Në tabelë paraqitet skema e mëposhtme, e cila plotësohet me raste të përdorimit të nyjave:



- Përmes projektorit paraqiten në tabelë rastet e mëposhtme:.
- Tabela plotësohet në bashkëpunim me nxënësit.

Rasti	Shembulli	Shpjegimi	Puno:
Rasti I	Publikimi i	- shohim nyjat (së)	- cili është shpjegimi për nyjën i (i

	poezisë së vajzës së re u prit me entuziazëm.	- meqë emri që i paraprin ( <i>poezisë, vajzës</i> ) është në femërore, nyja e përdorur është <b>së</b>	poezisë)? - ç'ndodh nëse emrin paraprirës e sillni në rasën dhanore dhe rrjedhore?
Rasti II	Me vete kisha kukullat e dashura të fëmijëve të mi	- Shohim nyjën <b>të</b> (fjala <u>kukullat</u> është femërore) - por fjala <u>fëmijëve</u> nuk lidhet drejtpërdrejt me emrin kukullat - nyja në këtë rast është <b>të</b>	- cili është shpjegimi? - ndërtoni një rregull (përdoret nyja <b>së</b> kur mbiemri ose emri në gjinore vjen drejtpërdrejt pas emrit femëror, në të kundërt përdoret nyja <b>të</b> )
Rasti III	Dita e fillimit të ngjitjes drejt Everestit ishte emocionuese.	- shohim nyjën <b>të</b> - emri përpara është në gjininë mashkullore (e fillimit), rasa gjinore.	- cili është shpjegimi? - kur një emër në rasën gjinore vjen pas një emri mashkullor të rasës gjinore a dhanore të shquar njëjës, vendodet nyja <b>të</b> . - provoni të përdorni rasën dhanore
Rasti IV	Një studim i kohës së rrëfimeve rreth zjarreve.	- shihni nyjën <b>së</b>	- shpjegoni sipas modelit 1
Rasti V	Në lidhje me origjinën e shqipes së vjetër dhe të hershme, janë bërë studime të ndryshme	- shihni nyjat - gjininë e emrit paraprirës - sa përcaktorë ka emri paraprirës	- formuloni rregullin - gjeni shembuj të tjerë të këtij rasti.
Rasti VI	Libri i historisë i klasës së dhjetë ndodhej mbi tavolinë.	- shihni nyjat <b>-i</b> - në ç'gjinë është emri që plotësojnë emrat <u>historisë</u> dhe <u>klasës</u> ? (mashkullore)	- formuloni rregullin - sillni shembuj të tjerë - provoni të plotësoni një emër në gjininë femërore (fletorja) në rasën emërore dhe shpjegoni ndryshimet - vendoseni në kallëzore ( <u>librin e historisë të klasës...</u> )
Rasti 7	Ekspedita e së dielës është kënaqësi e veçantë për babanë.	- emri femëror <u>e diela</u> në gjinore merr nyjën <b>së</b>	- provo: ekspedita e një të diele.... formulon rregullin.



Rasti 8	Iu kushtua mbrojtjes të së drejtave të fëmijëve.	- kur pas emrit femëror dalin dy nyja së, e para shkruhet të.	- sillni shembuj të tjerë
Rasti 9	- E gjeti shtëpinë e braktisur që ndodhej në.... - E gjeti shtëpinë të braktisur.	- shpjegoni përdorimet e nyjave në të dy rastet	

- Në këtë fazë nxënësve u kërkohet të ndahen në **2 grupe**, me të njëjtën kërkesë:
  - Kërkesa: Zbuloni në tregimin "Babai im", raste të përdorimit të nyjave të përparme dhe ndërtoni një tabelë si në modelin e punuar në klasë.
- Diskutime, vlerësime
- **Detyrë shtëpie:**
  - Krijoni një paragraf të shkurtër me ndërtime të ndryshme sintaksore, ku të përdorni njëjën në raste të ndryshme. Shpjegoni përdorimet.

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me temën e nyjave të përparme;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore;</li> <li>• shpjegojnë të gjitha rastet e përdorimit të nyjave të përparme nga pikëpamja e rregullave të përgjithshme.</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë në përgjigjet;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të shkruarit.</li> </ul>

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes udhëzimit</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
<b>TEMA MËSIMORE 5.2 (7)</b>  <b>“SI TË SHKRUAJMË NJË CV?”</b> <b>MBIEMRAT CILËSORË,</b> <b>MARRËDHËNIORË DHE TË EMËRZUAR</b>		<b>Situata e të nxënit Nr.41</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që mbiemrat. Ata zhvillojnë njohuritë për dallimin dhe drejtshkrimin e mbiemrave cilësorë, marrëdhënorë dhe të emëruar		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</b> Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit mbiemrave, në situata të ndryshme të komunikimit dhe shkrimit</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit.</b> Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) që lidhet me përdorimin e llojeve të ndryshme të mbiemrave.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit.</b> Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë , sipas qëllimeve që i cakton vetes në raport me temën e mësimi.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale.</b> Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</li> </ul>				
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e mbiemrave cilësorë, marrëdhënorë e të emëruar;</li> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit;</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për përdorimin llojeve të ndryshme të mbiemrave në situata të ndryshme.</li> </ul>			<b>Fjalët kyçe:</b>  analizë morfologjike mbiemra cilësorë mbiemra marrëdhënorë, mbiemra të emëruar	
<b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe <b>Mjete:</b> tabela, markera, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Letërsi:</b> përdor tekstet letrare, për të studiuar modele të përdorimit të mbiemrave;; <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, për vlerësim të zbatimit të rregullave të drejtshkrimit të llojeve të ndryshëm të mbiemrave.		
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit;</li> <li>• lojë mësimore;</li> <li>• tabela e mendimit;</li> <li>• punë në grupe me nga dy;</li> </ul>			<b>Koha: 45 minuta</b>	

- ditar dypjesësh;
- punë e pavarur.

### Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:


- Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Një nxënës prezanton punimin e vet. Nxënësit e tjerë plotësojnë tabelën vlerësuese, sipas rubrikave të përcaktuara në tabelë, të cilën e plotësojnë në grupe dyshe
- Në fund secili grup dyshesh jep numrin e pikëve që arrin gjatë prezantimit nxënësi që prezanton. (P.sh: pikët e fituara në tabelën më poshtë janë 8. Ato mund të konvertohen në notë (14 pikë japin notën 10). Gjithçka demonstron si **lojë** në klasë.


Trajtimi i plotë i idesë								Struktura e tekstit					
- plotësohet në mënyrë të plotë								- dallohen paragrafët sipas bërthamave					
- mbrohen përmes përvojash aftësitë e shkruarit								- teksti është koherent, sipas modelit udhëzues në tekstin e nxënësit					
- nxirren përfundime në mënyrë logjike								- mjetet gjuhësore mbështesin logjikën e tekstit)					
- teksti është bindës)													
a	a	b	b	c	c	d	d	a	a	b	b	c	c
+	-	+	+	-	-	-	+	+	+	-	+	+	-

Pyetje 1: A mund të kujtoni ç'është kategoria e nyjës?

(Nxënësit japin përgjigjet e tyre, duke sjellë shembuj të përdorimit të nyjës)

- U kërkohet nxënësve t'iu rikthehen punimeve të tyre dhe të gjejnë në to mbiemra të llojeve të ndryshme. Në tabelë paraqitet skema e mëposhtme, e cila plotësohet me raste të përdorimit të nyjave: i vogli i gjori





- Tabela plotësohet në bashkëpunim me nxënësit.
- Në tabelë shkruhet : **Shumësi i mbiemrave** dhe bashkë me nxënësit plotësohet diagrami:

Shumësi i mbiemrave ndryshon në varësi të gjinisë (rregulla prindërore rregull i qartë)

...në varësi asaj nëse ata janë të nyjshëm apo të panyjshëm (aftësitë e kërkuara, punëdhënësit paraprakë)



mbiemrat e nyjshëm të gjinisë mashkullore e bëjnë shumësin duke ndryshuar - i në - **të**; të gjinisë femërore ndryshojnë -e në - **të**

- shumësi i mbiemrave të panyjshëm të gjinisë mashkullore formohet:

duke ruajtur të njëjtën trajtë: *krijues/krijues*  
duke marrë zanoren -ë: *relativ/relativë*

me prapashtesën -nj: *ari/arinj*

- Shumësi i mbiemrave të panyjshëm femërore ruan të njëjtën trajtë me njëjës *shqetësuese/shqetësuese*

- shpjegoni rregullin për mbiemrat që përcaktojnë emra të dygjinishëm

- Nxënësit duhet të zbulojnë në tekstin e Bojaxhiut mbiemra të llojeve të ndryshme dhe duhet t'i klasifikojnë në tabelë sipas llojit.
- Gjithashtu ata duhet t'i kthejnë mbiemrat në shumës ose anasjelltas


Mbiemri	Lloji	Shumësi/njëjësi
---------	-------	-----------------

relativ	marrëdhënior	relativ
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Diskutime, vlerësime</li> <li>➤ <b>Detyrë shtëpie:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ushtrimet 1 dhe 2 në fq.147.</i> Klasa ndahet në dy grupe me një nga ushtrimet.</li> </ul> </li> </ul>		
<b>Vlerësimi i situatës</b>		<b>Vlerësimi i nxënësve:</b>
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me temën e mbiemrave;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore;</li> <li>• shpjegojnë të gjitha rastet e përdorimit të shumësit të mbiemrave nga pikëpamja e rregullave të përgjithshme.</li> </ul>		Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë në përgjigjet;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të shkruarit.</li> </ul>

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes rrëfimit</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
<b>TEMA MËSIMORE 5.2 (9)</b> <b>“LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË”</b>  <b>USHTRIME</b> <b>(VLERËSIM PORTOFOLI)</b>		<b>Situata e të nxënit Nr. 44</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, duke përcaktuar llojin udhëzues të tekstit, duke zbuluar tiparet e strukturës së këtij lloji, si dhe duke i shpjeguar.		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për llojin udhëzues, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të, përmes diskutimit mbi tekstin konkret.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi analizon struktura tekstore të llojit udhëzues,</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b> Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti që lidhet</li> </ul>				

<p>me të ardhmen e tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e realizimit të një teksti udhëzues.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje që lidhen me tekste të tipit udhëzues;</li> <li>➤ <b>Kompetenca digjitale</b> Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me tekstet udhëzuese.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës</b></p> <p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime që lidhen me tekstin udhëzues, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës në diskutime për tema të ndryshme;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të strukturës dhe gjuhës së tekstit udhëzues, si dhe analizon dhe interpreton atë;</li> <li>• shkruan qartë dhe me stil vetjak dhe në mënyrë logjike, tekste udhëzuese për qëllime të ndryshme;</li> <li>• nxënësi prezanton qartë udhëzimet në detyra të vetat me shkrim dhe me gojë</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Ligj themelor Kushtetutë Të drejta të fëmijës FJALOR</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ privatësi</li> <li>■ korrespondencë</li> <li>■ ligj</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit për tekstin; modelet e teksteve të ndryshëm udhëzues.</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, fleep-charter, markera (shkumësa me ngjyra), (kur është e mundur projektor, ose tabelë interaktive).</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi materiale të shkëputura nga tekste letrare.</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme në funksion të temës.</p> <p><b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e shoqërore, të dhëna për aspekte të jetës shoqërore ku mund të përdoren tekste udhëzuese.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim</li> <li>• punë individuale</li> <li>• punë në grupe</li> <li>• diskutim</li> <li>• shkrim i lirë</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	

- Mësimi nis me diskutimin e çështjeve të rubrikës “Përsiatje dhe endje” (*Udhëzimet e pasaportës së vjetër shqipe*) që e kishin detyrë shtëpie.
- Bëhen komente dhe vlerësime rreth tyre.
- Në këtë fazë të mësimit, nxënësve u kërkohet t’i rikthehen tekstit “Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”. Ata realizojnë krahasimin mes dy teksteve mbi teknikën e diagramit të Venit:



teksti I

teksti II

- Diskutime.
- **Në këtë fazë klasa ndahet në dy grupe**
  - Grupi i shkruan një tekst udhëzues sipas kërkesës së U. 1; fq.153 (Rubrika “Të shkruarit”):
  - Grupi II realizon një listë sipas U.2; fq.153:
- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur;
- Lexohen dy punime (një për çdo grup);
- Diskutime.
- Në këtë fazë nxënësit orientohen për grumbullimin dhe klasifikimin e punimeve të portofolit dhe vëzhgojnë tabelën e vlerësimit:

Detyra	Eseja, punë me shkrim	Projekti	Detyra shtëpie dhe klase	Mbledhje informacioni, hulumtime, krijime etj.	Portofoli
Pikët	15	20	10	5	50

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	13	13-18	19-24	25-31	32-38	39-44	45-50

**Detyrë shtëpie):**

Përsëritje për testin e tremujorit.

- *Studime të teksteve rrëfyese dhe udhëzues nga pikëpamja e teknikave të shkrimit, problemeve përmbajtësore, ndërtimit strukturor dhe çështjeve gjuhësore*

<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Studim-përsëritje e koncepteve gjuhësore: emrat, foljet, nyjat, mbiemrat në aspektet e trajtuara deri tani.</i></li> </ul>	
<b>Vlerësimi i situatës</b>	<b>Vlerësimi i nxënësve:</b>
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• diskutojnë brenda etikës së komunikimit, për të interpretuar tekstin, sipas tipareve të llojit udhëzues;</li> <li>• dallojnë tiparet e strukturës dhe gjuhës së tekstit.</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për shpjegimin e çështjeve që lidhen me kategori gjuhësore.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 6.1 (1) KARAKTERISTIKAT STRUKTURORE, GJUHËSORE, STILISTIKE TË TEKSTIT ARGUMENTUES  
TEKNIKAT E SHKRIMIT ARGUMENTUES**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes argumentimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 47</b>			
<p>Krijohet një mjedis i tillë komunikimi, ku nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi karakteristikat e tekstit argumentues. Ata përcaktojnë tiparet strukturore, gjuhësore e stilistike të këtij teksti, si dhe teknikat e shkrimit të tij, përmes ushtrimit në analiza e në shkrimin e teksteve argumentuese të llojeve të ndryshme.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon për llojet e tekstit argumentues, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të, si dhe duke diskutuar mbi informacionin për këtë temë, nxjerrë nga fushat e të nxënit (p.sh. gjuhë komunikim) ose nga jeta e përditshme.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për tekstin argumentues, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura dhe arti (arti gojor, miti, përralla, kultura antike etj.).</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p>			



Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënies të dijeve të reja në lidhje me llojin argumentues.

➤ **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësi hartoi një projekt (p.sh.: debat në lidhje me probleme të mjedisit) duke shkëmbyer mendime, duke konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar e vlerësuar burimet njerëzore, materiale e monetare në përputhje me rezultatet e pritshme.

➤ **Kompetenca personale**

Nxënësi analizoi përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit, kritikës së teksteve argumentuese si dhe realizimit të teksteve të tilla.

➤ **Kompetenca qytetare**

Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve të teksteve argumentuese që mbështetin qëllimin e tij.

➤ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative (mediat e ndryshme) duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me tekstet argumentuese.

**Rezultatet e të nxënies të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Merr pjesë në diskutime ku flet dhe argumenton për tema të ndryshme, duke pasur parasysh qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;
- përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme
- Përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të tekstit rrëfyes;
- Realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit të paragrafëve dhe teksteve argumentuese, si dhe përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij;
- Përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit argumentues dhe kur shkruan tekste argumentuese.

**Fjalët kyçe:**

argument  
fakt/opinion  
analogji  
referencë  
prova  
evidencë

**FJALOR**

- ese argumentuese
- arsyetim bindës

**Burimet:**

Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënies, materiale të shtypit të shkruar, modele të tekstit argumentues në të gjitha format e përfaqësimit, libri i nxëniesit.

**Mjete:** tabela, *fleep-charter*,



**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**

**Komunikim:** Përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij masiv.

**Histori dhe shkencat shoqërore,** për kontekstin historik dhe sociokulturor të të gjitha teksteve që studiohen nga nxënësit.


**Letërsi:** I ofron gjuhës modele të përsosura të përdorimit të gjuhës argumentuese.

**TIK:** nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar.

shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)	<b>Qytetari:</b> Përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përvijim i mendimit /Të nxënit ndërveprues</li> <li>• Skemë rreze</li> <li>• Stuhi mendimi</li> <li>• Lexim i orientuar</li> <li>• Organizues grafik</li> <li>• Praktikë e drejtuar</li> <li>• Punë në grup (dhe në çift)</li> <li>• Konsolidimi</li> </ul>	<b>Koha:</b> 45'
<b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b>	
<p>➤ Me synim përvijimin e mendimit paraqitet pamja e mëposhtme në projektor (në mungesë të projektorit, nxënësve u jepet në formate të gatshme A<sub>4</sub>)</p>	
	 <p style="text-align: center;">Mes së thënës dhe së pathënës</p>
<p>➤ Nxënësit ftohen të interpretojnë fotot dhe t'i krahasojnë ato me njëra-tjetrën. Ata nxiten të krijojnë një diçiturë (ngjashëm me atë të njëres nga fotot : <u>Mes së thënës dhe së pathënës</u>)</p> <p><b>Pyetje:</b> Ç'loj komunikimi zbulojmë në fotot në studim?</p> <p>(<b>Model:</b> komunikim përmes fjalës, gjestit, si dhe përmes heshtjes (në foton në tekst)</p> <p><b>Pyetje:</b> Pse kemi një situatë të tillë komunikimi?</p> <p>(<b>Model:</b> duket se personazhet mbajnë një qëndrim të caktuar kundrejt një çështjeje dhe secili mban qëndrimin e vet (qoftë dhe me heshtje).</p> <p><b>Pyetje:</b> Në ç'marrëdhënie kuptimore mendoni se janë fjalët me gjestin, mimikën ?</p> <p>Diskutohen përgjigjet e nxënësve në klasë.</p>	

- Në këtë situatë klasa ndahet në grupe dyshe dhe secilit i jepet një detyrë: *Mbroni qëndrimin tuaj në lidhje me veshjen e uniformës në shkollë.* (Nxënësit orientohen që, brenda grupit, të mbështetin qëndrime të kundërta, vetëm me **një argument**. Kjo situatë përgatit nxënësin për hapin e radhës.
- Mësuesi shkruan në tabelë: TEKST ARGUMENTUES dhe fton nxënësit të ndërtojnë së bashku një skemë rreze me në qendër këtë togfjalësh.

Nxënësit thonë gjithçka u kujton ky term. Mësuesi ndihmon për plotësimin e plotë të tabelës.



- Nxënësve u është kërkuar të sjellin në klasë tekste të ndryshme të llojit argumentues (artikull shkencor, fjalim, reklamë)

**Pyetje:** (duke rikujtuar njohuritë e mëparshme)

- Ç'lloj teksti ke zgjedhur?
- Çfarë trajton teksti?
- Cili është funksioni i tij?

Nxënësi do të rikujtojë njohuritë e mëparshme: *funksionin*, *qëllimin* e tekstit argumentues. (Nxënësi mund të kujtojë edhe specifikat e tekstit argumentues, si: bindës, shprehës, informues)

- Në tabelë paraqitet teksti argumentues: (ose nxënësit e lexojnë atë në libër)

### Të mbjellim në mënyrë organike

Ka shumë arsye pse duhet të dalin ligje të reja, të cilat i bëjnë metodat organike bujqësore të detyrueshme për të gjithë fermerët e Shqipërisë. Përdorimi i kimikateve toksike mund të eliminohet lehtësisht nga bujqësia. Kostot e ndryshimit janë të parëndësishme në krahasim me përfitimet dhe fitimet e shtuara për fermerët që përdorin metoda organike janë një ndër fitimet e bujqësisë organike dhe të praktikave agrikulurore të qëndrueshme. Përparimet në shkencën bujqësore dhe në teknologji e bëjnë më se të mundur që edhe fermerët shqiptarë të prodhojnë fruta dhe perime në mënyrë organike.

Shumica e kimikateve të reja që përdoren në bujqësi, janë të dëmshme për njerëzit, kafshët, tokën, ujin, ajrin dhe bimët në mjedisin ku jetojmë, ndaj nuk janë të domosdoshme. Pesticidet toksike që janë shpikur për të vrarë insektet, fare lehtë mund

të zëvendësohen nga substanca organike, si p.sh. hudhër ose ujë i pasuruar me minerale. Fertilizuesit janë të panevojshëm, nëse fermerët korrin në mënyrë periodike, përdorin plehrat natyrale dhe bimët ushqyese për të ushqyer tokën. Nëse fermerët janë të përgatitur t'i marrin parasysh këto praktika të thjeshta që përdoren me sukses që në lashtësi nga popujt e botës, ata do të kuptojnë se është më mirë të përdoren këto praktika alternative sesa të helmohet mjedisi dhe konsumatorët me agjentë toksikë dhe kimikate sintetike.

Një nga problemet kryesore që fermerët mund të ngrenë kundër praktikave organike, është kostoja e zbatimit të procedurave alternative. Megjithatë, këto shpenzime janë të rikuperueshme shumë shpejt për shkak të çmimeve më të larta me të cilat shiten prodhimet organike. Studime që vijnë nga fermat "Domatet e Gentit" (2013) dhe "Tregu i Teutës" (2015) tregojnë se shpenzimet për zbatimin e metodave organike, të vjetra e modeste, mbulohen qysh në stinën e parë të shitjes së produkteve organike. Kjo është provë bindëse që tregon se ndryshimi nga metodat helmuese tek ato organike ia vlen tërësisht.

- Organizuesi grafik i mëposhtëm gjithashtu duhet të paraqitet në tabelë (për të fituar kohë punohet me *fleep-charter* ose projektor)

Teksti përmban:

- hyrje, zhvillim, mbyllje; Paragrafë që fillojnë me një fjali kryesore;
- një linjë qendrore argumentimi që ruhet gjatë gjithë tekstit;
- detaje, fakte, shembuj (prova për argumentin);
- rimarrje të thelbit në paragrafin e fundit;
- citime nga autoritete të fushës;
- burime të tjera të besueshme;
- gjuhë të përshtatshme për audiencën së cilës i drejtohet:
  - pyetje retorike;
  - thjeshtëzim/përgjithësim;
  - përsëritje;
  - kontrasti/krahasimi;
  - gjuha emotive (nxënësit ftohen ta shpjegojnë);
  - foljet modale.

Punohet në klasë shembulli i librit, duke i tërhequr nxënësit në zbulimin e karakteristikave që lidhen me elementet që përmban skema në të majtë të tekstit.

Pyetje: *A mund të shpjegoni, duke ilustruar, cilat nga parametrat e teknikave të mësipërme të strukturës, gjuhës dhe stilit të tekstit argumentues janë zbatuar në këtë shkrim?*

- Diskutime të nxënësve:

(**Model:** tekst 1. ka hyrje, zhvillim, mbyllje, të organizuar në 3 paragrafë;

2. teza e cila mbrohet në këtë tekst.

3. çdo paragraf fillon me një fjali kryesore që shtjellohet në vijim;

- Ka shumë arsye pse duhet të dalin ligje të reja, të cilat i bëjnë metodat organike bujqësore të

detyrueshme për të gjithë fermerët e Shqipërisë.,

4. linja qendrore e argumentimit- mbështetja e përdorimit të metodave organike bujqësore....

5. në këtë linjë arsyetimi vijohet deri në fund)

➤ Në këtë fazë përpiqemi të analizojmë teknikat e shkrimit të tekstit të mësipërm, sipas **modelit në tabelë:**

(KUJDES! Mësuesi duhet të plotësojë tabelën në bashkëpunim me nxënësit përmes teknikës së **leximit të orientuar**; Tab nuk duhet të jetë e plotësuar!!!)

STRUKTURA E TEKSTIT	PJESËT E TEKSTIT	ROLI I FJALIVE
Titulli	<b>Të mbjellim në mënyrë organike</b>	Prezanton problemin dhe qëndrimin e autores/ teza parashtrohet që në titull.
<b>PARAGRAFI I</b>		
Teza	Ka shumë arsye pse duhet të dalin ligje të reja, të cilat i bëjnë metodat organike bujqësore të detyrueshme për të gjithë fermerët e Shqipërisë.	Qëndrimi i autores për çështjen/ problemin
Argumenti I	Përdorimi i kimikateve toksike mund të eliminohet lehtësisht nga bujqësia.	Mbështet tezën (shtjellohet në vijim)
Argumenti II	Kostot e ndryshimit janë të parëndësishme në krahasim me përfitimet.	Mbështet tezën (shtjellohet në vijim)
Argumenti III	Fermerët kanë fitime të shtuara.	Mbështet tezën (shtjellohet në vijim)
Përmbledhje e tezës kryesore	Përparimet në shkencën bujqësore dhe në teknologji e bëjnë më se të mundur që edhe fermerët shqiptarë të prodhojnë fruta dhe perime në mënyrë organike.	Përmbledh tezën kryesore
<b>PARAGRAFI II</b>		
Fjalja 1	Shumica e kimikateve të reja, që përdoren në bujqësi, janë të dëmshme për njerëzit, kafshët, tokën, ujin, ajrin dhe bimët në mjedisin ku jetojmë, ndaj nuk janë të domosdoshme.	Fjali kyçe e paragrafit pasi ky paragraf do të përqendrohet tek fakti që përdorimi i kimikateve mund të eliminohet. Sillet një kontrast mes metodave të reja përballë atyre të vjetrave.
Fjalja 2	Pesticidet toksike që janë shpikur për të vrarë insektet, fare lehtë mund të zëvendësohen nga substanca organike, si p.sh. hudhër ose ujë i pasuruar me minerale.	Fjalja e dytë e rimerr të njëjtën ide dhe paraqet një tjetër kontrast midis organikes dhe toksikes.
Fjalja 3	Fertilizuesit janë të panevojshëm, nëse fermerët korrin në mënyrë periodike, përdorin plehrat natyrale dhe bimët	Fjalja e tretë jep detaje konkrete me shembuj metodash që mund të

	ushqyese për të ushqyer tokën.	përdoren për të mënjanuar përdorimin e fertilizuesve.
Fjalja 4 (fjalja mbyllëse e paragrafit)	Nëse fermerët janë të përgatitur t'i marrin parasysh këto praktika të thjeshta që përdoren me sukses që në lashtësi nga popujt e botës, ata do të kuptojnë se është më mirë të përdoren këto praktika alternative, sesa të helmohet mjedisi dhe konsumatorët me agjentë toksikë dhe kimikate sintetike.	Kjo fjali lidh edhe një herë provat e dhëna me tezën për të cilën po argumentohet. Paraqet gjithashtu një kontrast midis artificiales dhe natyrales.
<b>PARAGRAFI III (i fundit)</b>		
ARGUMENT/ KUNDËR (fjalja 1) që përmbysset (në fjalinë 2)	Një nga problemet kryesore që fermerët mund të ngrenë kundër praktikave organike është kostoja e zbatimit të procedurave alternative. Megjithatë, këto shpenzime janë të rikuperueshme shumë shpejt për shkak të çmimeve më të larta me të cilat shiten prodhimet organike.	Fillon me një argument kundërshtues të cilin e "shpërbën" po aty, brenda së njëjtës fjali dhe fjalisë që vijon.
Fjalja 3	Studime që vijnë nga feramat "Domatet e Gentit" (2013) dhe "Tregu i Teutës" (2015) tregojnë se shpenzimet për zbatimin e metodave organike, të vjetra e modeste, mbulohen qysh në stinën e parë të shitjes së produkteve organike.	Paraqet raste konkrete studimi, që autorja i citon për t'i dhënë më shumë peshë argumentit të saj. Po ashtu, brenda fjalisë së tretë vëmë re sërish realizimin e një kontrasti midis së resë dhe së vjetrës.
Fjalja 4 (e fundit)	Kjo është provë bindëse që tregon se ndryshimi nga metodat helmuese tek ato organike ia vlen tërësisht.	Përmes teknikës së gjuhës emotive, me përdorimin e fjalëve "bindëse" dhe "helmuese", përpiqet t'i ngjallë lexuesit reagimin e përshtatshëm dhe ta bindë që argumentet janë të fuqishme dhe duhen dëgjuar.

**Detyrat dhe puna e pavarur:**

- U kërkohet nxënësve që të lexojnë vargjet e Migjenit dhe të përpiqen ta trajtojnë si një tekst që operon me teknikat e tekstit argumentues. Klasa ndahet në 2 grupe, sipas grupeve në modelin më poshtë dhe diskutojnë brenda grupit në çift.

**Pyetje:** Ç'mund të thoni për titullin e poemës? A ka ndonjë qëndrim të autorit në raport me objektin e komunikimit (referentin)? Nxënësit përgjigjen dhe mësuesi konkludon:

- Sqarohet titulli: **Poema e mjerimit** (tema);

**Pyetje:** Nëse do ta shihnim poemën si tekst argumentues (funksioni estetik i poemës e dallon atë

nga tekstet me funksion thjesht praktik) cila do të ishte teza e shkrimit? Po argumentet në mbështetje të saj?

- Nxënësit duhet të gjejnë **tezën** (Mjerimi është kafshatë që s'kapërdihet) dhe argumentet që sjell autori në mbështetje të saj (vargu i parë i çdo strofe).

1.

**Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi**

kafshatë që të mbetë në fyt edhe të ze trishtimi kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin të tanë jetën e vet derisa të vdesin.

**Mjerimi ka vulën e vet të shëmtueme;**

asht e neveritshme, e keqe, e turpshme; balli që e ka, sytë që e shprehin, buzët që më kot mundohen ta mfshefinjanë fëmitë e padijes e flitë e përbuzjes, të mbetunat e flliqta rreth e përçark tryezës mbi të cilën hangri darkën një qen i pamshirshëm me bark shekulluer gjithmonë i pangishëm.

**Mjerimi s'ka fat.** Po ka vetëm zhele, zhele fund e maje, flamujt e një shprese të shkymë dhe të coptuem me të dalun bese.

**Mjerimi pjek fëminë para se të burrnohet**

don ta msojë t'i iki grushtit q'i kërcnohet atij grusht që në gjumë e shtrëngon për fyti kur fillojnë kllapitë e etheve prej unit, dhe fëtyrën e fëmis e mblon hij' e vdekjes, një stoli e kobshme në vend të buzqeshjes. Një fryt kurse piqet, dihet se ku shkon q'ashtu edhe fëmia në bark të dheut mbaron.

- plotësohet tabela

2.

**Mjerimi punon, punon ditë e natë**

tu' i vlue djersa në gjoks edhe në ballë, tue u zhigatun deri në gjunjë në baltë e prap zorrët nga uja i bahen palë-palë. Shpërblim qesharak! Për qindenjë afsh në ditë- vetë: lekë tre-katër dhe "marsh!"

**Mjerimi kaiher' i ka faqet e lustrueme**


buzët e pezmatueme, mollzat e ngjyrueme trupin përmendore e një tregtis së ndytë, që asht i gjikuem të bijë në shtrat vet i dytë dhe për at shërbim ka për të marrë dy franga ndër çarçafë, ndër fëtyra dhe në ndërgjegje dranga.

**Mjerimi ka motër ngushlluese gotën.**

Në pijetore të qelbta, pranë tryezës plot zdrale të neveritshme, shpirti, me etje derdh gotën në fyt për me harrue nandhetenand' halle. Të gjitha hallet skami në gotë i mbyt kur njëqind I derdh një nga një në fyt:

**Mjerimi asht një njollë e pashlyeme**

në ballë të njerëzimit që kalon nëpër shekuj. Dhe kët njollë kurrë nuk asht e mundshme ta shlyejnë pacavrat që zunë myk ndër tempuj.



TEKNIKAT E SHKRIMIT TË TEKSTIT ARGUMENTUES		
Formati tezë/antitezë	Formati grup	Formati alternim
<b>I.Hyrja</b> (teza +antiteza) <b>II.Pjesa I</b> A. argumenti I antitezë B. argumenti II antitezë C. argumenti III antitezë <b>II.PjesaII</b> A. argumenti I pro tezës B. argumenti II pro tezës C. argumenti III pro tezës <b>III. Mbyllja</b> (rikthim te teza/ përmbledhje e argumenteve kryesore)	<b>I. Hyrja</b> (teza dhe antiteza paraqiten këtu) <b>II. Pjesa I</b> (paraqitja e tezës dhe i antitezës në literaturë) A. Paraqitja e tezës B. Argumenti i parë dhe provat C. Kundërargumenti i parë dhe provat për të D. Argumenti i dytë dhe provat E. Kundërargumenti i dytë dhe provat për të F. Argumenti i tretë dhe provat G. Kundërargumenti i tretë dhe provat për të <b>II.Pjesa II</b> (paraqitja e tezës sërish) A. Paraqitja e tezës B. Argumenti i parë i autorit dhe provat për të C. Argumenti i dytë i autorit dhe provat për të	<b>I. Hyrja</b> (teza dhe antiteza paraqiten këtu) <b>II. Zhvillimi</b> A. Paraqitja e tezës B. Argumenti i parë dhe provat C. Kundërargumenti i parë dhe provat për të D. Argumenti i parë i autorit dhe provat për të E. Argumenti i dytë dhe provat F. Kundërargumenti i dytë dhe provat për të G. Argumenti i dytë i autorit dhe provat për të H. Argumenti i tretë dhe provat për të I. Kundërargumenti i tretë dhe provat për të J. Argumenti i tretë i autorit dhe provat për të <b>III Mbyllja</b>



	D. Argumenti i tretë i autorit dhe provat për të <b>III. Mbyllja</b>	
--	---	--

➤ **Detyrë shtëpie:**

Kërkesa: *Përgatitni me shkrim një ese argumentuese për një problem që ju shqetëson.*

Klasa ndahet në 3 grupe, sipas skemave, secili grup punon esenë e tij sipas njërës nga skemat e mësipërme:

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit përgjigjen saktë në situatat në të cilat vendosen;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit argumentues (tezat , argumentet, shembujt ,gjuha etj) dhe i zbërthejnë ato konkretisht;</li> <li>• shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit që lidhen me.</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 6.1 (2) TEKSTI ARGUMENTUES BINDËS.**

**ARGUMENTIMI DHE FORMAT E TIJ. SI TË BINDIM?**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla V	Klasa 10
<b>Tematika:</b> Bota përmes argumentimit			
<b>Situata e të nxënit nr. 48</b>			
Krijohet një mjedis i tillë komunikimi, ku nxënësit vendosen në situata ku lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë karakteristikat e tekstit argumentues bindës. Ata përcaktojnë përmes veprimtarive të ndryshme argumentimin dhe format e tij.			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për një temë të caktuar, duke diskutuar mbi informacionin për këtë temë, duke mbajtur një qëndrim të caktuar kundrejt temës dhe duke shprehur opinionet e tij.			
➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b>			

Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për strukturën dhe teknikat e tekstit argumentues, ofron argumente për mbrojtjen e mendimit të tij nga fusha të ndryshme të shkencës dhe artit.

➤ **Kompetenca e të nxënit**

Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në lidhje me teknikat e organizimit të argumentimit.

➤ **Kompetenca personale**

Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të teksteve argumentuese, kritikës si dhe organizimit strukturor të tyre.

➤ **Kompetenca qytetare**

Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen dhe strukturimin e llojeve të teksteve argumentuese që mbështetin qëllimin e tij.

➤ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me tekstet argumentuese.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

Nxënësi:

- Realizon diskutime të ndryshme me gojë, duke marrë në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim mbi strukturën dhe teknikat e argumentimit, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi;
- përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj. përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit mbi mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme tek lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme
- Përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të çështjeve që lidhen me organizimin e tekstit argumentues; realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit të paragrafëve argumentues;
- Përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit argumentues dhe kur shkruan tekste argumentuese.

**Fjalët kyçe:**

Tekst argumentues  
Teknika argumentimi  
Tezë  
Fakt  
Opinion  
**FJALOR**  
eksplicit  
implicit

<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit, materiale të shtypit të shkruar, modele të tekstit argumentues në të gjitha format e përfaqësimit, libri i nxënësit</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, fleep-charter, shumësia me ngjyra (kur është e mundur projektor, ose tabelë interaktive); mjete pune të nxënësit</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Komunikim:</b> Përdor rregulla të thjeshta të komunikimit të përditshëm dhe atij masiv.</p> <p><b>Histori dhe shkencat shoqërore,</b> për kontekstin historik dhe sociokulturor të të gjitha teksteve që studiohen nga nxënësit.</p> <p><b>Letërsi:</b> I ofron gjuhës modele të përsosura të përdorimit të gjuhës argumentuese.</p> <p><b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar.</p> <p><b>Qytetari:</b> Përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përvijim i mendimit</li> <li>• rrjeti i diskutimit</li> <li>• diagrami i Venit</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• punë në grupe</li> <li>• INSERT</li> <li>• shkrim i lirë</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>	
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrës së shtëpisë.</li> <li>➤ Teknikat e mëposhtme janë sërish të afishuara në klasë, në mënyrë që nxënësit t'i kenë parasysh gjatë diskutimeve.</li> <li>➤ Diskutohen 2 punime. Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë, të plotësojnë dhe të vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës.</li> </ul>		
<p><b>TEKNIKAT E SHKRIMIT TË TEKSTIT ARGUMENTUES</b></p>		
<p><b>Formati tezë/antitezë</b></p>	<p><b>Formati grup</b></p>	<p><b>Formati alternim</b></p>

<p><b>I.Hyrja</b> (teza +antiteza)  <b>II.Pjesa I</b>  A. argumenti I antitezë  B. argumenti II antitezë  C. argumenti III antitezë  <b>II.PjesaII</b>  A. argumenti I pro tezës  B. argumenti II pro tezës  C. argumenti III pro tezës  <b>III. Mbyllja</b> (rikthim te teza/ përmbledhje e argumenteve kryesore</p>	<p><b>I.Hyrja</b> (teza dhe antiteza paraqiten këtu)  <b>II. Pjesa I</b> (paraqitja e tezës dhe i antitezës në literaturë)  A. Paraqitja e tezës  B. Argumenti i parë dhe provat  C. Kundërargumenti i parë dhe provat për të  D. Argumenti i dytë dhe provat  E. Kundërargumenti i dytë dhe provat për të  F. Argumenti i tretë dhe provat  G. Kundërargumenti i tretë dhe provat për të  <b>II. Pjesa II</b> (paraqitja e tezës sërish)  A. Paraqitja e tezës  B. Argumenti i parë i autorit dhe provat për të  C. Argumenti i dytë i autorit dhe provat për të  D. Argumenti i tretë i autorit dhe provat për të  <b>III. Mbyllja</b></p>	<p><b>I. Hyrja</b> (teza dhe antiteza paraqiten këtu)  <b>II. Zhvillimi</b>  A. Paraqitja e tezës  B. Argumenti i parë dhe provat  C. Kundërargumenti i parë dhe provat për të  D. Argumenti i parë i autorit dhe provat për të  E. Argumenti i dytë dhe provat  F. Kundërargumenti i dytë dhe provat për të  G. Argumenti i dytë i autorit dhe provat për të  H. Argumenti i tretë dhe provat për të  I. Kundërargumenti i tretë dhe provat për të  J. Argumenti i tretë i autorit dhe provat për të  <b>III Mbyllja</b></p>
---	--	---

- Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë, të plotësojnë dhe të vlerësojnë përgjigjet e shokëve, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj detyrës.
- Në këtë fazë shtrohet çështja: Përmes teknikës së **rrjetit të diskutimit**, sillen argumente për po ose jo, të cilat shkruhen në tabelë.

**A duhet zgjatur orari mësimor në shkollën shqiptare?**

<b>Po</b>	<b>Jo</b>
Pse?	Pse?

Shpjego..... /.....  
Përshkruaj..... /.....  
Informo ..... /.....

- Mësuesi i sjell të dyja variantet e tezave: Orari mësimor në shkollën shqiptare duhet të zgjatet dhe Orari mësimor në shkollën shqiptare nuk duhet të zgjatet. Ndërkaq klasifikon bashkë me nxënësit argumentet në pro dhe kundër tezave.
- Diagrami i Venit ndihmon nxënësin në të kuptuarit aktiv të dallimeve mes një teksti argumentues dhe atij argumentues bindës.

- tregon që argumenti është i vlefshëm dhe lexuesi mban qëndrimin e vet ndaj tezës -jo vetëm mbron tezën, por hedh poshtë antitezën (me argumente)
- ndryshojnë formatet e strukturës (formatet më sipër)

- kërkon të bindë që argumenti i autorit është më i forti
- autori argumenton vetëm për tezën (edhe pse mund ta paraqesë atë)
- ka vetëm një format strukture (formati i mënoshtëm)

- tekste që ngrenë një tezë dhe e mbështetin me argumente
- argumentet janë të shoqëruara me evidenca ose prova të verifikueshme të marra nga burime të besueshme
- kanë hyrje, zhvillim, mbyllje,
- kanë teknika strukture të ngjashme
- kanë gjuhë argumentuese, subjektive.
- .....

**KUJDES!** Është momenti për të nënvizuar se brenda tekstit argumentues ndeshim edhe forma të tjera të tekstit (shpjegues, përshkrues, informues).

(**Model:** nëse nxënësi do të sjellë idenë e tij se pse nuk ka qeveri nxënësish në shkollë, duhet të argumentojë se qeveria e nxënësve nuk kryen funksionet e saj apo të përshkruajë detyrat e këtij organizmi, ose të renditë informacione të aktiviteteve të papërbushura të saj.)

### Argumentim bindës

#### I. Hyrja

#### II. Zhvillimi

A. Argumenti i parë dhe provat për të


B. Argumenti i dytë dhe provat për të

C. Argumenti i tretë dhe provat për të

#### III. Mbyllja

➤ U rikthehemi argumenteve pro / kundër dënimit me vdekje.

Pyetje: Ç'është për ju një argument? Cilat janë elementet përbërëse të tij?



- Në këtë fazë nxënësit ndahen në 2 grupe të mëdha me një çështje:
  - GRUPI I: Nxënësit do të realizojnë në çift U.2, 3; fq.166 lidhur me mbështetjen ose jo të tezës: “Klasat nuk duhet të kenë më shumë se 20 nxënës”, duke zbatuar skemën e elementeve të argumentimit.
  - GRUPI II: Nxënësit duhet të ndërtojnë formatin e një teksti argumentues që trajton temën e futjes së njohurive:
    - a) për historikun e fesë në kurrikulat shkollore.
    - b) Për mësimin e lojës së Shahut në kurrikulën e gjimnazit.

Nxënësit zgjedhin një nga temat dhe gjatë punës duhet të mbajnë qëndrim, të formulojnë tezën dhe të ofrojnë tri argumente që mbrojnë këtë qëndrim.

(Nuk është e nevojshme që argumentet për këtë ushtrim të shoqërohen me shembuj e të dhëna faktike).

- Përmes metodës INSERT, përpunohet materiali teorik në tekst “Argumentimi dhe format e tij”. Nxënësit njihen me mënyrën e funksionimit të kësaj teknike:

✓	+	-	?
Informacion i njohur	Informacion i ri	Kundërshton njohuritë e mëparshme	Informacion i panjohur

- Mësuesi ndjek punën e nxënësve, orienton dhe mbështet apo sqaron ata për mënyrën se si do të punojnë.
- Mësuesi ndalet tek terminologjia dhe informacioni i ri:

**FAKTI:**

Një e dhënë që mund të mbështetet në prova

*(Klasa jonë ka 45 nxënës)*

**OPINIONI:**

Një e dhënë që mbështetet tek bindjet dhe parapëlqimet, nuk mbështetet në prova të verifikueshme.

*(Arsimi nuk ndikohet aspak nga numri i nxënësve në klasë)*

**Punë e pavarur: (shkrim i lirë)**

Pyetje: Bëni dallimin mes një teksti argumentues bindës dhe një teksti argumentues propagandistik. Provoni veten në një situatë të llojit të dytë. Zgjidhni tezën dhe propozoni tri argumente dhe fakte mbështetëse.

**Detyrë shtëpie:**

Realizoni një ese argumentuese duke u orientuar në skemën në tekst, fq. 168 për qëndrimin ndaj dënimit me vdekje.

**Vlerësimi i situatës:**

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë tiparet e strukturës dhe teknikave të shkrimit të tekstit argumentues dhe argumentues bindës dhe i zbërthejnë ato konkretisht;
- shkruajnë saktë paragrafët argumentues, sipas orientimeve të mësuesit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për saktësinë e përgjigjeve që lidhen me detyrën e shtëpisë dhe ushtrimet në klasë;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;
- për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.

**TEMA MËSIMORE 6.2 (1) A ËSHTË NË RREZIK TOKA ? XHON KRISTI**

<p><b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b></p>	<p><b>Lënda: Gjuhë shqipe</b></p>	<p><b>Shkalla V</b></p>	<p><b>Klasa 10</b></p>
<p><b>Tematika: Bota përmes argumentimit</b></p>			
<p><b>Situata e të nxënit nr. 49</b></p> <p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin, duke përcaktuar llojin argumentues, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit dhe organizimit gjuhësor të tij. Ai dallon teknikat e shkrimit argumentues përmes situatave në të cilat vendoset gjatë orës së mësimi.</p>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për llojin argumentues, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të; diskuton mbi tekstin konkret, duke analizuar dhe vlerësuar tiparet e tij</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e tekstit argumentues, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura, arti dhe shkenca</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b> Nxënësi demonstroi shkathhtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja, në lidhje me llojin argumentues</p> <p>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të tekstit argumentues, kritikës së këtij lloji dhe ushtrimit në shkrime të këtij lloji .</p> <p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojit argumentues, që mbështet qëllimin e tij.</p>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me llojin e tekstit argumentues, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit argumentues konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda këtij konteksti, duke dalluar tekstin argumentues nga ai argumentues bindës;</li> <li>• parafrazon pjesë nga tekste argumentues (bindës ose jo)</li> <li>• përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin argumentues;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>		<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Tekst argumentues Ngrohje globale njolla diellore</p> <p>FJALOR skeptik karibu</p>	



<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit: fragment ("A është në rrezik toka?- Xhon Kristi), materiale nga interneti, apo media të tjera që lidhen me temën</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga Xh.Kristi.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga "Jeta ime"</p> <p><b>Letërsi:</b> përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar</p> <p><b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p> <p><b>Histori:</b> nxënësi përdor njohuritë për periudha dhe personalitete të ndryshme historike për të analizuar dhe për të vlerësuar tekste e vepra të ndryshme letrare.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim mbi detyrën</li> <li>• vëzhgim/debat</li> <li>• praktikë e udhëhequr hap pas hapi</li> <li>• lexim me ndalesa</li> <li>• punë në grupe (praktikë e drejtuar)</li> <li>• punë e pavarur (shkrim i lirë)</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Mësuesi kërkon nga <b>2 nxënës</b> të lexojnë punimet e tyre. Ndërkaq nxënësit e tjerë vlerësojnë duke iu referuar parametrave të mëposhtëm, të cilat paraqiten në tabelë përgjatë diskutimit. Ata mbajnë shënime gjatë procesit të dëgjimit, për të diskutuar më pas për punimet.</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin: 10px 0;"> <p>A mbahen parasysh gjatë realizimit të punimit të shokut, orientimet mbi realizimit të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Problemit që qëndron në bazë të diskutimit dhe që zakonisht ndërtohet me pyetje;</li> <li>❖ Tezës kryesore të mbështetur nga autori: Dënimi me vdekje është i dëmshëm e i padrejtë,</li> <li>❖ Dallimit të tezës kryesore nga teza të tjera dytësore.</li> <li>❖ Dallimit të kundërtezës.</li> <li>❖ Mbështetjes së tezës kryesore përmes: <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> të dhënave faktike (dënimi me vdekje në shtetet ku është i ligjshëm, nuk e frenon krimin + statistika);</li> <li><input type="checkbox"/> parimeve universale të referimit (nuk është e ligjshme ta privosh njeriun nga e drejta universale e jetës);</li> <li><input type="checkbox"/> mendimeve nga autorë të njohur (edhe Zhan Zhak Ruso, Albert Kamy...);</li> <li><input type="checkbox"/> edhe bindjeve vetjake (vetëm edukimi dhe kushte më të mira jetese mund ta parandalojnë krimin);</li> <li><input type="checkbox"/> shembujve metaforikë;</li> <li><input type="checkbox"/> analogjive etj.</li> </ul> </li> </ul> </div> <p>➤ Më pas mësuesi shkruan temën e mësimin në tabelë: <b>A ËSHTË NË RREZIK TOKA?</b></p> <p>➤ Nxënësit ftohen të vëzhgojnë foton në tekst, në fq.169 (ose foto të nxjerra nga interneti sipas</p>	

modelit më poshtë, të cilat mund t'u kërkohe nxënësve t'i sjellin në klasë për të diskutuar rreth problemit)



Pyetje: Bëni një interpretim tuajin mbi foton.

Nxënësit janë të lirë të sjellin interpretimet e tyre. (**Model:** Të gjitha interpretimet orientohen drejt idesë se natyra është e bukur dhe madhështore, ajo ka ligjet e veta të zhvillimit, por njeriu dhe zhvillimi industrial po e ndotin mjedisin në atë masë që po e çojnë drejt shkatërrimit)

Mësuesi ndan nxënësit në grupe debati me temë:

**A ËSHTË NË RREZIK TOKA ?**

**PO** (Pse?) **JO** (Pse?)

**KUJDES!**

Debati përcakton që njëri grup duhet (pavarësisht se si e kanë bindjen pjesëtarët e grupi në raport me temën) të pohojë dhe tjetri të mohojë përmes argumenteve.

➤ Në këtë fazë, përmes teknikës së praktikës së udhëhequr hap pas hapi, nxënësit do të lexojnë me ndalesa tekstin "A është në rrezik toka".

- Arsyetimi nis me **titullin**.

Pyetje: Arsyetoni mbi tiparet e titullit të këtij teksti? Çfarë prisni të sjellë autori në këtë shkrim?

Nxënësit do të sjellin idetë e tyre (**Model:** është një pyetje, që sikurse është tipike për tekstin argumentues shtron problemin. Duket se problemi lidhet me rrezikun për shkatërrimin e tokës.)

Teksti lexohet në klasë me zë nga nxënës të ndryshëm dhe mësuesi ndërhyr herë pas here, për të sqaruar, komentuar, diskutuar, apo për të ndërtuar pyetje që lidhen më pjesët e veçanta të tekstit. Kjo mënyrë kërkon që nxënësit të parafrazojnë tekstin.

- **Ndalesa e parë:** lexohet paragrafi i parë dhe i dytë. Nxënësve u kërkohe të përcaktojnë raportin mes titullit dhe frazës së parë të tekstit. (**Model:** fraza e parë është një përgjigje për pyetjen e shtruar në titull)

Pyetje 1: Cili është mendimi që shpaloset në paragrafin e parë? (**Model:** autori i referohet një reviste për të parashtruar mendimin se në tokë po ndodhin ndryshime të ngadalta por të pandalshme. Gjithashtu ai vëren se ka studiues skeptikë që e vënë në dyshim këtë pohim por që nuk e shohin veçanërisht të rëndësishëm rolin e njeriut)

Pyetje 2: A mund të dallojmë në këtë paragraf qëndrimin e autorit në raport me çështjen? Si e dallojmë

këtë? (**Model:** autori mbështet idenë e sjellë nga revista shkencore,. Kjo duket kur ai pohon se këtë fakt e kundërshtojnë të tjerët (skeptikët jep një ngjyresë të dukshme kundërshtuese ndaj qëndrimit të autorit).

Pyetje 3: *A mund ta konsiderojmë këtë pohim si tezë që kërkon të mbështesë autori i tekstit?* (Sillen përgjigje të cilat do t'i çojnë nxënësit përmes arsytimit, që Kemi vënë në lëvizje një ortek ndryshimesh të ngadalta por të pandashme është teza që do të mbrojë autori).

- Kërkesë: *A mund t'i shënojmë me ngjyrë blu pohimet në mbështetje të tezës dhe me të kuqe ato që kundërshtojnë temën?* (Nxënësit gjatë leximit nënvizojnë sipas orientimit)

Pyetje 1: *Çfarë funksioni kryen pyetja retorike: Pse këto mos pajtime?* (**Model:** nxit kërkshërinë e lexuesit, e bën atë pjesë të diskutimit të çështjes, sinjalizon një shpjegim pasardhës)

Pyetje 2: *Çfarë qëndrimi mbështesin shpjegimet e paragrafit të dytë (Pohojnë apo mohojnë tezën)?*

- **Ndalea e dytë:** Lexohen tre paragrafët e fragmentit nën nëntitullin “*A po ngrihen vërtet temperaturat*” Nxënësit duhet të nënvizojnë sipas orientimit argumentet pro dhe kundër tezës .
  - Kërkesë: *Nënvizoni me ngjyrë jeshile të gjitha referencat që mbështesin argumentet apo kundërargumentet.*

Pyetje1: *Ç'rol luan sipas jush nëntitulli i sjellë në këtë rast?* Nxënësit japin idetë e tyre. (**Model:** nëntitulli vjen si argument i autorit në mbështetje të tezës së tij, që më pas mbrohet mes shembujsh nga shkenca apo nga përvojat njerëzore, apo kundërshtohet nga kundërargumentet )

Pyetje 2: *Ç'rol luajnë referencat e këtij paragrafi? Ç'ndikim kanë ato tek audienca?* (**Model:** kemi triv referenca – raporti i KNNK, dëshmia e Klifordit dhe të dhënat e 2007 – që mbështesin argumentin e sjellë nga autori. Rrisin besueshmërinë tek audienca)

- **Ndalea e tretë:** lexim i paragrafëve nën nëntitullin: “*Efekti serrë- Thelbësor për jetën*” . Nxënësit duhet të vijojnë me nënvizimet e bëra.

Pyetje 1: *Nga pikëpamja e ndërtimit ç'lloj nëntitulli kemi në këtë rast? Ç' funksion kryen një titull i tillë?* (**Model:** titulli është eliptik, mungesa e foljes ngjesh mendimin dhe e fokuson lexuesin tek thelbi dhe rëndësia e tij)

Pyetje 2: *Cilat janë shembujt, provat, referencat që vijnë në mbështetje të argumentit të ri? Si lidhen ato me tezën? Cilin argument të saj mbështesin ato?* (**Model:** ref: shpjegimet shkencore për energjinë diellore, ndikimin e lëndëve ndotëse, ndryshimi i përqendrimit të gazrave në atmosferë, metani dhe protoksidi i azotit...etj. Ato mbështetin argumentin e sjellë në titull, i cili vjen në mbështetje të tezës që mbron autori në raport me pyetjen e shtruar në titullin e pjesës.)

- **Ndalea e katërt:** lexim i paragrafëve nën nëntitullin: “*Thjesht luhatje?*”. Nxënësit duhet të parafrzojnë informacionin e këtij paragrafi. Mësuesi ndërton pyetje në ndihmë të diskutimit. Pasi kanë nënvizuar sipas orientimit, nxitet diskutimi.

Pyetje 1: *Cila është fjala kyçe e këtij paragrafi?* (Luhatje)

Pyetje 2: *Shpjegoni funksionin e nëntitullit në këtë rast: A e mbështet apo e kundërshton ai tezën? Po fakti që ndërtohet me pyetje ç ide krijon tek lexuesi?*

(**Model:** Ky nëntitull është kundërargument, që provohet nga shembujt më pas. E sjellë në formë pyetje ndikon tek lexuesi, për të ngritur dyshime mbi të dhe për ta bërë lexuesin aktiv ndaj çështjes)

Pyetje 1: *Zbuloni se si autori në këtë pjesë shfrytëzon argumentimin përmes teknikës së*

*krahasim/kontrastit. Ç'përfytyrime ju krijohen nga ky organizim?*

(**Model:** Zbulohet ky qëndrim që në paragrafin e parë të fragmentit, kur hidhet shikimin në kohë për ndryshimet klimaterike, për ta krahasuar me të sotmen )

➤ Tani u lihet në dorë nxënësve arsyetimi. Klasa ndahet në dy grupe. Secili grup ka detyrat e tij.

- **Grupi I:** gjatë leximit të fragmentit "Modele të klimës" duhet:
  - të vijojë më nënvizimet
  - të arsyetojë mbi llojin emëror të nëntitullit dhe funksionin e tij

Pyetje 1: *Gjeni foljet modale dhe tregoni rolin që ato luajnë në tekst.*

Pyetje 2: *Autori përsërit fjalë apo fraza kyçe. Amund t'i zbuloni ato dhe të nxirrni përfundime?*

- Kërkesë: Përpiquni të ngrini pikëpyetjet tuaja mbi tekstin dhe të ndërtoni pyetje për auditorin. (nxënësit duhet të ngrenë pyetje për klasën dhe të prezantojnë disa prej tyre.)

Pyetje 3: *Në revistën "Shkenca" thuhet që "sistemi klimatik mund të sjellë surpriza2. Për çfarë surprizash bëhet fjalë? Thoni disa prej tyre.*

- **Grupi II:** gjatë leximit të fragmentit "A janë të besueshme modelet?" duhet:
  - vijojë më nënvizimet
  - të arsyetojë mbi llojin e nëntitullit dhe funksionin e tij

Pyetje: 1. *Evidentoni lidhëzat e përdorura. Cili është roli i tyre në këtë tekst? (Lidhin pjesë fjalisie, ide, paragrafë)*

Pyetje 2: *Cili është funksioni i paragrafit përmbyllës në raport me tezën dhe argumentet. A mund të shihet si paragraf përmbyllës ai? Pse?*

Pyetje 3: *Zbuloni në paragraf shembuj të gjuhës emotive dhe shpjegoni ngjyresat që fiton teksti. (P.sh: për të ndenjtur duarkryq)*

Diskutohen për gjigjet e grupeve në klasë.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Klasa ndahet në dy grupe.

- **GRUPI I: U.16, fq.173** (shënimet e mbajtura gjatë leximit do t'u vijonë në ndihmë nxënësve për të plotësuar tabelën e mëposhtme, e cila u paraqitet nxënësve.
- **GRUPI II: U:17, fq. 17**

	<b>Në tekst</b>	<b>Funksioni</b>
<b>Titulli</b>	A është në rrezik toka?	Tërheq vëmendjen tek problemi që do të trajtohet.
<b>Hyrja</b>	Dy paragrafë	Shton problemin, tezën, paraqet me shembuj pas çdo fjalie qëndrimet lidhur me çështjen
<b>Teza</b>	Kemi vënë në lëvizje një ortek ndryshimesh të ngadalta por të pandalshme	Qëndrim i autorit ndaj temës. (Vini re ngjyresat emotive)
<b>Paragrafi I</b>		
<b>Titulli</b>	A po ngrihen vërtet temperaturat?	Çështja për diskutim që shtjellon (mbështet) temën.
<b>Argumente pro</b>		
<b>Referenca mbështetëse</b>		
<b>Argumente kundër</b>		
<b>Referenca mbështetëse</b>		
<b>Paragrafi II</b>		
<b>Paragrafi III</b>		
<b>Paragrafi IV</b>		
<b>Paragrafi V</b>		
<b>Mbyllja</b>		

KUJDES! Nëse nuk mjafton koha, kjo detyrë lihet të përfundohet në shtëpi.

**Detyrë shtëpie:**




- Shfrytëzoni materiale nga interneti apo burime të tjera informacioni mbi jetën e dhe kontributet e Xhon Kristit, për të provuar interesin e shkencëtarëve për ngrohjen globale
- Materialet mbi jetën e autorit përdorini për të ndërtuar skedën e autorit.

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit argumentues dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin “ a është në rrezik toka?”</li> <li>• shkruajnë drejt tezat, argumentet, referencat, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja dhe mënyrën si i përcjellin ato</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit dhe debatit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

## TEMA MËSIMORE 6.2 (2) “A ËSHTË NË RREZIK TOKA?” XHON KRISTI GJYMTYRËT E FJALISË


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla V	Klasa 10
<b>Tematika:</b> Bota përmes argumentimit			
<b>Situata e të nxënësve nr. 50</b>			
Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me gjymtyrët kryesore dhe të dyta të fjalisë, duke u ushtruar në ushtrime konkrete me to.			
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit dhe drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, tekste argumentues bindës etj.;</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga fusha e gjuhës (gjymtyrët e fjalisë);</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënësve</b></p> <p>Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, sipas qëllimeve që i cakton vetes.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave gjuhësore, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;</p>			
<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>			<b>Fjalët kyçe:</b>
Nxënësi:			Analizë sintaksore
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin</li> </ul>			Gjymtyrë të fjalisë

<p>e gjymtyrëve të fjalisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për gjymtyrët kryesore dhe të dyta të fjalisë, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstin “ A është në rrezik toka? ”</li> </ul>	<p>Gjymtyrë kryesore dhe të dyta Rregulla të drejtshkrimit të gjymtyrëve të fjalisë.</p>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe, <b>Mjete:</b> fleep-charter (projektor), tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti “A është në rrezik toka?”</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Letërsi:</b> përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes, si dhe forma të ndryshme të fjalive të thjeshta e të përbëra. <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi që lidhen me gjymtyrët e fjalisë.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• tabela e mendimit</li> <li>• bisedë e kombinuar me shpjegim, DDM</li> <li>• punë e pavarur,</li> <li>• punë në grupe</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexohen nga nxënësit dy punime, dhe diskutohet mbi mënyrën e realizimit të kërkesës për të sjellë të plotë skedën e autorit të tekstit “A është në rrezik toka”</li> <li>• Nëse në orën e mëparshme nuk ishte përfunduar puna e pavarur për skemën e strukturës së tekstit “A është në rrezik toka”, mësuesi i kthehet edhe asaj kërkesë.</li> </ul> </li> <li>➤ Përmes teknikës <u>stuhi mendimi</u>, nxënësve u kërkohet të rikujtojnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ç’është fjalia?</li> <li>• Ç’lloj fjalish kemi nga pikëpamja e kuptimit?</li> <li>• Sa lloj fjalish kemi nga pikëpamja e ndërtimit?</li> </ul> </li> <li>➤ Në bashkëpunim me nxënësit ndërtohet <u>organizuesi grafik</u></li> </ul>	



- U kërkohet nxënësve të nënvizojnë nga 3 fjali të thjeshta dhe tre të përbëra në tekstin “A është në rrezik toka”
  - Kërkesë: *Nënvizoni me të kuqe fjalitë e thjeshta dhe me blu fjalitë e përbëra.*
- Diskutime në klasë
- Në këtë fazë të mësimin shkruhet në tabelë **Fjalja**, dhe ftohen nxënësit përmes pyetjesh të rikujtojnë gjymtyrët e fjalisë





grup emëror		një fjalie të përbërë: <i>U pa qartë (cila, çfarë?) se planeti tokë është në rrezik</i>
Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë...	Sa lloj kallëzuesish kemi për nga ndërtimi?	Kallëzuesit klasifikohen në: të thjeshtë dhe të përbërë (shembuj)
Kundrinori ---		

### Detyrat dhe puna e pavarur:

- Nxënësit ndahen në tre grupe dhe secili nga grupet punon përkatësisht me fragmentet (“A po ngrihen vërtet temperaturat?”, “Efekti serë- thelbësor për jetën” dhe “Thjesht një luhatje”), sipas kërkesave të U.1, fq.175 dhe U.2, fq 176.

Gjymtyra	Fjala në tekst	Lloji/ Me se shprehet
Kryefjala	Temperaturat	Emër (gjinia, numri,...
Kallëzuesi		
Kundrinori		
Rrethanori		
Përcaktori		
Ndajshtimi		
Përcaktori kallëzuesor		

### Detyrë shtëpie:


Realizoni një shkrim të shkurtër argumentues, sipas kërkesës së U.5, fq.173.

Kujdesuni të përdorni fjali të plota, të përbëra dhe gjymtyrë të dyta nga të gjitha llojet. Nënvizoni nga tre tipe gjymtyrësh në tekstin tuaj.


Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me trajtimin e gjymtyrëve të fjalisë</li> <li>shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore fjalët e fjalitë</li> <li>analizojnë drejt funksionet e gjymtyrëve të fjalisë, si dhe përcaktojnë drejt me se shprehen ato</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>për pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja</li> <li>për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit</li> <li>për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 6.2 (3) "A ËSHTË NË RREZIK TOKA?" XHON KRISTI PËRSHTATJA E KALLËZUESIT ME KRYEFJALËN**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes argumentimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 51</b>			
Krijohen situata të tilla ku nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me kryefjalën, kallëzuesin dhe përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit që lidhen me përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën, në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, letër formale dhe joformale, shkrim argumentues etj.;</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi që lidhet temën e përshtatjes së kallëzuesit me kryefjalën;</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b></p> <p>Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për mënyrën e ndërtimit dhe shkrimit drejt të fjalive për të kryer një veprim, aktivitet apo detyrë, sipas qëllimeve të caktuara.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b></p> <p>Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b></p> <p>Nxënësi gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin e duhur për përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të kallëzuesit, kryefjalës dhe rregullave të përshtatjes së kallëzuesit me kryefjalën;</li> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit të teksteve të ndryshme,</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin, përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstin "A është në rrezik toka?" dhe tekste të tjera letrarë ose joletrarë.</li> </ul>		<p>Analizë sintaksore Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën; Rregulla të drejtshkrimit të fjalive të thjeshta dhe të përbëra. <b>FJALOR:</b> këpujë</p>	

<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, modele tekstesh të llojit letrar dhe joletrar, fjalori i gjuhës shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> fleep-charter (projektor), tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst nga Xh.Kristi.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes dhe për të përmbushur rezultatet e të nxënësit të kësaj ore</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim mendimi /</li> <li>• vëzhgim për interpretim</li> <li>• praktikë e udhëhequr</li> <li>• diskutim/ organizues grafik</li> <li>• tabela e mendimit</li> <li>• punë në grupe,</li> <li>• punë individuale e pavarur</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Lexohen nga nxënësit dy punime dhe <u>diskutohet</u> me nxënësit mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mënyrën e realizimit,</li> <li>• teknikat e shkrimit të esesë argumentuese,</li> <li>• ndërtimin drejt të strukturës së esesë,</li> <li>• analizën e gjymtyrëve të dyta në tekstet e krijuara nga nxënësit.</li> </ul>	
	<p>Pyetje: Çfarë e vë në lëvizje trupin e njeriut? (gjymtyrët)</p> <p>Pyetje: A e ndeshim këtë fjalë si term gjuhësor? Në ç'kontekst? (gjymtyrët e fjalisë)</p> <p>Pyetje: Në cilin rast ajo ka kuptim të figurshëm dhe mbi ç'bazë ndërtohet figurshmëria? (Në rastin e përdorimit në fushën e gjuhës. Figura ndërtohet mbi bazën e ngjashmërisë së funksionit: Gjymtyrët e përbëjnë fjalinë dhe e vënë në lëvizje, sikurse gjymtyrët e njeriut e vënë në lëvizje atë)</p>
<p>➤ Në tabelë shkruhen <u>fjalitë e mëposhtme</u> të shkëputura nga teksti "A është në rrezik toka?":</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Gjithsesi rritja e temperaturës po e bën të pamundur mënyrën tradicionale të jetesës</li> <li>2. Shkaqe të mundshme janë njollat diellore dhe shpërthimet diellore.</li> <li>3. Përqendrimi i gazrave të efektit serë në atmosferë është rritur ndjeshëm gjatë 250 viteve të fundit</li> </ol> <p>Mësuesi përgatit skemën më poshtë për fjalinë e parë:</p>	


**Fjalja:** Gjithsesi rritja e temperaturës po e bën të pamundur mënyrën tradicionale të jetesës




- **Kërkesë:** A mund të ndërtojme skemën e fjalive të tjera sipas këtij modeli?

(Model)

**Fjalja:** Shkaqe të mundshme janë njollat diellore dhe shpërthimet diellore



- Në këtë fazë, pas rikujtesës së grupeve emërore dhe foljore në fjali, mësuesi tërheq vëmendjen tek llojet e kallëzuesve në fjalitë e mësipërme. Plotësohet tabela e mendimit:



**Përshtaten me kryefjalën sipas rregullave :**

- Kur kryefjala shprehet me emër (përemër) përshtatet në vetë dhe në numër (Nxënësit do të japin shembuj nga teksti: *(Modeli u krijon mundësi shkencëtarëve për të bërë studime të ndryshme. /Ata që nuk e besojnë se .....* )
- Kur kryefjala është në numrin njëjës edhe kallëzuesi foljor (emëror) është në numrin njëjës (Nxënësit do të japin shembullin: *Modeli u krijon mundësi shkencëtarëve për të bërë studime të ndryshme*). E njëjta situatë edhe kur kryefjala është në shumës.

- Kur kryefjala shprehet me grup emëror, po ashtu kallëzuesi do të ndjekë vetën dhe numrin e emrit (përemrit) brenda grupit emëror (*Gjithsesi rritja e temperaturës po e bën të pamundur mënyrën tradicionale të jetesës – rritja (emri)*)
  - Kur kryefjala shprehet me gjymtyrë homogjene emra, kallëzuesi do të përshtatet në numrin shumës (*Piktura e parë dhe e dytë më pëlqyen shumë.*)
  - Kur kryefjala shprehet me gjymtyrë homogjene përemra (ose emër + përemër), nëse në përbërje të kryefjalës ka një përemër në vetën e parë, kallëzuesi përshtatet edhe në vetë me përemrin e vetës së parë. (*Unë dhe ai ngjitemi çdo të dielë në mal/ Ata dhe ne mbollëm pemë dekorative për shkollën/ Altini dhe unë shkuam në kinema*) Nxiten nxënësit të sjellin shembuj të tjerë.
  - Kur kryefjala shprehet me gjymtyrë homogjene përemra (ose emër + përemër), nëse nuk ka në përbërje të grupit të kryefjalës përemra në vetën e parë, kallëzuesi përshtatet në vetën e dytë. (*Ti dhe ai do të shkoni në koncert/ Ju dhe djemtë do të ndihmoni në mbjelljen e pemëve të kopshtit*) Nxiten nxënësit të sjellin shembuj të tyre.
- Në këtë fazë nxënësit ndahen në grupe dhe punojnë me U.1; fq.177. Nxënësit duhet të gjejnë dhe të nënvizojnë me të kuqe kallëzuesit foljorë dhe me blu ata emërorë; do të veçojnë kallëzuesit e përbërë.
- Sipas tabelës më poshtë do të analizojnë kallëzuesit në raport me përshtatjen me kryefjalën.

Lloji i kallëzuesit		Analiza e përshtatjes.
i thjeshtë foljor		
1.	....betoni dhe çeliku e thithin kollaj nxehtësinë...	Përshtatje në numrin shumës
2.		
3.		
i thjeshtë emëror		
1.	Një arsye është shtimi i efektit serë.	Përshtatje në numër /vetë
2.		
3.		
i përbërë emëror		
1.	Përqendrimi i gazrave është rritur ndjeshëm gjatë....	Përshtatje në numër dhe vetë
2.		
3.		
i përbërë foljor		
1.		
2.		
3.		

#### Detyrat dhe puna e pavarur:

- Nxënësit plotësojnë në tekstin e nxënësit U.5; fq. 177
- Ushtrimi diskutohet në klasë.


**Detyrë shtëpie:** Shkëputni dy paragrafë nga një tekst letrar dhe analizoni përshtatjen e kallëzuesit (të të gjitha formave) me kryefjalën. Ndërtoni një tabelë organizuese, sipas modelit të punës në klasë.

KUJDES! Mësuesja mund ta sugjerojë veprën në përputhje me nivelin e nxënësve

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve me gojë që lidhen me temën</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore</li> <li>• analizojnë drejt përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime në grup dhe në klasë</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Tematika: Bota përmes argumentit	Shkalla: V	Klasa: X
<p><b>TEMA MËSIMORE 6.2 (5)</b> <b>RELAMA SI TEKST ARGUMENTUES</b></p>		<p><b>Situata e të nxënësve Nr. 49</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi reklamën, duke përcaktuar llojin argumentues, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit dhe organizimit gjuhësor.</p>		
<p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b></p>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për reklamën, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të; diskuton mbi një reklamë konkrete, duke analizuar dhe vlerësuar tiparet e tij</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e reklamës, si dhe ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënësve</b> Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënësve të dijeve të reja, në lidhje me llojin argumentues të reklamës.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të një reklame.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. duke shfrytëzuar njohjen e reklamës si lloj argumentues.</li> </ul>				
<p><b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës</b></p>				<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Reklamë</li> </ul>



<p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me reklamën si tekst argumentues, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së reklamës, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda këtij konteksti;</li> <li>• parafrazon pjesë nga tekste reklamash të ndryshme;</li> <li>• përdor strategji të ndryshme për të planifikuar prodhimin e një reklame;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Shërbim postar</li> <li>■ Imazh reklamues</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit: fragment (“REKLAMË PËR SHËRBIM POSTAR”), materiale nga interneti, apo media të tjera që lidhen me temën</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga reklama.</p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës në një reklamë</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit të reklamës</p> <p><b>Qytetari:</b> nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p> <p><b>Histori:</b> nxënësi përdor njohuritë për zhvillimin e reklamës në periudha historike të ndryshme.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vëzhgim/diskutim</li> <li>• praktikë e udhëhequr hap pas hapi</li> <li>• lexim me ndalesa</li> <li>• punë në grupe (praktikë e drejtuar)</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Mësuesi paraqet një reklamë (poster) dhe fton nxënësit të diskutojnë mbi përmbajtjen dhe formën e këtij teksti.</p> 	



- Ndërkaq nxënësit e tjerë vlerësojnë duke iu referuar parametrave të mëposhtëm, të cilat paraqiten në tabelë përgjatë diskutimit. Ata mbajnë shënime gjatë procesit të dëgjimit, për të diskutuar më pas për punimet.

- ❖ A tërhiqet vëmendja e lexuesit nga teksti?
- ❖ A e detyron ai dëgjuesin të shprehë interes gjatë gjithë pjesës?
- ❖ A krijon teksti dëshirën për produktin që po reklamohet?
- ❖ A mbyllet teksti me një thirrje për veprim?
- ❖ Si e shpalos reklama origjinalitetin e saj?
- ❖ A përmban reklama ide të ndryshme?
- ❖ Si e kalon reklama lexuesin nga njëra ide te tjetra?
- ❖ A ka detaje mbështetëse që zhvillojnë një ose disa ide më tej?
- ❖ Cilat janë vlerat artistike dhe stilistike të reklamës?

- Shkruhet tema e mësimit në tabelë: **REKLAMË PËR SHËRBIM POSTAR**
- Nxënësit ftohen të vëzhgojnë foton në tekst, në fq.178 (ose foto të nxjerra nga interneti sipas modelit më poshtë, të cilat mund t'u kërkohen nxënësve t'i sjellin në klasë për të diskutuar rreth çështjes).
- Në këtë fazë, përmes teknikës së praktikës së udhëhequr hap pas hapi, nxënësit do të diskutojnë mbi reklamën mbi bazë të çështjeve që shtron mësuesi:
  - Për ç'produkt është ndërtuar reklama? Shpjegoni zgjedhjen tuaj.
  - Duke e trajtuar këtë tekst (imazh) si argumentues, zbuloni tezën.
  - Cilat janë detajet mbështetëse të tezës?
  - Vlerësoni vlerat artistike. Cilat janë mbresat që ju krijohen përmes ngjyrave?
- Më pas u lihet në dorë nxënësve arsyesimi. Secili nxënës punon me një pyetje të tekstit (nga Pyetja 1 deri në Pyetjen 12). Atyre u lihen disa minuta për të përgatitur përgjigjen dhe menjëherë fillojnë diskutimet.
- Nxënësit lejohen ta thonë idenë e tyre siç e mendojnë ;
- Nxënësit e tjerë mbajnë shënime për të organizuar më pas diskutime mbi bazë argumentesh mbështetës për secilin qëndrim.
- **Detyrat dhe puna e pavarur:** Klasa ndahet në dy grupe, për të punuar me një nga çështjet:
  - **GRUPI I: U.1; fq.180**
  - **GRUPI II: U.2; fq.180**
- **KUJDES!** Nëse nuk mjafton koha, kjo detyrë lihet të përfundohet në shtëpi.
- **Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4; fq. 180.**

Vlerësimi i situatës

Vlerësimi i nxënësve:


<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit argumentues dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin konkret;</li> <li>• shkruajnë drejt tezat, argumentet, referencat, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit dhe debatit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>
---	--

<p><b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b></p>	<p><b>Lënda: Gjuhë shqipe</b></p>	<p><b>Tematika: Bota përmes argumentit</b></p>	<p><b>Shkalla: V</b></p>	<p><b>Klasa: X</b></p>
<p><b>TEMA MËSIMORE 6.2 (6) RELAMA SI TEKST ARGUMENTUES FJALIA DËFTORE</b></p>		<p><b>Situata e të nxënit Nr: 54</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi reklamën, duke përcaktuar llojin argumentues, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit dhe organizimit gjuhësor. Ata analizojnë fjalitë sipas kumtimit, duke u ndalur tek fjalia dëftore.</p>		
<p style="text-align: center;"><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për reklamën, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të; analizon fjalitë dëftore për nga kumtimi dhe ndërtimi.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e reklamës, si dhe përdorimit të strukturës së fjalisë dëftore në një reklamë.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b> Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja, në lidhje me fjalitë dëftore.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të një reklame, si dhe në ndërtimin për funksione të caktuara të fjalive dëftore.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e reklamës si lloj argumentues.</li> </ul>				

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës</b></p> <p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me fjalitë dëftore dhe funksionet e saj;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së fjalive dëftore;</li> <li>• parafrazon pjesë nga tekste reklamash të ndryshme për nga struktura e fjalive;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Reklamë</li> <li>■ Shërbim postar</li> <li>■ Imazh reklamues</li> <li>■ Fjali dëftore</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit: fragment (“REKLAMË PËR SHËRBIM POSTAR”), materiale nga interneti, apo media të tjera që lidhen me temën <b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga reklama. <b>Letërsi:</b> përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës në një reklamë <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit të reklamës dhe përdorimit të fjalive dëftore në to.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lexim /diskutim</li> <li>• stuhi mendimi/ pema e mednjes</li> <li>• lexim teksti i orientuar</li> <li>• punë në grupe (praktikë e drejtuar)</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi fillon me detyrën e shtëpisë: nxënësit kanë sjellë reklamat e tyre dhe i paraqesin në klasë.</li> <li>➤ Ndërkaq nxënësit e tjerë vlerësojnë duke iu referuar parametrave të mëposhtëm, të cilat paraqiten në tabelë përgjatë diskutimit. Ata mbajnë shënime gjatë procesit të dëgjimit, për të diskutuar më pas për punimet.</li> </ul> <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin-top: 10px;"> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ A tërhiqet vëmendja e lexuesit nga teksti?</li> <li>❖ A e detyron ai dëgjuesin të shprehë interes gjatë gjithë pjesës?</li> <li>❖ A krijon teksti dëshirën për produktin që po reklamohet?</li> <li>❖ A mbyllet teksti me një thirrje për veprim?</li> <li>❖ Si e shpalos reklama origjinalitetin e saj?</li> <li>❖ A përmban reklama ide të ndryshme?</li> <li>❖ Si e kalon reklama lexuesin nga njëra ide te tjetra?</li> <li>❖ A ka detaje mbështetëse që zhvillojnë një ose disa ide më tej?</li> <li>❖ Cilat janë vlerat artistike dhe stilistike të reklamës?</li> </ul> </div>	

- Shkruhet tema e mësimit në tabelë: **FJALIA DËFTORE**.
- Nxënësit ftohen të rikujtojnë njohuritë mbi fjalinë dëftore. Në tabelë paraqitet skema

### FJALIA DËFTORE



Rendi më i zakonshëm i fjalisë: Kry+Kall+ Kund+ Rreth.

Rendi i gjymtyrëve mund të ndryshojë për të krijuar ngarkesë emocionale

Përdoren dy pika: a) ndan dy fjali

- Në këtë fazë, nxënësit do të lexojnë materialin në tekst për fjalinë dëftore.
- Pyeten ata nëse kanë ndonjë gjë të paqartë.

Më pas nxënësit në fragmentet e tekstit *“REKLAMË PËR SHËRBIM POSTAR”*, zbulojnë

- fjalitë dëftore dhe analizojnë gjymtyrët përbërëse të saj.
- Diskutime nga nxënësit për fjali të veçanta.
- **Detyrat dhe puna e pavarur:**

Klasa ndahet në 4 grupe, për të punuar me një nga ushtrimet U.1- U.4; fq. 181

- Dy nxënës zhvillojnë në tab. ushtrimet 2 dhe 3
- Diskutohen ushtrimet në klasë.
- **Detyrë shtëpie:** Në 3 fjalitë më të gjata të tekstit të analizohen gjymtyrët kryesore dhe të dyta.

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me fjalitë dëftore</li> <li>• dallojnë tiparet e fjalive dëftore dhe funksionin e tyre</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen : <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit dhe debatit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes argumentit</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
<b>TEMA MËSIMORE 6.2 (7) RELAMA SI TEKST ARGUMENTUES FJALIA E PAPLOTË</b>		<b>Situata e të nxënimit Nr. 55</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi reklamën, duke përcaktuar llojin argumentues, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit dhe organizimit gjuhësor. Ata analizojnë fjalitë sipas kumtimit, duke u ndalur tek fjalia e paplotë.		
<b>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për reklamën, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të; analizon fjalitë e paplota për nga kumtimi dhe ndërtimi.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e reklamës, si dhe përdorimit të strukturës së fjalisë së paplotë në një reklamë.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënimit</b> Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënimit të dijeve të reja, në lidhje me fjalitë e paplota.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të një reklame, si dhe në ndërtimin për funksione të caktuara të fjalive të paplota.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. duke shfrytëzuar njohjen e reklamës si lloj argumentues.</li> </ul>				
<b>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës</b>			<b>Fjalët kyçe:</b>	
<b>mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me fjalitë e paplota dhe funksionet e saj;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së fjalive të paplota;</li> <li>• parafrazon pjesë nga tekste reklamash të ndryshme për nga struktura e fjalive ta paplota;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>			<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Reklamë</li> <li>■ Shërbim postar</li> <li>■ Imazh reklamues</li> <li>■ Fjali e paplotë</li> </ul>	
<b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; libri i nxënësit: fragment ("REKLAMË PËR		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>  <b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga reklama.		

<p>SHËRBIM POSTAR”); materiale nga interneti, apo media të tjera që lidhen me temën.  <b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst</p>	<p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës në një reklamë  <b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit të reklamës dhe përdorimit të fjalive të paplota në to.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lexim /diskutim</li> <li>• stuhi mendimi/ pema e mendjes</li> <li>• lexim teksti i orientuar</li> <li>• punë në grupe (praktikë e drejtuar)</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi fillon me detyrën e shtëpisë: nxënësit kanë analizuar fjalitë e tyre dhe i paraqesin në klasë.</li> <li>➤ Ndërkaq nxënësit e tjerë vlerësojnë, ndërhyjnë për të plotësuar, apo korrigjojnë arsyetimet e shokëve.</li> <li>➤ Shkruhet tema e mësimin në tabelë: <b>FJALIA E PAPLOTË.</b></li> <li>➤ Nxënësit ftohen të rikujtojnë njohuritë mbi fjalinë e paplotë. Në tabelë paraqitet skema</li> </ul> <div style="margin-top: 20px;"> <p style="text-align: center;"><b>FJALIA E PAPLOTË.</b></p> <p style="text-align: center;">Fjali që u mungojnë gjymtyrët kryesore</p> <p style="text-align: center;">Fjali të paplota të kontekstit ( kanë gjymtyrë të pashprehura të përmendura një herë më Parë)</p> <p style="text-align: center;">Fjali të paplota të situatës (gjymtyra që mungon kuptohet nga situata ligjërimore)</p> </div> <p>Ato janë më tepër karakteristike e tekstit rrëfyes – në rrëfimet në ligjëratë të drejtë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Në këtë fazë, nxënësit do të lexojnë materialin në tekst për fjalinë e paplotë.</li> </ul>	

- Pyeten ata nëse kanë ndonjë gjë të paqartë.
- Më pas nxënësit në fragmentet e tekstit “REKLAMË PËR SHËRBIM POSTAR”, zbulojnë fjalitë e paplota dhe analizojnë gjymtyrët përbërëse të saj.

- Diskutime nga nxënësit për fjali të veçanta.
- **Detyrat dhe puna e pavarur:**

Klasa ndahet në 3 grupe, për të punuar me një nga ushtrimet U.1- U.3; fq. 182

- Dy nxënës zhvillojnë në tabelë ushtrimet 2 dhe 3;
- Diskutohen ushtrimet në klasë.

- **Detyrë shtëpie:** Ndërtoni një tekst reklame ku të përdoren fjalitë e paplota.

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me fjalitë e paplota;</li> <li>• dallojnë tiparet e fjalive të paplota dhe funksionin e tyre.</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit dhe debatit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të shkruarit.</li> </ul>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Tematika: Bota përmes argumentit	Shkalla: V	Klasa: X
<b>TEMA MËSIMORE 6.2 (8)</b> <b>“DISIDENCA SHQIPTARE”</b> <b>ARDIAN KLOSI</b>		<b>Situata e të nxënit Nr. 56</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin, duke përcaktuar llojin argumentues, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit dhe organizimit gjuhësor të tij. Ai dallon teknikat e shkrimit argumentues përmes situatave në të cilat vendoset gjatë orës së mësimi.		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për llojin argumentues, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të; diskuton mbi tekstin konkret, duke analizuar dhe vlerësuar tiparet e tij</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e tekstit argumentues, ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura, arti dhe shkenca.</li> </ul>				

<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b> Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja, në lidhje me llojin argumentues.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të tekstit argumentues, kritikës së këtij lloji dhe ushtrimit në shkrime të këtij lloji.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. duke shfrytëzuar njohjen e llojit argumentues, që mbështet qëllimin e tij.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës</b></p> <p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me llojin e tekstit argumentues, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit argumentues konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda këtij konteksti, duke dalluar tekstin argumentues nga ai argumentues bindës;</li> <li>• parafrazon pjesë nga tekste argumentues (bindës ose jo)</li> <li>• përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin argumentues;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Tekst argumentues</li> <li>■ Disidencë</li> <li>■ Totalitarizëm</li> </ul> <p>FJALOR</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ tezë</li> <li>■ zyrtar</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; libri i nxënësit: fragment (“Disidencë shqiptare” - A.Klosi); materiale nga interneti apo media të tjera që lidhen me temën</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga “Disidencë shqiptare”.</p> <p><b>Letërsi:</b> përdor teknikat letrare të interpretimit të figurës dhe kuptimit të fjalës.</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit letrar dhe joletrar.</p> <p><b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p> <p><b>Histori:</b> nxënësi përdor njohuritë për periudha dhe personalitete të ndryshme historike për të analizuar dhe për të vlerësuar tekste e vepra të ndryshme letrare.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskutim mbi detyrën</li> <li>• vëzhgim/debat</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>



- praktikë e udhëhequr hap pas hapi
- lexim me ndalesa
- punë në grupe (praktikë e drejtuar)
- punë e pavarur (shkrim i lirë)

### Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:

- Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Mësuesi kërkon nga **2 nxënës** të lexojnë punimet e tyre. Ndërkaq nxënësit e tjerë vlerësojnë analizat e fjalive të paplota në tekstet e krijuara nga vetë nxënësit.
- Më pas mësuesi shkruan temën e mësimit në tabelë: **DISIDENCA SHQIPTARE**
- Nxënësit ftohen të vëzhgojnë foton në tekst, në fq.183 (ose foto të nxjerra nga interneti sipas modelit të tekstit)
- Pyetje: *Bëni një interpretim tuajin mbi foton.*

Nxënësit janë të lirë të sjellin interpretimet e tyre. (**Model:** Të gjitha interpretimet orientohen drejt idesë se pamja paraqet fuqinë e disidencës shqiptare)

- Arsyetimi nis me **titullin**.

Pyetje: *Arsyetoni mbi tiparet e titullit të këtij teksti? Çfarë prisni të sjellë autori në këtë shkrim? Nxënësit do të sjellin idetë e tyre.*

- Teksti lexohet në klasë me zë nga nxënës të ndryshëm dhe mësuesi ndërhyr herë pas here, për të sqaruar, komentuar, diskutuar, apo për të ndërtuar pyetje që lidhen më pjesët e veçanta të tekstit. Kjo mënyrë kërkon që nxënësit të parafrazojnë tekstin.
- **Ndalesa e parë:** lexohet paragrafi i parë dhe i dytë. Nxënësve u kërkohet të përcaktojnë raportin mes titullit dhe frazës së parë të tekstit.

Pyetje 1: *Cili është mendimi që shpaloset në paragrafin e parë?*

Pyetje 2: *A mund të dallojmë në këtë paragraf qëndrimin e autorit në raport me çështjen? Si e dallojmë këtë?*

Pyetje 3: *A mund ta konsiderojmë këtë pohim si tezë që kërkon të mbështesë autori i tekstit?*

- Kërkesë: *A mund t'i shënojmë me ngjyrë blu pohimet në mbështetje të tezës dhe me të kuqe ato që kundërshtojnë temën? (Nxënësit gjatë leximit nënvizojnë sipas orientimit)*

Pyetje 1: *Çfarë funksioni kryen pyetja retorike: Pse këto mospajtime? (Model: nxit kërksherinë e lexuesit, e bën atë pjesë të diskutimit të çështjes, sinjalizon një shpjegim pasardhës)*

Pyetje 2: *Çfarë qëndrimi mbështesin shpjegimet e paragrafit të dytë (Pohojnë apo mohojnë tezën)?*

- **Ndalesa e dytë:** Lexohen tre paragrafët e fragmentit. Nxënësit duhet të nënvizojnë sipas orientimit argumentet pro dhe kundër tezës .
- Kërkesë: *Nënvizoni me ngjyrë jeshile të gjitha referencat që mbështesin argumentet apo kundërarargumentet.*

Pyetje: *Ç'rol luajnë referencat e këtij paragrafi? Ç'ndikim kanë ato tek audienca?*

- **Ndalesa e tretë:** lexim i tre paragrafëve më tej. Nxënësit duhet të vijojnë me nënvizimet e bëra.

Pyetje : *Cilat janë shembujt, provat, referencat që vijnë në mbështetje të argumentit të ri? Si lidhen ato me tezën? Cilin argument të saj mbështesin ato?*

- Tani u lihet në dorë nxënësve arsyetimi. Klasa ndahet në dy grupe. Secili grup ka detyrat e tij.
  - **Grupi I:** gjatë leximit të fragmentit, duhet:
    - të vijojë më nënvizimet
    - të arsyetojë mbi mënyrën se si fillon secili paragraf.

Pyetje 1: *Gjeni foljet modale dhe tregoni rolin që ato luajnë në tekst.*

Pyetje 2: *Autori përsërit fjalë apo fraza kyçe. Amund t'i zbuloni ato dhe të nxirrni përfundime?*

- Kërkesë: Përpiquni të ngrini pikëpyetjet tuaja mbi tekstin dhe të ndërtoni pyetje për auditorin. (nxënësit duhet të ngrenë pyetje për klasën dhe të prezantojnë disa prej tyre.)

- **Grupi II:** gjatë leximit të fragmentit duhet:
  - të vijojë më nënvizimet
  - të arsyetojë mbi llojin e nëntitullit dhe funksionin e tij

Pyetje: 1. *Evidentoni lidhëzat e përdorura. Cili është roli i tyre në këtë tekst? (Lidhin pjesë fjalie, ide, paragrafë)*

Pyetje 2: *Cili është funksioni i paragrafit përmbyllës në raport me tezën dhe argumentet. A mund të shihet si paragraf përmbyllës ai? Pse?*

Pyetje 3: *Zbuloni në paragraf shembuj të gjuhës emotive dhe shpjegoni ngjyresat që fiton teksti. (P.sh: për të ndenjur duarkryq)*

Diskutohen përgjigjet e grupeve në klasë.

- **Detyrat dhe puna e pavarur:** Klasa ndahet në dy grupe.
  - **GRUPI I:** U.5, fq.186.
  - **GRUPI II:** U:12, fq. 186

➤ **Detyrë shtëpie:** U. 1; U.2; fq. 187 ( Rubrika: Të shkruarit)

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit argumentues dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin <i>DISIDENCA SHQIPTARE</i>;</li> <li>• shkruajnë drejt tezat, argumentet, referencat, duke zbatuar rregullat e</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja dhe mënyrën si i përcjellin ato;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit dhe debatit;</li> </ul>

drejtshkrimit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>
----------------	--


**TEMA MËSIMORE 7.1 (1) KARAKTERISTIKAT STRUKTURE, GJUHËSORE DHE STILISTIKE TË TEKSTEVE INFOPARAQITËSE. TEKNIKAT E SHKRIMIT TË TEKSTIT**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes informimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 60</b>			
<p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë karakteristikat e tekstit infoparaqitës, duke përcaktuar tiparet dhe llojin e tekstit. Ata ushtrohen në shkrimin e teksteve infoparaqitëse, duke zbatuar skemat e strukturave të tij.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>          Nxënësi bashkëbisedon për llojet e tekstit informues-paraqitës, duke veçuar disa karakteristika kryesore që lidhen me të</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b>          Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për këtë lloj teksti dhe ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi nga kultura, arti dhe shkenca etj.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b>          Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre në llojin infoparaqitës.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca personale</b>          Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit të teksteve, kritikës së teksteve.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b>          Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojeve infoparaqitëse</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca digjitale</b>          Nxënësi përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive të tij, që lidhen me tekstet infoparaqitëse.</p>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor strategjitë e duhura gjatë të folurit për të përmbushur qëllimin që ka dhe për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• Bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve infoparaqitëse, si dhe hulumton në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;</li> <li>• Përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të tekstit të llojeve të ndryshme dhe i kupton ato;</li> <li>• Shkruan tekste infoparaqitëse për qëllime personale dhe funksionale, duke zbatuar kriteret e domosdoshme për këtë lloj</li> <li>• Përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore dhe njohuritë gramatikore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>Tekst informues-paraqitës strukturë “përkufizim- shembull” “problem-zgjidhje” <b>FJALOR</b> Analitik sintetik</p>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, materiale të shtypit të shkruar, modele të tekstit infoparaqitës në të gjitha format e përfaqësimit, libri i nxënësit</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, <i>fleep-charter</i>, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> Nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga një tekst infoparaqitës.</p> <p><b>Letërsi:</b> Nxënësi përdor modele të gjuhës së shkrimeve të ndryshme dhe ngjyresave të fjalës në rrethana të caktuara.</p> <p><b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme të llojit infoparaqitës dhe për t’i prezantuar ato gjatë diskutimit.</p> <p><b>Qytetari:</b> Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• stuhi mendimi/skema rreze</li> <li>• INSERT/lexim i drejtuar</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• punë e pavarur</li> <li>• ditari dypjesësh</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>Për të siguruar përvijimin e mendimit, mësimi nis me një situatë bashkëbisedimi:</p> <p>➤ <i>U kërkohet nxënësve të thonë çfarë kanë ndjekur në lajmet në TV një natë më parë.</i> Nxënësit do të përgjigjen sipas mënyrës së tyre (<b>Model:</b> informacion mbi situatën e plazheve të bregdetit në pritje të turistëve). Pyeten disa nxënës për të dalë tek ideja e <b>informimit, informacionit.</b></p> <p>➤ Paraqiten imazhet në projektor (ose mësuesi ka të gatshëm artikuj gazetash, të cilat ua shpërndan nxënësve). Këto imazhe do të ndihmojnë nxënësit të kthejnë në vëmendje tekstin infoparaqitës.</p>	



- Rikthejuni njohurive që keni nga vitet e mëparshme mbi tekstin informues-paraqitës dhe kujtoni: Cili është funksioni dhe qëllimi i tij?  
Përmes përgjigjeve të nxënësve dhe komenteve të mësuesit, ndërtohet skema rreze e mëposhtme:



- Pyetje të tjera ndihmojnë të plotësohet edhe më skema e mësipërme, si:
- A mund të paraqesim disa tipe tekstesh infoparaqitëse? (Plotësohen të dhënat në skemë)
- A mund të kujtoni nëse të dhënat në një tekst të tillë vijnë në mënyrë të detajuar apo të përmbledhur?

[**Model:** Nëse nxënësve nuk iu vjen ndërmend përgjigjja, plotësohet tabela dhe shpjegohen termit “analitik” = të dhëna të detajuara (leksionet) dhe “sintetik” = të dhëna përmbledhëse (skedat biografike)]

- Nxënësit orientohen të lexojnë tekstin dhe përmes procedurës së INSERT-it kontrollojnë shkallën e të kuptuarit gjatë leximit.


**INSERT** - metodë që ju lejon të kontrolloni shkallën tuaj të të kuptuarit gjatë leximit.

V	+	-	?
	Përdorimi i një toni		Përfshirja e paragrafëve

**V** (kontrollo) = ajo që lexon pohon atë që dini ose mendoni se e dini.  
**+** (plus) = një pjesë e informacionit është e re për ju  
**-** (minus) = nëse kjo pjesë informacioni kundërshton ose është e ndryshme nga ajo që dini  
**?** (pikëpyetje) = nëse ka informacion të paqartë ose duhet të dini më shumë për të.

	autoritar		rrëfytes apo përshkrues
--	-----------	--	-------------------------

➤ Në këtë fazë paraqitet e plotë në tabelë organizuesi grafik i mëposhtëm:




➤ **Lexim i orientuar.** Një nxënës lexon fragmentin në tekst nga *Kongresi i Manastirit*. Gjatë leximit nxënësit duhet të kodojnë tekstin për të zbërthyer çështjet:


- Cila është teza e tekstit?
- Teksti është objektiv apo subjektiv?
- A është i qartë teksti?
- A ka detaje të panevojshme në këtë tekst?

➤ Skema e **parapërgatitur nga mësuesi** paraqitet në tabelë (me *fleep-charter* ose përmes projektorit, ndërkohë që nxënësit punojnë me tekstin):


- Grafiku i strukturës “shkak-pasoje”




- Grafiku i strukturës “problem-zgjidhje”



- Grafiku i strukturës **“krahasim – kontrast”** (ngjashmëri/ ndryshim)



- Grafiku i strukturës **“përkufizim-shembull”**



➤ Diskutime mbi skemat e mësipërme

Mësuesi duhet të ketë materiale që zhvillojnë këto skema të tekstit infoparaqitës, të cilat u jepen nxënësve, si modelet më poshtë.

Nxënësit duhet të analizojnë në grupe dyshe se cilës skemë strukturimi i takojnë tekstet. (analizat bëhen në paragrafë të veçantë të teksteve, pasi brenda teksteve gjenden lloje të ndryshme tekstesh për nga pikëpamja e strukturës)

1. Duke marrë për bazë sipërfaqen e caktuar nga Ministria e Punëve Botore, gjejmë se si dëndësia mesatare e popullsisë në Shqipëri është 36 frymë për çdo km katrorë. Kjo tregon se sa të varfër jemi në njerëz, domethënë në elementin që formon faktorin kryesor për çfrytëzimin intensiv të pasurive të shumta që na ka dhuruar natyra. Aq më tepër duhet të na vijë keq që këta pak njerës në një tokë kaq të gjerë e të begatëshme të mos mund të përmbushin nevojat e tyre në bukë kallamboqi...

Ndarja e popullsisë shqiptare në meshkuj dhe femra mbas regjistrimit të 1930-ës tregon një tepricë në favor të meshkujve. Kështu, të parët arrinin 521.780, domethënë 54% dhe të dytat 446.309, domethënë 46% të popullsisë. Nga kjo pikëpamje Shqipëria çquhet prej shumë shteteve të Evropës ku lufta çfarosi meshkujt dhe la një tepricë femrash. Por kjo nuk është për t'u çuditur mbasi shumë vise të tjera të botës, si për shëmbëll Kanada, Shtetet e Bashkuar, etj.

2. Në Keimbrixh, Masaçusets, ndodhej një shtypshkronjë, ku më 1704 u shtyp dhe gazeta e parë e suksesshme e Bostonit. Ajo u pasua nga disa të tjera, dhe jo vetëm në New England, por edhe në zona të tjera. Në New York liria e shtypit e kaloi provën e parë me Piter Zengerin, gazeta e të cilit "New York Weekly Journal", që filloi të botohet më 1733, ishte zëdhënësja e opozitës së qeverisë së atëhershme. Kaluan dy vjet dhe qeveria koloniale s'po i duronte dot më shigjetat e satirës së Zengerit, ndaj e akuzoi për shpifje dhe e futi në burg. Gjatë nëntë muajve të procesit të tij gjyqësor, Zengeri vazhdoi të botonte gazetën nga burgu, duke e bërë shumë të kërkuar në të gjitha kolonitë. Endru Hamilton, avokati i tij mbrojtës i mirënjohur, provoi vërtetësinë e akuzave të Zengerit. Pra akuza për shpifje nuk qëndronte. Trupi gjykues e nxori Zengerin të pafajshëm duke i dhënë lirinë. Ky vendim i rëndësishëm luajti rolin e vet në vendosjen e lirisë së shtypit në Amerikë.



<p>paraqesin një gjendje të përgjasëshme me t'onën.</p> <p>Në Shqipërinë t'onë ekonomikisht të pashvilluar dallimi ndërmjet qytetit e katundit nuk është ende mjaft i theksuar. Edhe në qytetet më të mëdhenj bujqësia nuk është çdukur. Prandaj ndarja e popullsisë në qytetas e katundarë do të jetë pak a shumë artificiale. Në kategorizimin t'onë po fusim në radhën e qyteteve ato grumbullime njerëzish që kanë përmbi 3000 frymë. Një përjashtim po e bëjmë për Sarandën, e cila me gjith që ka më pak se 3000 banorë, mund të kundrohet si një qytet.</p> <p>Pjesa aktive e gjith Shqipërisë kap gjithsej 309. 372 veta, prej tyre bujq e barinj janë 252.175 veta. Pjesa aktive e katundeve arrin 273.215 veta që bëjnë 33% të gjith popullsis së katundeve, kurse ndër qytetet kemi 36.157 veta që merren me punë produktive, këta përbëjnë vetëm 23 % të popullsis së qyteteve. Nga elementi produktiv i gjithë Shqipërisë 81% janë bujq e barinj. Këto shifra provojnë dy gjëra. E para që ne jemi një shtet ekskluzivisht bujqësor, gjë që e dinim edhe më parë. E dyta, që elementi aktiv i kolektivitetit shqiptar është katundari, kurse qytetet t'ona janë mbushur me parazitë, që janë një barë e kotë për pjesën produktive të këtij populli dhe një pengesë për shvillimin t'onë ekonomik.</p>	<p>Gjithë periudha e zhvillimit kolonial karakterizohet nga fakti që qeveria angleze asnjëherë nuk ushtroi ndonjë kontroll apo ndikim të ndjeshëm mbi kolonitë. Zhvillimi i tyre u la në dorë të rrethanave të krijuara. Qeveria angleze nuk mori pjesë drejtpërdrejt në krijimin e asnjë kolonie me përjashtim të asaj të Xhorxhias dhe u desh të kalonte njëfarë kohe derisa ajo gradualisht të shtinte në dorë drejtimin politik të vendit.</p> <p>Fakti që mbreti e la botën e re në dorë të shoqërive aksionare dhe pronarëve të mëdhenj nuk do të thoshte se kolonët e Amerikës do të kishin dorë të lirë për gjithçka edhe nga jashtë. Kartat e shoqërisë së Virxhinias dhe Masaçusets Belt i jepnin pushtet të plotë shoqërive në fjalë, qendra e të cilave duhej të ishte detyrimisht në Angli. Në këto kushte banorët e Amerikës s'mund të gëzonin më shumë të drejta për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit, edhe sikur Mbreti ta kishte ruajtur pushtetin absolut.</p>
---	---

### Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve u kërkohet të ndahen në 2 grupe:

- **Grupi I:** Do të analizojë strukturën e tekstit nga Kongresi Manastirit.

Tiparet e strukturës së paragrafëve	Fragmenti në tekst
Hyrja	
<p>Prezantim i përgjithshëm i çështjes. Ç'përfaqëson Kongresi i Manastirit për nga rëndësia (miratimi i alfabetit)? Parashtron problemin që ky kongres u mor edhe me <u>çështje të tjera të arsimit</u> (pra arsimit shqiptar kishte probleme që kërkonin zgjidhje). Zbulon faktin e takimit të fshehtë në një nga dhomat e kongresit.</p>	<p>Kongresi i Manastirit është kongresi ku u mor vendimi më i rëndësishëm për gjuhën shqipe, ai i miratimit të alfabetit të njësuar të gjuhës shqipe, prandaj shpesh quhet edhe Kongresi i Alfabetit. Por ky kongres kishte në plan edhe çështje të tjera të arsimit. Historianët përmendin një takim të fshehtë mes delegatëve, që u zhvillua në një nga dhomat e ndërtesës ku mbahej kongresi:</p>

Paragrafi I (zhvillues)	
Ofron zgjidhje për problemin e arsimit (mësimet në të gjitha shkollat duhej të zhvilloheshin në gjuhën shqipe, ndërsa turqishtja si gjuhë e perandorisë duhej të hynte në këto shkolla vetëm pas klasës së katër fillore) <u>Propozimi</u> për zgjidhje <b>erdhi</b> vjen nga ekspertë të fushës. (Shahin Kolonja)	Është fjala për një propozim që Shahin Kolonja kishte përgatitur për ta paraqitur në parlamentin osman. Sipas këtij propozimi, mësimet në të gjitha shkollat duhej të zhvilloheshin në gjuhën shqipe, ndërsa turqishtja, si gjuhë e perandorisë, duhej të hynte në këto shkolla vetëm pas klasës së katër fillore.
Paragrafi II (zhvillues)	
Fillon me situatën e financimit të shkollave nga shteti, me fakte e shifra nga kjo situatë. Ofrohet <u>propozimi</u> tjetër mbi ndarjen e fondeve të arsimit të lartë për studentët shqiptarë që arsimohen jashtë vendit.	Shkollat, si edhe më parë, financoheshin nga shteti (në prag të Kongresit të Manastirit në trojet shqiptare funksiononin vetëm 15 shkolla). Në propozim hidhej ideja e krijimit të shkollave të larta. Në buxhetin e perandorisë duhej të caktohej një fond vjetor për arsimimin e studentëve shqiptarë në Evropë ose në Amerikë, ku ata të përgatiteshin për të dhënë mësim në universitetet shqiptare.
Paragrafi III (zhvillues)	
Evidenton një problem dytësor që lidhet me problemin kryesor (ndërhyrjen e Italisë, Greqisë a Austrisë në çështje të arsimit). Ofron zgjidhjen për këtë problem (priftërinjtë katolikë e ortodoksë të paguheshin nga shteti osman).	Për të shmangur ndërhyrjen e Italisë, Greqisë a Austrisë në këto çështje, në mbledhjen e fshehtë në Manastir u propozua që priftërinjtë katolikë e ortodoksë të paguheshin nga shteti osman. Ky ishte një projekt që u ndikua nga entuziazmi që rilindasit provonin në prag të Kongresit të Manastirit.
Mbyllja	
Paraqet situatën e pandryshuar në lidhje me problemin dhe pohon se duhen vite për ndryshim, sikurse u deshën shumë vite për të rënë dakord për alfabetin	Propozimi që sot..... (deri në fund)

- **Grupi II:** Do të plotësojë ditarin dypjesësh për tiparet e tekstit në fjalë:

Çështjet për analizë	Tiparet e tekstit
Cili është problemi (dukuria) që trajtohet?	
Në ç marrëdhënie janë dukuritë me njëra-tjetrën?	Problemi kryesor është në marrëdhënie me problemet e tjera. (Problemi i arsimit shqiptar të kohës dhe ndërhyrjet e Italisë, Greqisë dhe Austrisë në këtë drejtim)

Cili është kuptimi (mesazhi) i tekstit?	Ndyshimet në arsimin shqiptar të kohës ishin të domosdoshme, por do të arriheshin përmes përpjekjeve për kapërcimin e pengesave nga shumë drejtime.
Cilin model organizues ka ndjekur autori?	Problem-zgjidhje
Ç' karakteristika përmbajtësore kanë paragrafët zhvillues?	Çdo paragraf përmban informacion të ri që lidhet me temën kryesore.
A bëhet fjalë për trajtim të paanshëm të çështjes?	
A ka detaje të panevojshme në tekst?	Paragrafi IV
A ka koherencë, qartësi, plotësi?	Informacioni është i qartë, i plotë dhe ndjek rrjedhën logjike.
Ç' lloj publiku i drejtohet?	I specializuar
Ç' lloj leksiku e karakterizon?	Leksik teknik, përdoret në shkencat e historisë
Cilat janë karakteristikat gjuhësore?	-Ka ndërthurje të foljeve në të tashmen me të shkuarën (shmanget në të shkuarën kur sjell fakte mbështetëse për tezën - <i>këtu ndërfiten elemente të rrëfimit</i> ) -përdoren lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore (por, sipas këtij, si edhe, ndërsa, ndoshta, ashtu si) -ka shumëllojshmëri fjalish dëftore, të thjeshta dhe të përbëra. Fjalitë e përbëra janë kryesisht me marrëdhënie përcaktore.
Ç' rol luan fotoja që paraprin tekstin?	Fotoja të shmang përmes ngacimit vizual në histori, prezanton. ( <i>komentojnë nxënësit për foton</i> ).

#### Detyrë shtëpie:

- Realizoni një tekst mbi avantazhet dhe disavantazhet e pushimeve në Theth dhe në Ksamil. Zgjidhni grafikun më të përshtatshëm për këtë qëllim dhe plotësojeni atë.

**Kujdes!** Nxënësit duhet të orientohen të shkruajnë sipas orientimeve të mëposhtme:

1. Shkruani në 5 paragrafë
2. Realizoni fazat e mëposhtme:
  - a. Parashikimi → - hedhje e materialit në letër  
- përzgjedhje e materialit nga interneti apo burime të tjera  
- përdorni një nga grafikët e strukturës
  - b. Draftimi (shestimi) → - përcaktoni fjalinë më të rëndësishme (tezën);  
- tri paragrafët e tjerë mbuljnë tri pika të ndryshme provash që zhvillojnë më tej tezën;  
- fjalitë e secilit paragraf ofrojnë fakte në mbështetje të tezës;  
- paragrafi përmbyllës përforcon tezën dhe provat mbështetëse.

<p>c. Rishikimi →</p> <p>d. Redaktimi →</p>	<p>- teksti duhet të paraqesë analizë të paanshme me fakte e shembuj;</p> <p>- infomacioni duhet të komunikohet qartë dhe në mënyrë efektive;</p> <p>- të shmangen detajet e panevojshme;</p> <p>- të zgjidhen fjalët dhe të ketë strukturë të larmishme fjalish;</p> <p>teksti shihet për gabime drejtshkrimore dhe për stilin e shkrimit.</p>
<b>Vlerësimi i situatës:</b>	<b>Vlerësimi i nxënësve:</b>
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përgjigjen saktë;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit dhe i zbërthejnë ato konkretisht;</li> <li>• shkruajnë saktë paragrafët, sipas orientimeve të mësuesit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

## TEMA MËSIMORE 7.1 (2) BUTRINTI, UNESKO.

### VEÇORITË E QYTETIT ANTIK

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika:</b> Bota përmes informimit			
<b>Situata e të nxënit nr. 61</b>			
<p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin, duke përcaktuar llojin infoparaqitës të tij, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit e të organizimit gjuhësor të tij.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>            Nxënësi bashkëbisedon për llojin infoparaqitës, duke veçuar karakteristikat kryesore të tij, përmes studimit të tekstit konkret.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b>            Nxënësi prezanton me gojë dhe me shkrim mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e tekstit, si dhe ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b>            Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave gjatë të nxënit të dijeve të reja, në lidhje me llojin infoparaqitës.</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca qytetare</b>            Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojit infoparaqitës, që mbështet qëllimin e tij..</p>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b>            Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me llojin</li> </ul>			<p>Fjalët kyçe:            Tekst informues – paraqitës</p>

<p>infoparaqitës, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së tekstit konkret, si dhe analizon e interpreton kuptimet që merr fjala brenda këtij konteksti;</li> <li>• Dallon elementin informues, shpjegues, rrëfyes, përshkrues në tekstin në studim;</li> <li>• Përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin infoparaqitës;</li> <li>• Shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	<p>Burime informacioni Unesco Trashëgimi kulturore <b>FJALOR</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■Pani</li> <li>■Kaoni</li> <li>■Enea</li> <li>■avanpost</li> <li>■Agrip</li> </ul>						
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit: fragment (“Veçoritë e qytetit antik”), materiale nga interneti apo media të tjera që lidhen me temën, <b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, postera <i>fleep-charter</i>, projektor.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Arte:</b> Nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga “Veçoritë e qytetit antik”. <b>Letërsi:</b> Nxënësi përdor teknikat letrare të interpretimit të kuptimit të fjalës, fjalorin e zgjedhur. <b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme tekstesh infoparaqitëse. <b>Qytetari:</b> Nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën. <b>Histori/Arkeologji:</b> Nxënësi përdor njohuritë për periudha të ndryshme historike dhe zhvillime arkeologjike për të analizuar dhe për të vlerësuar tekste të llojit informues-paraqitës në kohë.</p>						
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• lexim i drejtuar me ndalesa</li> <li>• lexim i drejtuar me ndalesa</li> <li>• diskutim</li> <li>• punë e pavarur</li> <li>• ditari dypjesësh</li> <li>• tabela e analizës gjuhësore</li> </ul>	<p><b>Koha: 45’</b></p>						
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Mësuesi kërkon nga <b>2 nxënës të lexojnë detyrën para klasës dhe të paraqesin në tabelë skemat e strukturës së punimeve të tyre, sipas modeleve të tekstit infoparaqitës.</b></li> <li>➤ Ndërkaq nxënësit e tjerë mbajnë shënime gjatë procesit të <u>dëgjimit</u>, për të <u>diskutuar</u> e më pas, për të <u>vlerësuar</u> punimet, duke iu referuar parametrevë të mëposhtëm.</li> </ul>							
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 70%;">Parametrat vlerësues</th> <th style="width: 30%;">Rezultatet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>• Organizimi i saktë i strukturës sipas njërit prej diagrameve në tekst.</td> <td style="text-align: center;">+    +</td> </tr> <tr> <td>• Tiparet informuese të tekstit.</td> <td style="text-align: center;">+    -</td> </tr> </tbody> </table>		Parametrat vlerësues	Rezultatet	• Organizimi i saktë i strukturës sipas njërit prej diagrameve në tekst.	+    +	• Tiparet informuese të tekstit.	+    -
Parametrat vlerësues	Rezultatet						
• Organizimi i saktë i strukturës sipas njërit prej diagrameve në tekst.	+    +						
• Tiparet informuese të tekstit.	+    -						

• Elementet rrëfyese/ përshkruese të tekstit.	+	-
• Ndjekja e logjikës së radhës së hapave të procesit (kohezioni).	+	-
• Raportet shkak-pasojë, kronologji, krahasim /kontrast, enumerative që krijohen në paragraf apo ndër paragrafë.	+	-
• Lloji i foljeve që përdoren; sinjalizuesit e ligjëritimit.	+	-
• Shumllojshmëria e fjalive dhe llojet e tyre.	+	-
• Stilin impersonal dhe respektimi i audiencës.	-	-
• Terminologjia e përdorur teknike.	-	-
• Referencat dhe vërtetësia e burimeve të informacionit.	+	+

➤ **Stuhi mendimi .**

Pyetje: 1. Ç'dini për Butrintin?Ku ndodhet ai?

2. Sa nga ju e kanë parë Butrintin?

(Nxënësit përgjigjen sipas njohurive të tyre)

3. Keni dëgjuar për UNESCON? Çfarë organizmi është ky?

4. Në ç'rrethana keni dëgjuar të flitet për të?

5. Cilat janë disa nga vendet që janë vendosur nën mbrojtjen e UNESCO në Shqipëri?

- Nxënësit mbështeten në përgjigjet e tyre përmes imazheve të mëposhtme, të cilat paraqiten në klasë, sipas mundësive (me projektor, foto, albume poster etj.)

UNESCO, the United Nations Educational, Scientific and Cultural Organisation, is a specialised agency of the United Nations system. The organisation was created more than a half century ago, with the mission to build the defences of peace in the minds of men. Its Constitution states that: "Since wars begin in the minds of men, it is in the minds of men that the defences of peace must be constructed". The Constitution was adopted by the London Conference in November 1945, and entered into effect on the 4th of November 1946 when 20 states had deposited instruments of acceptance.





UNESCO currently has 188 Member States (as of 31 December 2000). The main objective of UNESCO is to contribute to peace and security in the world by promoting collaboration among nations through education, science, culture and communication in order to further universal respect for justice and the rule of law and for the human rights and fundamental freedoms which are affirmed for the peoples of the world, without distinction of race, sex, language or religion.



- Përgjigjet renditen në tabelë në klasë.

➤ **Lexim i drejtuar me ndalesa:** Një nxënës lexon tekstin.

- **Ndalesa e parë (parag. I):**

1. *Komentoni paragrafin hyrës, cili është imazhi që ju krijohet për Butrintin?*

(**Model:** Butrinti përkufizohet si qytet me vlera të mëdha historike dhe trashëgimi kulturore që mbrohet nga UNESCO-ja. Paragrafi sjell përcaktimin e përgjithshëm për subjektin)

2. *Gjeni lidhëzat dhe shpjegoni a janë përdorur lidhëzat e duhura gjatë kalimit nga fjalia në fjali dhe nga paragrafi I në paragrafin II?*

(**Model:** Përdoret lidhëza shtuese “gjithashtu” brenda paragrafit, që përcakton marrëdhëniet shtuese nga fjalia në fjali. Lidhja me paragrafin e dytë sigurohet përmes parafjalës “sipas”, që tregon burimin nga vjen informacioni që lidhet me çështjen))

- **Ndalesa e dytë (parag.II):** *Kush është Virgjili, po Plutarku? Sa të besueshëm janë ata në përcaktimet e tyre? Ç’rol luan informacioni në këtë rast?*

(**Model:** Virgjili, autor i letërsisë romake të Antikitetit, krijuesi i poemës epike “Eneida” dhe i veprave të tjera “Bukoliket”, “Gjeorgjiket” etj.

Plutarku është historian grek dhe filozof gjithashtu. Vepra më e njohur e tij është “Jetë paralele”, ku sjell të dhëna mbi figura të shquara të antikitetit.

Informacionet e sjella nga ata janë të vetmet burime të cilat, pavarësisht se vishen me tisin e legjendës, mbeten shembujt më efikasë në mbështetjen e vlerave historike të Butrintit )

- **Ndalesa e tretë (parag. III) :** *Ç’informacion të ri sjell Ugolini? A e kundërshton kjo e dhënë informacionin e mëparshëm apo e plotëson atë? Cili nga informacionet mund të fitojë besueshmëri më të madhe? Pse?*

(Përgjigjet mund të jenë të ndryshme. Edhe qëndrimi në raport me besueshmërinë e të dhënave do të jetë personal. Diskutohet me nxënësit për mendimet e tyre, të cilat duhet të jenë të mbështetura)

- **Ndalesa e katërt (parag. IV):**

1. *Vini re, autori në rastin e këtij teksti nuk është një i vetëm, por një oraganizatë ndërkombëtare. Ç’rol luan ky fakt në vërtetësinë e informacionit? Si mbështetet në këtë paragraf vërtetësia e informacionit? Përcaktoni nëse informacioni vjen në mënyrë të paanshme ose jo.*

(**Model:** Ky fakt shton besueshmërinë dhe paanësinë në raport me problemin. Në paragraf përmendet “nga studiuesit, specialistë shqiptarë dhe të huaj”, përmenden mitet (memorja popullore), përcaktohen shekujt (VII dhe IV p.k ), përmenden luftërat që janë dokumentuar nga historia. Paanshmëria provohet në momentet kur pohohet që periudha mësjetare është e turbullt, gjë që nënkupton se merren në konsideratë ato të dhëna që janë vërtetuar.)

2. Shpjegoni kuptimet për fjalët: kep dhe qendër kulturi dedikuar Asklepit. Çfarë informacioni jep ky moment për mënyrën e jetesës së banorëve të vendit dhe për format e besimit shpirtëror? (Përgjigjet e nxënësve do të vijnë në formë diskutimesh)

• **Nadalesa e pestë (parag. V):**

1. Cilat janë provat që sjell ky paragraf që dëshmojnë se informacioni është komunikuar në mënyrë të qartë dhe efikase tek lexuesi?

(**Model:** Faktet e mbështetura me vite (1386, 400 vjet, 1537) e me emra vendesh e personalitetesh historikë, si: Republika e Venedikut, mbretërit anzhuinë, Ali Pashë Tepelena, Sulejmani i Madhërishtëm. Ka gjithashtu dëshmi objektesh e fortifikimesh të ndërtuara nga pushtuesit.)

2. Renditni ecurinë e ngjarjeve në zhvillimin e qytetit dhe zbuloni nëse ka nuanca të rrëfimit.

(Nxënësit do të renditin në fletoret e tyre sipas radhës në tekst të gjitha ngjarjet e sjella në paragraf.)

3. Shpjegoni kuptimin e fjalës “*avanpost*”? (**Model:** vend që ka epërsi mbi të tjerët)

• **Ndalesa e gjashtë (parag. VII):**

1. Cili është informacioni i kohëve të reja lidhur me Butrintin? A mund të nënvizojmë me të kuqe objektet e zbuluara, me blu mjediset dhe me të gjelbër botimet që solli kjo periudhë në mbështetje të tezës?

2. Zbatoni rregullin e 5 W për këtë paragraf (Who, Where, Why, When?What?)

• **Ndalesa e shtatë (parag. VIII-):** Vendosini një titull këtij paragrafi. Cilat nga llojet e drurëve të përmendura në këtë paragraf njihni? (Do të sillni informacione për to në orën e ardhshme)

• **Ndalesa e tetë (parag. IX):** A është ky paragraf tradicional në të cilin komunikohet vlera dhe kuptimi i tezës së trajtuar këtu?

(**Model:** Zakonisht paragrafët përmbyllës nuk sjellin informacion të ri. Në këtë rast vjen informacion i ri që lidhet me gjurmimet e vitit 1992 dhe zbulimet e reja në qendër të qytetit. Por, gjithsesi ky paragraf mbyll rrjedhën kronologjike të informacionit, duke përmbledhur materialet, dëshmi për vlerën e qytetit, dhe arsyen pse ky qytet është shpallur nga UNESCO-ja trashëgimi e njerëzimit. Duket se lihet e hapur vijimësia e zbulimeve në Butrint.)

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Klasa ndahet në 3 grupe:

**GRUPI I:** Karakteri shpjegues i tekstit kërkon që hartuesit e tij të përzgjedhin të dhënat e nevojshme për ta bërë atë sa më objektiv. Ndajini të dhënat në:

Të dhëna që lidhen me ngjarje historike;	1961- shpallet qytet-muze...
Të dhënat që lidhen me dëshmi të personaliteteve të së shkuarës;	Virgjili..... Plutarku ....
Të dhëna që vijnë nga burime mitologjike;	Legjenda e Panit.... Gojëdhëna e Helenit...
Të dhëna që sjell shkenca e historisë së vonë;	Ugolini--- Specialistë të arkeologjisë...
Të dhëna mbi pozicionin dhe organizimin e qytetit.	Vendndodhja, sipërfaqja....



**GRUPI II:** Analizoni tiparet e gjuhës dhe funksionin e tyre në tekst.

Mjetet gjuhësore dhe stilistike	Karakteristikat	Shembulli në tekst	Funksioni i tyre
<b>Foljet</b>	në të pakryerën dhe në të kryerën e thjeshtë të dëftores	u shpall, ishte	Vlera e konceptit përcaktohet nga vlerësime të së shkuarës.
<b>Mjete gjuhësore të tjera</b>	Mjete që tregojnë sekuenca kohore	në qershor 1961, në fund të viteve '30; së pari..., ndërkohë, atëherë	.....
	Mjete që tregojnë shkakun dhe pasojën (nëse ka)		
	Mjete që mundësojnë krahasimet (nëse ka)	.....	.....
	Mjete lidhëzore të tjera	gjithashtu, sipas....	
<b>Stili gjuhësor</b>	Fjali të shkurtra, të qarta e të sakta		
	Përdorim ndajfoljesh apo mbiemrash		
	Terminologjia teknike		
	Stil i figurshëm / ose jo		

**Detyrë shtëpie:** Shkruani mbi një nga ambientet e gjetura në Butrint, sipas kërkesës së U.4, fq. 206, duke pasur parasysh tabelën e mëposhtme të shkrimit infoparaqitës. Zgjidhni një nga skemat strukturore të tekstit infoparaqitës.

**Kujdes!** Nxënësit duhet të orientohen të shkruajnë sipas orientimeve të mëposhtme:


1. Shkruani në 5 paragrafë;
2. Realizoni fazat e mëposhtme:
  - e. Parashikimi → - hedhje e materialit në letër;
    - përzgjedhje e materialit nga interneti apo burime të tjera;
    - përdorni një nga grafikët e strukturës.
  - f. Draftimi (shestimi) → - përcaktoni fjalinë më të rëndësishme (tezën)
    - tri paragrafët e tjerë mbulojnë tri pika të

<p>g. Rishikimi →</p> <p>h. Redaktimi →</p>	<p>ndryshme provash që zhvillojnë më tej tezën;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- fjalitë e secilit paragraf ofrojnë fakte në mbështetje të tezës;</li> <li>- paragrafi përmbyllës përforcon tezën dhe provat mbështetëse.</li> </ul> <p>- teksti duhet të paraqesë analizë të paanshme me fakte e shembuj;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- infomacioni duhet të komunikohet qartë dhe në mënyrë efektive;</li> <li>- të shmangen detajet e panevojshme;</li> <li>- të zgjidhen fjalët dhe të ketë strukturë të larmishme fjalish.</li> </ul> <p>-teksti shihet për gabime drejtshkrimore dhe për stilin e shkrimit.</p>
Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit infoparaqitës dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin “ Veçoritë e qytetit antik”;</li> <li>• shkruajnë drejt tekste informuese, sipas orientimeve të mësuesit.</li> <li>• zbatojnë rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>- për mënyrën se si i përcjellin njohuritë e fituara;</li> <li>- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

**TEMA MËSIMORE 7.2 (1) BUTRINTI, UNESKO.**  
**GJYMTYRËT HOMOGJENE**

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Shkalla V</b>	<b>Klasa 10</b>
<b>Tematika: Bota përmes informimit</b>			
<b>Situata e të nxënit nr. 62</b>			
<p>Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me gjymtyrët homogjene, përdorimin e tyre në tekst dhe funksionin gjuhësor e stilistik të këtij përdorimi.</p>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></p> <p>Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjymtyrëve homogjene, në situata të ndryshme të komunikimit dhe shkrimit</p>			
<p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p>Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj), duke shfrytëzuar njohuritë gjuhësore që lidhen me përdorimin në fjali të gjymtyrëve homogjene.</p>			

<p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b> Nxënësi shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë , sipas qëllimeve që i cakton vetes.</p> <p>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi ilustron me shembuj para të tjerëve modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë, duke shfrytëzuar njohuritë mbi gjymtyrët homogjene.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b> Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të gjymtyrëve homogjene;</li> <li>• Zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit;</li> <li>• Ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për gjymtyrët homogjene dhe i aplikon ato në punët me shkrim</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> gjymtyrë homogjene përshtatja e përcaktorëve me gjymtyrët homogjene rregull i përgjithshëm/përrjasht im efekte stilistike</p>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe <b>Mjete:</b> <i>fleep-charter</i> (projektor), tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> <b>Letërsi:</b> Nxënësi përdor tekstet letrare për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes. <b>TIK:</b> Nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• imagjinatë e drejtuar</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• punë në grupe dyshe /ditar tripjesësh</li> <li>• DDM</li> <li>• punë e pavarur,</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Një nxënës lexon detyrën detyrën me temë: <i>“Shkruani mbi një nga ambientet e gjetura në Butrint”</i> Nxënësit e tjerë plotësojnë informacionin me materiale shtesë.</p> <p>➤ Paraqiten në tab. foto nga arkeologë shqiptarë që morën pjesë dhe drejtuan operacionet e gërmim-zbulimit (përkrah atyre të huaj) në Butrint. (materialet mund të kërkohen në IMK)</p>	



### **Bep Jubani**

U lind më 2 nëntor 1935 në një familje qytetare shkodrane dhe u nda nga jeta më 7 janar 2014. Profesor Bep Jubani ishte arkeolog i mirënjohur shqiptar.



Prof. SELIM ISLAMI

Profesor **Selim Islami** U lind më 18.3.1927, në Sarandë, dhe u nda nga jeta më 26.10.2001, në Tiranë. Ishte pikërisht njeriu kyç, që, së bashku me kolegë të tjerë, arkeologë shqiptarë e të huaj, luajti rolin kryesor në fazat sa delikate, aq edhe domethënëse për arkeologjinë shqiptare. Nëse sot mund të flasim për një histori të arkeologjisë shqiptare dhe të mendimit arkeologjik shqiptar, kjo i kushtohet shumë kontributit, personalitetit dhe përkushtimit të profesor Selim Islamit.



### **Dhimosten Budina**

(1930/ Korçë). Në vitet 1956, Budina pati temë doktorature studimin e Butrintit, ku vazhdoi punën e lënë nga Luigi Ugolini dhe Misioni Arkeologjik Italian në Butrint. Në vitin 1970 drejtoi dy projekte, në qytetin e Finiqit dhe Antigonesë. Gjatë vitit 1982, së bashku me Selim Islamit, drejtoi shkollën e gërmimit në Butrint. Më 1992 ai u largua në Moskë dhe kreu gërmime në Sheshin e Kuq. *“Gjatë gërmimeve gjithmonë përpiqem të ruaj çdo gjë, sidomos në gërmimin shumështrësor, megjithëse mund të mos jem i interesuar për ta studiuar në mënyrë të plotë atë. Hera e parë dhe e fundit kur dëmtuam një pjesë muri, ishte vetëm atëherë kur gjetëm statujën e parë gjatë gërmimit dhe nga emocioni e humbëtoruan....”*



### **Neritan Ceka,**

(Lindur më 11.2.1941, në Tiranë ), i biri i arkeologut **Hasan Ceka**, është anëtar i Këshillit Shkencor në Institutin e Arkeologjisë në Tiranë, Institutit të Arkeologjisë në Berlin etj. Në vitet 1963-1964 gërmoi në kështjellën ilire të Rosujës në Tropojë; në 1969 zbuloi varrin e pasur të Selcës së Poshtme dhe po atë vit filloi gërmimet disavjeçare në Belsh. Tërheqjen më të fortë e pati drejt qytetit të madh të Bylisit, ku drejtoi ekspeditat në vitet 1978-1991, duke zbuluar teatrin, stadiumin, shëtitoret, gjimnazin dhe disa nga hyrjet dhe kullat e fortifikimeve të qytetit ilir. Në vitet 1992-1994 drejtoi ekspeditën e përbashkët shqiptaro-franceze në Apolloni, si dhe gërmimet në Butrint, ku u rikthye përsëri dy vitet e fundit.

Pyetje 1: A keni dëgjuar për këta arkeologë? Ju mund të sillni edhe materiale të tjera më të plota për ta, si dhe për figura të tjera që kontribuan në fushën e arkeologjisë apo historisë së qytetit antik të Butrintit, por edhe më gjerë.

Pyetje 2: A mund t'i renditni arkeologët e mësipërm, sipas datës së lindjes? A mund të formoni një fjali ku të përfshihen sipas asaj renditjeje të gjitha këto personalitete?

(Model: Profesorët: Selim Islami, Dhimosten Budina, Bep Jubani dhe Neritan Ceka ishin arkeologët shqiptarë që përkrah atyre të huaj kontribuan në zbulimin e lavdisë së Butrintit)

- Fjalja shkruhet në tabelë. Mësuesi nënvizon emrat e arkeologëve dhe pyet nxënësit:

Pyetje3: Si i kemi ermërtuar nga pikëpamja gjuhësore gjymtyrë të fjalisë që renditen në këtë formë?

(Model: Gjymtyrë homogjene)

- U kërkohet nxënësve që në tekstin "Butrinti..." , të ndarë në **3 grupe (teksti gjithashtu ndahet në tri pjesë)**, të gjejnë shembujt e gjymtyrëve homogjene.


(Model: mbrojtësit të pyjeve dhe të luleve; lopa... e goditur, por jo e vrarë etj.

Të gjithë shembujt në tekst renditen në një rën anë të tabelës; në anën tjetër përgatitet kllasteri përmes metodës: **stuhi mendimi**.

1. Ç'funksion kryejnë në fjali?
2. Ç'raporte kuptimore ndërtojnë mes tyre?
3. Ç'lloj gjymtyrësh të fjalisë janë ato?
4. Ç'klasa fjalësh janë ato?
5. Si lidhen me njëra-tjetrën?)

- mbrojtësit të pyjeve dhe të luleve  
 - lopa... e goditur, por jo e vrarë  
 - për qëllime mbrojtjeje dhe kontrolli  
 - drurë me gjelbërim të përhershëm, si: dafina, pralli, ilqe, fishekarthe, kullastra...

përbushin të njëjtat funksione sintaksore, janë në të njëjtat raporte varësie me gjymtyrën drejtuese



- **Ditari tripjesësh.** Mësuesi ka përgatitur pyetjet në anën e majtë të tabelës më poshtë, ndërsa nxënësit do të plotësojnë ana e djathtë e tabelës, duke dhënë edhe ilustrimin përkatës. Ilustrimet nxirren nga teksti:

Pyetjet	Përgjigjet	Ilustrime
Cili është pozicioni i	Ato ndodhen gjithmonë	Në përbërjen e tij gjenden lloje

gjymtyrëve homogjene, nëse kemi përdorim të fjalëve që paralajmërojnë numrim të tyre (si, p.sh, këto)?	pas fjalëve që paralajmërojnë numërimin.	të shumta drurësh me gjelbërim të përhershëm, si: <i>dafina, prralli, ilqe, fishekarthi, kullastra, mimoza</i> etj.
Cili është rregulli i shkrimit të nyjes së gjinore, nëse gjymtyrët homogjene janë emra të rasës gjinore?	Nyja e përparme shkruhet vetëm para gjymtyrës së parë dhe <u>kjo tregon lidhjen e ngushtë mes gjymtyrëve</u>	Në qytet kishte marrë hov ndërtimi <i>i shtëpive, shkollave, rrugëve.</i>
Si shkruhen nga pikëpamja e shenjave të pikësimit, gjymtyrët homogjene që krijojnë mes tyre raporte kundërshtuese (veçuese)?	Gjymtyrët homogjene që lidhen mes tyre me lidhëza veçuese ose kundërshtuese, ndahen me presje, në dallim me ato që lidhen me lidhëza shtuese.	Lopa që do t'u flijohej perëndive, <i>e goditur, por jo e vrarë.....</i>  Që nga rruga nuk dalloheshin mirë <i>as shtëpitë e fshatarëve, as shkolla e re e fshatit.</i>
Gjatë renditjes së gjymtyrëve homogjene në fjali, në cilat raste përdoret pikëpresja?	Kur kemi të bëjmë me një numër të madh gjymtyrësh homogjene në fjali dhe lind nëvoja e pazave më të gjata, përdoret krahas presjes edhe pikëpresja.	Veprat më me vlerë që u zbuluan në teatrin e Butrintit, janë: <i>statuja e Apollonit, Perëndesha e Butrintit; disa koka mermeri, si ajo e Zeusit; portreti i Agripës; u zbuluan edhe....</i>
Cili është rregulli i drejtshkrimit për gjymtyrët homogjene që shoqërohen me pjesëza të (mohores, paskajores, përcjellores)?	Si rregull, pjesëzat përsëriten, por ka edhe raste kur për efekte stilistikore mund t'i ndeshim edhe pa to.	Ai u kishte lënë njëfarë kohe për të menduar e për të vepruar. Ai u kishte lënë njëfarë kohe për të menduar e vepruar.
Cili është rregulli i drejtshkrimit për gjymtyrët homogjene që përdoren me folje ndihmëse)?	Si rregull, folja ndihmëse përdoret përpara çdo gjymtyre, por ka edhe raste kur për efekte stilistikore mund t'i ndeshim edhe pa to.	.....
Nëse gjymtyrët homogjene shoqërohen me përcaktorë, si përshtaten këta të fundit me gjymtyrët homogjene?	Përcaktorët mbiemra ose përemra përshtaten në gjini dhe numër me gjymtyrët homogjene.	

➤ Në këtë fazë mësuesi fton nxënësit të rishikojnë tabelën dhe të ndërtojnë pyetje për të plotësuar tabelën sipas procedurës **DDM**

Di	Dua të di	Mësova
Nyja e përparme /ose parafjalët shkruhen vetëm para gjymtyrës së parë dhe kjo tregon lidhjen e ngushtë	Pse në disa raste përdoren nyjet ose parafjalët përpara secilës nga gjymtyrët homogjene?	Kur gjymtyra e fundit lidhet më gjymtyrën para saj me anë të lidhëzave, ajo përdoret: <i>..mbrojtësit të pyjeve dhe të luleve</i>



mes gjymtyrëve.		
Si rregull pjesëzat përsëriten, por ka edhe raste kur për efekte stilistikore mund t'i ndeshim edhe pa to.	Po kur gjymtyrët homogjene përdoren me parafjalë, si funksionon?	I njëjti rregull vlen edhe në rastet kur gjymtyrët homogjene përdoren me parafjalë: Qyteti u përfshi së pari në luftërat për pushtet <i>midis bizantinëve, më pas midis normanëve, anzhuinëve, venedikasve</i> dhe së dyti...
Nyja e përparme shkruhet vetëm para gjymtyrës së parë dhe <u>kjo tregon lidhjen e ngushtë mes gjymtyrëve</u>	Në cilat raste vendoset nyja e përparme në secilën prej gjymtyrëve homogjene?	E vendosim nyjën e përparme kur duam të theksojmë çdo gjymtyrë më vete Ai foli gjatë për jetën e prindërve, të vëllezërve, të të afërmeve të tij të dashur.
Përcaktorët mbiemra ose përemra përshtaten në gjini dhe numër me gjymtyrët homogjene.	Po nëse gjymtyrët homogjene kanë gjini apo numër të ndryshëm si përshtaten përcaktorët me to?	Përcaktorët marrin gjithnjë gjininë ose numrin e gjymtyrës më të afërt.  <i>Vajzat dhe djemtë e vegjël</i> ishin nisur për në shkollë

#### Detyrat dhe puna e pavarur:

- Klasa ndahet në tri grupe.
- Punohet me librin e nxënësit:  
U.2, fq.209 (grupi I)  
U.5, fq 209 (grupi II)  
U.3, fq. 209 (grupi III)

#### Detyrë shtëpie:

Realizoni një ese mbi qytetin antik të

Bylisit.

- *Grumbulloni dhe përzgjidhni materialin nga burime të ndryshme informacioni*
- *Zgjidhni ta sillni shkrimin tuaj në trajtën e një eseje: përshkruuese, argumentuese, udhëzuese, rrëfyese apo infoparaqitëse.*
- *Zbatoni të gjitha rregullat e shkrimit për llojin në të cilin keni zgjedhur të shkruani.*
- *Rilexoni dhe redaktoni shkrimin tuaj për të siguruar qartësinë, plotësinë dhe saktësinë e shkrimit tuaj.*

#### Kujdes!

**Nuk duhen ngatërruar gjymtyrët homogjene me fjalitë e bashkërenditura .**

Pyetje: *A janë gjymtyrët e nënvizuara në fjalinë e mëposhtme gjymtyrë homogjene?*

I shpëtoi nga duart dhe kaloi detin me not  
(**Model:** Nxënësit duhet t'i rikthehen përkufizimit të gjymtyrëve homogjene në skemën e parë dhe të pohojnë që këtu kemi të bëjmë me fjali të përbërë me lidhje bashkërenditëse.)

Vlerësimi i situatës:	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me gjymtyrët homogjene;</li> <li>• analizojnë rregullat e përdorimit ose jo të pjesëzave, nyjeve, parafjalëve, foljeve ndihmëse etj para gjymtyrëve homogjene;</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë në përgjigjet;</li> <li>• për mendimet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>
---	--

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes INFORMIMIT</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
<b>TEMA MËSIMORE 7.2 (3)</b> <b>LASHTËSIA E PËRRALLAVE</b> <b>DEJVID SHULC</b>		<b>Situata e të nxënit Nr. 64</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin, duke përcaktuar llojin info-paraqitës të tij, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit dhe organizimit gjuhësor të tij.		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për llojin info-paraqitës, duke veçuar karakteristikat kryesore të tekstit konkret.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e tekstit, si dhe ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b> Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave gjatë të nxënit të dijeve të reja, në lidhje me llojin info-paraqitës.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave mbështet avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit, kritikës së këtij lloji si dhe ushtrimit në shkrime të llojit info-paraqitës.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. duke shfrytëzuar njohjen e llojit info-paraqitës, që mbështet qëllimin e tij.</li> </ul>				
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me llojin info-paraqitës, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda këtij konteksti;</li> <li>• dallon elementin informues, shpjegues, rrëfyes, përshkrues në tekstin në studim;</li> </ul>			Fjalët kyçe:  Tekst informues –paraqitës Trashëgimi kulturore Krijimtari gojore  <b>FJALOR</b>  ■ evoluim	



<ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin info-paraqitës;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ korpus</li> <li>■ protoindoevropiane</li> <li>■ antropolog</li> <li>■ gjuhë indoevropiane</li> </ul>												
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit ;libri i nxënësit: fragment (“Lashtësia e përrallave”); materiale nga interneti, apo media të tjera që lidhen me temën.</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, postera fleep-charter, projektor.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga “Lashtësia e përrallave”</p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor teknikat letrare të interpretimit të kuptimit të fjalës, fjalorin e zgjedhur</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme tekstesh info-paraqitëse të llojit të mësipërm</p> <p><b>Qytetari:</b> përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>												
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• lexim i drejtuar</li> <li>• diskutim</li> <li>• punë e pavarur</li> <li>• ditari dypjesësh</li> <li>• tabela e analizës gjuhësore</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>												
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>													
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Mësuesi kërkon nga <b>2 nxënës të lexojnë detyrën para klasës dhe të paraqesin në tabelë skemat e strukturës</b> së punimeve të tyre, <u>sipas modeleve të tekstit info-paraqitës</u>.</li> <li>➤ Ndërkaq nxënësit e tjerë mbajnë shënime gjatë procesit të <u>dëgjimit</u>, për të <u>diskutuar</u> e më pas, për të <u>vlerësuar</u> punimet, duke iu referuar parametrave të mëposhtëm.</li> </ul>													
<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="225 1576 1172 1720">Parametrat vlerësues</th> <th colspan="2" data-bbox="1172 1576 1362 1720">Rezultatet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="225 1720 1172 1802"> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i saktë të strukturës sipas njërit prej diagrameve në tekst</li> </ul> </td> <td data-bbox="1172 1720 1232 1802">+</td> <td data-bbox="1232 1720 1362 1802">+</td> </tr> <tr> <td data-bbox="225 1802 1172 1875"> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tiparet informuese të tekstit</li> </ul> </td> <td data-bbox="1172 1802 1232 1875">+</td> <td data-bbox="1232 1802 1362 1875">-</td> </tr> <tr> <td data-bbox="225 1875 1172 1944"> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Elementët rrëfyes/ përshkrues të tekstit</li> </ul> </td> <td data-bbox="1172 1875 1232 1944">+</td> <td data-bbox="1232 1875 1362 1944">-</td> </tr> </tbody> </table>		Parametrat vlerësues	Rezultatet		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i saktë të strukturës sipas njërit prej diagrameve në tekst</li> </ul>	+	+	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tiparet informuese të tekstit</li> </ul>	+	-	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Elementët rrëfyes/ përshkrues të tekstit</li> </ul>	+	-
Parametrat vlerësues	Rezultatet												
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i saktë të strukturës sipas njërit prej diagrameve në tekst</li> </ul>	+	+											
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tiparet informuese të tekstit</li> </ul>	+	-											
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Elementët rrëfyes/ përshkrues të tekstit</li> </ul>	+	-											

• Ndjekjen e logjikës së radhës së hapave të procesit (kohezioni)	+	-
• Raportet shkak-pasojë, kronologji, krahasim /kontrast, enumerative që krijohen në paragraf apo ndër paragrafë	+	-
• Llojin e foljeve që përdoren; sinjalizuesit e ligjërit, ligjërit,	+	-
• Shumëllojshmëria e fjalive dhe llojet e tyre	+	-
• Stilin impersonal dhe respektimi i audiencës	-	-
• Terminologjia e përdorur teknike	-	-
• Referencat dhe vërtetësia e burimeve të informacionit	+	+

### Stuhi mendimi

Pyetje: 1. Ç'janë përrallat?

2. Pse ato klasifikohen si letërsi gojore?

(Nxënësit përgjigjen sipas njohurive të tyre)

3. Si mendoni ju, në ç'kohë janë krijuar ato?

5. Cilat janë disa prej përrallave që ju mbani mend që nga fëmijëria?

Nxënësit mbështeten në përgjigjet e tyre përmes imazheve, të cilat paraqiten në klasë, sipas mundësive (me projektor, foto, albume poster etj.)

- Nxënësit i kanë sjellë vetë foto-fabula, përralla për fëmijë dhe ilustrime për përrallat.
- Përgjigjet renditen në tabelë në klasë.

#### ➤ Lexim i drejtuar:

- Një nxënës lexon tekstin.
- Klasa është ndarë në 3 grupe; secili grup gjatë leximit, duhet të ketë parasysh që të zbulojë në tekst:
  - ✓ Grupi I: zulon tezën dhe dalloni faktet dhe opinionet ndër paragrafë; shpjegoni rolin që luajnë opinionet në një tekst info-paraqitës.
  - ✓ Grupi II: analizoni strukturën e tekstit; shpjegoni veçoritë e paragrafit hyrës dhe përmbyllës.
  - ✓ Grupi III: shpjegoni metodat e përdorura në këtë punë kërkimore.
    - Diskutime me nxënësit.

➤ **Detyrat dhe puna e pavarur:** Klasa ndahet në 2 grupe.

✓ **GRUPI I:** Karakteri shpjegues i tekstit kërkon që hartuesit e tij të përzgjedhin të dhënat e nevojshme për ta bërë atë sa më objektiv. Ndajini të dhënat si në tabelë:

Të dhëna që lidhen me studime shkencore	
Të dhënat që lidhen me dëshmi të personaliteteve të fushës	
Të dhëna që lidhen me metodologjitë e përdorura	

✓ **GRUPI II:** Analizoni tiparet e gjuhës dhe funksionin e tyre në tekst.

Mjetet gjuhësore dhe stilistike	Karakteristikat	Shembulli në tekst	Funksioni i tyre
<b>Foljet</b>	Në të pakryerën dhe në të kryerën e thejstë të dëftores		
<b>Mjete gjuhësore të tjera</b>	Mjete që tregojnë sekuenca kohore		
	Mjete që tregojnë shkakun dhe pasojën (nëse ka)		
	Mjete që mundësojnë krahasimet (nëse ka)	.....	.....
	Mjete lidhëzore	gjithashtu, sipas....	

	të tjera		
<b>Stili gjuhësor</b>	Fjali të shkurtra, të qarta e të sakta		
	Përdorim ndajfoljesh apo mbiemra		
	Terminologjia teknike		
	Stil i figurshëm / ose jo		

➤ **Detyrë shtëpie:** ushtrimi 5; fq.213

<b>Vlerësimi i situatës</b>	<b>Vlerësimi i nxënësve:</b>
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit info-paraqitës dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin “Lashtësia e përrallave”;</li> <li>• shkruajnë drejt tekste informuese, sipas orientimeve të mësuesit;</li> <li>• zbatojnë rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• mënyrën si i përcjellin njohuritë e fituara;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes informimit</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
<b>TEMA MËSIMORE 7.2 (4) LASHTËSIA E PËRRALLAVE; DEJVID SHULC. GJYMTYRËT E VEÇUARA USHTRIME</b>		<b>Situata e të nxënit Nr. 65</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me gjymtyrët e veçuara, përdorimin e tyre në tekst dhe funksionin gjuhësor e stilistik të këtij përdorimi.		

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

- **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.** Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjymtyrëve të veçuara, në situata të ndryshme të komunikimit dhe shkrimit.
- **Kompetenca e të menduarit.** Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj), duke shfrytëzuar njohuritë gjuhësore që lidhen me përdorimin në fjali të gjymtyrëve të veçuara.
- **Kompetenca e të nxënit.** Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë , sipas qëllimeve që i cakton vetes.
- **Kompetenca personale.** Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë, duke shfrytëzuar njohuritë mbi gjymtyrët e veçuara.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të gjymtyrëve të veçuara;</li> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit;</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për gjymtyrët e veçuara, dhe i aplikon ato në punët me shkrim.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>gjymtyrë të veçuara</p> <p>rregull i përgjithshëm/përrjashtim</p> <p>efekte stilistike</p>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> fleep-charter (projektor), tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes,</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• imagjinatë e drejtuar</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• punë në grupe dyshe /ditar trepjesësh</li> <li>• DDM</li> <li>• punë e pavarur,</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>

## Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:

- Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Një nxënës lexon detyrën dhe ngrihen diskutime e vlerësime mbi të.
- U kërkohet nxënësve që në tekstin “Lashtësia e përrallave”, të ndarë në **3 grupe (teksti gjithashtu ndahet në tri pjesë)**, të gjejnë shembujt e gjymtyrëve të veçuara.
- Përgatitet kllasteri përmes metodës: **stuhi mendimi**.
  6. Ç’funksion kryejnë në fjali?
  7. Ç’raporte kuptimore ndërtojnë mes tyre?
  8. Ç’lloj gjymtyrësh të fjalisë janë ato?

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Beni, <u>djali ynë më i vogël</u>, mbeti në shtëpi.</li> <li>- <u>Pa u ngutur</u>, kreu flokët para pasqyrës.</li> <li>- Populli, <u>me krijimet e veta poetike</u>, ndihmoi në fillimet e letërsisë së re.</li> <li>- Ata rrinin në heshtje, <u>të lodhur e të mërzhitur</u>.</li> </ul>	
--	--

- **Ditari tripjesësh.** Mësuesi ka përgatitur pyetjet në anën e majtë të tabelës më poshtë, ndërsa nxënësit do të plotësojnë ana e djathtë të tabelës, duke dhënë dhe ilustrimin përkatës. Ilustrimet nxirren nga teksti:

Pyetjet	Përgjigjet	Ilustrime
Cili është pozicioni i gjymtyrëve të veçuara?	Ato ndodhen para ose pas gjymtyrëve që plotësojnë.	
Cili është funksioni që kryejnë gjymtyrët e veçuara?		
Si shkruhen nga pikëpamja e shenjave të pikësimit, gjymtyrët e veçuara?	Gjymtyrët e veçuara ndahen me gjithmonë me presje.	
Gjatë renditjes së gjymtyrëve		

të veçuara në fjali, në cilat raste përdoret pikëpresja?		
Cili është rregulli i drejtshkrimit për gjymtyrët e veçuara që vijnë pas një përemri?		
<p>➤ <b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasa ndahet në tre grupe.</li> <li>• Punohet me librin e nxënësit: <b>U.1; U.2; U.3; fq.215</b></li> </ul> <p>➤ <b>Detyrë shtëpie:</b> Realizoni një tekst prej 20 rreshtash, ke të përdorni sa më shumë gjymtyrë të veçuara.</p>		
<b>Vlerësimi i situatës</b>	<b>Vlerësimi i nxënësve:</b>	
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me gjymtyrët e veçuara;</li> <li>• analizojnë rregullat e përdorimit të gjymtyrëve të veçuara;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë në përgjigjet;</li> <li>• për mendimet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>	

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes informimit</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
<b>TEMA MËSIMORE 7.2 (5) LASHTËSIA E PËRRALLAVE; DEJVID SHULC. (VLERËSIMI I PORTOFOLIT)</b>		<b>Situata e të nxënësve Nr. 66</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me gjymtyrët e veçuara, përdorimin e tyre në tekst dhe funksionin gjuhësor e stilistik të këtij përdorimi.		
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b>				

<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</b> Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjymtyrëve të veçuara, në situata të ndryshme të komunikimit dhe shkrimit.</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit.</b> Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj), duke shfrytëzuar njohuritë gjuhësore që lidhen me përdorimin në fjali të gjymtyrëve të veçuara.</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të nxënit.</b> Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë , sipas qëllimeve që i cakton vetes.</p> <p>➤ <b>Kompetenca personale.</b> Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë, duke shfrytëzuar njohuritë mbi gjymtyrët e veçuara.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor strategjitë para, gjatë dhe pas leximit dhe bën identifikimin e tipareve të gjymtyrëve të veçuara;</li> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit;</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për gjymtyrët e veçuara, dhe i aplikon ato në punët me shkrim.</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>gjymtyrë të veçuara</p> <p>rregull i përgjithshëm/përrjashtim</p> <p>efekte stilistike</p>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> fleep-charter (projektor), tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes,</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• imagjinatë e drejtuar</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• punë në grupe dyshe /ditar tripjesësh</li> <li>• DDM</li> <li>• punë e pavarur</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	



- Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Një nxënës lexon detyrën me temë
- Në këtë fazë ndahen në klasë tekste të përgatitura nga mësuesi për nxënësit.
- U kërkohet nxënësve që në tekstin e dhënë të ndarë në **3 grupe**, të gjejnë shembujt e gjymtyrëve të veçuara, sipas grupeve:
  - **Grupi I:** zbulon rrethanorët e veçuar
  - **Grupi II:** zbulon përcaktorët e veçuar
  - **Grupi III:** zbulon ndajshkrimet dhe kallëzuesoret e veçuar.
- **Ditari tripjesësh.** Mësuesi ka përgatitur tabelën që do të plotësohet në klasë:

Gjymtyra	Funksioni	Me se shprehet

- **Detyrat dhe puna e pavarur:**
  - Duke qenë se është ora e fundit e kontrollit të punimeve në portofol, secili nxënës njihet me rezultatet e Portofolit. Vlerësime pa përfshirë projektin përfundimtar.

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me gjymtyrët e veçuara;</li> <li>• analizojnë rregullat e përdorimit të gjymtyrëve të veçuara;</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore.</li> </ul>	Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime;</li> <li>• për saktësinë në përgjigjet;</li> <li>• për mendimet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të shkruarit.</li> </ul>

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes INFORMIMIT</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
<b>TEMA MËSIMORE 7.2 (7) “RECENSION I VONUËM” ARBEN NDRECA</b>		<b>Situata e të nxënit Nr.68</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin, duke përcaktuar llojin info-paraqitës të tij, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit dhe organizimit gjuhësor të tij.		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>				
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> Nxënësi bashkëbisedon për llojin info-paraqitës, duke veçuar karakteristikat kryesore të tekstit konkret.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të menduarit</b> Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e tekstit, si dhe ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi.</li> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit</b> Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave gjatë të nxënit të dijeve të reja, në lidhje me llojin info-paraqitës.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale</b> Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave mbështet avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit, kritikës së këtij lloji si dhe ushtrimit në shkrime të llojit info-paraqitës.</li> <li>➤ <b>Kompetenca qytetare</b> Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojit info-paraqitës, që mbështet qëllimin e tij.</li> </ul>				
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me llojin info-paraqitës, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda këtij konteksti;</li> <li>• dallon elementin informues, shpjegues, rrëfyes, përshkrues në tekstin në studim;</li> <li>• përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin info-paraqitës;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>			Tekst informues - paraqitës  <b>FJALOR</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ realizmi socialist</li> <li>■ rëndomtë</li> <li>■ rrafsh ideologjik</li> </ul>	
<b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; libri i nxënësit: fragment (“Recension i vonuem”); materiale nga interneti, apo media të tjera që		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b>  <b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga “Recension i vonuem”. <b>Letërsi:</b> nxënësi përdor teknikat letrare të interpretimit të		

<p>lidhen me temën</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, postera fleep-charter, projektor.</p>	<p>kuptimit të fjalës, fjalorin e zgjedhur.</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme tekstesh info-paraqitëse të llojit të mësipërm.</p> <p><b>Qytetari:</b> nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim i mendimit</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• lexim i drejtuar</li> <li>• diskutim</li> <li>• punë e pavarur</li> <li>• ditari dypjesësh</li> <li>• tabela e analizës gjuhësore</li> </ul>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<p>➤ <b>Stuhi mendimi</b></p> <p>Pyetje: 1. Ç'është <i>recension</i>?</p> <p>2. Keni lexuar <i>recensione</i>?</p> <p>(Nxënësit përgjigjen sipas njohurive të tyre)</p> <p>3. Si mendoni ju, ç'vlerë ka ai?</p> <p>➤ Nxënësit mbështeten në përgjigjet e tyre përmes imazheve,(imazhet lidhen me autorin në studim: Arben Ndrecën) të cilat paraqiten në klasë, sipas mundësive (me projektor, foto, albume poster etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgjigjet renditen në tabelë në klasë.</li> </ul> <p>➤ <b>Lexim i drejtuar:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një nxënës lexon tekstin.</li> <li>• Klasa është ndarë në 3 grupe; secili grup gjatë leximit, duhet të ketë parasysh që të zbulojë në tekst:</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Grupi I: zuloni tezën dhe dalloni faktet dhe opinionet ndër paragrafë; shpjegoni rolin që luajnë opinionet në një tekst info-paraqitës.</li> <li>✓ Grupi II: analizoni strukturën e tekstit; shpjegoni veçoritë e paragrafit hyrës dhe përmbyllës.</li> <li>✓ Grupi III: shpjegoni metosdat e përdorura në këtë punë kërkimore.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutime me nxënësit.</li> </ul> <p>➤ <b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b> Klasa ndahet në 2 grupe</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ <b>GRUPI I:</b> Karakteri shpjegues i tekstit kërkon që hartuesit e tij të përzgjedhin të dhënat e nevojshme për ta bërë atë sa më objektiv. Ndajini të dhënat si në tabelë:</li> </ul>	

Të dhëna që lidhen me studime shkencore	
Opinionet e autorit	
Të dhëna që lidhen me metodologjitë e përdorura	

✓ **GRUPI II:** *Analizoni tiparet e gjuhës dhe funksionin e tyre në tekst.*

Mjetet gjuhësore dhe stilistike	Karakteristikat	Shembulli në tekst	Funksioni i tyre
<b>Foljet</b>	Në të pakryerën dhe në të kryerën e thejstë të dëftores		
<b>Mjete gjuhësore të tjera</b>	Mjete që tregojnë sekuenca kohore		
	Mjete që tregojnë shkakun dhe pasojën (nëse ka)		
	Mjete që mundësojnë krahasimet (nëse ka)	.....	.....
	Mjete lidhëzore të tjera	gjithashtu, sipas....	
<b>Stili gjuhësor</b>	Fjali të shkurtra, të qarta e të sakta		

	Përdorim ndajfoljesh apo mbiemra		
	Terminologjia teknike		
	Stil i figurshëm/ ose jo		

➤ **Detyrë shtëpie:** Ushtrimi 7; fq. 220

Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm;</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit info-paraqitës dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin “Recension i vonuem”;</li> <li>• shkruajnë drejt tekste informuese, sipas orientimeve të mësuesit;</li> <li>• zbatojnë rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>• mënyrën si i përcjellin njohuritë e fituara</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Tematika: Bota përmes informimit	Shkalla: V	Klasa: X
<b>TEMA MËSIMORE 7.2 (8)</b> <b>RECENSION I VONUEM</b> <b>ARBEN NDRECA</b> <b>PËRDORIMI I SHENJAVE TË PIKËSIMIT</b>		<b>Situata e të nxënit Nr: 69</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë, për të zhvilluar njohuritë gjuhësore që lidhen me rregullat e drejtshkrimit, përdorimin e tyre në tekst dhe funksionin gjuhësor e stilistik të këtij përdorimi.		
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>				
<p>➤ <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</b> Nxënësi bashkëbisedon duke zbatuar rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit, në situata të ndryshme të komunikimit dhe shkrimit</p> <p>➤ <b>Kompetenca e të menduarit.</b> Nxënësi modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj), duke shfrytëzuar njohuritë gjuhësore që lidhen me përdorimin në fjali të</p>				

<p>rregullave të drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Kompetenca e të nxënit.</b> Nxënësi shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë , sipas qëllimeve që i cakton vetes.</li> <li>➤ <b>Kompetenca personale.</b> Nxënësi ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë, duke shfrytëzuar njohuritë mbi rregullat e drejtshkrimit.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës</b></p> <p><b>mësimore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore apo të pikësimit në shkrimet e tij dhe gjatë redaktimit</li> <li>• ndërton dhe zhvillon njohuri gjuhësore për rregullat e drejtshkrimit, dhe i aplikon ato në punët me shkrim</li> </ul>	<p><b>Fjalët kyçe:</b></p> <p>rregull i përgjithshëm/përjashtim</p> <p>efekte stilistike</p>
<p><b>Burimet:</b></p> <p>Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit, libri i nxënësit, enciklopedi, fjalori i gjuhës shqipe</p> <p><b>Mjete:</b> fleep-charter (projektor), tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësit, fragmenti në tekst.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Letërsi:</b> përdor tekstet letrare, për të studiuar pasurinë gjuhësore të shqipes,</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme, si dhe për të ndërtuar skema prezantimi.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përvijim imendimit</li> <li>• imagjinatë e drejtuar</li> <li>• stuhi mendimi</li> <li>• organizues grafik</li> <li>• punë në grupe dyshe /ditar tripjesësh</li> <li>• DDM</li> <li>• punë e pavarur,</li> </ul>	<p><b>Koha: 45'</b></p>
<p><b>Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:</b></p>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimi nis me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Një nxënës lexon detyrën detyrën dhe ngrihen diskutime e vlerësime mbi të.</li> <li>➤ U kërkohet nxënësve që në tekstin “<i>Recension i vonuar</i>”, të ndarë në <b>3 grupe (teksti gjithashtu ndahet në tri pjesë)</b>, të gjejnë shembuj nga shenjat e përdorura të pikësimit.</li> <li>➤ Përgatitet kllasteri përmes metodës: <b>stuhi mendimi</b>.</li> </ul>	

9. Ç'fshenja pikësimi njihni ju?

10. Ç'raporte kuptimore ndërtohen përmes përdorimit të tyre?


- Beni, djali ynë më i vogël, mbeti në shtëpi.

- Pa u ngutur, kreu flokët para pasyrës.

- Populli, me krijimet e veta poetike, ndihmoi në fillimet e leytërsisë së re.

- A rrinin ata në heshtje, të lodhur e të mëzitur?

- Mos e hap derën!



➤ **Ditari tripjesësh.** Mësuesi ka përgatitur pyetjet në anën e majtë të tabelës më poshtë, ndërsa nxënësit do të plotësojnë ana e djathtë të tabelës, duke dhënë dhe ilustrimin përkatës. Ilustrimet nxirren nga teksti:

Pyetjet	Përgjigjet	Ilustrime
Në cilat raste e përdorim pikën		
Në cilat raste përdoret pikëpresja		
Në cilat raste përdorim presjen		

Në cilat raste përdoret pikëçuditja		
Në cilat raste përdoret pikëpyetja.		
<p>➤ <b>Detyrat dhe puna e pavarur:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasa ndahet në tre grupe.</li> <li>• Punohet me librin e nxënësit: Ushtrimet: <b>12, 14, 15; fq. 219</b></li> </ul> <p>➤ <b>Detyrë shtëpie:</b> Realizoni një tekst prej 20 rreshtash, ku të përdorni të gjitha shenjat e pikësimit.</p>		
<b>Vlerësimi i situatës</b>		<b>Vlerësimi i nxënësve:</b>
Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me shenjat e pikësimit</li> <li>• analizojnë rregullat e përdorimit të tyre</li> <li>• shkruajnë saktë nga pikëpamja drejtshkrimore e gramatikore</li> </ul>		Nxënësit do të vlerësohen : <ul style="list-style-type: none"> <li>• për pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>• për saktësinë në përgjigjet</li> <li>• për mendimet e sjella në mbështetje të njohurive të reja</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të shkruarit.</li> </ul>

<b>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi</b>	<b>Lënda: Gjuhë shqipe</b>	<b>Tematika: Bota përmes INFORMIMIT</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: X</b>
<b>TEMA MËSIMORE 7.2 (9)</b> <b>RECENSION I VONUEM</b> <b>ARBEN NDRECA</b>		<b>Situata e të nxënit Nr. 70</b> Nxënësit lexojnë, flasin, dëgjojnë dhe shkruajnë mbi tekstin, duke përcaktuar llojin info-paraqitës të tij, tiparet e strukturës, teknikave të shkrimit dhe organizimit gjuhësor të tij.		



### Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe

- **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit** Nxënësi bashkëbisedon për llojin info-paraqitës, duke veçuar karakteristikat kryesore të tekstit konkret.
- **Kompetenca e të menduarit** Nxënësi prezanton, me gojë dhe me shkrim, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për realizimin e tekstit, si dhe ofron argumente për mbrojtjen e këtij klasifikimi.
- **Kompetenca e të nxënësve** Nxënësi demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave gjatë të nxënësve të dijeve të reja, në lidhje me llojin info-paraqitës.
- **Kompetenca personale** Nxënësi analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave mbështet avancimin personal në fushën e leximit, vlerësimit, kritikës së këtij lloji si dhe ushtrimin në shkrime të llojit info-paraqitës.
- **Kompetenca qytetare** Nxënësi diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj, duke shfrytëzuar njohjen e llojit info-paraqitës, që mbështet qëllimin e tij.

<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës</p> <p>mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme që lidhen me llojin info-paraqitës, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës;</li> <li>• bën identifikimin e tipareve të formës dhe përmbajtjes së tekstit konkret, si dhe analizon dhe interpreton kuptimet që merr fjala brenda këtij konteksti;</li> <li>• dallon elementin informues, shpjegues, rrëfyes, përshkrues në tekstin në studim;</li> <li>• përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin info-paraqitës;</li> <li>• shkruan saktë dhe pa gabime.</li> </ul>	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Tekst informues - paraqitës</p> <p>FJALOR</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ realizmi socialist</li> <li>■ rëndomtë</li> <li>■ rrafsh ideologjik</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b> Njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësve, libri i nxënësve: fragment (“Recension i vonuem”), materiale nga interneti, apo media të tjera që lidhen me temën</p> <p><b>Mjete:</b> tabela, shkumësa me ngjyra, mjete pune të nxënësve, postera fleep-charter, projektor.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b></p> <p><b>Arte:</b> nxënësi përdor elementet dhe parimet e artit për të shprehur emocionet e marra nga “Recension i vonuem”</p> <p><b>Letërsi:</b> nxënësi përdor teknikat letrare të interpretimit të kuptimit të fjalës, fjalorin e zgjedhur</p> <p><b>TIK:</b> nxënësi përdor internetin për të nxjerrë materiale të ndryshme tekstesh info-paraqitëse të llojit të mësipërm</p> <p><b>Qytetari:</b> nxënësi përdor njohuritë për etikën dhe normat e vlerat shoqërore, gjatë diskutimit për temën.</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p>	<p><b>Koha: 45 minuta</b></p>

- përvijim i mendimit
- pyetje – përgjigje
- punë e pavarur
- ditari dypjesësh
- tabela e analizës gjuhësore

**Veprimet e kryera për trajtimin e situatës:**

➤ Mësimi nis me detyrat e shtëpisë; lexohen disa prej detyrave.  
Pyetje- përgjigje. Ndërtohen disa pyetje rresht dhe nxënësit duhet të përgjigjen, sipas pyetjeve në rubrikën: Të kuptuarit dhe të folurit.

- Pyetje: 1, 3, 4, 5, 9, 17.
- Përgjigjet diskutohen me klasën.

➤ **Detyrat dhe puna e pavarur:** Klasa ndahet në 3 grupe.

- Secili grup do të studiojë strukturën e paragrafëve për njërin nga pjesët. Plotësohet për të tri grupet tabela:

Paragrafi	Tiparet (bërthama ideore)
Hyrja	
Paragrafi I zhvillues	
Paragrafi II zhvillues	
Paragrafi III zhvillues	
Mbyllja	

- Analizoni tiparet e gjuhës dhe funksionin e tyre në tekst.

Fjalët	Shpjegimi
Xeherorët	
Recencë	
Garda e vjetër	
➤ <b>Detyrë shtëpie:</b> Ushtrimi 2; fq. 220	
Vlerësimi i situatës	Vlerësimi i nxënësve:
<p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nxënësit u përgjigjen saktë pyetjeve që lidhen me tekstin e mësipërm</li> <li>• dallojnë tiparet e tekstit info-paraqitës dhe i zbërthejnë ato konkretisht në tekstin “Recension i vonuem”</li> <li>• shkruajnë drejt tekste informuese, sipas orientimeve të mësuesit</li> <li>• zbatojnë rregullat e drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit do të vlerësohen :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për saktësinë në pjesëmarrjen në diskutime</li> <li>• mënyrën si i përcjellin njohuritë e fituara</li> <li>• për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit</li> <li>• për realizimin e hapave të procesit të të shkruarit.</li> </ul>

## TEST TREMUJORI I

KLASA 10

Emri:

Terri u derdh, e një rrigë e praruar e rrezeve të hënës e leu kreshtën e malit, luginën dhe u ngrit poshtë, atje mbi syprinën e lëmuar të lumit që rimon buzët dredharake të fushës. Cdo gjë është e lidhur dhe shtrënguar mirë e mirë nga penjtë e qetësisë, nga penjtë e kësaj heshtjeje, e cila është e rëndë, e palëvizshme. Edhe qyqja hesht. As bulku nuk dëgjohej. Cdo gjë është struktur në vetvete, është mbyllur e kyçur në therrën e gjumit. E lart, atje lart nëpër hapësirën e kupës së qiellit, një yll noton duke lënë mbas vetes një hark të gjatë vezullues. Një klithmë u dëgjua! Korbi krrokati. E penjtë e qetësisë u prenë si me shpatë. Lisat e gjatë, që duken si fantazma të trishtueshme, shushuruan. Edhe qyqja kukati tri herë. As bulku nuk mbeti pa lëshuar zë. Kurse hëna ndali rigën e praruar të rrezeve të veta. Ajo u fsheh pas një reje me skaje të grisura. Nuk desh të shihte krimin, nuk desh të përlyhej nga pikat e gjakut që i lëshonte preja e korbit. Një hije, si hije vdekjeje, kaploi vendin.

- 
1. Materiali i mësipërm është më së shumti një tekst: **(1 pikë)**
    - A) përshkruet -objektiv;
    - B) përshkruet - bindës;
    - C) përshkruet - filozofik;
    - D) përshkruet - shprehës.
  
  2. Teksti i mësipërm e fiton karakterin përshkruet sepse: **(1 pikë)**
    - A) është tekst i llojit letrar;
    - B) përshkruet në mënyrë objektivo- emotive;
    - C) shpjegon përjetimet e personazhit;
    - D) është një kronikë nga e kaluara.
  
  3. Cila është struktura e tekstit të mësipërm për nga raportet e krijuara në paragraf? **(1 pikë)**
    - A) Struktura kronologjike;
    - B) Struktura e krahasimit dhe e kontrastit;
    - C) Struktura enumerative;
    - D) Struktura e problemit dhe e zgjidhjes;
  
  4. Gjenerali dhe shkruani nga dy detaje shqisore sipas renditjes më poshtë: **(3 pikë)**
    - A) detajet shqisore të të parit: \_\_\_\_\_

B) detaje shqisore të të dëgjuarit: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

C) detaje shqisore të prekjes: \_\_\_\_\_

5. Analizoni një nga teknikat e përshkrimit të përdorura në këtë tekst. **(3 pikë)**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

6. A kemi të dhëna për vetën e rrëfimit në këtë tekst? Çfarë do të fitonte dhe do të humbiste teksti nëse do të sillej në tri vetat e komunikimit? Ilustroni me shembuj nga fjalitë në tekst, duke ndryshuar vetën e shkrimit, pa dëmtuar kuptimin. **(4 pikë)**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

7. Gjeni :

A) dy nga burimet morfologjike të shprehësisë **(2 pikë)**

\_\_\_\_\_

B) dy nga burimet leksikore të shprehësisë **(2 pikë)**

\_\_\_\_\_

C) dy nga burimet sintaksore të shprehësisë **(2 pikë)**

\_\_\_\_\_

Shpjegoni funksionin e tyre:

\_\_\_\_\_

---

---

Mënyra më e zakonitë për të zbutur zemrat e atyre që kemi fyer e që duke pasur hakmarrjen në dorë, na mbajnë në mëshirë të tyre, është të dish t'i mallëngjesh duke iu drejtuar përdëllimës e shpirtbutësisë së tyre. Megjithatë, trimëria e qëndresa, mënyra gjithë të kundërta, kanë shërbyer herë-herë për të njëjtin qëllim.

Eduardi, princi i galëve, ai që qeverisi aq gjatë Gienën tonë, personazhi, kushtet dhe pasuria e të cilit kanë mjaft anë të dukshme madhështie, duke qenë fort i fyer nga Limosinët dhe duke e marrë qytetin e tyre me forcë, as që mund të ndalej prej thirrjeve të popullit dhe të grave e të fëmijëve të braktisur që ta ndalte kasaphanën; ata i kërkonin mëshirë edhe i luteshin para këmbëve. Por ai nuk u ndal, përveç se, duke shkuar më tej nëpër qytet, vuri re tre fisnikë frëng, që me guxim të pabesueshëm i bënë ballë të vetëm goditjes së ushtrisë së tij ngadhënjimtare. Vlerësimi dhe nderimi për një virtyt aq të shquar e zbuti kulmin e zemërimit të tij dhe, duke filluar qysh nga ata të tre, ai tregoi mëshirë për të gjithë banorët e tjerë të qytetit.

Skanderbeku, princ i Epirit, iu qep pas një ushtari nga të vetët për ta vrrarë; ky ushtar, pasi u përpoq me çdo lloj përulesie e lutje për ta qetësuar, më në fund vendosi që ta priste fundin e tij me shpatë në dorë. Kjo vendosmëri e tij e ndali në vend tërbimin e të zotit, i cili, duke e parë atë të merrte një qëndrim aq të nderuar, i dha faljen. Ky shembull do të mund të lejonte tjetër interpretim për ata që nuk do të kenë lëçitur dot mbi forcën dhe burrërinë e atij princi.

---

8. Plotësoni skemën e komunikimit.

(2 pikë)

**Konteksti**  
**Referenti**  
Dërguesi-----kanali-----Mesazhi-----kanali-----Marrësi  
**Kodi**

9. Zhvilloni kërkesat:

I. Renditni nga një shembull për secilën klasë fjalësh, marrë nga teksti i mësipërm.

(5 pikë)

_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____

II. Analizojini 3 nga fjalët e mësipërme nga pikëpamja morfologjike

(3 pikë)

---

---

---

10. Analizoni tekstin nga pikëpamja e llojeve të fjalive të përdorura në të (fjalitë të analizohen sipas kuptimit, kumtimit dhe ndërtimit)

(2 pikë)

---

---

---

---

---

---

---

11. Përshkruani në një paragraf të plotë një imazh të paharrueshëm të së kaluarës

(4 pikë)

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-13	14-19	20-24	25-28	29-32	33-35

**KLASA 10**  
**TEST TREMUJORI I**

**“SIKUR ZOTI TË MË FALTE PAKËZ JETË” – Gabriel Garsia Marquez**

Sikur të harronte Zoti për një çast se jam kukull prej lecke e sikur të më jepte një çikëz jetë, nuk do të thosha gjithçka mendoj, por do të mendoja për çdo gjë që them.

Do t'i vlerësoja gjërat jo për hir të vlerës së tyre, por për atë që duan të thonë.

Do të flija më pak, do të ëndërroja më shumë, pasi kam kuptuar se në çdo minutë që mbylлим sytë, humbasin gjashtëdhjetë sekonda dritë.

Do të ecja kur të tjerët stepen, do të zgjohesha kur të tjerët flenë, do të dëgjoja kur të tjerët flasin. Pale pastaj si do ta shijoja një akulllore me çokollatë!

Sikur Zoti të më falte pakëz jetë, do të zhytja me kokë në diell jo vetëm trupin, por edhe shpirtin.

Oh, Zot, sikur të kisha një zemër, do të shkruaja urrejtjen në akull dhe do të prisja të shfaqej dielli. Me një ëndërr të Van Gogut do të pikturoja mbi yje një poemë të Benedetit, ndërsa hënës do t'i shpalosja për serenatë një këngë të Seratit. Do t'i ujisja trëndafilat me lotët e mi, që të ndieja dhimbjen e gjembave dhe puthjen e kuqe të petaleve të tyre.

Imzot, po të kisha një çikëz jete...s' do të lija ditë pa u thënë njerëzve që dua, se i dua. Do ta bindja çdo grua e çdo burrë se ata kam për zemër dhe do të rroja i dashuruar me dashurinë. Do t'u dëfteja njerëzve ç'gabim të madh bëjnë tek pandehin se s'janë më të dashuruar, kur thyhen në moshë, sepse ata nuk e dinë se pikërisht kur s'janë më të dashuruar, thyhen në moshë!

Do t'i jepja fletë fëmijës, po do ta lija ta mësonte fluturimin vetë.

Të moshuarve do t'u mësoja se vdekja nuk vjen me moshën e shtyrë, por me harresën. Kaq gjë e mësova nga ju, o njerëz.

Mësova se gjithkush dëshiron të jetojë në majë të malit, pa e ditur se lumturia e vërtetë janë pragjet dhe burgjet e tij.

Mësova se, kur foshnja shtrëngon me grushtin e vet të njomë gishtin e të atit, e ka bërë për vete përgjithmonë.

Mësova se njeriu ka të drejtë ta shikojë tjetrin nga lart poshtë, vetëm atëherë kur tjetri ka nevojë të ngrihet në këmbë.

Mësova kaq e kaq gjëra nga ju, por e vërteta është që s'më bëjnë shumë dobi, sepse, kur t'i kem futur në këtë valixhe, do të jem duke vdekur.

- 
1. Përcaktoni qëllimin e këtij teksti, në përputhje me llojin dhe funksionin e tij. **(2 pikë)**

---

---

---

---

2. Përshkrimi në këtë tekst ka funksion:

**(1 pikë)**

- E) informues;  
F) shpjegues;




- G) bindës;  
H) mbështetës për rrëfimin.

**3. Plotësoni:**

**I.** Përmes këtij teksti autori sjell mesazhin se: **(1 pikë)**

- A) jeta e shkrimtarit dallon nga ajo e njeriut të zakonshëm,  
B) vetëm një pjesë njerëzish dinë ta jetojnë jetën,  
C) vlera e vërtetë e jetës zbulohet në momentet kur nuk e ke më,  
D) duhet jetuar çdo çast i jetës.

**II.** Ndërtoni skemën e komunikimit **(2 pikë)**



**4.** Informacioni mes paragrafëve renditet sipas kriterit: **(1 pikë)**

- A) enumerativ,  
B) shkak – pasojë,  
C) ngjashmëri – kundërshti,  
D) shpjegim dukurish.

**5.** Në paragrafët përmyllës të esesë kohezioni sigurohet përmes: **(1 pikë)**

- A) epiforës,  
B) sinonimeve,  
C) mjeteve lidhëse bashkërenditëse,  
D) rimarrjes.

**6.** Zbuloni dy karakteristika tipike të strukturës së këtij teksti **(2 pikë)**

Karakteristika I \_\_\_\_\_

Karakteristika II \_\_\_\_\_

**7.** Gjeni :

D) dy nga burimet morfologjike të shprehësisë **(2 pikë)**

\_\_\_\_\_

E) dy nga burimet leksikore të shprehësisë **(2 pikë)**

\_\_\_\_\_

F) dy nga burimet sintaksore të shprehësisë

**(2 pikë)**

\_\_\_\_\_

Shpjegoni funksionin e tyre:

---

---

---

---

---

8. Në ç'vetë realizohet rrëfimi në këtë tekst? Cili është funksioni i këtij rrëfimi? Çfarë do të fitonte dhe do të humbiste teksti nëse do të sillej në dy vetat e tjera. Ilustroni me shembuj duke ndryshuar vetën e shkrimit në të dy rastet.

**(4 pikë)**

---

---

---

---

---

---

---

---

9. Ç'janë klasat e fjalëve?

**(1 pikë)**

---

Renditni nga një shembull për secilën klasë fjalësh, marrë nga teksti i mësipërm.

**(5 pikë)**

<hr/>	<hr/>
<hr/>	<hr/>
<hr/>	<hr/>
<hr/>	<hr/>
<hr/>	<hr/>

10. Gjeni cila është mënyra dhe koha kryesore e foljeve në këtë tekst. Pse e përdor autori atë? Jepni dy shembuj ilustrues.

**(3 pikë)**

---

---

---

---

11. Zbuloni dy emra

**(2pikë)**

A. që formojnë shumësin me ndërrime tingujsh: \_\_\_\_\_

B. që janë emra të dygjinishëm: \_\_\_\_\_

12. Përshkruaj në një paragraf të plotë një ndjesi të paharrueshme që lidhet me një çast të trishtë të jetës sate . (

**4 pikë)**

-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----  
-----

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-13	14-19	20-24	25-28	29- 32	33-35

## TEST TREMUJORI I

KLASA 10

EMRI:

Kur nuk arrinte dot ta thithte atë aromë edhe vetë, duke mos e marrë vesh kurrë se cili dhe çfarë që në të vërtetë, atëherë në djall të vinin edhe bota, edhe vetvetja, edhe parfumi vetë! Dora që mbante shtrënguar flakonin, vinte erë mjaft e këndshme dhe, kur e afronte dorën te hunda dhe e nuhaste, atëherë e pushtonte melankolia, për ca sekonda harronte të ecte, ndalonte në vend dhe e nuhaste. "Askush s'e di se sa i mirë është në të vërtetë ky parfum,- mendoi. – Askush nuk e di se sa mirë është përgatitur . Të tjerët i nënshtroheshin vetëm efektit të tij, madje atyre as u shkonte mendja se ai që po i trullos dhe i magjeps, është një parfum. I vetmi që e ka njohur atë në bukurinë e tij të vërtetë jam vetëm unë, sepse e kam krijuar vetë me duart e mia. Por, njëkohësisht, unë jam i vetmi që nuk magjepsëm prej tij. Jam i vetmi për të cilin ai s'ka më kuptim. Po atëherë kur ndodhesha në Burgund? Kur po qëndroja matanë kopshtit ku lozte ajo vajza flokëkuqe dhe aroma e saj vinte si fllad...ose më saktë premtimi i aromës së saj, sepse aroma e saj e mëvonshme nuk ekzistonte më, mos vallë ajo që ndjeva atëherë, ishte e ngjashme me atë që ndjejnë njerëzit në sheshin e Grases, kur i përmbyta me parfumin tim...?"

---

12. Qëllimi i autorit është të: (1 pikë)

- E) të informojë dhe shpjegojë, për të thelluar njohuritë e marrësit që lidhen me teknologjinë e parfumerisë,
- F) të përshkruajë në funksion të një ngjarjeje që lidhet me të,
- G) të bindë përmes argumenteve për cilësinë e mirë të parfumit,
- H) të analizojë veçoritë e përbërjes së këtij parfumi.

13. Cila është struktura e tekstit të mësipërm për nga raportet e krijuara në paragraf? (1 pikë)

- E) Struktura kronologjike;
- F) Struktura e krahasimit dhe e kontrastit;
- G) Struktura enumerative;
- H) Struktura e problemit dhe e zgjidhjes.

14. Cilat janë dy nga veçoritë e këtij teksti, që i japin atij natyrë tregimtare? (2 pikë)

---

---

---

15. Gabimi drejtshkrimor në fjalinë e fundit lidhet me: (1 pikë)

- A) një folje;

- B) një mbiemër;
- C) një ndajfolje;
- D) një emër.

Shkruajeni saktë fjalën që është shkruar gabim.

(1 pikë)

Thoni nëse është gjymtyrë kryesore, apo gjymtyrë e dytë e fjalisë dhe a kryen funksionin e një detaji shqisor në këtë fjali?

(1 pikë)

16. Çfarë pjese e ligjëratës është në fjalinë e mëposhtme fjala e nënvizuar? *Askush s'e di se sa i mirë është në të vërtetë ky parfum,- mendoj.* Sillni një sinonim të saj, në përbërjen e të cilit të ketë një fjalë që i takon klasës së emrave, duke u kujdesur që të mos dëmtohet kuptimi i fjalisë.

(2 pikë)

17. Analizoni dy nga teknikat e përshkrimit të përdorura në këtë tekst.

(3 pikë)

18. Në ç'vetë realizohet rrëfimi në këtë tekst? Cili është funksioni i këtij rrëfimi? Çfarë do të fitonte dhe do të humbiste teksti nëse do të sillej në dy vetat e tjera. Ilustroni me shembuj duke ndryshuar vetën e shkrimit në të dy rastet.

(4 pikë)

19. Gjeni :

G) dy nga burimet morfologjike të shprehësisë

(2 pikë)

H) dy nga burimet leksikore të shprehësisë

(2 pikë)

I) dy nga burimet sintaksore të shprehësisë

(2 pikë)

Shpjegoni funksionin e tyre:

---

---

---

Disa nga kritikët e sotëm besojnë se Antigona është pikërisht kështu, një person jonormal. Edmund Uilson nuk ka asnjë dyshim për këtë. Për të Antigona është e çuditshme. Po ashtu, Uilter Agadi e konsideron Antigonen një personalitet jonormal. Sipas tij , ka diçka të dyshimtë në sjelljen e saj e, në veçanti , në urrejtjen për Kreontin. Kundërshtimi i saj ndaj tij vjen në fakt nga vetë antagonizmat e saj personalë. Po ashtu, për Agadin është i çuditshëm dhe raporti i saj me Hemonin: nga njëra anë ajo ankohet vazhdimisht se prej fatit të keq ajo do të vdesë e pamartuar, nga ana tjetër ajo nuk i referohet asnjëherë martesës me Hemonin. Sipas tij “ajo as nuk e merr në konsideratë këtë gjë”, duke mos iu referuar atij as edhe njëherë të vetme. Vërtet marrëdhënia mes Antigones dhe Hemonit është e çuditshme, por ajo duhet trajtuar me kujdes, sepse mënyra se si Agadi e konsideron marrëdhënien e saj më Hemonin duket të jetë spekulative. Agadi nisat nga fakti se Hemoni është gati të japë jetën për të dhe sërish ai nuk meriton as edhe një fjalë të vetme prej saj. Në këtë mënyrë Agadi arrin në konkluzionin se “asaj nuk i intereson Hemoni”

20. Plotësoni skemën e komunikimit.

(2 pikë)

**Konteksti**

**Referenti**

**Dërguesi-----kanali-----Mesazhi-----kanali-----Marrësi**

**Kodi**

21. Në fjalinë: *Kur po qëndroja matanë kopshtit*

*ku lozte ajo vajza flokëkuqe dhe aroma e saj*

*vinte si fllad... zbuloni në ç'klasë fjalësh*

bën pjesë fjala me të zeza.

Krijoni një fjali ku kjo fjalë t'i përkasë një

klase tjetër fjalësh.

(2 pikë)

---

---

---

22. Zhvilloni kërkesat:

III. Renditni nga një shembull për secilën klasë fjalësh, marrë nga teksti i mësipërm.

(5 pikë)

_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____

IV. Analizojini 3 nga fjalët nga pikëpamja morfologjike. Kujdesuni të sillni analiza nga mënyra të ndryshme fjalëformimi:

(3 pikë)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

23. Analizoni nga pikëpamja sintaksore tekstin (fjalitë, sipas kuptimit, ndërtimit dhe kumtimit)

(2 pikë)

-----

-----

-----

-----

-----

-----

24. Përshkruani në një paragraf të plotë një portret të pashlyeshëm në kujtesën tuaj.

(4 pikë)

-----

-----

-----

-----

-----

-----

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-13	14-19	20-25	26-30	31- 35	36-40

## POPULLI: EPI I GILGAMESHIT

## (KËNGA E DYMBËDHJETË)

*Lexoni me kujdes tekstin:*

Shkoi Gilgameshi n' madhen shkretëtirë,

deri te dera e botës nëntokësore.

Arrin te shtëpia e errët e Irkallës;

kah vendbanimi hapat i drejton.

Në të kush ka hyrë prapa s'është kthyer.

Niset në rrugë, në rrugën që s'ka kthim,

në vend ku njerëzve drita nuk u duhet;

pluhurin e kanë ushqim e baltën gjellë.

Dritën ata s'e shohin, n' terr qëndrojnë,

të veshur n' pendla, krahët si të zogjve.

Troket në der., i thotë derëtarit:

“Ma hap, ti, derën brenda që të hyj!

Në qoftë se derën ti nuk do ta hapësh,

unë do ta thej, shulin për ta copëtuar”

Të parën ia çeli derëtari.

Ia muer mantelin, e e shpuri n' shtatë dyer.

Pastaj të gjitha teshat ia zhveshi

që t'hyjë cullak n' parajsën e të vdekurve.

Hyjneshë Ereshkigalës madhështore

i del përpara duke i folur kështu:

“Lejoje Enkidujin, mikun tim,

t'kthehet, ta pyes për fatin e të vdekurve!”



Por roja e hyjneshës e mban t'vdekurin '

hyjnesha s'e lejon atë të hyjë.

Ereshkigala i thotë Gilgameshit:

"Kthehu prapa! T'vdekurin s'mund ta shohësh;

askush nuk të ka ftuar ty këtu".

Zë Gilgameshi ta thërrasë me guxim mikun.

Me zë të dridhur i përgjigjet hija.

Hap Gilgameshi gojën dhe i thotë:

"Më thuaj, mik, të lutem, pa më thuaj!

Kumtoma ligjin nëntokë që mbretëron!"

"Ta them këtë kurrqysh nuk mundem, mik.

Nëqoftëse ta kumtoj ligjin e nëntokës,

të cilin e kam parë unë këtu,

ti do t'plandosesh edhe do t'vajtosh".

„T'plandosem dua, të vajtoj përjetë“.

„Vështroje mikun që ti e pranove,

për të cilin zemra jote u gëzua,

e hanë krimbat si t'ish teshë e vjetër!

Mik Enkiduji, që dora jote e preku,

Sikurse baltë toke është bërë,

në pluhur është mbytur krejtësisht,

prandaj dhe pluhur tash ai është bërë“.

Më tej ta pyeste deshi Gilgameshi,

por hija e Enkidujit shpejt u zhduk.

Pa folur Gilgameshi prapa u kthye

n'qytet me mure t'larta, në Uruk.

Tempulli i malit t' shenjtë ngrihet lart.

Atëbotë n' gjumë bie Gilgameshi-

Vdekja e rrëmbeu n' pallat, n' sallën e

Ndritshme

---

*Përgjigjuni pyetjeve që vijojnë:*

1. Cili nga vargjet e sjell më mirë konfliktin e protagonistit? **(1 pikë)**
  - A) Kthehu prapa! T' vdekurin s' mund ta shohësh;/askush nuk të ka ftuar ty këtu"
  - B) "Më thuaj, mik, të lutem, pa më thuaj!/Kumtoma ligjin nëntokë që mbretëron!"
  - C) "Ma hap, ti, derën brenda që të hyj!/Në qoftë se derën ti nuk do ta hapësh,/unë do ta thej shulin për ta copëtuar"
  - D) Shkoi Gilgameshi n' t' madhen shkretëtirë,/deri te dera e botës nëntokësore.
  
2. Paragrafi hyrës i këtij fragmenti organizohet sipas teknikës: **(1 pikë)**
  - A) përshkrim i një rrethane kohore;
  - B) një fjali pohuese;
  - C) një përshkrim personazhi;
  - D) një fjali mbi një veprim të papritur.
  
3. Cili nga emrat e nënvizuar është emër i dygjinishëm? **(1 pikë)**
  - A) ...kah vendbanimi hapat i drejton.
  - B) Më thuaj, mik, të lutem, pa më thuaj....
  - C) Tempulli i malit t' shenjtë ngrihet lart.
  - D) ...por hija e Enkidujit shpejt u zhduk.
  
4. Në vargjet: *Nëqoftëse ta kumtoj ligjin e nëntokës,/të cilin e kam parë unë këtu,/ti do t'plandosesh edhe do t'vajtosh*, kuptimi i foljes së nënvizuar është: **(1 pikë)**
  - A) dridhesh;
  - B) qetësohesh;
  - C) përmbysesh;
  - D) habitesh.

Kjo folje është e llojit kalimtar apo jokalimtar? Pse?

**(1 pikë)**

---

5. Analizoni këtë tekst për nga përdorimi i kohëve të foljeve. Shpjegoni funksionin e kësaj përzierje kohësh, përmes shembujsh konkretë nga teksti. **2 pikë**

---

---

---

---

6. Strukturoni skenën e rrëfimit në këtë tekst (skena, prezantimi i personazheve.... Mbyllja) **(3 pikë)**

Skena: \_\_\_\_\_

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

7. Zbuloni dy forma të pashtjelluara foljore (të ndryshme nga njëra – tjetra) dhe shpjegoni funksionin që kryejnë ato në vargun nga ku i keni shkëputur. **(2 pikë)**

---

---

---

---

---

8. Zbuloni në këtë tekst një emër që përdoret vetëm në numrin njëjës, si dhe një emër që ka dy trajta shumësi. Përdorini ato në fjali në kontekste të ndryshme. **(4 pikë)**

---

---

---

---

---

---

---

---

9. Zbuloni një mbiemër të nyjshëm dhe një të panyjshëm në vargjet e tekstit.

A) Analizoni mbiemrat për nga lloji.

(2 pikë)

---

---

---

B) Mbiemrin e panyjshëm silleni në njëjës (ose shumës); mashkullore (ose femërore), sipas rastit.

(2 pikë)

---

---

C) Gjeni dy mbiemra të emëruar dhe sillini ato në rasën dhanore.

(2 pikë)

---

---

---

10. Në vargun: *Arrin te shtëpia e errët e Irkallës*, silleni të gjithë togun e nënvizuar në rasën rrjedhore, duke shpjeguar nga pikëpamja teorike ndryshimet që pësojnë nyjat e përparme.

(2 pikë)

**Shtëpia e errët e Irkallës:**

---

---

---

11. Në vargjet: “Më thua, mik, të lutem, pa më thua!Kumtoma ligjin nëntokë që mbretëron!”ktheni foljet në të tashmen dhe në më se të kryer të **mënyrës habitore.**, duke ruajtur vetën. Shkruajini të plota fjalitë: **(2 pikë)**

---



---



---



---



---



---



---

12. Realizoni një tekst udhëzues, ku të përcaktoni 8 rregulla që duhet të zbatojë Gilgameshi kur të hyjë në botën e të vdekurve. **(4 pikë)**

---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---

Pikët	0 – 6	7-10	11-14	15-18	19-22	23-26	27-30
notat	4	5	6	7	8	9	10

## MARIN BARLETI: HISTORIA E SKËNDERBEUT

## (LIBRI I TREMBËDHJETË)

Skënderbeu dha urdhër që të mblidheshin nga të katër anët ushtarët, me qëllim që, pasi të grumbullohej kështu një ushtri shumë e madhe, të nisej për të pushtuar qytetin e Valmëvet, që kish themeluar para pak kohe Mehmeti. Fati i keq veç, me pushtetin e vet të pamëshirshëm, e goditi me një sëmundje të rëndë dhe e largoi nga ajo fushatë. Në kohën kur ai e kish shëtitur me kalë tërë krahinën për të shikuar ushtrinë dhe kish arritur më në fund në Lisos, për të thirrur atje në mbledhje shokët dhe të konfederuarit, - sepse qytetin Lisos, që i bindej pushtetit venedikas, Skënderbeu e donte në mënyrë të veçantë, e zunë një palë ethe të rënda. Prandaj, duke ia patur përhera e më tepër frikën vetes, meqë sëmundja po keqësohej dita-ditës, dha urdhër që të mblidheshin gjithë shokët dhe princët që kishin ardhur tek ai, të deleguarit të venedikasvet, si edhe kapedanët dhe krerët e kampit të tij. Dhe të gjithëve u foli me mirësi kështu:

“Virtyti më i lartë dhe besa e vërtetë, o princër fort bujarë dhe ju, o bashkëluftëtarë të mij shumë të dashur, kujtoj se është së pari të adhurosh, të kesh kujdes dhe të nderosh si duhet, me shpirt të pastër e me frikë perëndie në zemër Zotin e madh e të vërtetë. Së dyti, jo vetëm ta duash dhe ta kesh gjithmonë para syvet atdheun dhe shtetin ku secili ka lindur dhe është edukuar, por edhe ta mbrosh e ta shpëtosh edhe me gjak. Këto, pa dyshim, të gjithë këto kurdoherë unë i kam patur për zemër dhe për to kam derdhur tërë zotësinë dhe jam përpjekur me mish e shpirt. Dëshmitarët më të mirë për këtë unë kam së pari Perëndinë dhe ju...”

Djalit iu drejtua kështu:

“...Këto janë, o drita ime, o biri im, porositë dhe mësimet që unë vetë kam mësuar nga prindi im, mësonjës i merituar, dhe nga këto mësimet kam mbetur gjithmonë i kënaqur... Prandaj këto tani të këshilloj me të madhe, të porosis dhe, po durove, të lutem si prind, si prind, them, të lutem e të lëshoj be që t’i mësosh edhe ti, t’i përqafosh, t’i thithësh, t’i ruash”.

Ndërsa Skënderbeu po thoshte këto fjalë, në qytet ia plasi një zhurmë tepër e madhe dhe potera e papritur, që erdh prej fushe që si lajmërim se turqit ia kishin mbërritur tanimë, se kishin përshkuar e djegur viset fqinje. Skënderbeu, kur dëgjoi, edhe pse lëngonte nga sëmundja e rëndë në shtrat, megjithatë nuk mundi të shtypte apo të frenonte atë vrullin e vet të dikurshëm e të pamposhtur, ato ndjenja të gjalla e luftarake. Duke u ngritur nga shtrati me gjymtyrë që i lëkundeshin e i dridheshin, po kërkonte armët dhe mburojën e vet dhe po jepte urdhër që t’i shalonin kalin. Kaq fort vlonte në atë gjoks të zjarrtë një zemër e zjarrtë. Por, meqë gjymtyrët e tij e humbën krejt fuqinë dhe gjallërinë e vet dhe po dridheshin të dobësuar, ra mbi shtrat dhe, pasi u kthye nga ushtarët, u tha këto fjalë: “Dilni, dilni ushtarë, kundër armiqvet e barbarëvet, shkoni përpara meje se po ju vij menjëherë pas”.

Barbarët, kur i panë, duke kujtuar se ishte atje Skënderbeu, lanë pjesën më të madhe të plaçkës dhe në një rrëmujë e dridhmë të madhe e të pafund, muarrë gjatë natës arratinë dhe ua mbathën përmes vendesh të ashpër e gati të pakalueshëm. Pra ishte muaji Janar dhe tokën të gjithë e kishin mbuluar barërat.

Kur e dëgjoi që po e qanin të vdekur, Lek Dukagjini, princ epirot, dolli me vrap në mes të pazarit dhe me fytyrë të pikëlluar e me zë të mbytur tha, duke çkukur mjekrën e flokët: "Mblidhuni, mblidhuni me vrap të gjithë, o princër sundimtarë arbërorë. Sot u bënë copë dyert e Epirit dhe të Maqedonisë, sot u rrëzuan muret dhe fortesat tona; sot fluturoi tërë forca dhe fuqia jonë; sot u përmbysën fronet e pushtetit tonë; sot u shua krejt sëbashku me këtë njeri çdo shpresë e jonë".

- 
13. Zëri i rrëfimitarit në paragrafin e fundit të tekstit: **(1 pikë)**  
E) zë i frikësuar;  
F) zë misterioz;  
G) zë i penduar;  
H) zë i trishtuar.
14. Paragrafi hyrës i këtij fragmenti organizohet sipas teknikës: **(1 pikë)**  
E) përshkrim i një rrethane vendore;  
F) një fjali mbi problemin;  
G) një përshkrim personazhi;  
H) një fjali mbi një veprim të papritur.
15. Cili nga emrat e mëposhtëm është emër i dygjinishëm? **(1 pikë)**  
E) Ndjenjë.  
F) Fron.  
G) Armik.  
H) Ushtri.
16. Cila nga fjalitë e mëposhtme e ka foljen kalimtare? **(1 pikë)**  
E) ...po kërkonte armët dhe mburojën e vet dhe po jepte urdhër që t'i shalonin kalin;  
F) ...të grumbullohej kështu një ushtri shumë e madhe, të nisej për të pushtuar qytetin e Valmëvet;  
G) ...sot u rrëzuan muret dhe fortesat tona; sot fluturoi tërë forca dhe fuqia jonë;  
H) Dilni, dilni ushtarë, kundër armiqvet e barbarëve, shkoni përpara meje se po ju vij menjëherë pas.
17. Zbuloni në këtë tekst një fragment ku teksti të fitojë tone udhëzuese. Shpjegoni mjetet gjuhësore që e bëjnë atë të tillë. **(2 pikë)**

---

---

---

---

18. Zbuloni perspektivën e rrëfimit në këtë tekst. Shpjegoni çfarë dimensionesh i jep veprës ky përdorim? **(2 pikë)**

---

---

---

---

---

19. Zbuloni:

A) dy forma të pashtjelluara foljore (të ndryshme nga njëra –tjetra) dhe shpjegoni funksionin që kryejnë ato në fjalinë nga ku i keni shkëputur. **(2 pikë)**

---

---

---

---

B) Zbuloni një folje të parregullt dhe silleni atë në formën veprorë dhe joveprorë, në pjesore, në të tashme dhe të kryer të thjeshtë dëftore.

**(3 pikë)**

---

20. Zbuloni në këtë tekst dy emra që përdoren vetëm në numrin shumës, si dhe dy emra që kanë dy trajta shumësi. Përdorini ato në fjali në kontekste të ndryshme.

**(4 pikë)**

---

---

---

---



---

---

---

---

21. Lexoni me kujdes paragrafin e dytë dhe zbuloni një mbiemër të nyjshëm dhe një të panyjshëm.

D) Analizoni mbiemrat për nga lloji. **(2 pikë)**

---

---

---

E) Mbiemrin e panyjshëm silleni në njëjës/shumës; mashkullore/femërore (sipas rastit) **(2 pikë)**

---

---

22. Togjet emërorë: **Virtyti më i lartë** dhe **besa e vërtetë**, sillini në rasën gjinore, duke shpjeguar nga pikëpamja teorike ndryshimet që pëson nyja e përparme. **(3 pikë)**

**Virtyti më i lartë**

---

---

**besa e vërtetë**

---

---

23. Në fjalinë: *Barbarët, duke kujtuar se ishte atje Skënderbeu, lanë pjesën më të madhe të plaçkës dhe në një rrëmujë e dridhmë të madhe e të pafund, muarrë gjatë natës arratinë dhe ua mbathën përmes vendesh të ashpër e gati të pakalueshëm, ktheni foljet në të pakryer dhe të kryer të mënyrës habitore. Shkruajini të plota fjalitë: **(2 pikë)***

---

---

---

---

---



## SHTËPIA Antonis Samarakis

Po ecte shpejt dhe pa vënë re gjë përreth. Në pëllëmbën e dorës së djathtë mbante shtënguar fort çelësin. Për pak sa s'e goditi një kamion që kaloi i ngarkuar deri në majë.

....

Si shkëlqente!

Me atë çelës pas pak do të hapte portën e lumturisë, mendoi. Iu duk letrare kjo ide. Gjykoi më thjesht : me këtë çelës do të hap derën e shtëpisë ku jetova vitet e fëmijërisë.

Përpara disa orësh kishte nënshkruar te noteri kontratën e blerjes së shtëpisë. Noteri, i gjatë, i dobët, e lexoi kontratën me një zë të ngadaltë që të cingëriste nervat.

Kishte katër vjet që priste çastin kur do të merrte në dorë çelësin. Rastësisht një mbrëmje para katër vjetësh kishte kaluar nga lagjja e vjetër. Kishte kohë pa kaluar andej. Qëndroi te cepi përballë shtëpisë së fëmijërisë. Një shtëpi e ulët njëkatëshe. Ndenji shumë. I bëri mirë ajo e parë e shtëpisë.

Kishte kaluar shumë vjet që nga koha që kishte qenë fëmijë.

Tani tëmthas i kishte gri. Dhe nuk kishte vetëm basetat gri. Bota e tij e brendshme ishte aq e ndryshme! Jeta e kishte ndryshuar. Me veçoritë dhe kompromiset e tij, me humbjet dhe konsumimin e përditshëm. Një varg zhgënjimesh ishte jeta e tij. Sidomos zhgënjime nga vetja...

Nuk mund të thoshte sa orë ndenji në shtëpi. Atje brenda e humbi sensin e kohës. Nuk hapi dritaret. i la të mbyllura siç ishin me grilat. Në errësirë ringjallen më lehtë të kaluarat.

Jashtë mbasditja shkonte drejt fundit, ndërsa ai tani ishte tjetër njeri. Ishte kthyer shumë vjet mbrapa, në kohët kur kishte qenë djalosh ezmer, me ëndrra për jetën, me ideale...

Dhomat nuk ishin të zhveshura nga mobilitet. Mobilitet e asaj kohe ishin akoma atje. Në sallonin e ngrënies, tryeza e madhe e rëndë, bufeja ku kacavirrej për të gjetur glikonë. Në sallon poltronat me mbulesën jeshile dhe perdet. Dhe në dhomën e tij tavolina e vogël ku bënte mësimet.

Ishte në dhomën e tij kur e thirrën nga jashtë. Ishin shokët e vet, që si çdo mbasditë kur dilnin nga shkolla, kishin ardhur ta thërrisnin për të luajtur...

Shkoi të hapte dritaren e dhomës së vet që binte nga rruga. Hapi xhamat, bëri të hapte grilën, por i mbeti dora te doreza. Nga të çarat e grilave i zuri syri një grua në trotuar, përpara dritares pak në të majtë.

I binte dielli. Mbeti atje me sytë ngritur nga grila. Nuk ia shikonte fytyrën. Po kishte trup të bukur. Ishte e gjatë dhe me trup të lidhur mirë. Dikë po priste. Përplaste me nervozizëm takat e këpucëve mbi pllakat e trotuarit.

Po e shikonte. i erdhi ai që priste. E mori për krahu dhe ikën. Atëherë u largua edhe ai nga dritarja. Por në kthim me ëndrrën e gruas brenda vetes tani kishte sensin e kohës, nuk ishte fëmijë, tëmthas i kishte gri, shtëpia tashmë ishte bosh, e zbrazur nga mobilitet e kohës kur ishte fëmijë, shtëpia tashmë ishte një shtëpi e zakonshme, një shtëpi çfarëdo. Hapi derën e jashtme, e la hapur dhe iku.

25. Zëri i rrëfimitarit në paragrafin e fundit të tekstit: (1

**pikë)**

- I) zë i frikësuar;
- J) zë misterioz;
- K) zë i penduar;
- L) zë i trishtuar.

26. Paragrafi hyrës i këtij fragmenti organizohet sipas teknikës: (1

**pikë)**

- I) përshkrim i një rrethane vendore;
- J) një fjali mbi problemin;
- K) një përshkrim personazhi;
- L) një fjali mbi një veprim të papritur.

27. Cili nga emrat e mëposhtëm është emër i dygjinishëm? (1

**pikë)**

- I) Çelës
- J) Vit
- K) Noter
- L) Diell

28. Cila nga fjalitë e mëposhtme e ka foljen jokalimtare? (1

**pikë)**

- I) Me atë çelës pas pak do të hapte portën e lumturisë, mendoj;
- J) Nga të çarat e grilave i zuri syri një grua në trotuar, përpara dritares pak në të majtë;
- K) Shkoi të hapte dritaren e dhomës së vet që binte nga rruga;
- L) Hapi xhamat, bëri të hapte grilën, por i mbeti dora te doreza.

29. Me cilën teknikë ligjërimi na drejtohet rrëfyesi? Interpretoni këtë zgjedhje të rrëfyesit.

**(2pikë)**

Teknika: \_\_\_\_\_

Interpretimi: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

30. Zbuloni perspektivën e rrëfimit (vetat) në këtë tekst. Shpjegoni çfarë karakteri i jep rrëfimit ky përdorim? (2

**pikë)**

\_\_\_\_\_

---

---

---

31. Shkëputni dy forma të pashtjelluara foljore nga teksti.

C) Shpjegoni funksionin që kryejnë në fjalinë nga ku i keni shkëputur, dy format e pashtjelluara foljore (të ndryshme nga njëra-tjetra).

**(2 pikë)**

---

---

---

---

D) Zbuloni një folje të parregullt dhe silleni atë në formën veprorë dhe joveprorë, në pjesore, pa ndryshuar kuptimin.

**(3pikë)**

---

32. Sillni në fjali (me kontekste të tjera), 1 emër të përdorur në këtë tekst : **(3 pikë)**

A) vetëm në numrin shumë:

---

---

---

B) vetëm në numrin njëjës:

---

---

---

C) që ka dy trajta shumësi:

---

---

---

33. Lexoni me kujdes paragrafin e pestë dhe zbuloni një mbiemër të nyjshëm cilësor dhe një marrëdhënior.

F) Analizoni mbiemrat për nga lloji se ç'funksion kanë.

**(2 pikë)**

---

---

---

G) Gjeni një mbiemër të panyjshëm dhe silleni atë në njëjës/shumës; mashkullore/femërore  
(sipas rastit) (2 pikë)

---

---

34. Togjet emërorë: Në **sallonin e ngrënies** dhe **tryeza e madhe e rëndë**, sillini në rasën gjinore, duke përshkruar (teorikisht) ndryshimet që pëson nyja e përparme. **(3 pikë)**

Në **sallonin e ngrënies**:

---

---

**tryeza e madhe e rëndë**:

---

---

35. Në fjalinë: *“Por në kthim me ëndrrën e gruas brenda vetes tani kishte sensin e kohës, nuk ishte fëmijë, tëmthat i kishte gri, shtëpia tashmë ishte bosh, e zbrazur nga mobiliat e kohës kur ishte fëmijë, shtëpia tashmë ishte një shtëpi e zakonshme, një shtëpi çfarëdo.”* ktheni foljet në të tashmen dhe të kryer të mënyrës habitore. Shkruajeni të plotë fjalinë. **(2 pikë)**

---

---

---

36. Realizoni një tekst udhëzues me 6 rregulla, ku t’i sugjeronit personazhin kryesor se si të sillej në shtëpinë e fëmijërisë së tij. **(3 pikë)**

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

<b>Pikët</b>	<b>0 – 6</b>	<b>7-10</b>	<b>11-14</b>	<b>15-18</b>	<b>19-22</b>	<b>23-26</b>	<b>27-30</b>
<b>notat</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>

## TEST GJUHE 10

### (TREMUIJORI 3)

#### T.ZAVALANI: Problemi demografik shqiptar (fragment)

Duke marrë për bazë sipërfaqen e caktuar nga Ministria e Punëve Botore, gjejmë si dendësia mesatare e popullsisë në Shqipëri është 36 frymë për çdo km katrorë. Kjo tregon se sa të varfër jemi në njerës, domethënë në elementin që formon faktorin kryesor për çfrytëzimin intensiv të pasurive të shumta që na ka dhuruar natyra. Aq më tepër duhet të na vijë keq që këta pak njerës në një tokë kaq të gjerë e të begatëshme të mos mund të përmbushin nevojat e tyre në bukë kallamboqi...

Ndarja e popullsisë shqiptare në meshkuj dhe femra mbas regjistrimit të 1930-ës tregon një tepricë në favor të meshkujve. Kështu të parët arrinin 521.780, domethënë 54% dhe të dytat 446.309, domethënë 46% të popullsisë. Nga kjo pikëpamje Shqipëria çquhet prej shumë shteteve të Evropës ku lufta çfarosi meshkujt dhe la një tepricë femrash. Por kjo nuk është për t'u çuditur mbasi shumë vise të tjera të botës, si për shëmbëll Kanada, Shtetet e Bashkuar, etj. paraqesin një gjendje të përgjasëshme me t'onën.

Në Shqipërinë t'onë ekonomikisht të pashvilluar dallimi ndërmjet qytetit e katundit nuk është ende mjaft i theksuar. Edhe në qytetet më të mëdhenj bujqësia nuk është çdukur. Prandaj ndarja e popullsisë në qytetas e katundarë do të jetë pak a shumë artificiale. Në kategorizimin t'onë po fusim në radhën e qyteteve ato grumbullime njerëzish që kanë përmbi 3000 frymë. Një përjashtim po e bëjmë për Sarandën, e cila me gjith që ka më pak se 3000 banorë, mund të kundrohët si një qytet.

Pjesa aktive e gjith Shqipërisë kap gjithsej 309.372 veta, prej tyre bujq e barinj janë 252.175 veta. Pjesa aktive e katundeve arrin 273.215 veta që bëjnë 33% të gjith popullsis së katundeve, kurse ndër qytetet kemi 36.157 veta që merren me punë produktive, këta përbëjnë vetëm 23 % të popullsis së qyteteve. Nga elementi produktiv i gjith Shqipërisë 81% janë bujq e barinj. Këto shifra provojnë dy gjëra. E para që ne jemi një shtet ekskluzivisht bujqësor, gjë që e dinim edhe më parë. E dyta, që elementi aktiv i kolektivitetit shqiptar është katundari, kurse qytetet t'ona janë mbushur me parazitë, që janë një barë e kotë për pjesën produktive të këtij populli dhe një pengesë për shvillimin t'onë ekonomik.

---

*Lexoni me kujdes tekstin dhe rrethoni alternativën e saktë për 7 pyetjet e para:*

1. Teksti i mësipërm është një tekst:

(1 pikë)

- A) informues - udhëzues
- B) informues - argumentues
- C) informues - përshkrues



- D) informues - shpjegues
2. Elementi që e bën titullin tipik të llojit përkatës është:  
(1 pikë)
- A) fakti që fjalia është e paplotë;  
B) mungesa e qëndrimit emocional të autorit;  
C) fakti që fjalia është emërore;  
D) mungesa e shenjave të pikësimit në fund të fjalisë
3. Sipas këtij studimi, një nga pengesat kryesore për zhvillimin ekonomik të vendit ishte:  
(1 pikë)
- A) dallimi thelbësor ndërmjet qytetit e katundit  
B) ndarja në meshkuj-femra, që tregon një tepricë në favor të meshkujve  
C) qytetet t'ona janë mbushur me parazitë,  
D) Saranda mund të kundrohet si një qytet
4. Sipas Zavalanit në këtë shkrim, njeriu është:  
(1 pikë)
- A) faktori kryesor për shfrytëzimin e burimeve natyrore  
B) pjesërisht faktor në shfrytëzimin e bukurive natyrore  
C) faktor i përkohshëm në zhvillimin ekonomik të vendit  
D) pengesë në zhvillimin e resurseve natyrore.
5. Cila nga fjalitë e mëposhtme përmban fjalë me shmangie nga norma gjuhësore?  
(1 pikë)
- A) të përmbushin nevojat e tyre në bukë kallamboqi...  
B) në një tokë kaq të gjerë e të begatshme  
C) grumbullime njerëzish që kanë përmbi 3000 frymë  
D) Një përjashtim po e bëjmë për Sarandën
6. Qëllimi i autorit të këtij teksti është: (1 pikë)
- A) të informojë mbi lëvizjet demografike në Shqipërinë e viteve '30  
B) të renditë të dhëna të sakta mbi raportet femra-meshkuj në vend  
C) të nxjerrë përfundim mbi shkaqet kryesore të gjendjes ekonomike të kohës  
D) të krahasojë Shqipërinë me vendet e tjera për nga pikëpamja demografike.
7. Renditni dy nga tiparet e gjuhës së këtij teksti që i japin atij karakteristikat e llojit përkatës. (2 pikë)

---

---

8. Shpjegoni si e siguron koherencën tekstuale Zavalani në këto rreshta. Ilustroni mendimin tuaj me shembuj nga teksti (të paktën dy shembuj).

**(4 pikë)**

---

---

---

9. Zbuloni dy shembuj që lidhen me njëri- tjetrin, nga të cilët njëri i jep tekstit karakter objektiv, tjetri subjektiv.

**(2 pikë)**

---

---

---

10. Sillni përmes një fjalie të plotë bërthamën e paragrafit të dytë në tekst.

**(3 pikë)**

---

---

11.

a) Analizoni gjymtyrët e veçuara në fjalinë e parë.

**(1 pikë)**

---

b) Zbuloni gjymtyrët homogjene në fjalinë: . *Aq më tepër duhet të na vijë keq që këta pak njerës në një tokë kaq të gjerë e të begatshme të mos mund të përmbushin nevojat e tyre në bukë kallamboqi...*

**(1 pikë)**

---

c) Me se janë shprehur ato? Bëni analizën morfologjike të fjalëve, sipas klasës përkatëse.

**(2 pikë)**

---

---

---

---

12. Në fjalinë: *Kjo tregon se sa të varfër jemi në njerës, domethënë në elementin që formon faktorin kryesor për çfrytëzimin intensiv të pasurive të shumta që na ka dhuruar natyra.*, çfarë janë fjalët e nënvizuara? **(2 pikë)**

*për:*

- a) parafjalë e kallëzores;
- b) pjesëz;
- c) lidhëz qëllimore;
- d) parafjalë e emërores.

*që:*

- a) pjesëz sqaruese;
- b) përemër lidhor;
- c) lidhëz fthilluese;
- d) lidhëz qëllimore.

13. Në fjalinë: *Kjo tregon se sa të varfër jemi në njerës, domethënë në elementin që formon faktorin kryesor për çfrytëzimin intensiv të pasurive të shumta që na ka dhuruar natyra.*, ktheni në numrin shumë fjalët me të zeza. **(2 pikë)**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

14. Fjalitë e marra nga teksti: *Këto shifra provojnë dy gjëra. E para që ne jemi një shtet ekskluzivisht bujqësor, gjë që e dinim edhe më parë. E dyta, që elementi aktiv i kolektivitetit shqiptar është katundari, kurse qytetet t'ona janë mbushur me parazitë, që janë një barë e kotë për pjesën produktive të këtij populli dhe një pengesë për shvillimin t'onë ekonomik.*, kthejini në një fjali të vetme, duke përdorur shenjat e duhura të pikësimit, pa dëmtuar kuptimin e fjalisë. **(1 pikë)**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

15. Gjeni gjymtyrët kryesore të fjalisë: *Në Shqipërinë t'onë ekonomisht të pashvilluar dallimi ndërmjet qytetit e katundit nuk është ende mjaft i theksuar.* Analizoni grupet e kryefjalës dhe kallëzuesit, si dhe përshtatjen mes tyre. **(3 pikë)**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

16. Planifikoni një tekst reklame, duke u mbështetur në këtë tekst. (Kujdes: planifikoni me kujdes të dhënat më të rëndësishme): **(6 pikë)**



**CIP Katalogu në botim BK Tiranë**

Gjuha shqipe 10: libër mësuesi / ;  
red. Aviola Kristo – Tiranë: Mediaprint, 2016  
f.; 207x284 cm

ISBN